

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Fakulteti Filozofik

Dega Histori

***„Lëvizja Popullore e Kosovës dhe Roli i saj në formimin
e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ”***

(Punim diplome për Master)

Mentori: Prof.Dr. Emine Bakalli

Kandidati: Metush Zenuni

Prishtinë, 2009

Përmbajta:

Hyrja

KAPITULLI I PARË

1. Formimit të LPK-së
2. Veprimtaria politike e LPRK-së (LRSSHJ-së), 1982 -1989
3. Mbledhja e Parë e Përgjithshme e LPRK-së
4. Mbledhja e Dytë e Përgjithshme e LPRK-së

KAPITULLI I DYTË

1. Veprimtaria e LPRK-së 1990 1993
2. Mbledhja e Tretë e Përgjithshme
3. Mbledhja Konsultative e LPRK-së
4. Mbledhja e Katërt e Përgjithshme
5. Programi i LPRK-së i vitit 1993

KAPITULLI I TRETË

1. Formimi i UÇK-së, 1993 1997
2. Fondi i UÇK-së „ Vendlindja Thërret”.
3. Roli i Gazetës „ Zëri i Kosovës” organ i LPK-së
4. Qëndrimi i LPK-së, ndaj Marrëveshtjes së Dejtonit

KAPITULLI I KATËRT

1. Qëndrimi i LPK-së për zhvillimet në Kosovë dhe Shqipëri 1996 – 1997
2. Qëndrimi i LPK-së, lidhur me Marrëveshjen, Rugova – Millosheviq
3. Qëndrimi i LPK për Ngjarjet e Marsit 1997 në Shqipëri
4. Zhvillimet politiko – ushtarake në Kosovë – 1996 -1997
5. Demonstratat e studentëve, 1 tetor 1997

KAPITULLI I PESTË

1. Dalja Publike e UÇK-së
2. Fillimi i luftës së armatosur (mars 1998)
3. Roli i LPK-së në luftën e UÇK-së 1998 -1999
 - 3.a. Qeveria e Bujar Bukoshit dhe „ FARK-u”
 - 3.b. Ekipi diplomatik i LPK-së
4. Qëndrimi i LPK-së për Marrëveshjes së Rambujesë
5. Shëndrrimi i LPK-së në Parti Politike Legale
 5. a. Mbledhja e Pestë e Përgjithshme e LPK-së
 - 5.b. LPK shëndrrohet në PBD

Përfundim

Burimet dhe literatura

Hyrje

Gjatë punës time studimore njëvjeçare lidhur me temën e Masterit „ **Lëvizjes Popullore e Kosovës dhe roli i saj në formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës** ‘’, jamë ballafaquar dhe mishëruar me këtë subjekt politik, duke pretenduar që njohuritë dhe dokumentacionin lidhur me LPK-në, e cila nga viti 1982 -1999 në Kosovë veprroi në ilegalitet të thellë, të jenë të dorës së parë, bindës dhe të denjë për një punim shkencor. Vështirësitë që kamë hasur në hulumtimin tim, lidhur me grumbullimin e burimeve dhe literaturës për punimin shkencor më kanë ofruar kënaqësinë njëkohësisht që të njoh më për së afërmi vetë subjektin në fjalë, por edhe të pasuroj fondin tim të dijes për një pjesë të Historisë së lavdishme më të re të popullit shqiptar.

Punimin e Temës „ Lëvizja Popullore e Kosovës dhe roli i saj në formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ‘’e kamë ndarë në pesë Kapituj, të cilët përbëjnë tërësinë e hulumtimit të punimit shkencor.

Organizata ilegale, LPK e formuar më 17 shkurt 1982, në Ankara të Turqisë nga dy grupeve të fshehta, Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi – LNÇKVSHJ dhe Partia Komuniste Marksiste Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi - PKMLSHJ, formuan Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi(LRSHJ), është vazhdimësi e lëvizjeve më të hershme ilegale e cila rrënjët e saj i ka në LRSSH-në, të cilën e udhëhiqte Adem Demaçi. LPK lindi në një kohë kur gati gjysma e botës ishte komuniste, si lëvizje alternative e cila kishte orientim politik të ngjajshëm me partinë në pushtet në Shtetin shqiptar, ndërsa ishte kundër sistemit administrativ Jugosllav dhe qëllim të fundit kishte bashkimin e Kosovës me shtetin Shqiptar.¹

Aktiviteti ilegal i LRSSHJ-së, e cila në vazhdimësi konform situatës dhe rrethanave politike u transformua në LRSHJ, pastaj në LPRK dhe në fund në LPK, vazhdoi në vitet 1982, 1984, e deri në vitin 1989, kur pas rrëzimit të Murit të Berlinit, edhe në Evropën Juglindore u bënë përpjekjet për shkatërrimin e sistemit Komunist në atë Demokratik. Nga Mbledhja e Tretë e Përgjithshme e LPRK-së, e cila u mbajt në tetor 1991, në Ujmir të Klinës, LPRK filloi të përgatitet konkretisht për luftë të armatosur, ngase politika pacifiste sipas saj ishte e dështuar.

¹ Shaban Sinani, Kosova në Gjeopolitikë, Tiranë 1998, f.36 – 37.

Në prill të vitit 1993, LPRK, në një Mbledhje Konsultative në fshatin Kollare, afër Kërçovës, me udhëheqës dhe aktivist të saj nga të gjitha territoret shqiptare në ish jugosllavi, deklaroi se „LPRK përkrah dhe mbështet grupet e armatosura në Kosovë”.² Ajo mori vendim që të bisedojë me këto grupe për unifikimin e aksioneve dhe të veprimtarisë në një grup të vetëm dhe në një emër të përbashkët. Më 28 -29 korrik 1993, në „Kodrën e Trimave” në Prishtinë, u mbajt Mbledhja e IV e Përgjithshme e LPRK-së. Mbledhja aprovoi ndryshimet programore dhe statutare, si dhe bëri ndryshimin e emrit të organizatës nga LPRK në LPK. Poashtu u mor vendim i rëndësishëm për afrimin e bërthamave të armatosura që i kishte krijuar LPRK dhe strukturimi i tyre, për kalimin në fazën e organizimit të luftës së armatosur.³ Në këtë mbledhje është zgjedhur Këshilli Drejtues dhe Kryesia e LPK-së dhe organet udhëheqëse të saj në Kosovë,⁴

Në programin e LPK-së të miratuar në Mbledhjen e 4 të përgjithshme, në nenin III të këtij programi thuhet: **“ Për arritjen e aspiratave kombëtare, LPK do të përdor të gjitha mjetet e luftës çlirimtare: demokratike, paqësore e politike dhe të rezistencës së armatosur“, pra LPK, si mjet për arritjen e qëllimit, parasheh, luftën e armatosur për çlirimin e Kosovës”.**⁵ Ideja për emërimin e ushtrisë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës – UÇK, është realizuar nga sektori i veçant i LPRK-së.⁶ Ndërtimi i njësiteve të para ushtarake, paraqiti nevojën para organeve udhëheqëse të LPK-së edhe detyrën e financimit të tyre. Fillimisht financimi i njësiteve ushtarake u bë nga financat e LPK-së, ndërsa fund të vitit 1993, LPK formoi Fondin „ Vendlindja Thërret“, i cili tanimë nuk i takonte vetëm LPK-së, por ishte në shërbim të luftëtarëve të lirisë dhe i zbatonte me përpikmëri kërkesat dhe urdhërat e SH.Q të UÇK-së.⁷

Rol të madh në propagandimin e luftës çlirimtare ka luajtur edhe gazeta „ Zëri i Kosovës“ e cila daton që nga viti 1973, si organ i Grupit Revolucionar të Kosovës. Nëpërmjet shkrimeve që botoheshin në të i bëhej apel popullit të mos i duronte padrejtësitë e shumta, sulmohej sistemi okupues jugosllav dhe udhëheqja më e lartë e tij⁸.

² Zëri i Kosovës, 1 maj 1993, fq. 3

³ Ramadan Avdiu, Epoka e Re, 24.2.2009.

⁴ Zëri i Kosovës, nr. 14, 1 shtator 1993, fq. 1

⁵ Zëri i Kosovës, nr. 15, 15 shtator, 1993, Programi i LPK-së, fq.4

⁶ Jakup Krasniqi, vepra e cituar, fq. 10 -11

⁷ Deklarata politike nr.18 e UÇK-së, 10 nëntor 1998, Prishtinë.

⁸ Po aty.

Pas Konferencës së Daytonit, më 1995, rënia heroike e tre themeluesve të UÇK-së, Zahir Pajazitit, Edmond Hoxhës dhe Hakif Zejnullahut, në janar të vitit 1997, aksionet e armatosura të njësiteve të UÇK-së gati në të gjitha pjesët e Kosovës, arrestimi i një pjese të udhëheqësve të UÇK-së, veçanarisht të Nait Hasanit më 28 janar 1997, pastaj ngjarjet e marsit të këtij viti në Shqipëri, protestat e studentëve më 1 tetor 1997, rënia heroike e Ardian Krasniqit, më 15 tetor 1997 dhe ngjarjet që rrodhën gjatë periudhës së dytë të vitit 1997, në Prishtinë, sollën një gjendje të re politike në Kosovë dhe Shqipëri, por ato e ndryshuan edhe gjendjen organizative dhe logjistike të UÇK-së.

Pak javë pas rënies së Ardian Krasniqit, më 28 nëntor 1997, në Llaushë të Skenderajt, u varros mësuesi i Halit Geci, i cili një ditë më herët ishte vrarë nga policia serbe, derisa po tërhiqeshin nga një betejë e humbur kundër UÇK-së. Në këtë varrim, në të cilin morën pjesë mbi 20.000 veta, tre ushtarë të UÇK-së: Rexhep Selimi, Mujë Krasniqi⁹ dhe Daut Haradinaj, zbresin nga malet e Drenicës dhe u thonë popullit të tubuar në varrim se „ ka dhe do të ketë UÇK, derisa të çlirohet Kosova nga Serbia" se „ Serbia po vret dhe po masakron shqiptarët dhe UÇK-ja është e vetmja forcë që lufton për çlirim dhe bashkim kombëtar“.

Dalja publike e UÇK-së ka qenë e veçantë, sepse mijëra qytetarë nga të gjitha vendet e Kosovës e pritën me duar hapur UÇK-në. Aty iu kthye besimi popullit se kësaj radhe është një forcë që do t'i dalë zot vendit. Edhe mesazhi ishte i qartë se ushtarët e UÇK-së janë të gatshëm të sakrifikohen për ta fituar lirinë.¹⁰ Janari i vitit 1998, solli me vete kumtin e fundit të paqes së rrejtshme në Kosovë, ndërsa në pranverën e hershme të vitit 1998, vatër e rezistencës dhe qëndresës heroike ishte prapë Drenica. Natën e 4 dhe 5 marsit 1998, forca të mëdha policore e ushtarake e kishin rrethuar Prekazin dhe lagjen e Jasharajve, ku sipas tyre, fshihej Adem Jashari me çetën e tij. Pushtuesi i kishte marrë të gjitha masat që të pengohej ndihma që mund t'u vinte nga të gjitha anët.

Ndonëse skajshmërisht të pabarabart, pas tri ditë e tri net luftimesh e rezistence të armatosur ranë heroikisht komandanti Adem Jashari dhe 55 dëshmorë të lirisë, prej tyre u flijuan edhe gra, fëmijë dhe pleq. Nga rrethimi kishte arritur të shpëtonte e gjallë vetëm Besartë Hamzë dhe Bashkim Rifat Jashari.¹¹

⁹ Mujë Krasniqi – Kapuqi, ish bashkëluftëtar i Adem Jasharit, njëri nga themeluesit e UÇK-së, tani dëshmor i kombit.

¹⁰ Intervistë e z.Daut Haradinaj, Epoka e Re, 27 nëntor 2006

¹¹ Emine Halimi, Ajnishahe Shala, Histori e një qëndrese, k.k. Skenderaj, 2000, fq. 27 -36.

Lufta heroike e Jasharajve pushtoi të gjitha mediat dhe vuri në lëvizje politikën botërore. Më 9 mars Grupi i Kontaktit miratoi një deklaratë për Kosovën e cila denonte Beogradin dhe e paralajmëronte se do të merren masa shtrënguese nga tyre.¹² Më 11 mars 1998, të gjithë të rënët në Prekaz u varrosën. Pas ngjarjes së Prekazit, në një takim me Kryetarin e Serbisë, Slobodan Millosheviq, në Beograd, Robert Gillbard i kishte thënë atij se „ duke sulmuar popullsinë civile, në përpjekjet e tij për ta eliminuar UÇK-në, ai në të vërtetë po shëndërrohej në agjentin e UÇK-së për rekrutim“.¹³

Pas fillimit të luftës së armatosur në Kosovë, LPK brenda vendit shkriu aktivitetin e saj në kuadër të UÇK-së, ndërsa jashtë vendit në shtetet perëndimore dhe SHBA, aktiviteti i saj ishte në propagandimin e luftës së drejtë të UÇK-së dhe të Fondit të saj „Vendlindja Thërret“. Me fillimin e bisedimeve për Kosovën më 06 shkurt 1999, në Rambuje, LPK, kishte kërkuar nga anëtarët e saj dhe të delegacionit shqiptar të mos e nënshkruanin asnjë dokument, i cili binte në kundërshtim me programin e LPK-së dhe të UÇK-së. Në radhët e UÇK-së nga LPK-ja në Rambuje ishin: Hashim Thaçi, Xhavit Haliti dhe Azem Syla. Gjatë kohës sa zhvillohej lufta në Kosovë, veçanarisht në vitin 1999, pas Konferencës së Rambujesë, dhe fillimit të bombardimit të Serbisë nga NATO-ja, LPK, kishte vlerësuar se fundi i luftës në Kosovë, nuk do të jetë edhe aq i largët, prandaj ajo duhet të përgatis terrenin e veprimit politik pas luftës në Kosovë, në kushtet dhe rrethanat e reja të krijuara pas luftës.¹⁴ Për shkak se LPK kishte vepruar në kushte të ilegalitetit në Kosovë dhe për shkak se shumicën e aktivitetit të saj politik e kishte zhvilluar jashtë vendit (veçanarisht në Zvicër dhe Gjermani), si dhe për shkak të një opinionioni negative që ishte krijuar nga politika legale dhe pacifiste në Kosovë, shumica e udhëheqësve të LPK-së, kishin dhënë mendimin se pas përfundimit të luftës LPK, duhej të transformohet në parti politike legale.¹⁵

Ajo tani në gjirin e saj duhej të përfshinte gjithë elementët e dëshmuar kombëtar para dhe gjatë luftës, por edhe qytetarët e thjeshtë të cilët do ta përkrahnin programin e saj.

¹² Paskal Milo, ditari i një Ministri, f.38.

¹³ Wesli K. Clark, Të bësh luftë moderne, gazeta ditore ZËRI, 2003, Prishtinë, fq.141.

¹⁴ Muhamet Kelmendi, ish -n. Kryetar i LPK-së deri në vitin 1999, janar 2009

¹⁵ Ibrahim Kelmendi, ish - Kryetar i LPK-së në Gjermani, 03.1.2009

Për këtë arsye, Kryesia e LPK-së, gjatë muajit prill 1999, në Tiranë, mban një takim konsultativ ku vendoset që LPK të ndërroj emrin e saj, të ndërroj programin dhe të shëndrrohet në një parti legale politike, e cila do të konkurronte në skenën politike të Kosovës pas luftës.¹⁶ Pas përfundimit të luftës në Kosovë, gjatë muajve qershor - korrik 1999, në Prizren dhe Prishtinë, u mbjaten disa takime konsultative, ku morën pjesë shumica e udhëheqësve të KP dhe veprimtarë të LPK-së, të cilët me shumicë votash vendosën që LPK të shuhet si organizatë politiko – ushtarake dhe të formohet një parti politike . Duke njohur tërë këtë veprimtari të LPK-së, e cila në Kosovë dhe në shtetet perëndimore veprimtari për gati për dy dekada, nuk ishte e lehtë për mua të rrumbullakësoj tërë veprimtarinë e saj në një punim Masteri. Poashtu, shkapërdherdhja e udhëheqësve të LPK-së pas vitit 1999 dhe mos arkivimi i dokumenteve në një qendër të vetme arkivore, pastaj mungesa e dokumenteve të shkruara nga takimet ilegale, për shkak të konspiracionit dhe tendenca e një pjese të ish- udhëheqësve të LPK-së, për ta shtrembëruar historinë e LPK-së në deklaratat e tyre në gazetat e pas luftës ose në libra autoial, kanë bërë që disa herë të vijë deri te dilemat e mëdha për çështje të caktuara.

Edhe pse jamë shumë i vetëdijshëm, që në punimin tim nuk kamë mundur ta them gjithë atë që duhet thënë dhe shkruar për LPK-në, jamë munduar të jap një kontribut modest në formë të argumentuar dhe shkencore, me pretendimin që punën time shkencore t'a vazhdoj edhe në të ardhmen.

¹⁶ Xhevat Bislimi, shkurt 2009, Prishtinë.

KAPITULLI I PARË

I. Formimi i LPK-së

Si pasojë e pakënaqësive dhe shfrytëzimit të egër ekonomik, si rezultat i veprimit dhe përpjekjeve të shumë grupeve e organizatave patriotiko – revolucionare që punuan me dekada në sqarimin dhe mobilizimin e popullit, si dhe në saje të punës së individëve dhe veprimtarëve patriot, mësuesve, studentëve dhe intelektualëve erdhi deri te një shpërthim i përgjithshëm popullor, shpërthimi i demonstratave të pranvesës së vitit 1981.¹⁷ Demonstratat shpërthyen në qendrën e studentëve në Prishtinë, të mërkurën në mbrëmjen e 11 marsit 1981. Ato në nismë, si pretekst kishin pakënaqësitë sociale të studentëve, me kushtet e ushqimit dhe të banimit. Më 26 mars dhe 1 prill 1981 studentët nga Qendra e Studentëve u drejtuan rrugëve dhe shesheve të Kryeqytetit të Kosovës, ndërsa po atë ditë në Prishtinë arrinte e ashtuquajtura Stafeta e Rinisë. Demonstruesve studentiu bashkangjiten edhe turma të mëdha të nxënësve, rinisë, punëtorëve dhe të fshatarëve. Kërkesë e studentëve ishte krijimi i kushteve më të mira në menzë dhe në konvikte, por më vonë kërkesat e tyre u ndryshuan dhe morën karakter politik. Ndër parullat e shumta u ndëgjuan edhe: Rroftë Klasa punëtore – poshtë borgjezia, Unitet, Kush s’bashkohet është tradhëtar, Rroftë populli shqiptar, Bashkim i të gjitha viseve shqiptare, jemi shqiptar e jo Jugosllav, Trepça punon, Beogradi ndërton, ndërsa njëra prej kërkesave, e cila më së shumti është brohoritur dhe që ka vazhduar të mbizotërojë në të gjitha demonstratat e mëtejshme ka qenë kërkesa - **Kosova Republikë**.¹⁸ Këto demonstrata ndodhën në një shtet si Jugosllavia, e paraqitur deri atëherë si modeli i bashkëjetesës mes kombeve dhe kombësive dhe ajo që ndodhi rrugëve të Kosovës, nuk ishte asgjë tjetër veçse parathënie e asaj që do të ndodhte më pas në të gjitha krijesat e shtetit Jugosllav.¹⁹ Regjimi i egërsuar i Serbisë dhe i Jugosllavisë demonstratat i shypi me polici dhe ushtri, duke vënë nën kontroll të hekurit dhe në lëvizje rrugëve edhe armatimin e rëndë. Në këto demonstrata që u zhvilluan në të gjitha pjesët e Kosovës pati 40 veta të vrarë afër 1000 të plagosur dhe mijëra të burgosur²⁰.

¹⁷ Zëri i Kosovës, Organ i LRSJH-së, nr.5. qershor 1984, Zvicër.

¹⁸ Gazeta javore ZERI, dosja e hapur, prill 2001, Agim Zogaj, Bexhet Haliti, fq.19.

¹⁹ Bedri Islami, Përjetësia e dyfishitë, Tiranë 2008, fq. 120.

²⁰ Frankfurter Allgemeine Zeitung, 27 prill 1981

Udhëheqja komuniste e Kosovës, sikurse ajo e Jugosllavisë i vlerësoi demonstratat të cilat ndodhën në Kosovë „armiçësore„ dhe „ kundërrevolucionare“, ndërsa akuza mbi mendimin dhe veprimin politik të ilegales shqiptare do të egërsohet që nga 3 prilli i vitit 1981, që u shpreh në të gjitha sferat e jetës politike në Kosovë dhe në Jugosllavi²¹. Pas demonstratave studentore të vitit 1981, në Kosovë, organet partiake shtetërore filluan të zbatonin sistemin e diferencimit gati në të gjithë lëmenjt e jetës, kryesisht ndaj punëtorëve, nxënësve, studentëve, kuadrove të shquar arsimor, kulturor, shkencor e politik. Ai që i dha vizë çdo veprimi antishqiptar ishte „ Programi aksional i veprimit të Lidhjes Komuniste të Kosovës në luftë kundër forcave armiçësore dhe kundërrevolucionare për stabilizimin e gjendjes në Krahinë” të cilën e miratoi Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste të Kosovës, më 23 maj 1981.²² Kjo ishte një vazhdimësi e politikës shfarosëse sipas planit të Akademikut serb Vasa Çubrilloviq.²³

Ndër të rrallët intelektual që doli guximshëm në mbështetje të demonstruesve dhe rinisë studentore, ishte, Ukshin Hoti, profesor i Universitetit të Prishtinës dhe maxhistër i shkencave politike, ish- udhëheqës i lartë i Kosovës para vitit 1981. Për shkak të qëndrimit të tij të pa lëkundur në përkrahje të demonstratave të vitit 1981, profesori i nderuar Ukshin Hoti u burgosur disa herë nga pushtuesi serb. Më 13 maj 1981, e cila ishte dita e policisë Jugosllave, në Prekaz të Skenderajt, forca të mëdha policore e ushtarake Jugosllave, sulmoi shtëpinë e Tahir Mehës. Në një luftë të pa barabartë, ballë për ballë me policinë Jugosllave heroikisht ranë babë e birë, Nebi dhe Tahir Meha.²⁴

Udhëheqja Komuniste e Kosovës dhe e Jugosllavisë, për ngjarjet e Pranverës së vitit 1981, u mundua të gjente edhe fajtorin kujdestar. Për këtë ata e akuzonin shtetin Shqiptar dhe udhëheqësin e saj Enver Hoxha. Fadil Hoxha në njërën nga mbledhjet e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë të mbajtura në Prishtinë, lidhur me shkaqet e demonstratave të vitit 1981 thotë se burim inspirimi i nacionalistëve të Kosovës janë fjalimet e Enver Hoxhës.²⁵

²¹ Mr. Ethem Çeku, Mendimi politik i lëvizjes ilegale në Kosovë 1945 – 1981, fq. 248 -250.

²² Rilindja, 23 maj 1981, Prishtinë

²³ Vasa Çubrilloviq, Problemi i pakicave Kombëtare në Jugosllavinë e re, Zëri i Kosovës, 1987.

²⁴ Gazeta Koha ditore, fejtton, në përkujtim të demonstratave të vitit 1981, 4 prill 2006, fq.15.

²⁵ Gazeta „ Kosova Sot” fejttoni çfarë tha udhëheqja Kosovare për dem.1981, e hënë 15 mars 2007, fq. 8.

Qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj çështjes së Kosovës, e në këtë rast ndaj ngjarjeve të vitit 1981, ishte i vështirë. Ky zhvillim i papritur befasoi udhëheqjen e Shqipërisë, e cila me sa duket nuk e kishte menduar dhe nuk e kishte parashikuar një evoluim e shpërthim kaq të shpejtë të situatës në Kosovë. Shtypi i Shqipërisë, në vitin 1981, shkroi shumë artikuj lidhur me demonstratat e pranverës së vitit 1981 që ndodhën në Prishtinë dhe qytetet tjera, ku jetonin shqiptarët në Jugosllavi. Më 8 prill, gazeta „ Zëri i Popullit ” në shkrimin me titull „ Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë ” njoftoi opinionin Shqiptar lidhur me trajtimin në mënyrë armiqësore dhe brutale të Demonstratave dhe kërkesve të drejta të popullit shqiptar të Kosovës.²⁶

Udhëheqësi i shtetit Shqiptar, Enver Hoxha që ndodhej aso kohe në Vlorë, ndërpreu menjëherë pushimet dhe erdhi në Tiranë, ku kryesoi një mbledhje urgjente të forumit më të lartë të partisë, përkatësisht të byrosë politike të Partisë së Punës së Shqipërisë - PPSH-së.²⁷ Ndërsa në Kongresin e 8 të PPSH-së, të mbajtur më 1 nëntor 1981, udhëheqësi i Shtetit Shqiptar, Enver Hoxha, kishte deklaruar se keqësimi i tanishëm i marrëdhënieve midis RPS të Shqipërisë dhe RSFJ-së është pasojë e veprimeve shovinist të autoriteteve të Beogradit ndaj popullsisë së Kosovës dhe e nxitjes nga ana e tyre të një fushate të re armiqësore kundër vendit tonë. Shteti Shqiptar thotë ai e ka mbrojtur dhe do ta mbrojë edhe në të ardhmen pjesën e kombit shqiptar që jeton në trojet e veta në Jugosllavi dhe kjo nuk është ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë. Kjo është e drejtë e pamohueshme.²⁸

Enver Hoxha e ngriti çështjen e Kosovës, si një problem politik dhe historik që duhej zgjidhur. Ai i rrëzoi tezat e Jugosllavisë Titiste, për gjoja barazi të shqiptarëve në Jugosllavi. Ky qëndrim politik i Shqipërisë i vuri në siklet të madh udhëheqësit e Jugosllavisë dhe udhëheqësit Komunist të Kosovës, të cilët ishin kundër rinisë shqiptare të Kosovës.²⁹ Ngjarjet e vitit 1981 mund të thuhet se shënojnë një pikë kthese në qëndrimin e Shqipërisë ndaj çështjes së Kosovës, duke i futur përpjekjet e saj në shtratin e duhur të interesave kombëtare.

²⁶ Gazeta „ Zëri i Popullit ” 8 prill 1981, Tiranë.

²⁷ Xhelal Gjeqovi, Qëndrimet e shtetit shqiptar ndaj demonstratave të vitit 1981, studime historike, ASHRSH, 3-4, Tiranë, 2001, fq. 189 – 190.

²⁸ Fjalimi i Enver Hoxhës në Kongresin e 8 të PPSH-së, të mbajtur më 1 nëntor 1981, Tiranë

²⁹ Lisen Bashkurti, Drejtor i Akademisë Diplomatike të Shqipërisë, debat në TV Alsat, Qëndrimi i shtetit shqiptar për demonstratat e vitit 1981. 10 shkurt 2009.

Pavarësisht nga problemet e brendshme që kishte vetë Shqipëria, shqiptarët në Jugosllavi, e ndjenin dhe e shikonin se në fund të fundit e vetmja mbrojtje dhe mbështetje për ta vinte prej saj. Shqipëria ka mbështetur kurdoherë Kosovën dhe popullsinë e viseve tjera shqiptare në Jugosllavi, për të drejtat e tyre legjitime, prandaj edhe lëvizja ilegale në trojet shqiptare në ish – Jugosllavi, përkrahte këtë qëndrim të Shtetit Shqiptar.³⁰

Tirana Zyrtare tani doli hapur në mbështetje të demonstruesve shqiptar dhe kritikon Jugosllavinë, lidhur me politikën nacionale që po ndjek ndaj shqiptarëve në Jugosllavi.³¹ Shqiptarët e Kosovës, që u ngritën në demonstrata, nuk e dinin se ndihmë të madhe i dhanë edhe ata Shqipërisë, duke e shtrënguar UDB-në Jugosllave të digjte kartën e „Shpresës së madhe” dhe të fundit për të përmbysur udhëheqjen e Shqipërisë, e cila ishte halë në sy, për udhëheqjen Titiste³². Jehonë të madhe këtyre demonstratave dhe kërkesave që dolën nga ato i dha edhe shtypi ilegal, që botohej brenda dhe jashtë Kosovës dhe viseve shqiptare, i cili nuk qëndroi duarkryq. Gazeta Liria, e cila drejtohej nga Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka, me shkrimet e saja, mendohej që demonstratat e pranverës së vitit 1981 ti arsyetoj si demonstrata me karakter atdhetar, duke i nxitur ato deri në fitoren përfundimtare. Në numrin 3 të kësaj gazete, në artikullin me titull „Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe do të triumfojë”, shkruante për gjendjen e padurueshme, të popullit shqiptar në Jugosllavi, i cili është mbështetur për muri.³³

Në kohën kur në Kosovë filloi një terror i pa parë psikologjik kundër shqiptarëve, kur po burgoseshin student, punëtor e intelektual, doli si domosdoshmëri çështja e bashkimit të organizatave ilegale në një Front Gjithëpopullor për Republikë. Hapin e parë për jetësimin e kësaj ideje e ndërmori Organizata Marksiste Leniniste e Kosovës (OMLK). Në verë të vitit 1981, Komiteti drejtues i Organizatës Marksiste Leniniste të Kosovës- OMLK si: Hydajet Hyseni, Mehmet Hajrizi, Nezir Myrtaj, shpërndau Tezat për formimin e Republikës së Kosovës- me titull, „Tezat rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës”.³⁴ Qëllimi i Frontit për Republikën e Kosovës ishte që Krahina e Kosovës të çlirohet nga sundimi i Serbisë dhe të fitojë statusin e Republikës brenda Federatës Jugosllave.

³⁰ Xhelal Gjeqovi, Qëndrimet e shtetit shqiptar ndaj demonstratave të vitit 1981, studime historike, ASHRSH, 3-4, Tiranë, 2001, f. 189 – 190.

³¹ Gazeta austriake „Kleine Zeitung” 11 prill 1981, f.3

³² Enver Hoxha, TITISTËT – Kombinati Poligrafik, 1992, Tiranë, f. 578

³³ Gazeta Liria, nr.3 maj 1981

³⁴ Emrush Xhemajli, LPK, 20 vjet veprimtari 1982 -2002, Zëri i Kosovës, Prishtinë, 2002,f. 4.

Fronti Popullor për Republikën e Kosovës nuk do të ketë asgjë të përbashkët, por do të jetë kundër LKJ-së dhe organizatave tradhëtare të masave, si LSPP, LRS, LS etj, që janë vegla të shovinizmit serbomadh. Në Frontin për Republikë, nuk mund të bëjnë pjesë organizatat terroriste dhe Fashiste si dhe agjencitë e ndryshme, ndërsa është për bashkëpunim me Shqipërinë Socialiste nën udhëheqjen e Partisë së Punës dhe të shokut Enver Hoxha.³⁵ Ky material programatik u lëshua në diskutim dhe hasi në përkrahje të madhe të popullit, të organizatave patriotike dhe të gjithë revolucionarëve.³⁶ Në këto „Teza” jepen argumentet që flasin se Kosovës i takon statusi i Republikës në Federatën Jugosllave, se ajo është e arritshme dhe se populli i Kosovës³⁷ ka potencial të luftojë për fitimin e saj.³⁸ Nga sa shihet, në vitin 1981, organizatat ilegale, si Organizata Marksiste Leniniste e Kosovës - OMLK, Partia Komuniste Marksiste Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi - PKMLSHJ, etj, të cilat kishin orientim kryesisht Marksiste – Leniniste ishin për Republikën e trojeve shqiptare në ish – Jugosllavi, ndërsa arritjen e këtij qëllimi e shihnin përmes demonstratave paqësore. Poashtu para se të hartohen Tezat e Frontit Popullor, Mehmet Hajrizi, kishte shkruar në vitin 1977/78, shkrimin me titull „*Në rrugë drejtë lirisë*”, i cili ishte artikull programatik i Grupit Marksist Leninist të Kosovës.³⁹ Demonstratat e vitit 1981 do ta ngrisin çështjen e Kosovës si një problem që kërkon zgjidhje të shpejtë dhe historikisht të drejtë.⁴⁰

Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës – LPRK, është vazhdim i drejtëpërdrejtë i platformës që shtrohet në „Tezat rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës, të përpiluara nga Organizata Marksiste Leniniste e Kosovës – OMLK, në vitin 1981, teza themelore që ishin të drejta dhe të qëndrueshme. Në vitin 1981, aktivitetin e tyre atdhetar në shtetet perëndimore kishin filluar ta shtrinin edhe dy figura të njohura të intelektualëve dhe të gazetarisë Kosovare: Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, si dhe Bardhosh Gërvalla. Në kohën kur Kosova vlonte nga arrestimet, gjykimet dhe dhuna e terrori serb, që ushtrohej mbi shqiptarët, Jusuf Gërvalla dhe bashkëpunuesit tjerë të tij, bënë përpjekje që organizatat që vepronin jashtë vendit të bashkohen në një të vetme.⁴¹

³⁵ OMLK, Tezat rreth Frontit popullor për Republikën e Kosovës, 1981.

³⁶ Zëri i Kosovës, nr.5 qershor 1984.

³⁷ LPRK-ja, me Kosovë nënkuptonte të gjitha trojet shqiptare në ish - Jugosllavi.

³⁸ Emrush Xhemajli, vepra e cituar, 4.

³⁹ Mehmet Hajrizi, *Në rrugë drejt lirisë, shkrim autorial, 1977/78, Prishtinë.*

⁴⁰ Jakup Krasniqi, Lëvizja Politike dhe qëndresa e armatosur në Kosovë 1991 -1999, Punim magjistrature, 2004, Prishtinë, fq. 8

⁴¹ Faridin Tafallari, Terror, dhimbje, qëndresë, Tiranë 1997

Të përndjekur nga pushtuesi serb, Jusufi ishte detyruar të shkonte në Gjermani, ndërsa Kadri Zeka në Zvicër, ku kishin filluar ti lidhnin fijet e këputura të Lëvizjes Ilegale në Kosovë dhe të mërgatës. Ata arritën ti bashkonin grupet e ndryshme në një subjekt të vetëm e të fortë politik që pas vrasjes së tyre mori emrin Lëvizja Revolucionare e Shqiptarëve në Jugosllavi - LRSNJ. Poashtu, që nga vitet '70 –ta në Gjermani vepronte edhe veprimtari i çështjes kombëtare, Ibrahim Kelmendi⁴², i cili nga viti 1979 -1980 nxori disa numra të gazetës « Bashkimi » i cili kishte një rrjet të organizuar të veprimtarëve⁴³ në Kosovë dhe Jashtë vendit që përbënin „ Frontin e Kuq Popullor „⁴⁴

Vetëm dhjetë ditë pas demonstratave popullore të 1 e 2 prillit 1981 në Prishtinë, Kadri Zeka, pasi ishte konsultuar me shokë brenda vendit, nga Zvicra kishte shkuar në Gjermani dhe ishte konsultuar me Jusuf Gërvallën dhe Ibrahim Kelmendin, lidhur me organizimin e demonstratës së parë më 11 prill 1981 në Bern. Kjo demonstratë, shenoi një kthesë të madhe në organizimin e mërgatës shqiptare në shtetet Euro- Perëndimore. Menjëherë pas kësaj, pasuan edhe demonstratat tjera në : Zurich, Gjenevë, Shtutgard, Dyseldorf, Frankfurt dhe Bruksel. Me këto demonstrata, nisi të realizohej ideja e Kadri Zekës, për një organizim të pavarur nga ambasadat Jugosllave.⁴⁵ Duke e ditur rëndësinë e punës dhe veprimtarisë së tyre, udhëheqja e Jugosllavisë përmes rrjetit të saj agjenturor të UDB-së, u kishte rënë në gjurmë dhe kishte hartuar edhe planin për likuidimin fizik të vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës. Pushtetit komunist serbo - jugosllav, i pengonte aktiviteti i atdhetarëve shqiptar në shtetet e Perëndimit, prandaj në shtypin e kohës, thuhej se „ Organizatat armiqësore në emigracion, në veprimtarinë e tyre i shfrytëzojnë të gjitha rrethanat e mundshme , duke filluar nga marrëdhëniet ndërkombëtare e deri te kushtet ligjore që u ofrojnë sistemet e Evropës Perëndimore. Në vitin 1982, nacionalistët dhe irredentistët shqiptar organizuan demonstrata antijugosllave në shumë qendra të Evropës Perëndimore dhe në SHBA.⁴⁶ Pas një sërë kërcënimesh e përcjelljesh nga UDB-ja më 17 janar 1982, në Untergruppenbach të Gjermanisë u vranë tre aktivistët më të dalluar të asaj kohe, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla.⁴⁷

⁴² Po aty

⁴³ Muhamet Kelmendi, ish nën - Kryetar i LPK-së para vitit 1999, deklaratë e dhënë më 20 janar 2009

⁴⁴ Emrush Xhemajli, ish – sekretar i LPK-së para vitit 1999, deklaratë e dhënë më 30 janar 2009

⁴⁵ Ismet Rashiti, 25 vjetori i demonstratave të vitit 1981, Epoka e Re, 18 prill 2006.

⁴⁶ Sinan Hasani, KOSOVA, të vërtetat dhe mashtrimet, Prishtinë 1987, f. 246 -247.

⁴⁷ Ismet Rashiti, 25 vjetori i demonstratave të vitit 1981, Epoka e Re, 18 prill 2006.

Pas vrasjes së vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës, të cilët ishin duke kurorëzuar bashkimin e grupeve të ndryshme që vepronin në Evropën Perëndimore, Jugosllavia mendoi dhe propagandoi se e zhduki udhëheqjen kryesore të „terroristëve" shqiptar të Kosovës.⁴⁸ Vetëm një muaj pas vrasjes së vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zeka, më 17 shkurt 1982, në Ankara të Turqisë përfaqësuesit e të dy grupeve të fshehta, Sabri Novosella, Xhafer Durmishi - Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi - LNÇKVSHJ, Abdulla Prapashtica, Osman Osmani dhe Faton Topalli - Partia Komuniste Marksiste Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi - PKMLSHJ, në prezencë edhe të Ambasadorit të Shqipërisë në Turqi, z. Bujar Hoxha shpallën të formuar Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ).⁴⁹ Pas nënshkrimit të marrëveshjes, u lëshua një Komunikatë për opinion, e cila u shpërnda jashtë atdheut dhe u botua në numrin e parë të gazetës „Zëri i Kosovës” tani organ i LRSHJ-së⁵⁰

a). Veprimtaria e LPRK-së (LRSHJ-së) 1982 -1989

LRSSHJ, u formua me bashkimin e oraganizatave më të hershme ilegale si dhe disa intelektualëve patriot dhe luftëtar të çështjes shqiptare, që kishin migruar në botën perëndimore, LKÇVSHJ dhe PKMLSHJ ‘‘⁵¹. Më 15 maj 1982, në Zvicër, Xhafer Shatri, përfaqësues i OMLK-së, deklaroi hyrjen në LRSHJ.⁵² Pas bashkimit të këtyre grupeve LRSHJ formon Komitetin Qendror të saj, i cili përbëhej nga 15 anëtar.

Organizata kishte edhe gazetën e vet „Zëri i Kosovës ‘‘ e cila dilte që nga viti 1974⁵³. Me presionin e PPSH-së dhe të Abdulla Prapashticës, LRSHJ-së iu shtrua edhe një fjalë, „socialiste’’ dhe u quajt „LRSSHJ’’.⁵⁴ Në qershor të vitit 1982 në Gjermani, me teknikën që kishte lënë dëshmorin Jusuf Gërvalla, vazhdoi botimi i gazetës „Zëri i Kosovës". Redaktor u zgjodh Xhafer Durmishi. Pasi aktiviteti i LRSSHJ-së ishte më i dendur në Zvicërë në vitin 1983, teknika dhe redaksia e gazetës „Zëri i Kosovës" kaluan në Zvicër. Redaktor deri në vitin 1983 do të jetë Xhafer Shatri.

⁴⁸ Po aty

⁴⁹ Xhafer Durmishi, 25 vjetori i vrasjes së vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës, Epoka e Re, 25 janar 2007, fq. 14.

⁵⁰ Sabri Novosella, intervistë në gazetën Zeri, 23 mars 1992.

⁵¹ Haki Kosumi, Rritja e lëvizjes ilegale në Kosovë 1981 -1990, punim në dorëshkrim, fq.70.

⁵² Emrush Xhemajli, vepra e cituar, 4.

⁵³ Sabile Keqmezi Basha, Organizatat dhe grupet ilegale në Kosovë, 1981 -1989.

⁵⁴ Sabri Novosella, intervista e cituar.

Në fund të vitit 1982, me insistimin e anëtarëve të saj, LRSSHJ, hoqi termin Socialist, sepse vetëkuptohet se Konstituimi i Republikës në kuadër të RSFJ-së, e përjashton këtë term të Organizatës⁵⁵ dhe tani e tutje, Lëvizja Revolucionare Socialiste e Shqiptarëve në Jugosllavi - LRSSHJ, do të quhet, Lëvizja Revolucionare e Shqiptarëve në Jugosllavi - LRSHJ.⁵⁶ Kjo organizatë, pos në shtetet perëndimore, ishte e lidhur edhe me veprimtarët e saj edhe në Kosovë dhe në vise tjera shqiptare në Jugosllavi, të cilët vazhdonin një aktivitet të dendur⁵⁷.

Gjatë vitit 1983, LRSHJ në Kosovë gati në të gjitha qytetet e saj organizoi demonstrata për shënimin e dy vjetorit të demonstratave të vitit 1981 dhe për të kërkuar Republikën e Kosovës, ndërsa në shtetet Perëndimore demonstrata u organizua para Parlamentit Evropian në Bern, Strasburg, Nju Jork, Frankfurt dhe në Bruksel. Në Podujevë vepronte, Bajram Ajeti, Ali Ajeti, Avdi Gjata etj,⁵⁸ në Lipjan Sherif Konjufca,⁵⁹ në Pejë, Adem Grabovci, Xhemajl Fetahaj, Rexhep Kelmendi, Adem Kelmendi, Blerim Muriqi,⁶⁰ në Gjilan, Nuhi Berisha dhe Ahmet Isufi, në Suharekë Gafurr Elshani dhe Ilaz Kadolli, ndërsa në rajonin e Drenicës, Shaban Shala dhe Ilmi Zeka.⁶¹ Nuhi Berisha, ndonëse ishte më i riu, në këtë kohë ishte ndër aktivistët më të dalluar të ilegales në Kosovë. Veprimtarinë ilegale Nuhiu e kishte filluar qysh në bangat e gjimnazit, si anëtarë i OMLK-së, ndërsa si student në kuadër të LRSHJ-së, me revolucionarin Rexhep Malaj, me të cilin kishte rënë në kontakt menjëherë pas daljes së Rexhep Malës nga burgu. Këto kontakte do të intensifikohen dhe do të vazhdojnë deri në rënien e tyre.⁶² Në vitin 1983, dy veprimtar të LRSHJ-së, Zija Shemsiu dhe Sami Kurteshi arrestohen nga policia jugosllave, duke transportuar armë dhe materiale të tjera propaganduese në relacionin Zvicer - Kosovë. Nga data 23 prill deri më 24 maj 1984, në gjyqin e qarkut në Beograd, në bankën e të akuzuarve, dolën: Zija Shemsiu, Sami Kurteshi, Fetah Shemsiu, Taip Zeka, Hasan Shemi, Shaban Shemsiu.

⁵⁵ Njoftim intern i LRSSHJ-së, shtator 1985

⁵⁶ Emrush Xhemajli, LPK, 20 vjet veprimtari 1982 -2002, Zëri i Kosovës, Prishtinë, 2002.

⁵⁷ Fahredin Tafallari, Terror, dhimbje, qëndresë, Eurorilindja, Tiranë, 1997, fq.70.

⁵⁸ Rilindja, 19.6. 1984, fq. 8

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ Rilindja, 22 .6. 1984

⁶¹ Emrush Xhemajli, vepra e cituar, 5.

⁶² Nuhi Berisha, Pranvera e luleve të kuqe, Kujtime – Ribotim, 2002, Gjilan.fq.5-7.

Pas mbrojtjes së të akuzuarve, Zija Shemsiu u denua me 13 vjet burg, Sami Kurteshi, 9 vjet, ndersa te akuzuarit tjerë nga 6 dhe 4 vjet.⁶³ Pas 18 muajsh torture, më 5 maj 1985 Zija Shemsiu, pasi nuk kishte pranuar të tregonte asgjë për shokët e organizuar të Organizatës, u vra nga UDB-ja Jugosllave në burgun e njohur „Centar Zatvor" të Beogradit⁶⁴. Pas çdo demonstratë në Kosovë pasonin rrahjet brutale, maltretimet dhe burgosjet e të rinjëve dhe studentëve nga anët e ndryshme të Kosovës. Gjatë periudhës së viteve 1983 -1984, LRSNJ të cilën e udhëhiqte Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha, kishte zhvilluar aktivitete të shumta në të gjitha rrethet e Kosovës.⁶⁵

Aktiviteti i LRSNJ-së, në këtë periudhë do të vë në lëvizje të gjithë elementin atdhetar të ilegales së kohës. Përveç në Gjilan dhe Prishtinë, LRSNJ, kishte shtrirë rrjetin e veprimit edhe në Drenicë, në Dukagjin, në Llap dhe pothuaj në të gjitha trojet e pushtuara shqiptare në ish - Jugosllavi. Rexhepi dhe Nuhiu e përgatisnin Lëvizjen për sprova të reja të avancimit të saj, në kryengritje të armatosur⁶⁶, si shkallë më e lartë e rezistencës.⁶⁷ Ata, pos aktivitetit ilegal, bënë edhe shkrime, trajtesa e analiza për çështje të ndryshme, si: demonstratat, organizimin, disiplinën e konspiracionin, përgatitjet luftarake për kryengritje të armatosur, gjendjen ekonomike e sociale në Kosovë, Lëvizjen Kombëtare, rininë, pozitën e gruas dhe potencialin e saj patriotik, dëshmorët e rënë në altarin e lirisë, etj.⁶⁸

Në vitin 1983, në Drenicë, Shaban Shala, Fehmi Lladrovci dhe Ali Ahmeti, formojnë udhëheqësinë e „Celulës" - „, Këshillin Organizativ" dhe zgjedhin udhëheqësinë e saj. Shaban Shala, zgjidhet sekretar, Fehmi Lladrovci zgjidhet këshilltar dhe Ali Ahmeti zgjidhet ndërlidhës i Këshillit Organizativ me „ Celulën" në Kërçovë. Me qëllim të mbarëvajtjes së punës sa më të sukseshme në teren, Fehmi Lladrovci angazhohet me detyrë që të formojë „ Celulën" me studentët Kosovarë në Zagreb.

⁶³ Rilindja, 25, 26 prill dhe 17, 19, 22, 25 maj 1984.

⁶⁴ Emrush Xhemajli, vepra e cituar, fq.5.

⁶⁵ Po aty.

⁶⁶ Në kuadër të Lëvizjes ilegale, veqanarisht të LPRK-së, gjithëherë ka ekzistuar opcioni i zgjidhjes së qështjes së Kosovës, përmes luftës së armatosur, siq është lufta dhe rënia e Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës, më 1984, rënia e Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut, Çeta e Llapit dhe rënia e Ali Ajetit, rënia e Hasan Ramadanit, e deri te rënia heroike e Zahir Pajazitit, Luan Haradinajt dhe Adem Jasharit dhe formimit të UÇK-së.(M.Z)

⁶⁷ Nuhi Berisha, Vepra e cituar.

⁶⁸ M.Hajrizi, vepra e cituar, fq.325.

Në bazë të kësaj detyre që e merr Fehmi Lladrovci, në Janar të vitit 1983 në dhomën nr. 52 të konviktit „ Ivo Llolla Ribar" në Zagreb, sëbashku me Hazir Tarën, Rrahim Bytyqi e Xhelal Canzibën e formojnë „ Celulën" e cila vepronte në bazë të platformës së organizatës LRSHJ. Udhëheqës i „Celulës" zgjidhet Fehmi Lladrovci.⁶⁹ Më vonë anëtar të rinj të këtij grupi pranohen edhe Fadil Demiri e Tomë Marku, ndërsa Miran Demirit i japin detyrë që në Mitrovicë të formojë një „Celulë" të re.⁷⁰

Aktivitetit të Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës me shokë, u kishin rënë në gjurmë agjentët e UDB-së, të cilët kishin vënë në lëvizje tërë rrjetin e saj të agjentëve për zbulimin e tyre. Në mes 11 dhe 12 janarit 1984 në Prishtinë Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha rrethohen nga forcat policore serbe në shtëpinë e Sejdi Veselit në lagjen më të varfër të Prishtinës, në Vranjevc⁷¹. Pas një lufte të ashpër heroike, por të pabarabartë, Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha bien heroikisht në fushën e nderit, duke lënë dhjetëra policë e ushtar serbë të vrarë, ndërsa Kadri Osmani arrestohet dhe denohet nga policia serbe.⁷² Të nesërmen, më 13 janar 1984, gazeta Rilindja, e cila ishte e dirigjuar krejtësisht nga LKJ-ja, boton kumtesën e Gjykatësit hetues të Gjyqit të qarkut në Prishtinë, Elez Hoxha, në të cilën shkruante se „ Pasi iu kundërvunë organeve të sigurimit duke u bërë barrikadë dhe duke shtënë në ta, Nuhi Berisha, i arratisur që nga dhjetori i vitit 1982, dhe Rexhep Mala, i denuar i mëparshëm politik, bënë vetëvrasje me revole."⁷³

Ende pa u bërë një muaj nga vrasja e Rexhepit dhe Nuhiut, me 8 shkurt 1984 rrethohet nga policia serbe, Bajram Bahtiri dhe pas një lufte të pabarabartë bie heroikisht edhe ky veprimtar i LRSHJ-së.⁷⁴ Pas vrasjes së Rexhep Malës, Nuhi Berishës dhe Bajram Bahtirit, fillojnë arrestimet në të gjitha pjesët e Kosovës. Nga fundi i dhjetorit të vitit 1983 ka qenë një fushatë e madhe e arrestimeve dhe deri në fund të shkurtit 1984, përveç vrasjes së tre veprimtarëve të devotshëm, janë arrestuar mbi treqind veprimtarë në të gjithë Kosovën.⁷⁵

⁶⁹ Sabile Keqmezi – Basha – vepra e cituar.

⁷⁰ Po aty.

⁷¹ Më vonë kjo lagje do të marrë emrin „ Kodra e Trimave" pikërisht për qëndresën heroike të Rexhepit e Nuhiut.

⁷² Nuhi Berisha, Pranvera e luleve të kuqe, Kujtime – Ribotim, 2002, Gjilan.fq.5-7.

⁷³ Rilindja, 13.01.1984, fq. 6.

⁷⁴ Po aty.

⁷⁵ Ramadan Avdiu, Epoka e Re, 24.2.2004.

Në gjykatën e qarkut në Prishtinë, në maj 1984 denohet një grup i veprimtarëve të LRSNJ-së, të cilët endi ishin të mitur, ndërsa më 18. 6. 1984, u gjykuan anëtarët e LRSNJ-së: Bajram Ajeti, Ismet Begolli, Sherif Konjufca, Ali Ajeti etj, ⁷⁶më 19. 6. 1984, u denuan me shumë vite burg 20 anëtarë të „ Frontit Nacionalçlirimtar“ në mesin e të cilëve ishin edhe Ramadan Avdiu dhe Afrim Zhitia.⁷⁷

Më 26 qershor 1984, fillon gjykimi i veprimtarëve të LRSNJ-së: Kadri Osmani, Enver Topalli, Mehë Uka, Ramë Buja, Bexhet Imishti etj, të cilët akuzohen se „ kanë vepruar nga pozita e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar, dhe si qëllim kanë minimin e sistemit socialist të Jugosllavisë“ se „ kanë lexuar gazetën „ Zëri i Kosovës“ se „ kanë shkruar parolla armiqësore dhe kanë shpërndarë pamfletin „Trakt kundër Tradhëtisë“ etj.⁷⁸ Gjykime të tilla, kundër atdhetarëve shqiptar u zhvilluan edhe në Ferizaj, më 24 maj, ⁷⁹në Pejë, më 24 qershor 1984, ku u denuan Adem Grabovci, Rexhep Kelmendi dhe Zenel Kadrijaj me nga 5 vjet burg, sipas nenit 136, paragrafi 1, lidhur me nenin 114, të ligjit penal të RSFJ-së, si iniciator dhe themelues të grupit armiqësor,⁸⁰ dhe se ka shkruar parolla armiqësore: Kosova Republikë dhe kanë lexuar gazeta ilegale „ Liria“ dhe „ Zëri i Kosovës“ etj.⁸¹ Të gjithë këta veprimtarë, të LRSNJ-së akuzoheshin për veprimtari armiqësore kundër Jugosllavisë, duke kërkuar që Kosova ta fitoj statusit e Republikës si dhe bashkimin e Kosovës me Shqipërinë“⁸²

Megjithëse lëvizja në këtë periudhë kalonte një situatë të vështirë për radhët e saj ilegale, veprimtarët e LRSNJ-së gjenin forma e metoda për të punuar dhe për të vazhduar aktivitetin e tyre atdhetarë për çlirimin dhe bashkimin e trojeve shqiptare. Në vitin 1985 LRSNJ bënte përpjekje të brendshme që të ndërrojë strategjinë e punës dhe të veprimtarisë. Këshillat bazë të LRSNJ-së brenda vendit dhanë mendimet me shkrim për programin e mëtejshëm të LRSNJ-së. Pak para arrestimeve të nëntorit 1985, kjo ide gjeti miratimin e përgjithshëm.⁸³

⁷⁶ Rilindja, 19.6.1984, fq.8

⁷⁷ Afrim Zhitia, më vonë udhëheqës i LPRK-së, më 2 nëntor 1989, bie heroikisht, sëbashku me Fahri Fazliun në „ Bregun e Diellit“, duke luftuar kundër policisë dhe ushtrisë serbe dhe shërbëtorëve të tyre.

⁷⁸ Rilindja, 26.6.1984, fq. 8

⁷⁹ Rilindja, 24.5.1984, fq. 6

⁸⁰ Rilindja 26..6. 1984, fq. 8

⁸¹ Rilindja 21..6. 1984, fq. 6

⁸² Rilindja, 20.6.1984, fq. 9.

⁸³ Emrush Xhemajli, vepra e cituar.

Në vitin 1985, LRSNJ, krijon dy bazat të rëndësishme dhe të sigurta në fshatin Dyz në Llap, ndërsa në Drenicë bazë me rëndësi ishte në fshatin Kleçkë, të Malishevës. Në Dyz dhe Kleçkë u strehuan udhëheqësit e LRSNJ-së, Xhavit Haliti, Hajdin Abazi dhe Ali Ahmeti. Bazë me rëndësi për aktivitetin e LRSNJ-së ishte edhe shtëpitë e Ahmet Haxhiut dhe Shaban Mujës, në Prishtinë.⁸⁴ Ndhimesë të madhe në këto vite të vështira dha dega e LRSNJ-së jashtë vendit, sidomos ajo në Zvicër dhe Gjermani. Në vitin 1985 në banesën e Hasan Malës, në Zvicër, LRSNJ, mbajti mbledhje ku merrnin pjesë: Xhafer Shatri, Xhafer Durmishi, Hasan Mala, Saime Isufi, Faridin Tafallari, Ibrahim Kelmendi dhe Sabri Novosella.⁸⁵ Në mbledhje, Komiteti Qendror i LRSNJ- së, i bazuar në "Tezat" e lartpërmendura, mori vendim për ndërrimin e emrit nga LRSNJ (Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi) në LPRK (Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës).⁸⁶

Në prill të vitit 1985 në Prishtinë, në emër të Këshillit Organizativ, Shaban Shala, Xhabir Morina, Bashkim Mazreku, Xhavit Haziri dhe Ali Ahmeti, marrin vendim për bashkimin e grupeve të Komitetit Organizativ të MLK-së". Më 23 qershor të vitit 1985, Shaban Shala, në shtëpinë e tij në Negrovç, sëbashku me Idriz Hysenin, në prani të Fehmi Lladrovci formojnë Komitetin e Rrethit të MLK-së në Glllogovç.⁸⁷ Sekretar përgjegjës për çështje ushtarake, i cili ishte sektori me përgjegjësinë më të madhe në kuadër të organizatës, zgjidhet Fehmi Lladrovci.⁸⁸ LPRK u shëndrrua në një organizatë masash e udhëhequr nga Komiteti i OMLK-së, i cili ishte pararojë e LPRK-së dhe formoi Komitetet e saj në territoret shqiptare në ish – Jugosllavi.⁸⁹ Gjatë vitit 1985, u formua Komiteti i OMLK-së, në Prizren, Suharekë, në Prishtinë, Ferizaj, në Kaçanik, Vushtri, Tetovë, Kërçovë, Strugë, Bujanovç, Klinë, Pejë..., etj.⁹⁰ Qëllimi kryesor i „ Komitetit Organizativ“ ishte riorganizimi i radhëve, strukturimi dhe forcimi i tyre, deri në krijimin unik të Organizatës ose të partisë. Më 4 nëntor të 1985, për shkak të veprimtarisë në kuadër të LPRK-së arrestohen shumë veprimtarë të saj në trojet shqiptare në ish – Jugosllavi, të cilët synonin krijimin e Republikës së Kosovës.⁹¹

⁸⁴ Ibish Neziri, Ahmet Haxhiu, një jetë e tërë në Lëvizjen Ilegale, fq.93 -97.

⁸⁵ Sabri Novosella, Intervistë, ZERI, 23.5.1992

⁸⁶ Emrush Xhemajli LPK 20 vjet veprimtari.....

⁸⁷ Po aty.

⁸⁸ Bedri Islami, Përjetësia e dyfyshtë, Tiranë 2008, fq.30.

⁸⁹ Sabri Novosella, Intervistë, ZERI, 23.5.1992

⁹⁰ Dr.Sabile Keqmezi – Basha, vepra e cituar.

⁹¹ Mustafë Xhemajli, intervistë, 07 korrik 2008, Prishtinë.

Kështu më 21 nëntor 1985 në Gjykatën e qarkut në Prishtinë, sipas nenit 136 al.1, lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ-së, filluan hetimet kundër: Xhabir Morina, Ramadan Haziri, Metush Krasniqi, Bilall Sherifi, Fehmi Lladrovci, Shaban Shala, Ilmi Reçica, Skender Osmani, Ilmi Zeka, Skender Luzha, ndërsa Xhavit Haliti, Xhavit Haziri, Hajdin Abazi dhe Nuhi Ahmeti, u denuan në mungesë.⁹² Po në këtë vit (1985), në Prekaz formohet këshilli i LPRK-së i përbërë nga Adem Jashari, Sami Lushtaku, Jakup Nura, Nuredin Lushtaku etj.⁹³ Adem Jashari si anëtar i LPRK-së, së bashku me Sami Lushtakun dhe të tjerë kishin organizuar protestat e viteve 1988, 1989, 1990, në Skenderaj etj, ndërsa kishin lidhje të pashkëputshme edhe me njërin nga udhëheqësit e LPRK-së, Fehmi Lladrovci.⁹⁴

Për shkak të arrestimeve të njëpasnjëshme dhe rrezikimit të aktivitetit ilegal, në shkurt të vitit 1986, Ahmet Haxhiu me pasaportë të Hamit Mustafës udhëton për në Gjermani, për të rivënë lidhjet mes shokëve të organizatës që vepronin jashtë vendit. Nga Gjermania, Ahmet Haxhiu kalon në Zvicër ku takohet me Emrush Xhemajlin, Ali Ahmetin, Xhavit Halitin, Mustafë Xhemajlin dhe Bexhet Luzhën⁹⁵. Pas kthimit nga Zvicra Ahmet Haxhiu, formon Këshillin e Rrethit të LPRK-së në Llap, ndërsa Kryetar zgjidhet Avdyll Mustafa –Mësuesi.⁹⁶ Nga shkurti i vitit 1986, e deri në vdekjen e tij më 1994, Ahmet Haxhiu, ka mbajtur lidhje të ngushta me Kryesinë e Këshillin e Përgjithshëm të LPRK-së, Dega Jashtë Vendit.⁹⁷

b). Mbledhja e Parë e Përgjithshme e LPRK-së

Për shkak të rrethanave të vështira dhe ndjekjeve të vazhdueshme nga pushteti, Mbledhja e Parë e Përgjithshme nuk kishte mundësi që të mbahet në Kosovë. Më 8 nëntor 1986, Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës, mban mbledhjen e saj konsultative në Zurich, ku formohet Grupi për Organizimin e Mbledhjes së Parë të Përgjithshme të saj me delegat në përbërje: Emrush Xhemajli, Gafurr Elshani dhe Hajdin Abazi.

⁹² Sabile Keqmezi – Basha, vepra e cituar.

⁹³ Emrush Xhemajli, vepra e cituar, 7

⁹⁴ Bedri Islami, Përjetësia e dyfyshtë, Tiranë 2008, 118-119.

⁹⁵ Emrush Xhemajli, deklaratë më 30.01.2009, Prishtinë

⁹⁶ Fehmi Pushkolli, Zahir Pajaziti –hero I Kombit, Prishtinë, 2001, f.148

⁹⁷ Bedri Islami, vepra e cituar

Mbledhja e Parë e Përgjithshme e LPRK-së, u mbajt në korrik 1987 në St. Gallen, Zurich dhe Delemont - Zvicër, ndërsa trojet shqiptare në ish -Jugosllavi i përfaqësonte Ahmet Haxhiu – Baca. Pjesëmarrja e tij në Mbledhjen e Parë të Përgjithshme të LPRK-së, ashtu si edhe fjala e tij, ishin pritur shumë mirë nga delegatët⁹⁸. Kjo Mbledhje, e cila zgjati tri ditë, zgjodhi edhe Kryesinë e re në përbërje: Fazli Veliu – Kryetar, Emrush Xhemajli - sekretar, Gafurr Elshani - përgjegjës financiar. Anëtar të Kryesisë zgjidhen: Avni Dehari, Ernest Jurstver, Xhavit Haliti dhe Rexhep Halimi.⁹⁹ Në këtë mbledhje Ahmet Haxhiu – Baca, u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshme të LPRK-së dhe anëtar i Kryesisë së këtij Këshilli. Ai u ngarkua edhe me detyrën e ndërlidhësit në mes të Organizatës në Kosovë dhe Degës Jashtë Vendit.¹⁰⁰ Organi ligjvënës i LPRK-së u emërua Këshilli i Përgjithshëm, i cili përbëhej prej 21 vetësh.

Në këtë kohë LPRK vepronte Jashtë Vendit, ndërsa në Kosovë dhe vise vepronte nën Komitetin Drejtues të OMLK-së.¹⁰¹ Ishte kjo periudhë e ndryshimeve të mëdha që po ndodhnin në shtetin e Jugosllavisë. Rinia Kosovare kishte filluar edhe një herë të shtrëngonte radhët e saj për t’u përballur me sundimin e egër të Beogradit. Serbia dëshironte t’ua hiqte Kosovës edhe atë pak autonomi që kishte.

Udhëheqja Komuniste e Kosovës nuk ishte e përgatitur kombëtarisht për t’u bërë ballë kërcënimeve që bëheshin hapur kundër Kosovës. Nga viti 1987 e deri në vitin 1989 LPRK, organizoi në Kosovë dhe në shtetet perëndimore qindra veprimtari për qëllimin programor të saj, duke e shtrirë rrjetin e saj të organizimit. Në demonstratën të organizuar nga LPRK më 31 tetor 1987, para ambasadës së Jugosllavisë në Bern, pos kërkesave për liri dhe barazi, në këtë protestë u kërkua nga organet Jugosllave që të lirohen të gjithë të burgosurit politik në krye me Adem Demaçin, i cili qe 25 vite po mbahej dhe torturohej nëpër kazamatet famëkeqe Jugosllave, vetëm e vetëm se nuk pajtohet me politikën pushtuese në Kosovë, vetëm për shkak të qëndrimeve të tija të pa tundura kundër robërisë, kolonizatorëve, shtypjes e shfrytëzimit si dhe kërkesës që Kosova të ketë statusin e Republikës.¹⁰²

⁹⁸ Ibish Neziri, Ahmet Haxhiu, një jetë e tërë në Lëvizjen Ilegale, fq.107 – 108.

⁹⁹ Emrush Xhemajli, 20 vjet veprimtari, 7.

¹⁰⁰ Ali Ahmeti, Kujtime, Ibish Neziri, vepra e cituar, fq.114,

¹⁰¹ Intervistë me Ramadan Avdiun, udhëheqës i LPRK-së në vitet 1989 – gusht 1993, marrë më 02 gusht 2008, Prishtinë.

¹⁰² Thirrje e LPRK-së për demonstratë, e cila u mbajt më 31 tetor 1987, në Bern, Zvicër.

Ndërsa në një Komunikatë të lëshuar më 12 dhjetor 1987, LPRK kundërshton vendimin e pushtetit Jugosllav pas mbajtjes së Plenumit të 9-të famëkeq të KQ të LKJ-së kundër Kosovës, për ndryshimin e flamurit kombëtar shqiptar. Përmes kësaj Komunikate, LPRK i ftonte të gjithë shqiptarët e ndershëm pavarësisht shtresës shoqërore, bindjeve politike, krahinës a fesë që i përkasin, të mbrojnë flamurin Kombëtar¹⁰³ Gjatë demonstratave të 19 – 21 nëntorit të vitit 1988, kur qindra e mijëra të rinjë e të reja, student e punëtorë kishin dalur në mbrojtje të autonomisë së Kosovës¹⁰⁴, në ballë të së cilës ishin Minatorët e Trepçës, LPRK, duke pasur edhe ndihmën financiare nga Kryesia e D.J.V, kishte siguruar armë, municione dhe paisje ushtarake, si dhe teknike moderne për propagandimin e çështjes shqiptare në ish - Jugosllavi.

Sigurimin e tyre e bënin veprimtarët e LPRK-së: Ahmet Haxhiu, Ali Reshani, Sahit Krasniqi, Shaban Muja dhe Arif Seferi.¹⁰⁵ Dega Jasht Vendit e LPRK-së, organizoi Demonstrata para Ambasadave të Jugosllavisë, në përkrahje të demonstratave në Kosovë dhe internacionalizimin e çështjes së Shqiptarëve.¹⁰⁶ LPRK, njoftonte zyrat e ndryshme diplomatike dhe opinionit Evropian, lidhur me gjendjen politike, sociale dhe ekonomike, të shqiptarëve nën Jugosllavi, të cilët ishin qytetatë të dorës së dytë, ndërsa rajoni ku jetonin shqiptarët ishte rajoni me i varfër në Jugosllavi. Poashtu LPRK, u bëntë thirrje popullit shqiptar edhe për vazhdimin e luftës përmes sabotimit të pushtetit serb, pengimit të ardhjes së kolonëve të rinj në Kosovë etj.¹⁰⁷ Shërbimi sekret shtetëror i ish-RSFJ-së, mendohej t'a pengonte, aktivitetin e LPRK-së dhe organizimin e mërgatës në përgjithësi, përmes njerzve të rekrutuar të saj. Ata pos ambasadave shpeshëherë arrinin që njerëzit e tyre t'i fusnin edhe në mesin e gurbetëqarëve, përmes klubeve, por edhe në organizimin ilegal. Shërbimi sekret Serb, kishte njohuri se „ emigracionit armiqësor shqiptar" veçanarisht LPRK-ja, kanë për qëllim të organizojnë demonstrata para përfaqësive diplomatike të Jugosllavisë. Në njoftimin e këtij shërbimi thuhej se „ në Zurich, LPRK, më datën 23 shkurt 1989, ka mbajtur mbledhje, në të cilën morën pjesë :Xhafer Shatri, vëllezërit Xhemajli, Ibrahim Kelmendi etj.

¹⁰³ Komunikatë e KP të LPRK-së, 12 dhjetor 1987.

¹⁰⁴ Rilindja e datës, 20 nëntor 1988, mundohet t'i paraqes këto demonstrate si tubime dinjitoze dhe në përkrahje të linjës së LKJ-së, dhe rrugës që e trasoi Tito., fq. 1.2.

¹⁰⁵ Emrush Xhemajli, LPK- 20 vjet veprimtari, 7.

¹⁰⁶ Komunikatë e LPRK-së, 26 nëntor 1988.

¹⁰⁷ Komunikatë e LPRK-së, 29 mars 1989, Prishtinë.

Mbledhja ishte e tipit të mbyllur dhe në të u vendos për bashkimin e të gjitha fraksioneve të LPRK-së, në një organizatë unike¹⁰⁸. Edhe në Kosovë dhe viset shqiptare në Jugosllavi, LPRK-ja dhe veprimtarët e saj, ndiqeshin dhe burgoseshin nga pushteti serb, për shkak të aktivitetit të dendur. Kështu në mars - prill 1989, në Divjakë, Malishevë, u mbajt Mbledhje e Parë e jashtëzakonshme e OMLK-së, në të cilën merrnin pjesë: Fadil Vata, Afrim Zhitia, Ali Ahmeti, Hajdin Abazi, Xhevat Ademi, Ilaz Kadolli, Sahit Krasniqi, Binak Berisha, Bardhyl Mahmuti, Behajdin Allaqi, Bajram Kadriu etj.¹⁰⁹

Në periudhën e iniciativës për ndryshimin e kushtetutës së atëhershme të Kosovës, aktivistët më të dalluar që e udhëhiqnin LPRK-në ishin: Fadil Vata, Afrim Zhitia, Ahmet Haxhiu, Arif Seferi, Fahri Fazliu, Bedri Sokoli, Ali Ajeti, Behajdin Allaqi, Ilaz Kadolli, Azem Sylja, Binak Berisha, Bardhyl Mahmuti, Ramadan Avdiu, Sabri Kiqmari, Halil Selimi, Beqir Beqa, Musa Demiri, Shaban Muja, Sahit Krasniqi, Hydajete Krasniqi, Ibish Neziri, etj.¹¹⁰ Këta veprimtar të LPRK-së, ndihmoheshin nga Dega jashtë Vendit, si: Ali Ahmeti, Hajdin Abazi, Shukri Buja, Isuf Sherifi, Emrush Xhemajli, Gafurr Elshani, Adem Grabovcin etj, të cilët bënë pjesë në organet drejtuese të LPRK-së dhe e ndihmonin organizatën në Kosovë, si nga pikëpamja politike, ashtu edhe për t'iu kundërvënë regjimit të atëhershëm të Jugosllavisë.

Gjatë kësaj periudhe në kuadër të LPRK-së formohet edhe sektori ushtarak, përmes të cilit LPRK, punonte në përgatitjen e popullit për kryengritje të armatosur, si opcion i fundit për zgjidhjen e çështjes së pjesëve të shqiptarëve të robëruar¹¹¹. Veprimtarët e LPRK-së kishin synim organizimin politik dhe strukturimin e organizatës, me futjen e armatimit në Kosovë, së paku për nevojat e aktivistëve dhe militantëve të LPRK-së, për krijimin e kushteve për kryerjen e aksioneve të mundshme guerlie në nivel të Kosovës.¹¹² Me çështjen e armatimit në këtë kohë janë marrë: Ahmet Haxhiu, Sahit Krasniqi, Skender Çeku, Ali Reshani, Halim Krasniqi, Ramadan Vishi etj, ndërsa plani i LPRK-së, ishte pajisja me armatim si një pjesë e strategjisë së përgjithshme për organizimin e luftës së armatosur.

¹⁰⁸ Fejton ekskluziv, Dokumente sekrete të Sekretariatit Federativ për punë të brendshme të RSFJ-së për Kosovën gjatë viteve 1983 – 1992, gazeta ditore ZERI, 29 maj 2000, fq.9.

¹⁰⁹ Ilaz Kadolli, intervistë, 12.09.2008 Prishtinë.

¹¹⁰ Xhavit Haliti, Si e bëmë UÇK-në, fejtton ekskluziv, Zëri, Prishtinë, 2003, fq.19

¹¹¹ Po aty.

¹¹² Emrush Xhemajli, deklaratë, 30.1.09

Në këtë kohë (1989 m.z.) veprimtarët e LPRK-së, kishin kryer disa aksione konkrete të cilat kishin për qëllim pengimin e eksploatimit të pasurive nëntokësore të serbisë nga Kosova.¹¹³ Në shkurt të vitit 1989, lirohet nga burgu i Zajçarit Ramadan Avdiu, i cili, në vitin 1984 ishte arrestuar bashkë me Afrim Zhitinë në kuadër të FÇK-së. Bashkëveprimtarët e tij të ilegalitetit: Afrim Zhitia, Fadil Vata dhe Bardhyl Mahmuti, e njoftuan me gjendjen organizative të LPRK-së si dhe me gjendjen mjaft eksplozive politik në Kosovë.¹¹⁴

Në vitet 1989 dhe '90 , drejtuesit më të lartë të LPRK, Fadil Vata, Afrim Zhitia, Ali Ahmeti, Bardhyl Mahmuti dhe Ramadan Avdiu, Hajdin Abazi, Hydajete Krasniqi, Shaban Muja etj, paralelisht janë marrë me organizimin e protestave dhe me forcimin e organizimit të radhëve të LPRK-së. Përmes organizimit të demonstratave, populli shqiptar i Kosovës mendohej t'u rezistoj sulmeve të vazhdueshme serbo-jugosllave, përderisa Republikat tjera në Jugosllavi, duke shpresur se asgjë e keqe nuk do t'u ndodh atyre, i miratonin në heshtje sulmet e Serbisë ndaj Kosovës. Serbët u bënë lëshime kombësive tjera në republikat e Jugosllavisë, por ata ngurrnin që këto lloj lëshime t'u bënin shqiptarëve të Kosovës, pasi ky rajon konsiderohej nga ta si „djep i historisë serbe“.

Megjithatë, pakënaqësitë e shqiptarëve të Kosovës në rritje, ndikuan edhe te popujt tjerë si në Kroaci dhe Slloveni që të shikojnë pozicionin e tyre në kuadër të Federatës Jugosllave¹¹⁵. Për të kundërshtuar vendimet e Kryesisë së LKJ-së dhe të LKK lidhur me ndryshimet kushtetuese, më 20 – 28 shkurt 1989, rreth 1500, Minatorë të Trepçës u hodhën në grevë 8 ditëshe në horizontin e 8, 9, 10 të Minierës së Trepçës. Grevat e Minatorëve të Trepçës u organizuan nga LPRK-ja dhe u përkrahën edhe nga studentët e UP-së të cilët në Sallën e Sporteve, poashtu hynë 7 ditë në grevë duke u solidarizuar me Minatorët. Protestat e qytetarëve, grevat e minatorëve dhe të studentëve të UP-së, shënuan kulmin e një rezistence të fuqishme kundër fushatës shoviniste të Sllobodan Millosheviqit, për rrënimin e autonomisë së Kosovës.

¹¹³ Po aty.

¹¹⁴ Ramadan Avdiu, Epoka e Re, 24.02.2004.

¹¹⁵ Uolltër Llakër, Europa në Kohën tonë, 1945 – 1992, Dituria, 2003, Tiranë, fq. 441.

Minatorët, studentët dhe intelegjencia Kosovare, paraqiti kërkesat e saj prej 10 pikash, ndër të tjera edhe atë për ruajtjen e parimeve themelore të Kushtetutës së vitit 1974, kërkesën për shqyrtimin e fatit të shqiptarëve në Jugosllavi, para OKB-së,¹¹⁶ si dhe dorëheqjen e udhëqësve marionetë të LKK-së: Rahman Morina, Ali Shukriu, Husamedin Azemi, Skender Karahoda dhe Tefik Llugini.¹¹⁷ Poashtu, më 21 shkurt 1989, 215 intelektual shqiptar të Kosovës, nënshkruan një APEL¹¹⁸, në të cilin ftonë opinionin publik të Jugosllavisë për rreziqet që i kanoseshin Autonomisë së Kosovës.¹¹⁹ Përkundër përpjekjeve, më 23 mars 1989, Slllobodan Millosheviqi me dhunë ushtarake dhe policore rrënoi Autonominë e Kosovës. Kundër këtij ndryshimi ishin vetëm 10 deputet të Kuvendit Krahinor të Kosovës: Melihate Tërmkolli, Sadik Zuka, Ukë Bytyqi, Shkelzen Gusia, Remzi Hasani, Menduh Shoshi, Riza Lluka, Bajram Buqani, Mehdi Uka dhe Agim Kastrati. Heqja në mënyrë të dhunshme e autonomisë së Kosovës, u shenua me demonstrata të cilat, po atë ditë(23 mars 1989) u organizuan nga studentët e UP-së, të cilët u përleshën me njësitë speciale të policisë jugosllave,¹²⁰. Protestat vazhduan edhe në ditët në vazhdim anë e mbanë Kosovës. Në këto demonstrata mbetën të vrarë 19 demonstrues dhe u plagosë qindra të tjerë¹²¹.

Më 28 mars 1989, regjimi Serb i Millosheviqit, vendosi gjendjen e jashtëzakonshme në tërë territorin e Kosovës, izoloi 300 intelektual Shqiptar si dhe burgosi me qindra të rinjë e të reja.¹²² Për të sqaruar opinionin vendor dhe për të vazhduar lufta deri në fitore përfundimtare, më 29 mars 1989, LPRK, përmes një komunikate¹²³ i bëu thirrje popullit shqiptar në Jugosllavi që edhe me forcë të vazhdojë rezistencën në të gjitha format e mundshme që t'a dëmtojë sa më shumë pushtuesin dhe t'i tregojë opinionit Jugosllav e atij botëror, se shqiptarët kurrë nuk do të pranojnë zgjedhën e robërisë.

¹¹⁶ Sylë Ukshini, Refleksione Historiografike, fq. 102 .

¹¹⁷ Raport I KP, për Mbledhjen e II të Përgjithshme të LPRK-së, shtator 1989.

¹¹⁸ Gazeta „ BORBA“ 25 shkurt 1989, Beograd

¹¹⁹ Revista Ekskluzive, 2000, fq.34,35. Prishtinë

¹²⁰ Sylë Ukshini, Refleksione Historiografike, fq. 103.

¹²¹ Komunikatë e LPRK-së, 29 mars 1989

¹²² Revista Ekskluzive,

¹²³ Komunikata e LPRK-së, u shkrua nga udhëheqësit e LPRK-së, Afrim Zhitia, Fadil Vata, Ali Ahmeti dhe Hajdin Abazi, ndërsa u shumëzua nga Ahmet Haxhiu – Baca dhe Shaban Muja – Magjupi dhe u shpërnda nga veprimtarët e LPRK-së në tërë Kosovën. E njëjta Komunikatë u shpërnda edhe tek mërgimtarët tanë në shtetet e perëndimit, nga data 17 prill 1989.

Më tej në komunikatë jepeshin edhe sqarime për format e rezistencës aktive që duhej të ndërmarrin populli i Kosovës në ato ditë të vështira ku po luhej edhe një herë me fatin e Kosovës.¹²⁴ Udhëheqësit e LPRK-së, Afrim Zhitia, Ramadan Avdiu, Fadil Vata dhe Bardhyl Mahmuti, e kishin shkruar dhe shpërndarë një trakt në të cilin i bëhet thirrje popullit për të dalur në demonstratë më 30 maj 1989, ditën kur një delegacion i Parlamentit Evropian kishte ardhur në Kosovë, me qëllim që të shihnin nga afër zhvillimet në Kosovë, pas shfuqizimit të dhunshëm të autonomisë së Kosovës.¹²⁵ Parlamentarët erdhën në Kosovë dhe nën organizimin e LPRK-së në Prishtinë, para Hotelit Grand shpërthyen demonstratat në të cilën u brohorit parolla „ *Parlament, mos lejo aparthejd dhe parolla tashmë e njohur, Jo jo, Serbi, nuk do të jesh Perandori*“!¹²⁶

Gjatë vitit 1989, kur Serbia e ndihmuar nga udhëheqësit e Kosovës, Rahman Morina, Husamedin Azemi etj. të cilët ishin në shërbim të tyre, intestifikuan dhunën dhe shkeljet mbi popullin e Kosovës, udhëheqësit e LPRK-së: Afrim Zhitia, Fahriu Fazliu, Fadil Vata, Ali Ajeti, Ramadan Avdiu etj, organizuan disa demonstrata kundër heqjes së autonomisë së Kosovës dhe e ripërsëriti kërkesën për Kosovën Republikë.¹²⁷ Njëra nga demonstratat më të përgjakshme ishte ajo e zhvilluar më 30 maj të vitit 1989 në qytetin e Podujevës dhe fshatrave të saj, ku operonin shumë anëtarë të LPRK-së. Në këto demonstrata, u vra Ali Ajeti, një nga udhëheqësit e LPRK-së.

Demonstratat vazhduan deri në muajin qershor 1989, gjatë së cilës veprimtarët e LPRK-së në Podujevë, Bajram Ajeti, Ali Ajeti, Sabri Kiçmari, Hasan Ramadani Nazmi Llapashtica, Zahir Pajaziti, Gani Hoxha, Ismet Abdullahu, etj, formuan grupin e armatosur „Çeta e Llapit“.¹²⁸ Pas takimeve që pati me këtë grup, Kryetari i LPRK-së, Afrim Zhitia, kjo çetë pushoi veprimtarinë e saj.¹²⁹

¹²⁴ Komunikatë e LPRK-së e lëshuar më 29 mars 1989 e cial u shpërnda në të gjitha qytetet dhe fshatrat e Kosovës, por edhe në viset tjera shqiptare nën Jugosllavi“. Arkivi i LPRK-së, Zvicër, 29 mars 1989.

¹²⁵ Ramadan Avdiu, 01.2.2009

¹²⁶ Po aty, fq. 132 - 133

¹²⁷ Emrush Xhemajli, vepra e cituar, 8.

¹²⁸ Gazeta „Zëri“ Fejton ekskluziv, Pesëvjetori i luftës në Kosovë, Xhavit Haliti, njëri ndër themeluesit e UÇK-së, e hënë, 24 mars 2003, fq. 6

¹²⁹ Ramadan Avdiu, deklaratë, 01 shkurt, 2009.

c) Mbledhja e Dytë e Përgjithshme e LPRK-së.

Në kohën e zhvillimeve të mëdha në Kosovë, të demonstratave, dhe ndryshimeve ideologjike në mbarë Evropën Juglindore, LPRK bënte përpjekje për vazhdimin e rezistencës aktive, si i vetmi subjekt politik ilegal i organizuar mjaft mirë në Kosovë dhe shtetet Perëndimore. Në shtator të vitit 1989, për shkak se Prishtina ishte qendër e studentëve dhe zhvillimeve politike, LPRK konsolidoi Këshillin e Rrethit të Prishtinës, kryetar i të cilit është zgjedhur Ramadan Avdiu. Po atë muaj gjatë një aksioni të shpërndarjes së trakteve janë zbuluar dhe pastaj janë arrestuar disa veprimtarë të LPRK-së. Arrestimi i tyre bëri që të rrezikoheshin edhe Fadil Vata dhe Afrim Zhitia. Në atë kohë Afrimi ishte sërish në kryerje të shërbimit ushtarak në Shibenik të Kroacisë. Pas dërgimit të një telegrami ai kishte ardhur në Kosovë dhe pas shoshitjes së situatës është vendosur që këta dy veprimtarë të futen në fshehtësi të thellë.

Fillimisht Fadil Vata, Afrim Zhitia, Bardhyl Mahmuti kanë qëndruar në shtëpinë e Ramadan Avdiut, dhe për tri ditë rresht, kanë biseduar për mundësinë e daljes nga situata e krijuar, sepse kalimi i tyre në ilegalitet të thellë, përveç se iu pamundësonte lëvizjet e lira dhe iu bënte shumë kufizime, mund të sillte rrezik për krejt organizimin.¹³⁰ Si pasojë e torturave në kazamatet Jugosllave, Fadil Vata ishte shumë i sëmurë dhe LPRK mori vendim që ai të të dërgohet menjëherë jashtë vendit, ngase ishte e domosdoshme të shtrihej në spital. Pas kalimit të Fadilit në Zvicër, Ramadan Avdiu kooptohet në udhëheqjen më të lartë të LPRK-së.¹³¹

Në fillim të tetorit 1989, në Kosovë, mbahet mbledhja e Komitetit Drejtues të LPRK-së. Në këtë mbledhje merrnin pjesë: Afrim Zhitia, Bardhyl Mahmuti, Behajdin Allaqi, Binak Berisha, Ilaz Kadolli, ndërkaq mungonte një anëtar i komitetit, Bajram Kadriu. Ndër të tjera në këtë mbledhje u vendos që, LPRK të organizoj demonstratë ditën e fillimit të procesi gjyqësor kundër dy udhëheqësve të Trepçës, Burhan Kavaja dhe Aziz Abrashi, të cilët akuzoheshin për organizimin e grevave të minatorëve, u aprovua plani i ristrukturimit të organizatës dhe masat që duheshin ndërmarrë për të parandaluar goditjet e arrestimeve të reja nga ana e UDB-së.

¹³⁰ R.amadan Avdiu, Epoka e Re, 24.02.2004.

¹³¹ LPRK, kishte angazhuar Rexhep Avdiun që të merret me dërgimin e Fadil Vatës për shërim në Zvicër.

Për Afrimin, u vendos që pas sistemimit të të gjitha lidhjeve dhe përfundimit të procesit të ristrukturimit të kalojë jashtë vendit.¹³² Edhe pse ishin bërë të gjitha përgatitjet, për shkak të gjendjes së krijuar, dhe për shkak se LPRK, vepronte në ilegalitet të thellë në Kosovë dhe troje shqiptare në ish -Jugosllavi, Mbledhja e Dytë e Përgjithshme e LPRK-së, u vendos që të mbahet në Zvicër, ku aktivisht punonte dega e LPRK-së, jashtë vendit.¹³³ Në pjesën e dytë të tetorit të vitit 1989, në Baden dhe Ollten - Zvicër, mbahet *Mbledhja e Dytë e Përgjithshme e LPRK-së*. Kryesia e LPRK-së në Kosovë, e cila më herët kishte mbajtur Mbledhje konsultative, kishte vendosur, që LPRK-në nga brenda ta përfaqësonin: Ahmet Haxhiu- Prishtinë, Fadil Vata, Suharekë dhe Arif Seferi – Kumanovë. Mbledhja e Dytë e Përgjithshme e LPRK-së, analizoi punën dyvjeçare të saj dhe shtroi detyrat për dy vjetët e ardhshme. Në Mbledhje u aprovua raporti i Këshillit të Përgjithshëm të LPRK-së si dhe raporti i Kolegjiumit të Redaksisë „ Zëri i Kosovës“.¹³⁴ Mbledhja e Dytë e Përgjithshme e LPRK-së, bëri ndryshime në Programin dhe statutin e saj, në përputhje me zhvillimet aktuale, aprovoi rezolucionet e Mbledhjes dhe u mori vendime të veçanta.¹³⁵

Pas Mbledhjes së Dytë të Përgjithshme , LPRK, më 27 tetor 1989, kur pushteti jugosllav po përgatitej për rrëzimin dhe gjykimin e udhëheqësve shqiptar të Kosovës, përmes të cilëve mendohej të dënoj përpjekjet e shqiptarëve për liri e të drejta kombëtare, si dhe të rrënoj edhe atë pak autonomi që kishte fituar në vitin 1974, përmes një thirrje drejtuar popullit shqiptar në ish-Jugosllavi, i ftonte ata që përmes grevave, demonstratave dhe bojkotimit, t'a demaskoj botërisht karakterin thellësisht antishqiptar të këtij procesi të montuar gjyqësor.¹³⁶ Më 2 nëntor 1989, në Prishtinë LPRK, kishte organizuar një demonstratë të fuqishme kundër riokupimit që po i bëhej Kosovës.

¹³² Ramadan Avdiu, . Epoka e Re, 24.2.2004

¹³³ Po aty.

¹³⁴ Raporti i KP të LPRK-së, prej 18 faqesh, lëshuar në shqyrtim për delegatët e MDP-së, në shtator 1989, analizonte me hollësi dhe largpamësi politike, situatën politike ndërkombëtre, luftën e popujve për liri dhe demokraci, situatën politike në Ballkan, Jugosllavi, veqanarisht situatën politike dhe ekonomike në Kosovë.

¹³⁵ Në rezolucinet e LPRK-së të lëshuar nga Mbledhja e Dytë e Përgjithshme veq tjerash thuhet se „ Këto dy vitet e fundit lufta e popullit shqiptar në RSFJ për Republikë, shkoi duke u rritur, forcuar dhe zgjeruar. Lufta jonë do të ngadhënjejë vetëm me zgjerimin e forcimit e frontit të të gjithë popullit për Republikë “ , Komunikatë e LPRK-së, tetor 1989 Rezolucionet e Mbledhjes së Dytë të Përgjithshme të LPRK-së.

¹³⁶ Trakt i LPRK-së, lëshuar më 27 tetor 1989, I cili u shpërnda në Kosovë dhe viset shqiptare, ndërsa jashtë vendit filloi të shpërndahet më 29 nëntor 1989. E njejta thirrje, iu bëhej popujve të ish Jugosllavisë, që të dalin në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve të Kosovës, e cila u lëshua më 07.11. 1989, në gjuhën serbokroate.

Në këto protesta gjithëpopullore ishte dalluar, Afrim Zhitia, i cili në këtë kohë ishte udhëheqës i LPRK-së. Po këtë ditë, pasi protesta kishte përfunduar, Afrimi do të gjendet i rrethuar bashkë me Fahri Fazliun në banesën e Fahriut në Breg të Diellit, dhe pas një lufte të pabarabartë për disa orë ata bien heroikisht. Edhe në qytete tjera të Kosovës ku kishte pasur demonstrata, armiku plagosi dhjetra demonstrues, ndërsa arrestoi qindra të tjerë.¹³⁷

Me rënien e Afrimit dhe Fahriut, emigrimi i Fadil Vatës¹³⁸ dhe Bardhyl Mahmutit, si dhe i disa veprimtarëve të tjerë fillimisht u rrezikua edhe aktiviteti ilegal politik i LPRK-së, por ajo nuk u hamend për asnjë çast.¹³⁹ Në gjysmën e Nëntorit 1989, u mbledh Komiteti Drejtues i LPRK-së, dhe u vendos që LPRK të vazhdojë me protesta dhe njëkohësisht gjetjen e lidhjeve që kishin mbetur të shkëputura. Në Janar 1990, LPRK, ka lëshuar dhe shpërndarë një Thirrje, përmes së cilës kërkonte që „ të vazhdohet rezistenca kundër pushtesve, që të afrohet populli mes vete dhe të dëshmojë unitet të fortë në luftë për çlirim, dhe ndër të tjera kërkohet edhe të tejkalohen hasmëritë në mes të familjeve shqiptare.”¹⁴⁰ Në këtë kohë, LPRK, mori vendim që deri në Konferencën zgjedhore, LPRK, të drejtohet sipas planifikimeve të parapara më herët, duke vazhduar me organizim e protestave popullore deri në fund të shkurtit 1990.¹⁴¹

LPRK kishte formuar sekretariatit e saj, i cili kishte rol udhëheqës të organizatës, në përbërje: Ramadan Avdiu, Behajdin Allaqi, Halil Selimi dhe Ismet Sylejmani. Ata vazhduan veprimtarinë e LPRK-së dhe rrugën e çlirimit e të propagandimit të programit politik.¹⁴² Natyrisht, ata bashkëpunonin me veteranët e Lëvizjes Popullore të Kosovës, Ahmet Haxhiun - Bacën,¹⁴³ ndërsa në Kumanovë dhe trojet shqiptare në Maqedoni, lidhjet i mbanin me ardhëtarin dhe veprimtarin, Arif Seferi, i cili si anëtar i LPRK-së, bënte përpjekje që, kërkesa për Republikën e Kosovës, duke u përfshirë edhe viset shqiptare në Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi të bëhej realitet.¹⁴⁴

¹³⁷ Komunikatë e KP të LPRK-së, 3 nëntor 1989, Zëri i Kosovës, botim i veçantë, nëntor 1989, fq.1.

¹³⁸ Pas përfundimit të Mbledhjes së Dytë të Përgjithshme të LPRK-së, njëri nga udhëheqësit e saj dhe delegat në MDP, Fadil Vata, për shkak të torturave në burgjet Jugosllave ishte shtrirë në spitalin e Bazelit në Zvicër. Veprimtarët e LPRK-së, d.j.v, kishin bërë shumë përpjekje, për shërimin e tij, por sëmundja e kishte rënduar aq shumë dhe më 24 prill 1990, Fadil Vata vdes në spital.

¹³⁹ Emrush Xhemajli, LPK, 20 vjet veprimtari.....10.

¹⁴⁰ Thirrje e LPRK-së, janar 1990, Prishtinë

¹⁴¹ Ramadan Avdiu, 24.2.2004, Epoka e re.

¹⁴² Ramadan Avdiu, 01.2.2009

¹⁴³ Po aty.

¹⁴⁴ Avni Dehari, Destan Hajdini, Arif Seferi në shërbim të popullit, monografi, Zvicër, 1993.

KAPITULLI I DYTË

1. Veprimtaria e LPRK-së 1990 - 1993

Viti 1989, që e majta në gjithë botën e kishte planifikuar për të festuar 200 vjetorin e revolucionit Francez, që thuhej se ishte periudha e fillimit të politikës radikale, u kthye në diçka tjetër, në një vit revolucionesh dhe në fakt kundër sundimit të marksizëm - leninizmit. Më 4 nëntor në Berlinin lindor marshuan mbi 1 milion vetë. Pesë ditë më vonë muri i Berlinit që ndante Gjermanët ra. Më 24 nëntor pas demonstratave në Pragë udhëheqja komuniste dha dorëheqje, dhe më pas Vaclav Haveli u zgjodh President.¹⁴⁵ Mbas një takimi të nivelit të lartë në bordin e një anije në Maltë, më 3 dhjetor 1989, zëdhënësi sovjetik Genadi Gerasimov tha „Lufta e ftoftë mbaroi sot në ora 12.45 minuta.”¹⁴⁶ Kjo klimë e ndryshimeve dhe pluralizmit demokratik në Evropën lindore kishte filluar të ndjehet edhe në Kosovë. Ndryshimet politike në Jugosllavi, ndryshe nga vendet e tjera të Evropës Juglindore, kishin ndodhur shumë më parë se në vitin 1989.

Protestat në rajonin e Kosovës vazhduan, ndërsa tensionet në mes të Serbisë dhe Republikave tjera u bënë intenzive. Sllovenia dhe Kroacia përgatiteshin të dilnin nga Federata¹⁴⁷. Në fakt, shqiptarët qysh në vitin 1981, kishin filluar të parët shkatërrimin e Jugosllavisë me protestat e tyre të njohura, por tani ishte një situatë krejt tjetër dhe ata më lehtë kuptoheshin nga popujt e Republikave të tjera në Jugosllavi. Edhe në trojet tjera shqiptare në ish-Jugosllavi u formuan parti politike me orientim demokratik. LDK, partia më e madhe legale e Shqiptarëve në Jugosllavi u formua më 23 dhjetor 1989 dhe shumica e shqiptarëve të Kosovës u anëtarësua në LDK, të cilën e udhëhiqte dr.Ibrahim Rugova. Pas formimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës -LDK, u formuan edhe Partia Fshatare e Kosovës -PFK, Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës - PSHDK, Partia Social Demokrate e Kosovës - PSDK etj. LPRK ka përkrahur dhe mbështetur krijimin e partive politike, me bindjen se me formimin dhe shtrirjen e tyre do të përshpejtohet shpartallimi i LKJ-së dhe mekanizmave të tjera të saj.

¹⁴⁵ Poll Xhonsion, Kohët Moderne, Bota nga 1920 – 1990, Apollonia, 2000, Tiranë, fq. 324.

¹⁴⁶ Po aty, fq.332.

¹⁴⁷ Uolltër Llakër, Europa në Kohën tonë, 1945 – 1992, Dituria, 2003, Tiranë, fq.453.

Por, e keqja këtu qëndron se strukturat e LKJ-së, ashtu siç ishin, vetëm barteshin kryesisht në LDK, kurse strukturat e LSPP-së, në Partinë Fshatare dhe ato pastaj vazhdonin punën e tyre brendapërbrenda LDK-së. Partitë që ishin krijuar në vitin '90 praktikisht nuk kanë bërë asgjë, përveç se kanë ndikuar që Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë të zhduket si nocion por jo edhe si strukturë.¹⁴⁸

LPRK, e dëmtuar shumë nga burgosjet dhe rënia e dy udhëheqësve të saj Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, si dhe vdekja e udhëheqësit tjetër, Fadil Vata, u ndodh para situatave sfiduese. Ajo ishte bartëse e aktivitetit ilegal në Kosovë dhe viseve shqiptare në Jugosllavi, prandaj duhej angazhim dhe vizion i shumëanshëm për të qenë në ballë të kërkesave të kohës. Njëkohësisht LPRK-së i duhej edhe ndryshimi i kursit ideologjik, sepse tani kur erërat e sistemit demokratik kishin filluar të ndjeheshin edhe në trojet shqiptare, sidomos kur në Shqipëri po ndodhte shkatërrimi dhe rënia e kultit të Enver Hoxhës, LPRK duhej të mendonte të përshtatej konform rrethanave të krijuara. Më 24 dhjetor 1989 dhe 31 janar 1990 LPRK organizoi, demonstrata të fuqishme në mbarë Kosovën, ndërsa më 11 shkurt 1990, pas 27 vjet burg të rëndë lirohet nga burgu simboli i rezistencës Kombëtare të Shqiptarëve, Adem Demaçi. Dalja në liri e simbolit të rezistencës kombëtare sikur e ngjalli pak veprimtarinë ilegale dhe shqipëtarët e Kosovës.

Ata kishin shpresë se Adem Demaçi do të udhëhiqte rezistencën aktive në Kosovë dhe se kërkesat e shqiptarëve për Republikë do të realizohen më lehtë.¹⁴⁹ Pas rrënimit të autonomisë dhe vendosjes së pluralizmit nën okupim, vija vazhduese e ngjarjeve të vitit 1981(tash të njohur si ish të burgosur politik) nuk krijoi parti të vetën legale, por u inkuadruan në partitë ekzistuese dhe sidomos në LDK që vlerësohej për momentin si një levizje legale kombëtare. Levizja ilegale (LPRK) vazhdoi veprimin në ilegalitet duke e vlerësuar situatën si të pa përshtatshme për legalizim, sepse Kosova me Serbinë do të ndahej vetëm me luftë dhe asaj i duhet një strukturë ilegale për ditët e vështira.¹⁵⁰ Gjatë muajve Janar, shkurt dhe mars 1990, gjendja politike në Kosovë ishte shumë e tensionuar, ndërsa tendenca e pushtesit serb për të shkatërruar çdo gjë shqiptare ishte në kulmin e saj.

¹⁴⁸ Ramadan Avdiu, Epoka e Re, 24.2.2008

¹⁴⁹ Zëri i Kosovës, mars 1990

¹⁵⁰ Ibrahim Shala Prishtinë, 22.11. 2001, Botuar në vazhdimë, "Epoka e re" 11-16 mars 2002, Prishtinë

Kjo gjendje ishte e padurueshme për popullin shqiptar të Kosovës, prandaj edhe një herë, populli i Kosovës doli në rrugë për të protestuar.¹⁵¹ Në këto demonstrata, të cilat i organizonte LPRK-ja, ranë heroikisht 28 protestues ndërsa u plagosën 119 të tjerë.¹⁵² LPRK, përmes një Komunikate të shpërndarë më 6 janar 1990, e cila iu dërgohej Kongresit të 14 –të të LKJ-së, u bënte thirrje popullit shqiptar për vazhdimin e luftës deri në realizimin e kërkesave të drejtave të popullit shqiptar, që familjet e armiqësuar të pajtohen, ndërsa të demaskohen dhe denohen spiunët dhe tradhëtarët.¹⁵³

Nga data 24 janar 1990 e deri më 20 shkurt 1990, LPRK, organizoi demonstrata masive në shumë qytete të Kosovës. Demonstrata më e përgjakshme u mbajt në Glllogovc, të cilën e organizuan veprimtarët e LPRK-së, Ramiz Lladrovci, Xhevë Krasniqi, Shemsije Istogu – Lladrovci. Në këtë protestë Xhevë Krasniqi – Lladrovci, mbajti një fjalim.¹⁵⁴ Protesta të ngjajshme, më 17 shkurt 1990, LPRK, organizoi edhe në shtetet e Evropës Perëndimore, si në Zurich, Berlin, Oslo, Goteborg etj, në shenjë përkrahje të demonstratave në Kosovë.¹⁵⁵ Për shkak të gjendjes së krijuar, më 21 shkurt 1990, Sekretari Krahinor i Punëve të Brendshme të Kosovës, Jusuf Karakushi, dha urdhër për orë policore në tërë Kosovën, e cila fillonte nga ora 21.00, dhe zgjaste deri në orën 04.00 të mëngjesit.¹⁵⁶

Për Lëvizjen ilegale në Kosovë, veçanarisht për LPRK-në, viti 1990 ka qenë viti i sfidës së madhe. Krijimi i partive politike legale, ndikoi që edhe disa veprimtarë të LPRK-së të kishin kërkesa që LPRK të legalizonte veprimtarinë e saj, ndërsa në anën tjetër, kishte kërkesa për të kaluar në fazë të re të rezistencës së armatosur. Kryesia e LPRK-së, sipas analizave që kishte bërë, konsideronte se është e domosdoshme të ruhet struktura e organizimit ilegal, sepse po të legalizohej veprimtaria e LPRK-së, pos rrezikimit të disa veprimtarëve (meqë LPRK kishte kryer edhe aksione diversive), nuk do të mund të bënte asgjë më shumë se ndonjë parti që krijohet dhe ishin mundësitë e kufizuara të veprimit.¹⁵⁷

¹⁵¹ Rilindja, 24 dhjetor 1989, 31 janar 1990, 11 shkurt 1990.

¹⁵² Zëri i Kosovës, mars 1990

¹⁵³ Komunikatë e LPRK-së, janar 1990, Prishtinë

¹⁵⁴ Bedri Islami, vepra e cituar, fq. 223.

¹⁵⁵ Arkivi i LPRK-së, Dega Jashtë Vendit

¹⁵⁶ Revista, Ekskluzive, 2000, fq. 39.

¹⁵⁷ R.amadan Avdiu, Epoka e Re, 24.2.2008

Pikërisht në këtë kohë, LPRK filloi të përgatitej për aksione të armatosura në konspiracion tepër të thellë. Vetëm disa njerëz të zgjedhur të cilët ishin piketuar nga sektori ushtarak i organizatës kishin njohuri për këto përgatitje. Kjo paraqiste një fazë të vështirë për LPRK-në, për shkak të aktivitetit të shtuar, lëvizjeve dhe kontakteve të shumta, me anëtar të LPRK-së nëpër qytete të Kosovës, sepse ishte rreziku i dekonsiprimimit dhe arrestimit të tyre.¹⁵⁸ Gjatë vitit 1990, veprimtaria e LPRK-së, është zhvilluar edhe nëpër tubime të hapura me qytetarë dhe në Aksionin për Pajtimin e Gjaqeve. Veprimtarët e LPRK-së kanë qenë forca motorike edhe e këtij aksioni, ndërkaq në strukturën udhëheqëse të organizatës janë kooptuar Halil Selimi nga Presheva dhe Mentor Kaçi nga Gjakova. Gjatë kësaj kohe, veprimtarë të LPRK-së, kanë shpërndarë trakte dhe buletinin e “Zërit të Kosovës” - “Rruga e Lirisë”.¹⁵⁹ Pas Komunikatave të LPRK-së, të lëshuar më 29 janar, 3 shkurt dhe 20 mars 1990¹⁶⁰, përmes së cilave LPRK-u bënte thirrje familjeve të armiqësuar që të ofrojnë dorën e pajtimit, në fillim të shkurtit, një grup i të rinjëve nga Peja, disa nga të cilët kanë qenë anëtarë dhe simpatizant aktivë të LPRK, e kanë filluar aksionin, duke ndërhyrë për pajtim së pari në Lumëbardh pastaj edhe në disa raste në Rrafsh të Dukagjinit.

Ideja për pajtimin e gjaqeve ka lindur nga një grup i studentëve të burgosur në proceset e njohura politike pas demonstratave të vitit 1981, pas lirimit nga burgu të një pjese të tyre, një grup studentësh dhe studenteve nga Peja. Meqë ata ishin të rinjë, kërkuan ndihmë nga personalitete me ndikim. Kështu iniciativa e tyre u shtri, kuptohet në radhë të parë përmes tyre, në tërë Kosovën, dhe aksioni mori përmasat e një lëvizjeje gjithëpopullore.¹⁶¹ Nismëtarët e parë të pajtimit të gjaqeve kanë qenë veprimtarët e LPRK-së: Adem Grabovci, Hava Shala, Ibrahim Dreshaj, Lulëzim Etemaj, Myrvete Dreshaj, etj,¹⁶² të cilët kanë filluar aksionin e pajtimit të gjaqeve në Kosovë. Idesë për pajtimin e gjaqeve ndihmë të madhe u kishte dhënë edhe falja e një gjaku në mes të dy minatorëve të futur në horizontet e Trepçës, të cilët më herët kanë pasur raporte hasmërie.

¹⁵⁸ „Njëri nga udhëheqësit e LPRK-së, Behajdin Hallaqi në masë të madhe ishte dekonspiruar, kështu që edhe ai kërkoi të lirohet nga Komiteti Drejtues dhe të mbetet i përqëndruar më shumë në Prizren dhe të kufizohet në lëvizje, ngase kishte dyshime se është shumë i përcjellur.“ Ramadan Avdiu, Epoka e Re, 24.2.2008

¹⁵⁹ Po aty

¹⁶⁰ Komunikatat e LPRK-së, drejtuar popullit shqiptar në Jugosllavi, të lëshuar më 29 janar, 3 shkurt dhe 20 mars 1990. Arkivi i LPRK-së, Prishtinë.

¹⁶¹ Anton Çetta, Intervistë, gazeta Fjala, nr. 20 shtator 1990, fq.27

¹⁶² Po aty

Kjo pajtesë, u bë publike dhe pati shumë jehonë pozitive tek të ë gjithë qytetarët e Kosovës.¹⁶³ Të trimëruar nga ky rezultat, veprimtarët e LPRK-së, kishin biseduar edhe me shumë intelektual dhe patriot për të vazhduar me pajtimin e ngatërresave dhe gjaqeve edhe në pjesët tjera të Kosovës. Atyre fillimisht u kishin bashkangjitur edhe veprimtar tjerë të LPRK-së, si: Nuriye Zekaj, Flamur Gashi, Ramë Buja, Akile Dedinca, Naser Veliu, Ibish Neziri, Jashar Salihu, Bajram Kurti, Serbeze Vokshi,¹⁶⁴ ndërsa më vonë kanë kërkuar nga disa personalitete që njiheshin kryesisht në nivelet akademike që të kyqen në aksion dhe të paktën të jenë të pranishëm në ceremonitë e faljes së gjakut, apo në momentin e shtrirjes së dorës së pajtimit.

Këshillat e Pajtimit, që janë krijuar më pastaj nëpër mjedise të ndryshme në Kosovë, kanë qenë të dominuara nga anëtarët e LPRK. Këto këshilla e kanë përgatitur terrenin, i kanë zhvilluar të gjitha negociatat për falje dhe në fund, kur organizohej ballafaqimi i familjeve të hasmuara për të shtrirë dorën e pajtimit, në ato ceremoni kanë marrë pjesë edhe personalitete të jetës kulturore e shkencore të Kosovës. Gjatë muajve mars, prill, maj të vitit 1990 në Kosovë, këta veprimtar, shumica nga ta të burgosur politik, në Prishtinë u takuan me, profesor Zekirija Canën, i cili e ka marrë përsipër të bisedoj edhe me plakun e urtë e të mençur të Kosovës, Anton Çetta, të cilët e përkrahën këtë lëvizje për pajtim.¹⁶⁵

Lëvizja për pajtim ishte përkrahur edhe nga shumë intelektualëve patriot dhe të të burgosurve politik që sapo kishin dalë prej burgjeve dhe kazamateve serbe. Aksioni për pajtimin e gjaqeve, bëri jehonë të madhe në tërë Kosovën dhe viset shqiptare, si një e keqe, e cila duhej larguar njëherë e përgjithmonë¹⁶⁶. Veprimtarët e LPRK-së, ndihmuan shumë në organizimin e tubimeve për pajtimin e gjaqeve nëpër fshatra dhe qytete të ndryshme të Kosovës. Njëri ndër ta ishte tubimi kryesor për pajtimin e gjaqeve në Kosovë te „Verrat e Llukës" i mbajtur në Komunën e Deçanit, i cili u organizua dhe u udhëhoq nga veprimtarët e LPRK-së¹⁶⁷

¹⁶³ Po aty.

¹⁶⁴ Po aty.

¹⁶⁵ Ibrahim Dreshaj, intervistë në gazetën „Zëri i Kosovës”nr.1, 9 janar 1991.

¹⁶⁶ Adem Grabovci, njëri nga udhëheqësit e LPRK-së dhe të aksionit për pajtimin e gjaqeve, deklaratë e dhënë më 20. Janar 2009, Prishtinë.

¹⁶⁷ Këtë tubim, të pajtimit të gjaqeve ku morën pjesë qindra e mijra shqiptar, e udhëhoqi Jashar Salihu, veprimtar i LPRK-së, i cili më vonë (në vitet 1993 -1999), ishte Kryetar i Fondit të UÇK-së „Vendlindja thërret“, propagandues në shtetet e Perëndimit i UÇK-së, ndërsa gjatë bisedimeve për Kosovën në Rambuje, anëtar i Grupit diplomatik të Drejtorisë Politike të UÇK-së(M. Z)

Në përkrahje të çështjes së pa zgjidhur të shqiptarëve në Jugosllavi, dhe demonstratave që po ndodhnin në Kosovë, LPRK, D.J.V,¹⁶⁸ nga data 19 maj e deri më 02 qershor 1990, organizoi demonstratë dyjavore para selisë së OKB-së në Gjenevë. Nga kjo demonstratë, ku morën pjesë mbi njëqind mijë mërgimtarë, një peticion me 23.800 nënshkrime për njohjen e të drejtave të shqiptarëve të ish-Jugosllavisë iu dërgua Sekretarit të OKB-së, z. Peres De Kuelar, Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Asamblesë së përgjithshme të OKB-së etj.¹⁶⁹ Në peticion, dërguar qendrave botërore të vendosjes, kërkohej që të caktohet një komision i hetimit i OKB-së, që të shkoj në Kosovë dhe të konstatoj gjendjen në vend, të mirren sanksione ekonomike kundër republikave Jugosllave (Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi), si dhe Qeverisë Federative të Jugosllavisë ti ndërpriten të gjitha beneficionet si anëtare e OKB-së. Poashtu njoftoheshin qendrat e vendosjes për terrorin, vrasjet, shpërnguljet e shqiptarëve dhe burgosjet që ka bërë e po bën Jugosllavia nga viti 1945 e deri në vitin 1990.¹⁷⁰ Kësaj Proteste dy javore, pos mediave shqiptare, një publicitet të madh i dha edhe shtypi Zvicran.¹⁷¹

Gjatë muajve prill - maj 1990, LPRK organizoi nënshkrimin e peticionit drejtuar Kuvendit të Kosovës me kërkesën që ai të shpall Republikën e Kosovës, i cili me gjithë presionin dhe dhunën që ushtronte pushteti Jugosllav, në Kosovë, nuk i pranoi masat e dhunshme të Serbisë. Kështu filloi diferencimi dhe diskriminimi edhe i deputetëve shqiptar të Kuvendit të atëhershëm të Kosovës që udhëhiqej nga Iljaz Ramajli, dhe Qeverisë së atëhershme të Kosovës, edhe ashtu pa kompetenca. Kërkesë e Populli shqiptar të Kosovës në vitin 1990, ishte që, Kosova patjetër duhet të jetë Republikë në Kuadër të Federatës Jugosllave, por në qoftëse kjo federatë shkatërrohet, atëherë Kosova doemos duhet të jetë shtet i pavarur.”¹⁷²

¹⁶⁸ LPRK, d.j.v., deri në vitin 1991 ishte organizata më e shtrirë dhe më me ndikim tek mërgimtarët shqiptar në shtetet e Evropës Perëndimore, veçanërisht në Zvicër, ku nga dhuna dhe terrori serb, ishin strehuar një numër i madh i veprimtarëve të saj.

¹⁶⁹ Komunikatë e LPRK-së, d.j.v, qershor 1990, Peticion dërguar OKB-së , 19 maj – 2 qershor 1990, Zvicër

¹⁷⁰ Peticion dërguar OKB-së , 19 maj – 2 qershor 1990, Zvicër (sëbashku me tekstin e Peticionit, delegacioni I LPRK-së, OKB-së ia dorëzoi edhe listën me 164 shqiptar të vrarëve nga viti 1981, listën me 202 të plagosurve gjatë vitit 1990, listën me 1660 të borgosur dhe dosjen me qindra procese të montuar politike etj.

¹⁷¹ Gazeta „ Le Courier“ e datës 19.6.1990, „ 24 Heurs“, e datës 21 maj 1990, „Tribun de Genevë“ etj.

¹⁷² Aktivisti më i dalluar i LPRK-së në mbledhjen e nënshkrimeve drejtuar Parlamentit të Kosovës ishte Xhemajl Fetahaj, i cili më vonë, gjatë luftës së vitit 1998 -1999, në Kosovë, ishte ushtar i UÇK-së dhe ra heroikisht në prag të përfundimit të luftës, tani dëshmor i kombit(M..Z).

Atëbotë, LDK-ja me një deklaratë të botuar në gazetën “Rilindja”¹⁷³, iu bënte apel qytetarëve që të mos nënshkruajnë peticionin që e ofrojnë njerëzit anonimë.¹⁷⁴ Si rezultat i presionit të madh që iu bë Kuvendit të Kosovës nga protestat dhe tubimet e tjera, e sidomos si rezultat i peticionit me qindramijëra nënshkrime, të cilat ishin grumbulluar nga LPRK, anë e kënd Kosovës, i cili iu dorëzua Kuvendit.

Duke mos pasur rrugë tjetër dhe duke e parë vullnetin e popullit, këta deputet kryen një akt atdhetarë pasi që më 2 korrik 1990 u mbledhën para Kuvendit Krahinor dhe shpallën Deklaratën Kushtetuese të Kosovës, e njohur si „Deklarata e 2 korrikut”.¹⁷⁵ Shteti i Serbisë dhe njësitet e saj të policisë kësaj deklarate iu përgjigjën me dhunë. Poashtu me dhunë u mbyll më 04 korrik 1990, edhe e vetmja dritare informative e shqiptarëve të Kosovës, TVP-ja dhe gazeta „Rilindja”. LDK-ja, dhunën serbe e jugosllave mundahej t’u sfidonte përmes politikës paqësore pasive, si dhe në informimin e opinionin ndërkombëtar me gjendjen në Kosovë, ndërsa partitë tjera të sapo formuar, ende nuk kishin ndërtuar një koncept se si duhet të reagonin në situatën e krijuar. I vetmi subjekt politik, kuptohet ilegal në Kosovë, e cila përmes formës aktive, protestave, por herë – herë edhe luftimeve sporadike, ishte Lëvizja Popullore Për Republikën e Kosovës - LPRK, e cila doli me parullën: „Pa liri nuk ka demokraci”.¹⁷⁶

Pas shpalljes së Deklaratës Kushtetuese nga ana e deputetëve të Kuvendit të Kosovës më 2 korrik 1990, në të cilën Kosova ishte subjekt i barabart me republikat tjera në Jugosllavi¹⁷⁷, Veprimtarët e LPRK-së, në Kosovë u hodhën në aksione në të gjitha qytetet e Kosovës për të propaganduar dhe për t’i sqaruar popullit se pa u çliruar nga pushtuesi serb, nuk ka liri dhe demokraci. Në thirrjen e lëshuar në gusht 1990, LPRK thërret popullin që „Të organizoj roje në qytete e fshatra të Kosovës, si preventivë ndaj sulmeve të befasishme dhe në rast rreziku të vetëmbrohet, ndërsa rinisë, u bënte thirrje që të mos i përgjithgjet thirrjes për shërbim në ushtrinë që na vret dhe na mbanë në qizmen e robërisë.

¹⁷³ Rilindja, 24 qershor 1990.

¹⁷⁴ Ramadan Avdiu, Epoka e Re, 24.2.2004

¹⁷⁵ Rilindja, 03 korrik 1990, 1-2.

¹⁷⁶ Emrush Xhemajli, vepra e cituar.

¹⁷⁷ Rilindja, 03 korrik 1990, fq.1.2

Më poshtë LPRK theksonte së nuk është për luftë të armatosur, por nëse pushtuesi luftën na e bën fakt, LPRK, bënte thirrje që „ pa luhatje dhunës shoviniste t’i përgjigjet me dhunë revolucionare“.¹⁷⁸ Pra LPRK, me kohë i kishte bërë të qartë popullit se Kosova nuk mund të çlirohet me fjalë dhe konferenca shtypi, por vetëm përmes rezistencës aktive dhe luftës së armatosur. LPRK, kishte besim se populli shqiptar do të jetë në gjendje Kushtetutën dhe Republikën e vet ta mbroj edhe më me shumë gjak se sa ishte derdhur deri tani.¹⁷⁹ Një përpjekje e madhe e politikës Kosovare, për zgjidhjen e çështjes së Kosovës me mjete paqësore ishte edhe shpallja e Kosovën Republikë, më 7 shtator 1990, në Kaçanik. Ky akt, me të cilin jo vetëm politikisht, por edhe juridikisht një të drejtën e statusit të kombit në kuadër të Republikës së Kosovës, shkaktoi reagime të ashpra ndaj kësaj kërkesë të drejtë të popullit shqiptar.¹⁸⁰ Deputetët që shpallën Kosovën Republikë, të gjendur para një presioni të madh të ndjekjes dhe burgosjes nga pushtuesi serb, u detyruan të ikin në Maqedoni, Slloveni, Shqipëri dhe shtete të Perëndimit.¹⁸¹ Pas largimit të tyre nga Kosova, deputetët e Parlamentit të Kosovës, iu drejtuan me një Apel, qendrave Evropiane të vendosjes, përmes të cilit njoftonin se „për shkak të ndekjeve dhe reprezaljeve të vazhdueshme të pushtetit serb, kundër popullit shqiptar, por edhe kundër deputetëve të Kosovës të cilët e kanë shprehur vullnetin e popullit i cili i ka zgjedhur.“¹⁸²

Deri me shpalljen e Republikës së Kosovës, LPRK është quajtur, Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës, ndërsa duke e pasur parasysh se Republika e Kosovës dhe Kushtetuta e saj është shpallur, LPRK mendon se programi i sja u realizua pjesërisht, tani LPRK do të angazhohet që Republika e Kosovës të bëhet realitet. U vendos që, emërtimit të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës, t’i hiqet parafjala PËR dhe në vend të saj vendoset nyja E, dhe tani e tutje do të jetë **LËVIZJA POPULLORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**¹⁸³

¹⁷⁸ Komunikatë e LPRK-së, gusht 1990, Prishtinë

¹⁷⁹ Zëri i Kosovës, nr. 11, 29 shtator 1990, fq. 1 – 3.

¹⁸⁰ Zëri i Kosovës, nr. 11, 29 shtator 1990, fq. 2.

¹⁸¹ Revista , Ekskluzive, 2000, fq. 45,46.

¹⁸² Apel i Delegatëve të Kuvendit të Kosovës, më 16.09.1990, nga Lublana, iu dërguar : Federatës së Helsinkit për të drejtat e njeriut, Federatës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Organizatës ndërkombëtare të Kombeve të bashkuara, Amnesty International, Parlamentit Evropian, Bashkësisë Evropiane dhe Parlamenteve dhe Qeverive të të gjitha shteteve anëtare të KEBS-it., Zëri i Kosovës, nr. 11. 29 shtator 1990.

¹⁸³ Konkluzionet e KP të LPRK-së, 22 dhjetor 1990, Zëri i Kosovës, 9 janar 1991, fq.1.

Pos këtij ndërrimi gjatë viteve 1990 dhe 1991, LPRK bënte përpjekje edhe për ndërrimin e kursit politik të saj, sepse në Evropën Juglindore kishte filluar të bie sistemi Komunist dhe Marksizëm Leninizmi, si koncepti politik i OMLK-së, pararojës së LPRK-së në Kosovë, konsiderohej i dështuar. Deri në formimin e LDK-së më 1990, LPRK ishte forca më e madhe politike ilegale e shqiptarëve në Jugosllavi.¹⁸⁴ Pas ndryshimit të rrethanave politike në të cilat vepron, LPRK tani e tutje do të veprojë si organizatë e pavarur politike e masave.¹⁸⁵

Për këtë arsye më 04 shkurt 1991 në shtëpinë e Bajram Prapashticës në Prapashticë, Prishtinë, u mbajt Konferenca e dytë e LPRK-së - OMLK-së.¹⁸⁶ Kjo ka qenë Konferencë e jashtëzakonshme, pas gjendjes së krijuar, kur në udhëheqjen e Organizatës ishin krijuar tri vende vakante. Në këtë Konferencë u zgjodh Komiteti Drejtues prej pesë vetëve: Xhavit Haziri, Ramadan Avdiu, Halil Selimi, Ismet Sylejmani dhe Halit Krasniqi.¹⁸⁷ Në mbledhje merrnin pjesë edhe Behajdin Allaqi, Ilaz Kadolli, Azem Sylja, Raif Qela,¹⁸⁸ Hydajete Krasniqi, Irfan Musmurati dhe Zyrafete Muriqi.¹⁸⁹ Poashtu u morr vendim, që të vazhdohet veprimtaria në formë ilegale dhe aty ku ka mundësi të kombinohet me praktikën legale të veprimit.¹⁹⁰ Është aprovuar platforma e punës, si dhe është marrë vendim që të vazhdohet veprimtaria në formën klandestine, aty ku ka mundësi të kombinohet me praktikën legale të veprimit. Është vendosur që menjëherë komiteti të fillojë punën e përgatitjes së Mbledhjes së Përgjithshme të LPRK-së dhe Këshilli Drejtues i LPRK-së të formohet brenda vendit.

Deri në Mbledhjen e Prapashticës, Këshillat e Rrethëve të LPRK-së vepronin brenda vendit, ndërsa që Kryesia e LPRK-së në këtë kohë ishte jashtë vendit. Në këtë mbledhje u vendos që të formohet krahu ushtarak i LPRK-së në përbërje: Azem Sylja dhe Ahmet Haxhiu¹⁹¹, si dhe u vendos që tani e tutje Kryesia e LPRK-së të bartet brenda vendit.¹⁹²

¹⁸⁴ Revista Sudost – Europa – nr.10/11 –Munchen, 1998.

¹⁸⁵ Po aty

¹⁸⁶ Ramadan Avdiu, intervistë, 02 gusht 2008, Prishtinë

¹⁸⁷ Po aty.

¹⁸⁸ Intervistë e Ilaz Kadollit, 12.09.2008, Prishtinë

¹⁸⁹ Ramadan Avdiu, 01.2.2009.

¹⁹⁰ Mr. Skendr Zhitia, UÇK, ZOLL, prishtinë 2008, fq. 49.

¹⁹¹ Deklaratë e Shaban Mujës, 07 mars 2009

¹⁹² Ramadan Avdiu, 01.2.2009.

Në anën tjetër, gjatë viteve 1990 -1991, Kryesia e LPRK-së, D.J.V, e pa kënaqur me politikën paqësore që po udhëhiqej në Kosovë, filloi të marrë masa për përgatitjen e shqiptarëve për situata më të vështira. LPRK-ja, nga antarësia e saj ndau buxhet për stërvitjen e luftëtarëve të ardhshëm për luftë të armatosur. Luftëtarët stërviteshin në grupe të vogla në Shqipëri. Po për këtë qëllim një delegacion i LPRK-së i përbërë nga Ahmet Haxhiu, Ramadan Avdiu, Hydajete Krasniqi, Xhavit Haziri, Xhavit Haliti, në vitin 1991 u takua më Presidentin e Shqipërisë, z. Ramiz Alia.¹⁹³ Në kuadër të punës përgatitore për organizimin e luftës së armatosur, në shtator të vitit 1991, në Prishtinë mbahet një konsultë e LPRK-së. Në këtë takim konsultativ ishin prezent: Xhavit Haziri, Ahmet Haxhiu, Adem Demaçi, Emrush Xhemajli, Ramadan Avdiu, Hydajet Hyseni, Mehmet Hajrizi, Ibish Neziri etj. Adem Demaçi me këtë rast bëri një diskutim të gjatë se si e mendon ai veprimin e LPRK-së në vitet në vijim¹⁹⁴

Edhe përkundër luhatjes së një pjese të popullit të Kosovës dhe partive legale të sapo formuar, LPRK-ja nuk pranoi të rrëmbehet nga „ demokratizimi" i RFJ-së dhe i Serbisë. Ajo vazhdoi dhe thelloi luftën në kushtet e ilegalitetit. Në këtë kohë u bënë përpjekje brenda dhe jashtë vendit për të formuar ushtrinë e Kosovës. LPRK, dërgoi grupe të vogla, për t'u ushtruar në Shqipëri, megjithëse, kjo iniciativë e LPRK-së, por edhe e Qeverisë Bukoshi, u hetuan nga pushteti serb dhe si pasojë, alternativa shqiptare e Kosovës shpejtë hoqi dorë nga organizimi i Ushtrisë së Kosovës.¹⁹⁵

Nga viti 1991 -1993, sektorin ushtarak të LPRK-së për Kosovë e udhëhiqte Xhavit Haziri, ndërsa jashtë vendit, Xhavit Haliti.¹⁹⁶ Në këtë kohë në Kroaci, Fehmi Lladrovci, veprimtar i hershëm i LPRK-së, në bashkëpunim me eprorët ushtarak, si Tomë Berisha etj, i mbështetur politikisht dhe financiarisht edhe nga LPRK-ja, formuan njësitin ushtarak në Gospiq, të cilin e përbënin ushtarë të rinj shqiptar që kishin dezertuar nga ushtria kriminele e Sërbisë. Ky njësit ishte krijuar nën organizimin e LPRK-së, d.j.v. LPRK, mendonte se meqë filloi lufta në Kroaci, të gjithë ushtarët dhe ushtarakët shqiptar duhet të dezertojnë nga ushtria Jugosllave dhe të grumbullohen në Zagreb, me qëllim të formimit të bërthamës së ushtrisë së Kosovës.¹⁹⁷

¹⁹³ Po aty

¹⁹⁴ Po aty

¹⁹⁵ Ramadan Avdiu, 15 janar 2009, Prishtinë

¹⁹⁶ Po aty.

¹⁹⁷ Po aty,

Gjithashtu, në vitin 1991, veprimtarët e LPRK-së shfrytëzuan iniciativat dhe organizimet që bëheshin për stërvitje ushtarake në Shqipëri¹⁹⁸ dhe herë pas here dërgonte grupe të vogla të cilat stërviteshin nga oficer të lartë të Shqipërisë në ilegalitet të thellë.¹⁹⁹ Këtë mundësi e ka shfrytëzuar edhe Adem Jashari, me grupin e tij nga Drenica, i cili kishte shkuar në Zvicër për të biseduar me zyrtar të Qeverisë në ekzil. Pas kthimit nga Zvicra Adem Jashari me një grup prej 54 vetësh, më 3 nëntor 1991 nga Aeroporti i Shkupit, shkon në Zvicër, ndërsa nga Zvicra me autobus përmes Italisë kishin arritur në Durrës.²⁰⁰

Iniciativën për stërvitjen e të rinjëve Kosovare në Shqipëri e kishin marrë drejtues të lartë të shtetit Shqiptar të cilët ishin vënë në dijeni të një plani serb për spastrimin etnik të Kosovës. Lejen për stërvitje të këtij grupi, të cilët më vonë do ta përbënin bërthamën e ushtrisë së Kosovës, e kishte dhënë Kryetari i atëhershëm i Shqipërisë, Ramiz Alia, dhe Ministri i atëhershëm i Mbrojtjes së Shqipërisë, Perikli Teta. Stërvitja u bë në repartin 8770, në Surrel. Në këtë grup kanë qenë edhe Adem Jashari, Zahir Pajaziti, Sali Çeku e shumë të tjerë.²⁰¹

Më 2 nëntor 1991, Fehmi Lladrovci, si drejtues politik i Njësisë vullnetare Shqiptare në Kroaci, i dërgon një letër LPRK-së, përmes së cilës i kërkon ndihmë financiare dhe përkrahje politike. Po këtë ditë, kur edhe u bë kërkesa nga Fehmi Lladrovci, me një urdhër të veçant, kryesia e KP të LPRK-së, i dorëzoi atij 10.000 frs, të cilat iu dhanë vullnetarëve. Mjetet i dorëzoi Gafurr Elshani, arkatar i LPRK-së.²⁰² Këtij njësit iu bënë sabotime të shumta nga Qeveria Bukoshi, nga Qeveria Kroate, por edhe nga institucionet tjera legale në Prishtinë. Duke e parë pamundësinë për të vazhduar më tutje, njësit iu detyrua të shpartallohej. Kjo ishte një goditje e madhe për vizionin e Fehmi dhe Xhevë Lladrovcit por, Fehmi Lladrovci, nuk hoqi dorë nga angazhimi për të parë Kosovën me ushtri çlirimtare. Armatimin që kishte ky njësit, më vonë u dërgua në Kosovë të cilën e përdorën njësitet e UÇK-së.²⁰³

¹⁹⁸ Emrush Xhemajli, deklarataë, 30 janar 2009.

¹⁹⁹ Ramadan Avdiu, deklaratë, janar 2009

²⁰⁰ Murat Jashari, intervistë, Jasharët, Historia e rrëfyer nga Rifat, Besarta, Bashkim, Murat dhe Lulzim Jashari, Bardh Hamzaj – Faik Hoti, Zëri, Prishtinë, 2003, fq. 39 -41.

²⁰¹ Rilindja 13 prill 2001, Intervistw e z. Perikli Teta, ish – Ministër i Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, f.10.

²⁰² Po aty,

²⁰³ Bedri Islami, Përvetësia e dyfishitë, Tiranë, 2008, fq. 243 – 260.

Për të shikuar mundësinë e angazhimit për organizimin e njësiteve të armatosura, veprimtar të LPRK-së, Ramadan Avdiu, Halil Selimi dhe Fehmi Lladrovci, u takuan me Bujar Bukoshin- Kryeministër në ekzil i Kosovës dhe Ramush Tahirin, Ministër i Mbrojtjes. Qëllimi i këtij takimi ishte stërvitja e ushtarëve në Shqipëri. Bukoshi nuk ishte i interesuar të punonte në këtë drejtim dhe takimi përfundoi pa sukses.²⁰⁴ Në vitin 1991, edhe në radhët e LPRK-së, kishte edhe mendime të kundërta të disa anëtarëve të saj, me atë që kishin vendosur udhëheqësit e LPRK-së. Një pjesë e veprimtarëve dhe udhëheqësve të LPRK-së, diskutuan mundësinë që edhe LPRK të ndërrojë pozicionin e saj dhe të dal si parti legale. Për shkak se mendonin ndryshe dhe se varianti i tyre nuk ishte miratuar në Kryesinë e LPRK-së, disa nga anëtarët, u larguan nga LPRK. Një pjesë u anëtarësuan në partitë legale në Kosove dhe në degët e tyre jashtë vendit, shumica nga ta në LDK, ndërsa të tjerët vepruan të pavarur nga partitë politike, por punuan në interes të çlirimit të Kosovës.²⁰⁵

2). Mbledhja e Tretë e Përgjithshme e LPRK-së

Në përpjekje për gjetjen e rrugës për rezistencë aktive, në kushtet dhe rrethanat e krijuara, pas fillimit të shkatërrimit të Jugosllavisë, LPRK, brenda dhe jashtë vendit, filloi konsultimet për hartimin e strategjisë dhe veprimit politik – ushtarak. Kryesia e LPRK-së brenda dhe jashtë vendit, vendosën dhe bënë përgatitje që më 4 tetor të vitit 1991, të mbajë Mbledhjen e III të Përgjithshme të saj. Mbledhja e Tretë e Përgjithshme e LPRK-së, kësaj radhe u vendos të mbahet brenda vendit. Hartimin e dokumenteve për Mbledhjen e III të përgjithshme gjatë muajve shkurt – tetor 1991, e bënë: Xhavit Haziri, Ramadan Avdiu, Halil Selimi dhe Ismet Sylejmani, ndërsa në stafin teknik ishin veprimtarët, Ahmet Haxhiu dhe Azem Syla.²⁰⁶

²⁰⁴ Ramadan Avdiu, 01.2.2009.

²⁰⁵ Njëri ndër themeluesit e LPRK-së Mustafë Xhemajli, thotë se „ më 1991 në mbledhjen e LPRK-së të majtur në Bazel, është larguar nga LPRK-ja për shkak se ka kërkuar që LPRK të regjistrohet si parti politike legale, si të gjithë partitë e tjera në Kosovë, me qëllim që të zihet hapësira politike, siq e kanë zënë partitë tjera politike LDK etj. qoftë edhe me emër tjetër, për shkak se LPRK, kishte bagazh të fortë 10 vjeçar veprimi, shumë veprimtar të burgosur, të vrarë në demonstrata, dhe se LPRK duhet të jetë përfaqësuese e tyre Mustafë Xhemajli, intervistë, 07 korrik 2008, Prishtinë.

Këtë fakt e pranon edhe udhëheqësi i LPRK-së Fazli Veliu, në intervistën dhënë gazetës ditore „ Zëri” në të cilën thotë se „ Mustafë Xhemajli, pasi mori vesh nga jashtë se nuk i është aprovuar propozimi i tij që LPRK të veproj publikisht nën okupim, dha dorëheqje, por nuk shkoi në asnjë parti tjetër e as nuk formoi parti të re”²⁰⁶

²⁰⁶ Ramadan Avdiu, 01.2.2009.

Për të ndihmuar në përgatitjen e mbledhjes, Emrush Xhemajli, Sekretar Organizativ i LPRK-së, Dega Jashtë Vendit me dokumente të falsifikuara, në fund të shtatorit 1991, me ndihmën e Ahmet Haxhiut, nga aeroporti i Shkupit, hyn në Kosovë. Në Organizimin e Mbledhjes së Tretë të Përgjithshme ndihmuan anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm të LPRK-së që vepronin në Kosovë, veçanarisht Ahmet Haxhiu, i cili ishte anëtar i Grupit të Riorganizimit të radhëve të LPRK-së dhe anëtar për organizimin e Mbledhjes së Tretë të Përgjithshme të LPRK-së. Në shtëpinë e tij, janë shtypur materialet e Mbledhjes së Tretë të Përgjithshme nga Ibish Neziri, Emrush Xhemajli dhe anëtarët e LPRK-së brenda vendit si, Ramadan Avdiu, Azem Sylja, Ahmet Haxhiu etj, të cilët bënë përpjekje që edhe në kushte shumë të vështira ta mbanin mbledhjen.²⁰⁷ Mbledhja u caktua të mbahet në Ujmir të Klinës.²⁰⁸

Në shtëpinë ku do të mbahej Mbledhja, poashtu një javë më parë ilegalisht kishte shkuar Emrush Xhemajli, i dërguar nga Dega e LPRK-së, Jashtë Vendit, i cili ishte marrë me punën përgatitore të mbledhjes. Në orët e vona të datës 4 tetor 1991, kishin filluar të vinin delegatët e MTP të LPRK-së. Mbledhja u mbajt në shtëpinë e Sadri Shalës, në një odë burrash ku kishte vend të mjaftueshëm për delegatët. Mbledhja zgjati punimet tri ditë, ndërsa pas përfundimit të Mbledhjes, delegatët nën perkujdesjen e Ukë Shalës dhe Ahmet Haxhiut, u larguan nga Ujmiri pa patur ndonjë problem.²⁰⁹

Në këtë mbledhje u diskutuan shumë çështje me rëndësi për të ardhmen e LPRK-së dhe të situatës në Kosovë. Në mbledhje merrnin pjesë: Emrush Xhemajli - i deleguar nga D.J.V, si dhe udhëheqësit e delegatët e LPRK-së brenda vendit, si: dr.Muhamet Mehmeti, Xhavit Haziri, Ilaz Kadolli, Behajdin Allaqi, Ahmet Haxhiu, Bahri Fazliu, Azem Sylja, Musa Demiri, Ramë Buja, Halil Selimi, Xheladin Gashi, Ramadan Avdiu, Ibish Neziri, Ali Lajçi, Hydajet Hyseni, Mehmet Hajrizi, Gani Sylja, Bedri Halimi, Hydajete Krasniqi, Guximtar Labënishti etj. Në këtë mbledhje është zgjedhur Këshilli Drejtues prej 17 anëtarësh si dhe u miratuan ndryshimet programore dhe statutore.

²⁰⁷ Ibish Neziri, vep. E cituar, 151 – 154.

²⁰⁸ Ahmet Haxhiu dhe Azem Sylja, kishin biseduar me Sadri Shalën, që Mbledhja e III e LPRK-së të mbahej në shtëpinë e tij, por pa i treguar atij se kush do të vinte aty dhe çka do të flitet në atë Mbledhje. Baca Sadri, si edhe shumë fshatarë shqiptar atdhetar të Kosovës, u kishte hapur dyert dhe zemrën delegatëve të MTP të LPRK-së. Ai bashkë me dy djemt e tij, Ukën, veprimtar i LPRK-së dhe Ymerin, kishin siguruar delegatët e MTP të LPRK-së, se nuk do të bien në duart e armikut. Të gjithë anëtarët e familjes Shala, nga Ujmiri i Klinës ishin vënë në shërbim të ruajtjes së sekretit dhe vëzhgimit të terrenit, sepse tër ditën në fshat sillleshin forca të mëdha policore serbe. Deklaratë e Sadri Shalës, Ujmir Klinë. Gusht 2008.

²⁰⁹ Deklaratë e Ukë Shalës, gusht 2008

Më 11 tetor 1991, në shtëpinë e Azem Sylës në Kizhnarekë(tash Ndreka), mbahet Mbledhja e Këshillit Drejtues i dalur nga MTP, i cili e zgjodhi Kryesinë e LPRK-së²¹⁰. Kryetar u zgjodh Gani Sylja, ndërsa në udhëheqësinë e ngushtë ishin: Xhavit Haziri, Ramadan Avdiu, Halil Selimi, Mehmet Hajrizi, Hydajet Hyseni, Ahmet Haxhiu, Musa Demiri, Ramë Buja, Azem Sylja, Hydajete Krasniqi, dhe Guximtar Labënishti nga Struga.²¹¹

Pak kohë pas përfundimit të Mbledhjes nga LPRK-ja u larguan, Hydajet Hyseni, Mehmet Hajrizi dhe Gani Sylja, i cili ishte edhe Kryetar i LPRK-së. Si pasojë e largimit nga LPRK të Kryetarit dhe një pjese të Kryesisë, LPRK brenda vendit u dëmtua shumë. Largimi i tyre ndodhi për shkak se ky grup pati kërkuar zyrtarisht të dilej me deklarin për të shpallur LPRK-në inekzistente. Si arsyetim jepej fakti se gjoja LPRK qenka e tepërt në jetën plurale të Kosovës dhe se sipas tyre, LPRK e kishte kryer detyrën e vet politike e shoqërore dhe se tash partitë legale duhet ta bëjnë politikën në vend.²¹²

Në fund të vitit 1991, do të pasojë edhe një fushatë e madhe arrestimesh kundër Frontit të Rezistencës dhe disa personave të tjerë të cilët kishin marrë pjesë në një stërvitje në Shqipëri. Përkundër kësaj LPRK vazhdoi me këmbëngulje për forcim të radhëve dhe gradualisht ata që në një mënyrë ishin dekonspiruar, kufizoheshin nga informacionet për të mbijetuar puna e LPRK-së. Ka pasur raste kur veprimtarët e LPRK-së, publikisht kanë dalur dhe folur në emër të LPRK-së, sepse ishin të nxitur nga deklaratat e vazhdueshme të partive politike legale dhe kishin bindjen sikur nuk po vërehej prezenca e radhëve klandestine në Kosovë. Kjo natyrisht që e dëmtonte organizimin ilegal. Ata veprimtarë, LPRK detyrohej t'i izolonte nga detyrat dhe informimi me punët që po bënte, sidomos për nismat e përgatitjes së bërthamave të armatosura. Megjithatë, LPRK arriti t'i mbijetoj edhe kësaj sfide të radhës, dhe se aktivitetin e LPRK-së, deri në vitin 1993, e vazhduan, anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haziri, Ramadan Avdiu, Halil Selimi, Guximtar Labënishti dhe Hydajete Krasniqi.²¹³

²¹⁰ Mr. Skendr Zhitia, UÇK, ZOLL, Prishtinë 2008, fq. 49.

²¹¹ Emrush Xhemajli, LPK 20 vjet veprimtari.... fq.10.

²¹² Muhamet Kelmendi, Pse nuk u ndërtua Fronti për Çlirimin e Kosovës, Tiranë 1999, fq. 12.

²¹³ Ramadan Avdiu, 01.2.2009.

Ata, me shumë vështirësi i mbanin lidhjet edhe me Kryesinë e LPRK-së D.J.V., e cila në këtë kohë përbëhej nga: Fazli Veliu – Kryetar, Muhamet Kelmendi – n. Kryetar, Emrush Xhemajli – Sekretar, Gafurr Elshani – përgjegjës Financiar, Ali Ahmeti, Xhavit Haliti dhe Agush Buja. Kryesia e D.J.V, në bashkëpunim edhe me LPRK-në brenda vendit, punonte për një organizëm tjetër në fushën ushtarake, krahas vazhdimit të punës për ndërtimin e LPRK-së e cila parashikohej si bazë politike²¹⁴Dorëheqja e një pjese të Kryesisë së re të LPRK-së e dalur nga MTP dhe tendenca e tyre për t'a shëndrruar LPRK-në në Parti legale, rrezikuan që LPRK ta humb karakterin e saj Çlirimtar.

Ky problem, e nxori kryesinë e LPRK-së, d.j.v, para një akti të vështirë. Tani LPRK duhej të punonte në dy fronte. Së pari në drejtim të zgjerimit të radhëve të LPRK-së brenda vendit, dhe së dyti në drejtim të krijimit të bazës politike e juridike, për të organizuar një forcë ushtarake e cila do të luftonte për çlirimin e Kosovës.²¹⁵ Në nëntor të vitit 1991, Kryesi e LPRK-së, e kishte ngarkuar Azem Sylën që të kërkonte rrugë të reja veprimi për përgatitjen e formacioneve të armatosura. Në këtë kohë në Prekaz, pas kthimit nga stërvitjet në Shqipëri, Adem Jashari veq kishte krijuar formacionin e parë ushtarak. Për këtë arsye pushteti serb, në mëngjesin e 30 dhjetorit 1991 kishin rrethuar familjen Jashari në Prekaz. Adem Jashari kishte vendosur të mos dorëzohej por të luftonte. Pushka e Adem Jasharit dhe formacionit të tij ushtarak në dhjetor 1991 është kushtrimorja e parë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më 25 dhjetor 1991, arrestohet Halil Selimi, njëri nga udhëheqësit e LPRK-së. Pas këtij arrestimi, Azem Sylë, Ahmet Haxhiu, Ramadan Avdiu dhe Xhavit Haziri, kalojnë në ilegalitet dhe shkojnë në Drenicë.²¹⁶ Pas gjendjes së krijuar, Hashim Thaçi, veprimtar i LPRK-së në Drenicë, kishte kërkuar nga udhëheqësit e LPRK-së, Ramadan Avdiu, Xhavit Haziri dhe Ahmet Haxhiu, që t'i sigurojnë armatim. Pas konsultimeve edhe me Kryesinë e LPRK-së, vendoset që i tërë armatimi në bazat ilegale në Kosovë, të dërgohet në Drenicë²¹⁷. Gjatë viteve 1991-1992, në Kosovë, represioni shtetëror u rrit në mënyrë dramatike. Vrasjet, kindapimet, rrahjet dhe torturat, burgosjet e disidentëve politik dhe aktivistëve, mbylljet e shkollave dhe institucioneve kulturore ishin bërë përditshmëri.

²¹⁴ Shënim nga ditari i Muhamet Kelmendit, n. Kryetar i LPRK-së, titulli i cituar në fusnotën 71.

²¹⁵ Po aty fq. 11.

²¹⁶ Ibish Neziri, vepra e cituar, fq. 159 – 160.

²¹⁷ Baza kryesore e LPRK-së ishte në shtëpinë e Ahmet Haxhiut në Prishtinë. Mitralozi të cilin e mban Adem Jashari rreth qafe në fotografinë që e përshkoi tërë botën, është njëri nga 6 mitralozët e dalur nga shtëpia e Ahmet Haxhiut, të cilin në Drenicë e dërgoi Azem Sylë. Ibish Neziri, vepra e cituar, fq. 159 – 160.

Grupet ultranacionaliste paramilitare, të sponzoruara nga Millosheviqi, ishin dërguar në Kosovë për të kërcënuar dhe terrorizuar popullatën shqiptare. Edhe përkundër këtij terrori të vazhdueshëm, lidershipi shqiptar kishte zgjedhur qasjen joviolente dhe vazhdoi të ndërtojë strukturat paralele politike, ekonomike dhe një jetë nëntokësore kulturore dhe arsimore.²¹⁸

Më 24 Maj, partitë legale në Kosovë, të udhëhequra nga LDK, organizuan „ zgjedhje të lira” nën okupim nga Serbia. Në këto zgjedhje LPK, nuk mori pjesë, sepse ajo mendon se nuk mund të ketë zgjedhje të lira, pa u çliruar vendi. LPK, nuk do të tregojë forcën e saj para partive politikie shqiptare, por këtë forcë ajo e ka treguar dhe do ta tregoj kundër pushtuesve, serb, maqedon e malazez.²¹⁹ Pas Zgjedhjeve të 24 majit 1992 edhe pse sipas Kushtetutës së Kosovës, brenda 15 ditësh duhet të konstituohet Parlamenti i dalur nga këto zgjedhje, nuk u mblodh asnjëherë. LPRK, duke e parë se Parlamenti dhe Qeveria e zgjedhur më herët, por edhe Presidenti nuk janë të përgjegjshëm për detyrat që kanë, mori vendim, që të mos bëhet pagesa në fondin e Qeverisë, por që mjetet financiare dhe materiale t’i investoj drejtpërsëdrejti në luftën çlirimtare.²²⁰

LPRK, me kohë kishte kundërshtuar politikën pacifiste të mosbërjes. Ajo punonte që lufta e cila ishte në prag të shpërthimit, popullin ta gjejë psiqikisht të përgatitur, por edhe në aspektin e armatimit. Për këtë, qysh në mars të vitit 1992 me vendim politik, Këshilli i LPRK-së për Drenicë, ka bërë sulmin e parë të armatosur mbi policinë armike, në stacionin e autobusëve në Drenas. Përgatitjet përfundimtare janë bërë në fshatin Shkabë të Drenasit në kullën e Fehmi Lladrovci, po ashtu veprimtar i LPRK-së, më vonë Kryetar i LPRK-së në Gjermani.²²¹ Përmes aksioneve kundër policisë serbe, LPRK në trojet shqiptare mendohej t’i bënte me dije opinionit vendor dhe atij të huaj se shqiptarët dijnë edhe të luftojnë për të fituar drejtat dhe lirinë e tij. Poashtu edhe D.J.V e LPRK-së, përcillte zhvillimet politike brenda dhe jasht vendit dhe reagonte në bazë të rrethanave politike që krijoheshin në Jugosllavi dhe botë. Në vitin 1992, për të ndihmuar aktivitetin e LPRK-së brenda vendit, D.J.V, kishte dërguar në Kosovë anëtarin e Kryesisë, Gafurr Elshanin.²²²

²¹⁸ Janus Bugajski, ngritja e Kosovës, Prishtinë 2006, fq 27.

²¹⁹ Fazli Veliu, LPK dhe UÇK: një emblemë, një qëllim, f.41

²²⁰ Material i Kryesisë së PK të LPRK-së, nëntor 1992.

²²¹ Jakup Krasniqi, vepra e cituar, fq.9,10.

²²² Emrush Xhemajli, vepra e cituar, fq. 13

Më 13 shtator 1992 në Gjenevë, D.J.V e LPRK-së, organizoi demonstratë me rastin e mbajtjes së Konferencës Paqësore për ish- Jugosllavinë, e cila filloi punimet në Londër dhe i vazhdoi në Gjenevë. Përmes kësaj demonstratë, Konferencës Paqësore i dërgoi një APEL, i cili iu drejtohej, Z. Sajrus Vens dhe Lordit David Oven. Në këtë apel, LPRK, i njoftoi pjesëmarrësit e kësaj Konference se populli shqiptar i Kosovës, sipas standardeve ndërkombëtare është deklaruar me referendum për Republikë. LPRK është e gatshme të përkrah çdo vendim të Konferencës që është në pajtim me vullnetin e popullit shqiptar në ish – jugosllavi dhe nuk do të pajtohet e nuk do të heqë dorë nga ky vullnet me asnjë çmim, sado i lartë dhe sado i dhimbshëm që të jetë.²²³

Në vitet 1991 -1992, Kryesia e LPRK-së në Gjermani, duke u munduar që t'a harmonizoj organizimin e luftës, takohet disa herë me Qeverinë në ekzil, të cilën e udhëheqte Bujar Bukoshi, të cilit iu bë thirrje për bashkëpunim në interes të zgjidhjes së çështjes së Kosovës.

Në takimin në mes të LPRK-së dhe Qeverisë Bukoshi, të datës 5 dhjetor 1992, LPRK-në e përfaqësonte Fazli Veliu, Kryetar, Emrush Xhemajli, sekretar, Gafurr Elshani, arkatar dhe Ali Ahmeti anëtar i KP të D.J.V. të LPRK-së. Në takim, pos Bujar Bukoshit, merrte pjesë edhe Ramush Tahiri, zv. Kryeministër.²²⁴

Për shkak se radhëve të organizuara të LPRK-së në Kosovë u nevojitej ndihmë në terren, në fund të vitit 1992, LPRK, dërgon në Kosovë, anëtarin e Kryesisë Adem Grabovci, që të ndihmojë aktivitetin e LPRK-së brenda vendit.²²⁵ Pasi nga të gjitha takimet e zhvilluara nuk ishte arritur gjuhë e përbashkët për të vazhduar më tutje dhe pasi organet e LPRK-së ishin mjaft të konsoliduara si në Kosovë ashtu edhe në D.J.V, në vitin 1993, LPRK, vendosi që si subjekt më vete të marrë masa për ndihmimin e veprimtarisë ilegale ushtarake në Kosovë.

²²³ Komunikatë e LPRK-së, 13 shtator 1992, Prishtinë.

²²⁴ Informatë e LPRK-së, lëshuar më 06 dhjetor 1992)

²²⁵ Emrush Xhemajli, vepra e cituar, fq. 14.

3). Mbledhja Konsultative e LPRK-së

Viti 1993, për shqiptarët karakterizohet për terrorin e organizuar shtetëror të pushtuesve serbo – malazez e maqedon. Konferenca Paqësore për ish- Jugosllavinë, e cila filloi punimet në Londër dhe i vazhdoi në Gjenevë, në shtator 1992 në Gjenevë, vendosi edhe një herë që Kosovën t’ia rianeksoj Sërbisë së Madhe dhe Maqedonisë. Bartësit e politikës pacifiste në Kosovë, përditë e më shumë po e quajnë shpalljen e Republikës si veprim të ngutshëm dhe po propagandohet pranimi i auonomisë së Kosovës nën Serbi.²²⁶ Kryesia e KP të LPRK-së, në bashkëpunim me Kryesinë e D.J.V-së, në janar 1993, mori vendim për mbajtjen e Mbledhjes Konsultative në nivel të LPRK-së.²²⁷ Në prill të vitit 1993, LPRK, vendosi që Mbledhja Konsultative të mbahet në fshatin Kollare, afër Kërçovës, me udhëheqës dhe aktivist të saj, nga të gjitha territoret shqiptare në ish- Jugosllavi. Në mbledhje u diskutua rreth situatës aktuale politike kombëtare e ndërkombëtare, me theks të veçant rreth gjendjes në Kosovë dhe në Maqedoni, të cilën OKB-ja, me pretekstin e krijimit të një zone stabile në këtë pjesë të Ballkanit, por pa njohur vullnetin e mbi 1 milion shqiptarëve që jetojnë në këtë Republikë.²²⁸

Poashtu u bisedua edhe rreth gjendjes organizative të LPRK-së. Në Mbledhjen Konsultative, është vendosur që të formohet Grupi i Organizimit dhe Riorganizimit (GOR). Ky grup ka pasur për detyrë që të përgatitë mbajtjen e Mbledhjes së Katërt të Përgjithshme, dhe të konstatoj qartë gjendjen organizative, me theks të veçantë ka pasur për obligim që të identifikojë dhe izolojë nga veprimet operative veprimtarët që ishin dekonspiruar.²²⁹ GOR, e përbënin: Ramadan Avdiu – Kryetar, Xhavit Haliti, Hashim Thaçi, Adnan Asllani, Bilall Sherifi, Atdhetar Labënishti.²³⁰

Pas Mbledhjes Konsultative GOR, ka filluar punën duke i hartuar materialet për Mbledhjen e Katërt të Përgjithshme, hartimin e programit dhe statutit të LPRK, rregulloren për Mbledhje të Përgjithshme dhe rezolutën.

²²⁶ Komunikatë e LPRK-së, shkurt 1993

²²⁷ Njoftim i Kryesisë së LPRK-së me konkluzionet dhe vendimet e mbledhjes së KD të LPRK-së, për Këshillat e LPRK-së, 23 janar 1993.

²²⁸ LPRK-ja nuk pranon asnjë vendim që është marrë në kundërshtim me vullnetin e popullit shqiptar dhe as vendimin e OKB-së . LPRK në Programin e saj ka të prazantuar se zgjidhja e drejtë e popullit tre milionësh në ish – Jugosllavinë artificiale – përfshirja e tij në Republikën e përbashkët shqiptare të Kosovës, Komunikatë e LPRK-së, 16.04.1993.

²²⁹ Ramadan Avdiu, Epoka e Re 24.2.2004.

²³⁰ Emrush xhemajli, deklaratë, 30 janar 2009.

Këto materiale GOR i ka shpërndarë nëpër të gjitha rrethet e organizuara për diskutim, dhe ka asistuar në Mbledhjet e Përgjithshme të Rretheve, për të përcjellur ecurinë e tyre si dhe i ka njohur delegatët e zgjedhur nga rrethet për të marrë pjesë në Mbledhjen e Katërt të Përgjithshme, e cila duhej për verifikim të mandateve. Përkundër rrethanave të rënda të veprimit, LPRK ka pasur një demokraci të brendshme shumë të zhvilluar dhe shumë më të mirë se shumica e partive të sotme legale në skenën tonë politike. GOR dhe anëtarët e tjerë të Kryesisë nga marsi deri në korrik 1993, kanë punuar në Organizimin e Mbledhjes së Katërt të Përgjithshme të LPRK-së, si dhe ka hartuar projektin për ndryshimet programore. Në projekt, GOR e LPRK-së, kishte dhënë dy propozime për emërtimin e forcës së re ushtarake që parashihej të vepronte në Kosovë. Propozimet ishin që kjo forcë të quhej: 1. FRONTI KOMBËTAR PËR ÇLIRIMIN E KOSOVËS ose,

2.BASHKIMI KOMBËTAR PËR ÇLIRIMIN E KOSOVËS.²³¹

GOR, kishte hartuar edhe një rregulloren e punës e cila do të jepte udhëzime për Këshillat e Rretheve në Maqedoni, Kosovë dhe Preshevë.²³² Gjatë muajve mars - maj,1993, Këshilli lokal i LPRK-së në Presheve kishte mbajtur disa mbledhje në të cilën ishin analaizuar qëndrimet e Kryesisë së LPRK-së si dhe ishte raportuar për gjendjen organizative të LPRK-së në Preshevë dhe komunat shqiptare në Kosovën lindore.²³³

Në mbledhjen Konsultative u tha se „LPRK përkrah dhe mbështet grupet e armatosura në Kosovë". Ajo mori vendim që të bisedojë me këto grupe për unifikimin e aksioneve dhe të veprimtarisë në një grup të vetëm dhe në një emër të përbashkët.²³⁴

Në këtë mbledhje morën pjesë: Gafurr Elshani, Ahmet Haxhiu, Ali Ahmeti, Xhavit Haziri, Behajdin Allaqi, Ilaz Kadolli, Ramadan Avdiu, Hysen Gega Adnan Asllani, Hashim Thaçi, Azem Syla, Adem Grabovci, Bilall Sherifi, Halil Selimi, Hidajete Krasniqi, Sali Lajçi, Ramadan Pllana, Fadil Bajrami, Musa Demiri, Bexhet Luzha, Fatmir Brajshori etj.

²³¹Projektstatusi i FKQK-së ose BKQK-së, GOR e LPRK-së, maj 1993, Prishtinë

²³² Rregullore e nëngrupit të Organizimit dhe Riorganizimit të Këshillave të Rretheve të LPRK-së, maj 1993.

²³³ Qarkorja interne e K.RR të LPRK-së, Preshevë, mars 1993, si dhe Njoftim i Këshillit të Rrethit të LPRK-së në Presheve, dërguar Kryesisë së LPRK-së, maj 1993.

²³⁴ Zëri i Kosovës, 1 maj 1993, fq. 3

Mbledhja aprovoi konkluzionet në bazë të të cilave do të veprohet deri në Mbledhjen e Katërt të Përgjithshme, lëshoi Komunikatën si dhe mori disa vendime të veçanta.²³⁵ Nga Mbledhja Konsultative, dolën këto vendime e rezoluta:

I.

Të përgatiten dhe të zhvillohen veprimtari për të çliruar vendin tonë të pushtuar, duke filluar me aksione popullore demonstrata, greva, protesta, aksione konkrete kundër forcave serbe, ushtrisë, policisë dhe bashkëpunëtorëve²³⁶ në përputhshmëri me format qytetare të rezistencës të shtrira në të gjithë hapësirën shqiptare.

Ato duhet të jenë të organizuara, të kohës dhe të kryhen me disiplinë të rreptë.

IV.

Të forcohet propaganda në Kosovë. Të shpërndahej në Kosovë „Zëri i Kosovës“. Kudo ku veprojnë anëtarët e LPRK-së pa e identifikuar veten të propagandojnë vijën politike të organizatës.

V.

Bashkëpunimi i LPRK-së me subjektet politike në Kosovë të bëhet me ata subjekte politike që janë të vendosur të vazhdojnë luftën deri në fitoren përfundimtare.

VII.

Qëndrimi i LPRK-së ndaj shtetit amë nuk varet nga forca politike që është në pushtet. LPRK-së i intereson Shqipëria e pavarur dhe përkrahja sa më e madhe për çlirimin e Kosovës.

VIII.

Çështja kombëtare do të gjejë përkrahje në faktorin e jashtëm vetëm atëherë kur faktori i brendshëm është i organizuar dhe i vendosur për ta çuar çështjen përpara duke aplikuar të gjitha mjetet e luftës çlirimtare. As BE, as NATO, as OKB-ja e as ndonjë organizatë tjetër nuk do ta zgjidhë çështjen tonë, nëse kombi ynë nuk bëhet zot i fatit të vet.²³⁷

Duke u nisur nga rezolucionet e Mbledhjes Konsultative të Kollares, për bashkëpunim me institucionet e Shqipërisë, më 23 qershor 1993 delegacioni i LPRK-së në përbërje nga; Fazli Veliu, Emrush Xhemajli dhe Xhavit Haliti u takuan me Preidentin e Shqipërisë, z. Salih Berisha.

²³⁵ Komunikatë e LPRK-së, prill 1993, Prishtinë

²³⁶ Ilaz Kadolli, 12.09.2008, Prishtinë

²³⁷ Konkluzat e Mbledhjes Konsultative të LPRK-së, prill 1993.

Përfaqësuesit e LPRK-së e njoftuan Presidentin Berisha lidhur me gjendjen shpërthyesë në Kosovë dhe për masat e egra që po merr pushtuesi kundër pjesës së robëruar të kombit tonë. Ata poashtu kërkuan që në përputhje me ligjet e vendit t'i jepet një status legal i veprimit të LPRK-së, së paku të njëjt si në Evropën Perëndimore. Presidenti i Shqipërisë Sali Berisha, duke dhënë mendime të vlefshme për LPRK-në, kishte theksuar se qëndrimi zyrtar i Shqipërisë është se në rast të një terrori masiv në Kosovë, të gjithë shqiptarët do të reagojnë si komb për ta mbrojtur Kosovën²³⁸.

Në vazhden e punës organizative për MKP të LPRK-së, më 3 dhe 4 korrik 1993, në Bazel të Zvicrës, zhvilloi punimet MKP e LPRK-së, D.J.V. MKP zgjodhi organet qendrore, Këshillin e Përgjithshëm dhe Kryesinë e Degës. Kryetar në mandatin e ardhshëm u zgjodh Prof. Fazli Veliu, nënkryetar Mr. Muhamet Kelmendi, sekretar Emrush Xhemajli, dhe arkatar Gafurr Elshani. Në mbledhje u caktuan delegatët për Mbledhjen e Katërt të Përgjithshme në Kosovë.²³⁹ Poashtu, Adem Jashari, i dëshpëruar në institucionet shtetërore të Kosovës, më 5-6 prill 1993, në Kullën e tij kishte mbajtur një takim të rëndësishëm për historinë më të re të Kosovës. Në këtë mbledhje, në të cilën, pos formacioneve ushtarake merrnin pjesë edhe veprimtar politik, u vendos që të punohet në zgjerimin e formacioneve politike dhe ushtarake. Adem Jashari, anëtarë i LPRK-së, një nga organizatorët e protestave gjatë vitit 1989-90 në Skenderaj, Drenas, Mitrovicë dhe Vushtrri duke e ditur se LPRK-ja, jo vetëm që ka menduar, por edhe ka punuar seriozisht në drejtim të ndryshimit të gjendjes, tek LPRK-ja shihte gatishmëri edhe për sakrificë.

Ai ishte në favor të shtimit të strukturës ushtarake nga të gjithë ata që ishin të gatshëm të luftojnë e sakrifikojnë, pavarësisht se në cilin subjekt politik ishin të organizuar.²⁴⁰ Ai ka qenë mbrojtës i tezës se në rrethanat ekzistuese të okupimit klasik nuk mund të zhvillohet kurrëfarë aktiviteti politik që mund të rezultojë me sukses, nuk mund të mbrohen argumentet tona të fuqishme që i kemi, nëse nuk e kemi forcën ushtarake.²⁴¹

²³⁸ Komunikatë e LPRK-së, 25.06.1993

²³⁹ Komunikatë e LPRK-së, D.J.V, 04 korrik 1993, Bazel - Zvicër.

²⁴⁰ Në shkurt të vitit 1992, në një takim me udhëheqësin e LPRK-së në Kosovë, Ramadan Avdiu, Adem Jashari kishte thënë se „ tashmë kapitulli i protestave është mbyllur. Të gjitha potencialet dhe kapacitetet tona duhet t'i vëjmë në drejtim të përgatitjeve të organizimit të luftës së armatosur. Rrugë të cilën nuk do ta dëshironim, por që nuk na ka ngelur asnjë shteg tjetër. Asnjëherë nuk do të mund të fitojmë lirinë tonë nëse nuk do të sakrifikojmë”.

²⁴¹ Ramadan Avdiu. Epoka e Re, 24.2.2004

4). Mbledhja e Katërt e Përgjithshme e LPRK-së

Në Mbledhjen Konsultative të LPRK-së në Kërçovë, e cila ishte mbajtur në prill 1993, veq tjerash ishte formuar edhe grupi punues për përgatitjen e MKP të saj. Pas punës së gjatë dhe të mundishme për organizimin e Mbledhjes, më 28 -29 korrik 1993, në shtëpinë e Fatmir Brajshorit në „Kodrën e Trimave" në Prishtinë, u mbajt Mbledhja e IV e Përgjithshme e LPRK-së.

Në Mbledhje merrnin pjesë: Xhavit Haziri, Ramadan Avdiu, Bilall Sherifi, Mehmet Bislimi, Halil Selimi, Adnan Asllani, Xhemail Rudi, Guximtar Labënishti, Ejup Thaçi, Mustafë Krasniqi, Isa Krasniqi, Xheladin Gashi, Fatmir Brajshori. Nga D.J.V. e LPRK-së ishin: Fazli Veliu, Emrush Xhemajli, Beqir Beqa, Sabri Kiqmari, Bilall Sherifi.²⁴²Mbledhja u mbajt në atmosferë pune dhe diskutimi konstruktiv për gjendjen e krijuar në Kosovë si dhe masat që duhet të mirren për kapërcimin e kësaj gjendje, u bë analizë situatës së përgjithshme politike në Kosovë dhe botë, u paraqit raporti i KP të LPRK- së, si dhe u nxorën detyrat për të ardhmen.²⁴³ Mbledhja aprovoi ndryshimet programore dhe statutare, si dhe bëri ndryshimin e emrit të organizatës nga LPRK në LPK. Arsyeja për ndërrimin e emrit nga LPRK në LPK, kësaj radhe ishte se Kosova tanimë në vijë institucionale e kishte shpallur Kosovën shtet. Poashtu u mor vendim i rëndësishëm për afrimin e bërthamave të armatosura që i kishte krijuar LPRK dhe strukturimi i tyre, duke iu dhënë dritën jeshile.

Pra, vendimi historik për kalimin në fazën e organizimit të luftës së armatosur.²⁴⁴ Mbledhja aprovoi rezolucionet, deklaratën politike të LPK-së dhe Komunikatën për opinion. Në këtë mbledhje është zgjedhur Këshilli Drejtues, Kryesia e LPK-së dhe organet udhëheqëse të saj në Kosovë,²⁴⁵. Kryesinë e LPK-së e përbënin: Xhavit Haziri, Bajrush Xhemajli dhe Emin Krasniqi. ²⁴⁶Në programin e LPK-së të miratuar në Mbledhje e 4 të përgjithshme, në neni III të këtij programi thuhet: " Për arritjen e aspiratave kombëtare, LPK do të përdor të gjitha mjetet e luftës çlirimtare: demokratike, paqësore e politike dhe të rezistencës së armatosur“.

²⁴² Mr. Skendr Zhitia, UÇK, ZOLL, prishtinë 2008, fq. 50.

²⁴³ Komunikatë e LPK-së, 14 gusht 1993, Prishtinë

²⁴⁴ Ramadan Avdiu, Epoka e Re, 24.2.2009.

²⁴⁵ Zëri i Kosovës, nr. 14, 1 shtator 1993, fq. 1

²⁴⁶ Ramadan Avdiu, 01.2.2009

LPK, si mjet për arritjen e qëllimit, parasheh, luftën e armatosur për çlirimin e Kosovës".²⁴⁷ Në këtë mbledhje u formua krahu ushtarak në krye me Azem Syla, për Kosovë, ndërsa Xhavit Haliti dhe Ali Ahmeti për Evropën Perëndimore.²⁴⁸

Ditën kur po mbahej Mbledhja e Katërt e Përgjithshme janë arrestuar 5 veprimtarë të LKÇK-së. Katër nga ta e kanë njohur deri diku veprimtarinë e LPK-së dhe hierarkinë organizative të saj. Kështu që me të kuptuar lajmin e atij arrestimi LPK ka supozuar se do të ketë fushatë arrestimesh nga ana e UDB-së dhe ka marrë masat që fillimisht t'i nxjerr jashtë Kosovës delegatët e Mbledhjes së Katërt të Përgjithshme, Emrush Xhemaili, Fazli Veliu, Beqir Beqa, Sabri Kiçmari dhe Bilall Sherifi që kishin ardhur nga Dega Jashtë Vendit, të cilët në Kosovë ishin futur ilegalisht. Pastaj Ramadan Avdiu dhe disa veprimtarë të tjerë janë tërhequr në fshehtësi të thellë. Policia serbe filloi një fushatë të egër të burgosjeve në të gjitha pjesët e Kosovës. Arrestimi më 26 Korrik 1993, i veprimtarëve të LKÇK-së, Raif Qela, Sali Salihu, Sali Mustafa, Ramize Abdullahu, Skender Hajdari etj, kishte karakter të një fushate të gjerë që përqëndrohej kryesisht në forcat më të ndërgjegjshme të popullit tonë, tek ata të cilët që nga viti 1981 u gjenden burgjeve të Serbisë dhe të ish- Jugosllavisë.²⁴⁹

Më 2 gusht 1993 ka filluar një fushatë e egër e arrestimeve të veprimtarëve të LPK-së. Diku para agimit të ditës së 2 gushtit është rrethuar shtëpia e Ramadan Avdiut, dhe në të njëjtën kohë janë rrethuar dhe kërkuar që të arrestohen pjesa më reprezentative e veprimtarëve të LPK-së. Këto ditë janë arrestuar: Xhavit Haziri, Ahmet Haxhiu, Nehat Selimi, Rexhep Avdiu e Shemsi Veseli në Prishtinë, Ismet Mahmuti, Hajredin Hyseni, Faik Ajeti në Besianë, Bejadin Allaqi e Binak Berisha në Prizren, Shefki Muqaj e Ilaz Kadolli në Therandë, Ramadan Pllana e Islam Mulaku në Vushtrri, Bajrush Xhemaili në Ferizaj, etj. Janë kërkuar që të arrestohen dhe iu kanë shmangur arrestimit, përveç Ramadan Avdiut, edhe Azem Syla, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Ramiz Lladrovci, Ekrem Jashari, Halil Selimi, Ibish Neziri, Hidajete Krasniqi, Adrian Krasniqi etj. Nga të gjithë të arrestuarit vetëm Xhavit Haziri ka qenë pjesmarrës i Mbledhjes së Katërt të Përgjithshme..²⁵⁰

²⁴⁷ Zëri i Kosovës, nr. 15, 15 shtator, 1993, Programi i LPK-së, fq.4

²⁴⁸ Nait Hasani, intervistë në „Libri I lirisë”, Prishtinë, 2003, f.144.

²⁴⁹ Po aty,

²⁵⁰ Po aty

Të gjithë këta të denuar politik nga pushtusei serb kishin akuzën e njejtë „ Armiq të Jugosllavisë“,²⁵¹ ndërsa për të qenë ironia edhe më e madhe pushteti serb vendimet i merrte „ në emër të popullit“²⁵²Lidhur me këto arrestime, gazetata Beogradase shkruanin se „ Më në fund duke iu falënderuar organeve të ndjekjes, u zbuluan dhe u kapën grupet „ terroriste“ „ seperatiste“ e „ marksist –leniniste“ anëtar të LPRK-së dhe LKÇK-së, të cilët ishin përgatitur për të kryer vepra „ terroriste“ në Kosovë.

Në kapje e sipër dhe në kontrollimin që iu bë shtëpive, vatrat e këtyre shtëpive, vatrat e këtyre grupeve në Prishtinë, Podujevë, Mitrovicë, Vushtrri, Prizren, Ferizaj, Pejë, Drenicë etj, u kap edhe një arsenal i madhë armësh të rënda.²⁵³ Në muajin tetor të viti 1993, LPK ka vendosur që Ramadan Avdiu të kaloj në Zvicër për shkak se ai ishte bartësi kryesor i aktivitetit të saj në këtë kohë dhe e njëjtte strukturën e organizimit më së miri nga të gjithë në Kosovë. Pas këtyre burgosjeve dhe largimeve, me organizimin politiko - ushtarak, në Kosovë kanë vazhduar të mirren : Hashim Thaçi, Azem Syla, Kadri Veseli, Adnan Asllani si dhe veprimtarë që nuk ishin të dekonspiruar, si Sokol Bashota, Nait Hasani, Zahir Pajaziti, Xheladin Gashi, Mujë Krasniqi, Rexhep Selimi, Luan Haradinaj, Lahi Ibrahimaj, Fatmir Limaj, Rrustem Mustafa, Jakup Nura etj., kurse rol vendimtar natyrisht se ka pasur Komandanti Legjendar i UÇK-së, Adem Jashari.

Ata kryesisht kanë qenë të përqëndruar në forcimin e organizimit ushtarak dhe strukturimin e bërthamave të armatosura nga të cilat u formua Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Sa herë që LPK është ndodhur në situata të vështira, Dega e saj Jashtë Vendit ka luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e organizimit dhe në sistemimin e lidhjeve të shkëputara. Në këtë periudhë, nga Dega Jashtë Vendit veçanarisht ka qenë aktiv dhe ka mbajtur barrë të madhe të organizimit dhe strukturimit Xhavit Haliti, por edhe Ali Ahmeti e Jashar Salihu.²⁵⁴ Me gjithë burgosjet masive të shqiptarëve të Kosovës dhe masat drastike që merreshin kundër tyre, reagimi i partive legale ishte shumë i dobët.

²⁵¹ Zëri i Kosovës, 15 gusht 1993, fq.1, dhe 15 tetor 1993, fq.1

²⁵² Aktakuza e ngritur nga pushteti i dhunshëm serb kundër Ilaz Kadollit, Behajdin Allaqit dhe Hysen Gegës, Hep.nr. 292/93, Gjykata e Qarkut Prizren, 10 nëntor 1993
– Arkivi I Familjes së Behajdin Allaqit, ish – udhëheqës I LPRK-së në vitet 1991 -1993, ish –ushtar I UÇK-së, tani dëshmor i Kombit.(M.Z)

²⁵³ Borba, gusht 1993, marrë nga Zëri i Kosovës, 1 shtator 1993, fq 6.

²⁵⁴ Ramadan Avdiu, Epoka e re, 24.2.2004

Në kohën kur veprimtarët e LPK-së burgoseshin, rraheshin dhe vriteshin, legalistët i etiketonin ato me lloj lloj epitetesh si: „ Lëvizja është organizatë ilegale“ „ Lëvizja është organizatë marksiste – leniniste dhe kundër Qeverisë së Kosovës dhe 3-përqindëshit“ etj.²⁵⁵ Edhe përkundër sulmeve që i bëheshin LPK-së si nga pushtuei serb, por edhe nga partitë legale në Kosovë, veqanarisht nga LDK-ja, LPK nuk u lëshua asnjëherë në luftë ideologjike, as në interesa të ngushta partiake, për ti akuzuar subjektet legale politike në Kosovë, të cilët në shumicë vinin nga Lidhja Komuniste e Jugosllavisë. Në vitin 1993, Fisnik Cukaj, atëherë student Rektor në UP dhe veprimtar i LPK-së, bashkë me, Hashim Thaçin student Pro-Rektor dhe Skender Sallauka, poashtu veprimtar të LPK-së, në emër të UPSP-së kishin një takim me Kryetarin e Kosovës, Ibrahim Rugova. Kryetari Ibrahim Rugova, në këtë takim i kishte përbuzur delegacionin e studentëve.²⁵⁶

Në këtë kohë, Lëvizja Popullore e Kosovës e cila ishte njëra ndër organizatat ilegale më të përkushtuara ndaj çështjes kombëtare shqiptare dhe padyshim organizata politike më e përndjekur që nga krijimi i saj në shkurt të vitit 1982, pësoi goditjen e saj më të madhe nga regjimi i Beogradit. U burgos edhe mr.Ukshin Hoti, politikologu dhe veprimtari më i njohur dhe më i përfolur i Kosovës, me të cilin veprimtarët e LPRK-së kishin bashkëpunim të madh dhe konsultoheshin me te shumëhërë.²⁵⁷Për t'i ikur arrestimit shumë veprimtar të LPK-së ishin detyruar të arratiseshin. Një pjesë e të arratisurve kishin dalur jashtë vendit, ndërsa pjesa tjetër vepronte ilegalisht në kuadër të UÇK-së në Kosovë.

Veprimtarët e LPK-së të arratisur në vitin 1993 janë: Ardian Krasniqi, Ali Ukaj, Azem Zejnullahu, Sejdi Gega, Azem Syla, Ekrem Jashari, Halil Selimi, Halit Krasniqi, Ibish Neziri, Fahri Makolli, Fatmir Brajshori, Hashim Thaçi, Murat Bytyqi, Ilmi Zeka, Kadri Veseli, Ramadan Avdiu, Ramiz Lladrovci, Sejdi Sejdiu, Skënder Krasniqi, Ukë Shala, Xhemajl Rudi, Muharrem Elshani, Bislim Elshani, etj.²⁵⁸

²⁵⁵ Tre përqindëshi, ishte Fond i themeluar nga Qeveria e Kosovës të cilën e udhëhiqte Bujar Bukoshi. Paratë e këtij fondi administroheshin për mbajtjen gjallë të jetës politike, arsimore, kulturore etj, në Kosovë, por jo edhe për organizimin e luftës së armatosur(verejtje autori).

²⁵⁶ Naim Balidemaj, Tragjedia Kosovare, Rugova – Millosheviq, Prishtinë 2001, f.123 – 124.

²⁵⁷ Ukshin Hoti, Filozofia Politike e çështjes shqiptare, Zëri i Kosovës, 1995, Tiranë, f. 279 – 323.

²⁵⁸ Zëri i Kosovës, 1 janar 1994, f. 2

Duke nxjerrë mësimet e duhura nga arrestimet e vitit 1993 nga njëra anë, por edhe duke u mbështetur në grupin e qëndresës së Adem Jasharit, LPK-ja do t'i caktoj njerëzit që do të punojnë për organizimin e krahut ushtarak, i cili do të organizohej e do të vepronte brenda vendit. Ky grup përbëhej nga: Nait Hasani, Rexhep Selimi, Xheladin Gashi Azem Syla, Adem Jashari, Xhavit Haziri, Xhavit Haliti, Nait Hasani, Zahir Pajaziti, Sokol Bashota, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Lahi Brahimaj, Luan Haradinaj, Ali Ahmeti etj.

Për të biseduar lidhur me organizimin e rezistencës aktive të armatosur në Kosovë, një delegacion i LPK-së i përbërë nga: Xhavit Haziri, Ramadan Avdiu dhe Azem Syla, u takuan me Kryetarin e LDK-së dhe të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, Fehmi Aganin dhe Zenel Kelmendin. Takimi përfundoi si shumë herë pa sukses.²⁵⁹ Azem Syla ishte i ngarkuar nga LPK-ja, për mbajtjen e lidhjeve të drejtëpërdrejta me formacionet e armatosura në Kosovë. Vështirësitë e kësaj forme të organizimit ishin të shumta, sepse këta veprimtar ndiqeshin sa nga makineria e kompletuar e shtetit serb, që sa vinte e shtonte rrjetin e bashkëpunëtorëve të rinj, sa edhe nga rrjeti i bashkëpunëtorëve të vjetër, që vepronin në radhët e partive politike shqiptare, e sidomos kishin depërtuar mirë në radhët e subjekteve pacifiste.²⁶⁰ Një pjesë e veprimtarëve të LPRK-së dhe të UÇK-së, ndonëse ishte i denuar nga pushtuesi serb, me shumë vite burg, ata nuk shiheshin me sy të mirë edhe në Shqipëri, ndërsa një pjesë nga ta arrestoheshin edhe në Tiranë, vetëm e vetëm pse bënë përparje për organizimin e rezistencës së armatosur në Kosovë.²⁶¹

5) . Pjesë nga Programi i dhe statuti i LPK-së, i dalur nga MKP e vitit 1993

Programi dhe statuti i LPK-së për herë të parë u aprovuan në MPP të LPK-së, në korrik të vitit 1987. Projekt për këto dokumente shërbyen „tezat e Frontit popullor për Republikën e Kosovës“ të lëshuara në diskutim nga viti 1981. Ndryshimet në to u bënë në MDP të LPK-së, 1989, MTP e LPK-së 1991. botimi i tashëm i veçantë, i pesti me radhë bëhet me ndryshimet që i bëri MKP e LPK-së në gusht të vitit 1993.

²⁵⁹ Ramadan Avdiu, 01.2.2009.

²⁶⁰ Jakup Krasniqi, vepra e cituar, fq. 13.

²⁶¹ Naim Balidemaj, vepra e cituar, fq.123 – 124.

Pika më e rëndësishme e programit të LPK-së e vitit 1993, ishte, paragrafi - h – përmes të cilit LPK parashihte si opcion për zgjidhjen e çështjes së Kosovës edhe luftën e armatosur. Për këtë arsye më poshtë po japim edhe pjesë nga programi dhe statuti i LPK-së i vitit 1993.

Programi:

- Duke u nisur nga e drejta e ligjshme e qdo populli për liri, pavarësi e vetëvendosje, është e drejtë e pa mohueshme dh edomosdoshmëri që edhe populli shqipëtar të luftoj me të gjitha mjetet dhe format për qlirim, konform me normat ndërkombëtare.
- Shqiptarët duhet të jenë të barabart me kombet tjera, sepse nuk janë minoritet as në përqsaje kombëtare, as ndërkombëtare, por komb i ndarë. Pjesa e robëruar e popullit shqipëtar i ka të gjitha karakteristikat që e përbëjnë një popull komb: është popull tre milionësh që ka historinë dhe gjuhën e vet, territorin kompakt, lidhjet ekonomike, formimin psikik dhe kulturor të tij.
- Populli shqipëtar duhet të orientohet drejt çlirimit të Kosovës dhe formimit të shtetit të pavarur të Kosovës, që do të përfshijë të gjitha trojet nën okupim, ku shqipëtarët janë shumicë.
- Çlirimi dhe formimi i shtetit të pavarur të Kosovës krijon kushtet që populli ynë të barazohet me popujt e tjerë të hapësirës Ballkanike. Vetëm atëherë ka mundësi të ndërtohet sistemi pluralist, të vendoset ekonomia e tregut, liritë e plota komëtare, njerëzore dhe demokratike.
- Çlirimi dhe formimi i shtetit të pavarur Kosovës është në përputhje të plotë me normat ndërkombëtare. E drejta e vetëvendosjes është e drejtë kombëtare e univerzale dhe parim themelor i kartës së OKB-së, të Helsinkit dhe të Parisit.
- Populli ynë nuk do të pranojë asnjë zgjidhje ndërkombëtare që është në kundërshtim me vullnetin e tij dhe me të drejtën e tij për vetëvendosje. Pa zgjidhje të drejtë të çështjes së popullit shqiptar nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme në Ballkan dhe më gjerë.

- LPK është Organizatë nacionalçlirimtare e pjesës së robëruar të kombit shqiptar në Serbi, Maqedoni e Mal të Zi që ka për qëllim: Çlirimin dhe formimin e shtetit të pavarur të Kosovës në bazë të parimit të vetëvendosjes.
- Për arritjen e aspiratave kombëtare, LPK do të përdor të gjitha format e luftës çlirimtare: demokratike, paqësore e politike dhe të rezistencës së armatosur. LPK i kombinon format ligjore legale të veprimit në përputhje me rrethanat dhe situatën që krijohen.
- LPK është për formë popullore të luftës, ndërsa është kundër formave fashiste, raciste, anarkiste e terroriste të veprimit, por edhe kundër atyre ekskluzive pacifiste e kapitulluese.
- LPK e konsideron Shqipërinë faktor të rëndësishëm për zgjidhjen e çështjes së popullit shqipëtar nën okupim.
- LPK do të bashkëpunojë me institucionet kombëtare në shqipëri e në Kosovë për të gjitha çështjet e karakterit Kombëtar. Në raport me forcat politike në Shqipëri, LPK do të mbaj qëndrim të pa anshëm.
- LPK respekton kartën e OKB-së, kartën e Helsinkit dhe aktet tjera ndërkombëtare, por është kundër vendimeve të bashkësisë ndërkombëtare e cila, në kundërshtim me parimet themelore të aprovuara nga vetë ajo, konfirmoi ndarjen e kombit shqiptar në pesë shtete në Londrën 2.

Statuti

- LPK është organizatë demokratike, çlirimtare e pjesës së robëruar të kombit shqiptar nën serbi, maqedoni e mal të zi.
- LPK synon formimin e frontit të gjerë popullor – pa dallim feje, krahine a ideje, me forcat që janë të gatshme për çlirimin e vendit.
- LPK ka për qëllim çlirimin e Kosovës dhe krijimin e kushteve për formimin e shtetit të pavarur të Kosovës, që do të përfshijë të gjitha trojet nën okupim, ku shqiptarët janë shumicë.
- Pas çlirimit LPK-ja do të angazhohet për ndërtimin e shoqërisë shqiptare të lirë dhe demokratike, në përputhje me vullnetin e popullit.

Anëtari i LPK-së ka për detyrë:

- a). Të zbatojë programin, statutin dhe vendimet e organeve udhëheqëse të LPK-së
- b). Të luftoj për çlirimin e trojeve shqipëtare të okupuara dhe për të drejtat kombëtare e demokratike.
- c). Të ruaj bashkimin dhe unitetin e radhëve të LPK-së

Anëtari i LPK-së ka të drejtë:

- a). Të marrë pjesë në diskutimin e qështjes së organizimit, të vijës politike dhe të punëve e detyrave që organizata ia ka parashtruar vetes.
- b). Të bëjë pyetje, kritikë, kërkesë, njoftim, propozim dhe ankesë në të gjitha instancat e LPK-së
- c). Të zgjedh dhe të zgjidhet në organet e LPK-së

II.

- a) Organi më i lartë i LPK-së është MP

III.

- a). Jeta e brendshme organizative e LPK-së ndërtohet mbi bazën e parimeve demokratike²⁶²

Programin dhe statutin e LPK-së e hartuan Kryesia e LPK-së: Xhavit Haziri, Emrush Xhemajli, Ramadan Avdiu, Hashim Thaqi, Halil Selimi dhe Ibish Neziri²⁶³

²⁶² Programi dhe statuti i LPK-së, Zëri i Kosovës, 1993, Prishtinë.

²⁶³ Ramadan Avdiu, 01.2.2009.

KAPITULLI I TRETË

1. Formimi i UÇK-së

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, i ka rrënjët e saj te organizatat nacionaliste, të cilat vepruan në fund të viteve, 70 –ta, veçanarisht te LPRK-ja, e cila u krijua në vitin 1982, më vonë LPK.²⁶⁴ Rënia heroike e Naser Hajrizit më 1981, e Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës më 1984, e Bajram Bahtirit, Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut më 1989, e Ali Ajetit, Hasan Ramadanit, Arif Seferit e shumë të tjerëve, i kishte nxitur veprimtarët e devotshëm të LPK-së dhe të çështjes kombëtare që lufta të vazhdojë deri në çlirimin përfundimtar të trojeve shqiptare. LPK, që nga vitet 80-ta, kishte krijuar sektorin e saj ushtarak, të cilët ishin marrë kryesisht me furnizimin me armatim nga shtetet perëndimore, kryesisht për nevoja të organizatës, por edhe për përballje me pushtuesit. Edhe pas viteve 90-ta kur politika pacifiste, propagandonte se Kosova mund të çlirohet me lutje e konferenca shtypi, bijtë më të mirë të Kosovës dhe viseve të banuara me shqiptar në Jugosllavi, u organizuan në forma të ndryshme dhe i bënë rezistencë aktive pushtuesit serbo – malazezo – maqedon.

Deri në vitin 1995, LPK ka qenë një parti radikale, e cila ka vepruar më shumë jashtë vendit dhe kishte ndikim të vogël në spektrin politik të Kosovës. LPK, sëbashku me organizatat tjera ilegale, në mes të viteve ,90-ta kanë formuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës – UÇK.²⁶⁵ Ideja për emërimin e ushtrisë, UÇK është realizuar nga sektori i veçant i LPRK-së. LPRK-ja, e cila më vonë u shëndrrua në LPK, aktivitetin e saj, pos në Kosovë e zhvillonte edhe në Zvicër, Gjermani dhe Shqipëri. E vogël dhe në ilegalitet – LPRK-ja filloi të vinte kontakte me militantët brenda Kosovës.²⁶⁶ Kjo Lëvizje po ashtu u mundua të mësojë se si ta organizoj një kryengritje guerilase, duke i studiuar përvojat në Irlandë, Vietnam, Algjeri dhe rajonin Bask të Spanjës, duke mësuar ku dhe prej kujt të sigurohen armët, si dhe duke e vënë në jetë një rrjet të mbledhjes së fondeve.²⁶⁷

²⁶⁴ Konrad Clewing, Jens Reuters, Der Kosovo – Konflikt, Munchen, 2000.

²⁶⁵ Stephan Lipsius, Untergrundorganisationen in Kosovo, Sudeuropa 47, 1998, s. 75 -82.

²⁶⁶ Jakup Krasniqi, vepra e cituar, fq. 10 -11

²⁶⁷ Henry H. Perritt Jr., UÇK- Rrëfim prej Brenda për një kryengritje, fq.16.

Më 30 dhjetor 1991, Adem Jashari me bashkëluftëtar i kishte bërë rezistencë të armatosur në Prekaz, forcave pushtuese serbe. Në këtë kohë Adem Jashari, pas kthimit nga sërviçet në Shqipëri, kishte krijuar bërthamën e organizimit të armatosur të quajtur Grupi i Drenicës, të cilin e përbënin: Adem Jashari, Sahit Jashari, Fadil Kodra, Ilaz Kodra dhe të tjerë që iu bashkangjitën këtij grupi në vazhdim. Edhe në rajone tjera të Kosovës, si në Llap, Dukagjin, dhe në Rrethin e Ferizajt, ishin krijuar njësitë guerile, të cilët kishin filluar të bënin edhe aksione të armatosura mbi policinë dhe ushtrinë pushtuese serbe. Përmes këtij angazhimi nëpër çeta, edhe pse jo me emrin UÇK, fillon organizimi i një ushtrie të re të Kosovës.²⁶⁸ Më 26 maj 1992, në Leshan të Pejës, në përpjekje të armatosura, në një postbllok të policisë serbe, ishte vrarë Tahir Lush Berisha 23 vjeç, dhe polici Serb Sllavolub Bogosavleviq, 25 vjeç, ndërsa u plagos rëndë polici tjetër serb Branisllav Çekerliq.²⁶⁹ Aksione të armatosura, njësitë guerile kryen edhe kundër punkteve të policisë serbe në Gllogovc, më 23 maj 1993, më 05 korrik 1993 në hyrje të fshatit Vitomiricë të Pejës, ku u plagosën policët serb Zharko Batkoviç dhe Vladimir Nikçeviq, pastaj më 23 korrik 1993, në Prizren ku u plagosën policët Vukomir Vuksanoviç dhe Bajram Gashi, ndërsa më 27 korrik 1993 në afërsi të Podujevës, njësitë gueril gjatë një aksioni plagosi një polic serb.²⁷⁰

Aksionet e armatosura të njësiteve guerile gjatë viteve 1991, 1992, 1993, janë parahistoria dhe provë për formimin e UÇK-së, sepse procesi formal i formimit të UÇK-së, nuk përkon vetë me një datë të vetme. Aksione të kohëpaskohshme pati thuaja në të gjitha rajonet, qytetet dhe fshatrat e Kosovës.²⁷¹ Fillimisht, njerëzit e angazhuar në UÇK ishin të pakët, ata më të devotshmit, më trimat, më sakrifikuesit, më të ndërgjegjshmit, kryesisht anëtar të LPK-së, krahut ushtarak të saj. Aksionet e para të kryera në Kosovë dhe ato të mëpastajmet, nuk u panë me sy të mirë, nga politika pacifiste, e cila ende kishte ndjenjën iluzioniste të bërjes së lirisë. Anatema për UÇK-në dhe veprimet e saj, fatkeqësisht, ishte shumë prezente në një pjesë të subjektit politik të Kosovës të asaj kohe.²⁷²

²⁶⁸ Murat Jashari, intervistë, B. Hamza, F.Hoti, Jasharët, Zëri, 2003, Prishtinë

²⁶⁹ Gafurr Elshani, UÇK, dokumente dhe artikuj, janar 1998, Zvicër, fq.1

²⁷⁰ Po aty, fq. 18,19, 20, 21.

²⁷¹ Libri i Lirisë, Zëri, Prishtinë 2003, intervistë e Rexhep Selimit, f. 250

²⁷² Ramë Buja, Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi I Jugosllavisë, Prishtinë 2007, fq.313 -314

Ashtu siç u quajtën të parakohshme dhe u anatemuan nga udhëhija Komuniste e Kosovës, demonstratat e vitit 1981, poashtu u anatemua dhe u etiketua edhe dalja në skenë e UÇK-së, nga udhëheqësit e politikës pacifiste të Kosovës.²⁷³

Njësitet e para të UÇK-së u krijuan nga bazat e LPK-së, të cilat mbetën edhe pas dorëheqjes së udhëheqjes së Kryesisë së LPK-së brenda vendit, më 1991.²⁷⁴ Me dëshirën e tyre, dhe me miratimin e LPK-së, një pjesë e Këshillave të LPK-së, kaluan në njësi luftarake,²⁷⁵ ndërsa protagonist kryesor në këtë proces është Adem Jashari dhe familja e tij.²⁷⁶

Duke u mbështetur në dokumentet e LPK-së, në programin dhe në statutin, në rezolutat dhe në vendimet që dolën nga MPP, MDP dhe MTP (Vitet: 1987, 1989 dhe 1991) para organeve udhëheqëse të LPK-së, sidomos Kryesisë dhe KP-së, qoftë brenda qoftë jashtë vendit, u paraqit nevoja e organizimit ushtarak që do të fuste në veprim të gjitha format dhe mjetet demokratike e ligjore të luftës, për të çliruar vendin dhe për të realizuar aspiratën historike të populli shqiptar për bashkimin kombëtar.²⁷⁷ Bazuar në këto dokumente, në nëntor 1994, edhe juridikisht, LPK ndërtoi subjektin e saj ushtarak, UÇK-në. Deri në këtë kohë, ky subjekt ushtarak nuk kishte emrin UÇK, as rregullore të përhershme dhe as dokumente normative. Në Kryesinë e LPK-së pos emrit UÇK, u paraqitën edhe dy emërtime tjera:

1. Forcat e Armatosura të Kosovës dhe

2. Lëvizja Çlirimtare e Kosovës. Pas analizës mbi baza politike, ushtarake e Juridike, si dhe pas diskutimit të gjerë me vota unanime, 7-të për (tër anëtarët e Kryesisë) dhe asnjë kundër, në nëntor 1994²⁷⁸ u pranua propozimi që kjo forcë ushtarake që u organizua dhe po udhëhiqej nga LPK-ja, të emërtohej Ushtria Çlirimtare e Kosovës – UÇK.²⁷⁹ Për të marrë karakterin shtetëror, pas emërimit të subjektit ushtarak u pa e domosdoshme edhe çështja e rregullimit juridik dhe të shëndrrimit të UÇK-së në ushtri të shtetit. Me emërtim dhe rregullim juridik, askush nuk kishte të drejtë dhe as mundësi të akuzonte këtë subjekt ushtarak për terrorizëm apo me ndonjë akuzë tjetër kriminale.

²⁷³ Lisen Bashkurti, debat në Alsat, 10.02.2009,

²⁷⁴ Muhamet Kelmendi, vepra e cituar, fq. 19.

²⁷⁵ Po aty, fq.20.

²⁷⁶ Rexhep Selimi, vepra e cekur, f. 250.

²⁷⁷ Muhamet Kelmendi, Pse nuk u ndërtua Fronti për Çlirimin e Kosovës, Tiranë 1991, fq. 9.

²⁷⁸ Emrush Xhemajli, deklaratë, 30 janar 2009.

²⁷⁹ Vendim i Kryesisë së KP të LPK-së, maj 1993

Aksionet e UÇK-së duhej të kishin karakter thjesht Çlirimtar, të liruar nga veprimtaria që futej në terrorizëm. Me urdhrat që kishte lëshuar LPK-ja, D.J.V. e shëndrroi UÇK-në në një ushtri të rregullt. Sektori politiko – juridik nxori edhe rregulloren e UÇK-së: „ UÇK-ja duhet të kryej aksione çlirimtare me karakter të drejtë, ku nuk goditen objektet sociale – kulturore, popullsia civile dhe objektet me rëndësi për jetën e popullit” UÇK-ja duhej të godiste:

1. Objektet ushtarke dhe policore, makinerinë pushtuese dhe të gjitha mjetet e komunikacionit, telekomunikacionit dhe atyre objekteve që pushtuesi i fut në shërbim të luftës kundër popullit shqiptar.
2. Njësitet speciale policore dhe forcat në shërbim të armikut, si: vullnetar serb, paramilitar e ushtarak të sjellur nga Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina në Kosovë të cilët kryejnë veprimtari të rënda kriminale përballë kombit shqiptar.
3. Elementët shqiptar, përkatësisht tradhëtarët mund të ekzekutohen, por vetëm pasi të ishte bërë analiza dhe të ishte paralajmëruar mbi veprimtarinë tradhëtare, duke ia lënë edhe afatin e tërheqjes, në mënyrë që të përmirësoheshin.

Pas kësaj, lejohej të merrej vendimi për ekzekutimin, kuptohet në organet më të larta dhe duke lajmëruar popullin, si dhe tregoheshin edhe shkaqet e një mase të tillë. Aksionet nuk lejohen të kryhen në vende publike, aty ku mund të rrezikohej jeta e qytetarëve, pavarësisht nga rëndësia që paraqet objekti në aspektin ushtarak. Në rregullore bëhej e ditur se UÇK e pranon LPK-në si organizatë udhëheqëse të cilës i kaloheshin kompetencat në fushën politike, juridike, diplomatike dhe financiare. Poashtu autorizohet LPK që të nxirrte Komunikata në emër të SH.Q të UÇK-së.²⁸⁰

LPK dhe Kryesia e Degës së saj jashtë vendit, si mbështetëse politike dhe financiare e UÇK-së, u autorizuan nga SH.Q.i UÇK-së për lëshimin e Komunikatave, përmes së cilave LPK duhej mbrojtur UÇK-në, para kundërshtarëve të brendshëm politik, pushtuesit serb dhe para opinionit të të huaj.²⁸¹Gjatë viteve 1993 -1996, LPK-ja dhe UÇK-ja, e morën veten nga arrestimet e vitit 1993, duke e konsoliduar procesin e rekrutimit, mbledhjes së fondeve dhe themelimit të strukturave logjistike për një luftë. LPK-ja dërgoi veprimtarë të saj në Kosovë për t'i identifikuar dhe rekrutuar njerëzit si dhe për t'i zëvendësuar ata që ishin arrestuar.

²⁸⁰ Platforma e LPK-së për luftën e armatosur në Kosovë dhe Rregullorja e UÇK-së, f. 24-26.

²⁸¹ M.kelmendi, vepra e cituar, fq. 46.

Ajo ishte pothuaj e pa dukshme në Kosovë, në mesin e Diasporës si edhe për Bashkësinë Ndërkombëtare.²⁸² LPK e cila, në programin e saj, mundësinë e zgjidhjes së problemit të Kosovës e shihte vetëm përmes luftës së armatosur, po të mos ishin ndarjet dhe përçarjet, karrierizmi, lufta për të qenë i pari dhe frika nga më të aftit, do të gjendej në ballë të Lëvizjes politike të Kosovës. Megjithate, edhe përkundër të metave LPK-ja, ka qenë forca më serioze ilegale e cila formoi UÇK-në, ndihmoi organizimin në terren, financoi ate, e armatosi dhe e ndihmoi politikisht. LPK ishte krahu politik i UÇK-së deri me formimin e Drejtorisë Politike më 1998.²⁸³

Goditja e shkaktuar nga burgosjet e veprimtarëve të LPK-së në vitin 1993, ishte tepër e rëndë. Ajo ishte shkaktuar nga përndjekja e aktivitetit të saj dhe krijimi i një mjedisi diferencues që udhëhiqte politika pacifiste legale. Me dhjetëra e dhjetëra anëtarë, disa prej të cilëve sapo ishin zgjedhur në vendet drejtuese të saj, tashmë ishin në burgjet serbe. Tashmë ishte i vështirë organizimi dhe riorganizimi i radhëve, mbijetesa e nëjsiteve të para të UÇK-së. Shumë gjëra duhej të filloheshin nga e para, duhej bërë ringritja e strukturave organizative dhe e nëjsiteve guerile, duheshin rindërtuar radhët e goditura rëndë.²⁸⁴ Tek populli shqiptar i Kosovës, në vitin 1993 ishte ngulitur bindja se e vetmja rrugë e drejtë për të siguruar pavarësinë e Kosovës ishte politika pacifiste dhe përfaqësuesit e kësaj linje. Tentimi për të tërhequr vëmendjen e njerëzve drejt radikalizimit të gjendjes, krijimit të një mendimi të ndryshëm ishte një nga herezitë më të rënda në mbrojtje të së cilës qëndronin pa asnjë kompromis „ QIK-u " gazetat "Bujku" dhe „Rilindja", aktivet e LDK-së, satelitët partiak të LDK-së, PSHDK dhe PLK, programi satelitor i TVSH-së etj.²⁸⁵ Në faqet e saj, gazeta Bujku, e cila zëvendësonte Rilindjen, shkruante me pompozitet lidhur me vizitat që bëheshin në Kosovë nga diplomat të huaj, të cilët premtinin se nuk do të lejojnë gjakëderdhje në Kosovë, ndërsa Ibrahim Rugova, kërkonte nga delegacionet e huaja që Kosova të vihet nën një sistem ndërkombëtar të protektoratit.²⁸⁶

²⁸² Henry H. Perritt Jr., UÇK- Rrëfim prej Brenda për një kryengritje, fq.16, 17.

²⁸³ Jakup Krasniqi, vepra e cituar, fq. 12.

²⁸⁴ Bedri Islami, E fshehta e hapur e Kosovës, Epoka e re, 2001, Prishtinë. 45 – 47.

²⁸⁵ Po aty

²⁸⁶ Bujku, 27 korrik 1993, fq. 3.

E gjithë kjo shoqërohej me krijimin e një psikoze të veçantë se drejtuesit e Lëvizjes ilegale përgjithësisht, dhe në mënyrë të veçantë të LPK-së, ishin jo vetëm „ të dyshimt", „ majtist" apo „Enverist", si dhe grupe të të lidhur me organet e sigurimit serb" asgjë nuk ishte e pa qëllim dhe asgjë nuk ishte e rastësishme.²⁸⁷

Përkundër këtyre arrestimeve dhe kësaj propagande që bëhej në dëm të LPK-së dhe krijesës së saj në embrion UÇK-së, gjatë viteve 1993 -1995, këshillat e LPK-së nëpër komunat e Kosovës si: Skenderaj, Gllogovc, Ferizaj, Prishtinë, Podujevë, Deçan, Pejë, Gjilan, Kërçovë, Tetovë, Kumanovë, Shkup etj, filluan organizimin e tyre ushtarak edhe më me përkushtim dhe më me vendosmëri, duke qenë të vetëdijshëm se rruga që kishin nisur nuk ishte e lehtë dhe se atë rrugë duhej vazhduar deri në fund. Ata shëndrrohen në njësite të armatosura, pra në njësite të para të UÇK-së.²⁸⁸

Veprimtarët më të njohur që nga puna politike iu përkushtuan punës ushtarake në radhët e UÇK-së ishin: Në rrethin e Maishevës dhe Klinës: Xheladin Gashi, Sokol Bashota, Fatmir Limaj, Rexhep Selimi, Mujë Krasniqi, Ragip Shala, Isa Krasniqi, Asllan Pantina, Skender Rexhepi, Fadil Nimani, në Rahovec: Durmish Gashi, Halil Qadraku, Selim Gashi, në rrethin e Ferizajt: Rexhep Bislimi, Vezir Jashari, Gursel Sylejmani, në Dukagjin: Qerim Kelmendi, Adrian Krasniqi, Beqir Limani, në Anamoravë: Xhemajl Jashari, Xhevat Qerimi, Ismet Sylejmani, Shaqir Shaqiri, Jonuz Musliu etj. Këta veprimtarë të LPK-së në Kosovë dhe veprimtarë të tjerë që vinin në ndihmë nga jashtë vendit kishin për detyrë të bënë rizgjimin, por pa krijuar një dremitje të re.²⁸⁹ Dega e LPK-së Jashtë Vendet, ishte vënë poashtu në shërbim të UÇK-së. Ajo ishte i vetmi subjekt politik që i kishte dalur në mbrojtje UÇK-së dhe ishte krahu politik i saj, sikurse që UÇK-ja në një farë forme mund të ishte krahu ushtrarak i LPK-së. UÇK dhe LPK, kishin një emblemë dhe një qëllim²⁹⁰ Kryesia e LPK-së -D.J.V, vuri në shërbim të UÇK-së të gjithë potencialin e saj intelektual, organizativ dhe financiar.

²⁸⁷ Bedri Islami, Po aty.

²⁸⁸ Emrush Xhemajli, 20 vjet veprimtari e LPK-së,

²⁸⁹ Po aty,

²⁹⁰ Fazli veliu, LPK – UÇK, vepra e cituar.

Ajo merr vendim për formimin e sektorëve të veprimtarisë së LPK-së, duke iu dhënë autonomi të madhe të veprimit sektorëve të veçantë, si:

1. Sektorit të organizimit politik - Fazli Veliu, Muhamet Kelmendi etj,
2. Sektorit të lidhje - mbajtjes me veprimtarët e LPK-së në Kosovë, në Shqipëri dhe jashtë vendit - Emrush Xhemajli, Gafurr Elshani, Adem Grabovci, Rexhë Ibërdemaj;
3. Sektori i rëndësisë së veçantë -Xhavit Haliti, Ali Ahmeti, dhe Azem Sylaj;
4. Sektori i propagandës, redaksisë së gazetës „ Zëri i Kosovës" etj. Veprimtaria e këtyre sektorëve koordinohet në Kryesi të LPK-së dhe për punën e përgjithshme raportohej në Këshillin e Përgjithshëm të LPK-së.²⁹¹ Duke u përballuar me një situatë të tillë, LPK lëshoi në qarkullim të brendshëm të radhëve të saja një material ku analizohej situata politike në Kosovë dhe detyrat që i dalin LPK-së në të ardhmen. Në këtë material, LPK njoftonte për Situatën në Kosovë të cilën po e rëndon rritja e tendencave negative në situatën në Ballkan, e cila po vie duke u bërë gjithnjë më eksplozive.

Në këtë ndikuan faktor të shumtë e më së shumti mungesa e një rezistence aktive të brendshme. Kundërshtimi verbal i Kryeministrit Bujar Bukoshi në takimin e nivelit Ballkanik në Stamboll dhe të tjerat të ngjashme, nuk janë duke u marrë parasysh askund, pasi prapa Kryetarit të Kosovës, Ibrahim Rugova dhe Kryeministrit Bujar Bukoshi nuk qëndron ndonjë forcë e brendshme ushtarake që do të rrezikonte planet e shteteve tjera për Kosovën. Me serbët mund të bisedohet dhe të vendosen marrëdhënie diplomatike, vetëm pasi të hiqen trupat serbe nga Kosova dhe vetëm pasi serbët t'a pranojnë Republikën e Kosovës dhe të pjesëve shqiptare etnike që i mban mini Jugosllavia.²⁹² Në këtë drejtim, para LPK-së shtrohet detyrë që në shumë drejtime të fillojë nga e para në ndërgjegjësimin e popullit dhe në përgatitjen e shpirtit të rezistencës dhe të aksionit. LPK e goditur nga arrestimet e pushtesit dhe e raskapitur nga sulmet e forcave që tashmë kanë filluar të dështojnë, në Kosovë aktualisht nuk paraqet forcë që do të mund të ecën me ritmin e kërkesave të kohës për të ndryshuar rrjedhat rrënjësisht. Kjo rrugë e vështirë për LPK-në, në të ardhmen do të jetë më e vështirë praktikisht, por fatkeqësisht, praktika vërtetoi konceptet e LPK-së për luftën dhe për ecjen drejt çlirimit.²⁹³

²⁹¹ Muhamet Kelmendi, pse nuk u ndërtua Fronti për çlirimin e Kosovës.

²⁹² Material për Këshillat e e LPK-së, maj 1994

²⁹³ Po aty,

Pas insistimit të grupeve të armatosura brenda vendit, Kryesia e LPK-së, merr vendim për fillimin e lëshimit të komunikatave, në të cilat merr përsipër kryerjen e aksioneve të armatosura. LPK, në mbledhjen e mbajtur më 17 nëntor 1994, vendosi që të lëshoj Komunikatën e parë për shtyp në emër të UÇK-së. Pas një diskutimi të gjatë, Kryesia, duke pasur parasysh edhe propozimet e grupeve të armatosura, merr vendim që organizimi i ri ushtarak të quhet „Ushtria Çlirimtare e Kosovës”. U vendos që Komunikata të ketë nr.rendor 11. Në këtë mbledhje merrnin pjesë: Fazli Veliu, Emrush Xhemajli, Xhavit Haliti, Ali Ahmeti, Gafurr Elshani, Azem Syla. Kryesia e LPK-së ka vendosur për stemën e UÇK-së, të cilën e punuan Gafurr Elshani dhe Adnan Asllani.²⁹⁴ Komunikatën, nga Zurichu, për në Shkup, fshehurazi e dërgoi një veprimtar i LPK-së,²⁹⁵ dhe nga këtu, ajo iu dërgua mjeteve të informimit në Kosovë, si dhe agjensisë serbe të lajmeve Tanjug²⁹⁶

Në Komunikatën e UÇK-së nr. 11, e cila u emetua në mediat e shkruara dhe elektronike serbe²⁹⁷ në të cilat thuhej se „ një grup i paidentifikuar terrorist i shqiptarëve të Kosovës, i quajtur „ Ushtria Çlirimtare e Kosovës“ më 9 nëntor 1994, mori mbi vete atentatin për vrasjen në Glligovc, të inspektorit të lartë të policisë serbe, Lutfi Ajazi“²⁹⁸

Edhe kësaj radhe, LDK dhe qendra e saj për informim, QIK, propaganduan pa sjellur ndonjë fakt, se „ sulmin, sikurse edhe në raste tjera, e ka kryer vetë serbia me qëllim të shkaktimit të konfliktit në shkallë të gjerë“. ²⁹⁹Përkundër sulmeve nga të gjitha anët, në mars - prill 1994, UÇK themeloi Shtabin Qendror të saj, anëtar të parë të të cilit ishin: Azem Syla, Nait Hasani, Xheladin Gashi, Sokol Bashota, Xhavit Haliti, Ali Ahmeti. Komandant i UÇK-së emërohet Azem Syla, kurse Shef Operativ në Kosovë, e cila e kishte selinë në Prishtinë, u caktua, Nait Hasani, anëtar të tij: Rexhep Selimi, Sokol Bashota, Mujë Krasniqi, Xheladin Gashi. Nait Hasani, ka qenë njeriu kryesor i UÇK-së në Kosovë, deri në arrestimin e tij. ³⁰⁰Ai ishte koordinues i të gjitha veprimeve të UÇK-së në Kosovë dhe lidhje në mes të UÇK-së brenda dhe jashtë vendit.³⁰¹

²⁹⁴ Xhavit Haliti, Fejton ekskluziv, pesëvjetori i UÇK-së, gazeta ditore, 31 mars 2003, Prishtinë.

²⁹⁵ Deklaratë e Emrush Xhemajlit, janar 2009, Prishtinë.

²⁹⁶ Rilindja, botimi për Zvicër, 29.11.1994.

²⁹⁷ Veçerni Novost, Jedinstvo, 10 nëntor 1994.

²⁹⁸ Zëri i Kosovës, nr.23. 1.12.1994

²⁹⁹ Po aty.

³⁰⁰ Nait Hasani, vepra e cituar, f.145.

³⁰¹ Xhavit Haliti, si e bëmë UÇK-në, Zëri, shkurt 2001, Prishtinë, si dhe në „ libri lirisë” Prishtinë, 2003, fq.42

Në nivel të Kosovës, Shtabi Operativ me seli në Prishtinë përbëhej nga: Nait Hasani, Rexhep Selimi, Adem Jashari, Sokol Bashota, Zahir Pajaziti, Lahi Brahimaj dhe Bislim Zogaj.³⁰² Rolin e zëdhënësit në propagandimin e ekzistimit dhe të rritjes së UÇK-së dhe të përkrahjes së idesë se „ pa luftë të armatosur nuk mund të ketë çlirim nga okupatori Serb“ e kanë luajtur, LPK dhe Zëri i Kosovës. Ndërsa Këshilli Qendror i fondit „ Vendlindja Thërret“,³⁰³ në financimit dhe konsolidimit të UÇK-së. Këshillat e Rretheve të LPK-së në Zvicër, Gjermani, Austri, Suedi, Danimarkë, SHBA etj, u shëndrruan në propagandues dhe financues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.³⁰⁴ Ndërsa, Kryesia e LPK-së, d.j.v. poashtu zhvillonte aktivitet diplomatik dhe takime me parlamentar e diplomat Evropian me qëllim të njoftimit me gjendjen aktuale në Kosovë, si dhe qëndrimin e LPK-së për zgjidhjen e kësaj çështje, jo në kuadër të Serbisë siç po pretendohet, por në bazë të të drejtës për vetëvendosje për shqiptarët në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Preshevë.³⁰⁵

2). Fondi i UÇK-së „ Vendlindja Thërret“

Dega e LPK-së j.v. gjatë viteve 1982 -1990, përmes LPK-së në Kosovë, bëri financimin kryesor të veprimtarive gjithëpopullore. Në kuadër të aktivitetit politiko – ushtarak që nga vitet 80-ta, LPK, kishte paraqitur nevojën edhe për ngritjen e fondeve, të cilët do ta ndihmonin në organizimin e saj dhe të njësiteve të armatosura. Aktivitet modeste të mbledhjes së fondeve kishin filluar në Zvicër, fillimisht në kuadër të LPK-së. Këto fonde mblidheshin dhe ishin të obliguar vetëm për antarësinë, ndërsa ndihmat pranoheshin edhe nga simpatizantët të cilët e përkrahnin vijën politike të saj. Pas demonstratave të vitit 1989, në Kosovë, heqjes së autonomisë së Kosovës nga Millosheviqi, mbledhja e fondeve u bë më formale.

³⁰² Nait Hasani, deklaratë më 06.3.2009

³⁰³ Fazli Veliu, LPK – UÇK, fq. 92.

³⁰⁴ Raportet dhe njoftimet e KP të LPK-së D.J.V, 1993 -1999.

³⁰⁵ Komunikatë e LPK-së, Bruksel, 17.12.1994.

Në vitin 1991, LPK fondin dedikuar veprimtarisë në Kosovë, e shkriu në fondin „**Humanitar Gjithëkombëtar**“, duke shpresuar se Qeveria e Kosovës do të jetë financues i veprimtarive kundër pushtuesve, mirëpo shumë shpejtë u kuptua se Qeveria e Kosovës, nuk ishte e gatshme të financonte veprimtarinë konkrete kundër regjimit të pushtimit në Kosovë dhe viset e saj. Si rrjedhim, LPK përsëri riaktivizoi fondin për realizimin e programit të saj, çlirimit të Kosovës.

Ndërtimi i njësiteve të para ushtarake, paraqiti nevojën para organeve udhëheqëse të LPK-së edhe detyrën e financimit të tyre. LPK e kishte financimin e brendshëm, i cili bëhej nëpërmjet antarësisë së saj, por ky financim ishte shumë simbolik. Fillimisht financimi i njësiteve ushtarake u bë nga financat e LPK-së. Ato jepeshin në formë të parave të gatshme, të mjeteve të ndryshme dhe të mjeteve luftarake të cilat siguroheshin në mënyrë ilegale. Mjetet që i siguronte antarësia e LPK-së, ndaheshin sipas territorit, njësisive e veprimtarisë që i kryenin. Pas vitit 1995, mjetet financiare iu dërgoheshin SHQ të UÇK-së, i cili edhe kryente administrimin e mjeteve. Financimi i vetëm për njësitet e para ushtarake për shumë vite u bë vetëm nga antarësia e LPK-së. Asnjë subjekt tjetër, as partiak, as qeveritar, as kulturor etj, nuk dha asnjë ndihmë për UÇK-në. E tërë shuma e mjeteve financiare të antarësisë së LPK-së shkonte tek njësitet e UÇK-së dhe asnjë lek nuk mbahej për nevoja të aktivitetit të LPK-së.

Të gjitha shpenzimet për aktivitetin e LPK-së mbulohehin individualisht nga anëtarët e LPK-së. Kjo ishte domosdoshmëri për kohën.³⁰⁶ Në kuadër të analizave për gjendjen financiare, nga përgjegjësi financiar i LPK-së, Gafurr Elshani, në vitet 1993 – 1995 u paraqitën në organet udhëheqëse të LPK-së tri propozime për financimin e UÇK-së:

1. Financimi përmes antarësisë së LPK-së,
2. Përcaktimi i shumave mujore dhe vjetore për anëtarët dhe simpatizantët e LPK-së, në lartësi prej 1.000 FRS, apo 1.000 DM dhe kundërvlera në valuta tjera, për anëtarët në shtet Skandinave dhe SHBA.
3. Hapja e Fondit dhe ndërtimin e Këshillit të financimit për të patur mundësi që të ndihmohej në baza vullnetare UÇK-ja.³⁰⁷

³⁰⁶ Muhamet Kelmendi, Pse nuk u ndërtua Fronti për Çlirimin e Kosovës, Tiranë 1991, fq. 9.

³⁰⁷ Vendim i LPK-së, 04.12.1993

Çështje të tilla u shqyrtuan nga Kryesia me disa rregulla, sidomos në formë dhe u paraqitën në KP të LPK-së për t'i miratuar, ndërsa fuqizimin e këtij vendimi duhej t'a bënte Mbledhja e Përgjithshme e LPK-së. Ky propozim, u shqyrtua në Mbledhjen e Katërt të LPK-së, në vitin 1993 duke u miratuar të tri këto forma të financimit të UÇK-së. Sipas vendimeve të dalura nga Mbledhja e IV –tër e Përgjithshme e LPK-së, më 04.12.1993, u mor vendim që: Të gjithë anëtarët e LPK-së që kanë të ardhura, të japin nga 1.000 frz. ose 1.000 DM³⁰⁸.

Ndarja dhe dështimi i bisedimeve në mes të LPK-së dhe Qeverisë së Bukoshit në ekzil, për ndërtimin e terrenit për një luftë guerile kundër shtypjes serbe, si dhe përfundimi me sukses të këtij aksioni, ndikoi që LPK të formojë fondin e saj „Vendlindja Thërret”, fond i cili i dedikohej luftës për çlirimin e trojeve të robëruara shqiptare.³⁰⁹ Fondi „Vendlindja Thërret“ i dedikohej kryesisht njësisë çlirimtare. Ky fond fillimisht u fut në kuadër të sektorit financiar të LPK-së që e udhëhiqte Gafurr Elshani, e kishte të shtrirë veprimtarinë e vet në 22 shtete të Evropës Perëndimore, në Skandinavi dhe në SHBA. Çdokund ishin të shtrira këshilla të financimit të Fondit, në nëndegët dhe këshillat e Rretheve të LPK-së.

Veprimtarët e LPK-së dhe të Fondit „Vendlindja Thërret“, veq financimit dhe logjistikës, u morën edhe me mobilizimin e vullnetarëve që donin t'i bashkoheshin UÇK-së si dhe propagandimin e luftës në aspektin politik.³¹⁰

Në mars 1994, Fondi „Vendlindja Thërret“ kishte hapur kontonumrin e saj në Schëeiz Bankverein në Zurich të Zvicrës. Ekzistenca e Fondit „Vendlindja Thërret“ fillimisht bëhej i ditur vetëm për organizimin e brendshëm të LPK-së³¹¹, ndërsa në njoftimin e LPK-së në gazetën e saj „Zëri i Kosovës“ nuk thuhej se ky fond u dedikohej luftëtarëve të UÇK-së, për shkak se ekzistonte rreziku i mbylljes së tij nga organet Zvicrane, por nga anëtarët dhe simpatizantët e LPK-së kërkohet që „të ndihmohen të burgosurit dhe të përndjekurit politik nga pushtuesi serb si dhe aktiviteti i LPK-së në Kosovë për realizimin e qëllimeve programore të saj“.³¹²

³⁰⁸ Vendim i Mbledhjes së IV të Përgjithshme të LPK-së, 1993

³⁰⁹ Vendim i Kryesisë së LPK-së, 04 dhjetor 1993,

³¹⁰ Arkivi i Fondit „Vendlindja Thërret“ Aarau, Zvicër

³¹¹ Njoftim nga Procesverbali i Mbledhjes së KP të LPK-së, 30.04.1994.

³¹² Zëri i Kosovës, nr.145, 1 mars 1994, fq.8.

Nga vitit 1994 e deri në qershor të vitit 1996, LPK, mbledhjen e mjeteve financiare për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e kishte fokusuar më shumë tek antarësia e saj, për shkak se në këtë kohë, mërgimtarët nuk besonin se UÇK ishte një ushtri e vërtetë dhe se Fondi „ Vendlindja Thërret“ është fond i saj. Kryesia e LPK-së ftonte anëtarët e saj për ndihma urgjente për të ndihmuar luftën çlirimtare në Kosovë, duke i obliguar ata të kryejnë obligimin ndaj fondit „ Vendlindja Thërret“ në vlerë mujore të 100 FRS ose 100 DM, si dhe kërkohej nga anëtarët e LPK-së që të bindin sëpaku nga tre antëar të familjes, miq dhe shokë që edhe ata të paguajnë në këtë fond. Kryesia e LPK-së poashtu u bënte thirrje anëtarëve dhe simpatizantëve të LPK-së që në bazë të mundësisë të marrin kredi ose të japin të holla të gatshme në formë të huasë me një afat të pacaktuar.³¹³

Nga qershori 1996, kur aksionet e armatosura të UÇK-së kishin filluar të marrin përmasa më të mëdha, LPK, kishte filluar që të organizoj tubime me bashkëatdhetarë, ku i njoftonte ata se veprimtaria çlirimtare në Kosovë duhet të përkrahet me të gjitha format dhe mjetet e mundshme dhe se aksionet e UÇK-së kundër pushtuesit janë në favor të çështjes së pa zgjidhur kombëtare.

Në një tubim me bashkëatdhetar në Kantoni Schëiz të Zvicrës, LPK, ftonte bashkëatdhetarë që veprimtaria çlirimtare të ndihmohet përmes fondit të LPK-së „ Vendlindja Thërret“, ndërsa nga Qeveria e Republikës së Kosovës kërkonte që fondin e saj të 3%, ta vëjë drejtëpërdrejtë në shërbim të UÇK-së.³¹⁴

Tubime të tilla me bashkëatdhetar, LPK, mbante në të gjitha qytetet dhe Këshillat e Rretheve ku kishte të shtrirë aktivitetin e saj në vendet perëndimore, në Skandinavi dhe SHBA. Shumë veprimtarë nëpër këshilla të rretheve të LPK-së në Zvicër, Gjermani, Austri, Itali, Amerikë dhe në vendet Skandinave u angazhuan me të gjithë potencialin e tyre që kishin, si në aspektin financiar ashtu edhe në aspektin ideologjik, duke u bërë shembull konkret së pari me derdhjen e mjeteve të tyre në këtë fond e pastaj duke organizuar edhe tubime informative për këtë qëllim. Ata në emër të LPK-së dhe nën moton „ Atdheu në rrezik, Vendlindja Thërret" organizuan qindra e mijëra tubime informative me bashkëatdhetarë.³¹⁵

³¹³ Njoftim për Këshillat e Rretheve të LPK-së, nxjerrë nga procesverballi i Mbledhjes së KP të LPK-së, 02.12.1996

³¹⁴ Zëri I Kosovës, Njoftim I K.Rr të LPK-së, Schëiz, 6 qershor 1996, fq.3.

³¹⁵ Po aty,

Në këto tubime, veprimtarët dhe udhëheqësit e LPK-së, i informonin bashkëatdhetarët për nevojën e përkrahjes së luftëtarëve të lirisë të cilët ia kishin kthyer pushkën armikut serb dhe poashtu kërkonin nga ata që përveq përkrahjes morale, kjo luftë të përkrahet edhe me të holla dhe forma të tjera logjistike. Me rritjen e aksioneve të armatosura të UÇK-së në Kosovë, rritej edhe nevoja e furnizimit me armatim dhe mjete financiare.³¹⁶ Për këtë LPK, Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm të Degës së LPK-së, më 04.5 1996 vendosi që Jashar Salihu të administroj të hyrat e fondit „Vendlindja Thërret“. Jashar Salihu, nga një vërtetim për të hyrat u dërgon Këshillave dhe individëve. Në Këshillin Qendror për financim të LPK-së u emëruan: Jashar Salihu, Azem Sylja, Zenuni Bajrami, Ali Ahmeti dhe Adem Grabovci.³¹⁷

Fondi „Vendlindja Thërret“ ishte makina më e njohur për mbledhjen e fondeve për UÇK-në. Integrimi i padepërtueshëm dhe udhëheqja e ndërlidhur me LPK-në, bëri që ky fond të jetë dominues për menaxhimin financiar dhe logjistikën e UÇK-së në Shqipëri.³¹⁸

Duke filluar nga viti 1996, pothuajse të gjitha Komunikatat e saj, UÇK-ja vazhdimisht përforçonte porosinë e përcjellë nga mbledhësit e fondeve në u bënin thirrje shqiptarëve në ekzil ta mbështesnin financiarisht UÇK-në, përmes fondit „Vendlindja Thërret“³¹⁹. Edhe gazeta „Zëri i Kosovës“ organ propagandistik i LPK-së, tani u shëndrrua hapur në zëdhënëse e UÇK-së, duke i publikuar Komunikatat e lëshuara nga aksionet e armatosuar të UÇK-së si dhe duke propaganduar tek mërgimtarët për përkrahje financiare të luftës Çlirimtare të përmes Fondit „Vendlindja Thërret“.³²⁰ Kryesia e LPK-së, d.j.v. ishte organ udhëheqës, me kompetenca politike, organizative, diplomatike etj, e cila e udhëhoqi UÇK-në deri më 01.05.1998, kur UÇK-ja, krijoi Drejtorinë e saj politike.³²¹ Krahas organizimit ushtarak, UÇK-së, Lëvizjes Popullore të Kosovës i duhej edhe angazhimi në gjetjen e mjeteve financiare për vazhdimin e luftës çlirimtare. Kjo ndodhte për shkak se ata që ishin të thirrur dhe të obliguar me Kushtetutë të Republikës së Kosovës, pra Qeveria e Kosovës, të cilën e udhëhiqte Bujar Bukoshi, nuk ishin të gatshëm të punonin për ndërrimin e strategjisë së veprimit.

³¹⁶ Njoftim i KP të LPK-së, nxjerrë nga Procesverbali i mbledhjes, 28.04.1996

³¹⁷ Vendim i Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së Dega Jashtë Vendi, 04.5.1996.

³¹⁸ Henry H. Perritt Jr., UÇK, Rrëfimi prej brenda për një kryengritje, Koha, Prishtinë, 2008, fq. 127 -130.

³¹⁹ Komunikatë e UÇK-së, nr. 30, 3 shkurt 1997.

³²⁰ Zëri i Kosovës, 26 shtator 1996, fq.3.

³²¹ Muhamet Kelmendi, fq. 21.

Qeveria e Bujar Bukoshit, në ekzil edhe pse mblidhte para nga tre përqindëshi në diasporë dhe në Kosovë, mjetet siç u tha edhe më lartë, mjetet financiare i përdorte për ndihmimin e jetës politike, kulturore dhe arsimore në Kosovë, por mjetet e mbledhura nga ky fond, fatkeqësisht, kurrë nuk ia dedikoi luftës dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.³²² Fondi „Vendlindja Thërret“ nxorri edhe rregulloren e saj, përmes të cilës i udhëzonte veprimtarët e saj për format e punës së tij. Në rregulloren e Fondit „Vendlindja Thërret“ thuhet: „Fondi „Vendlindja Thërret“ është Fond përmes të cilit mërgimtarët vullnetarisht kontribuojnë për të forcuar rezistencën e popullit tonë kundër etnocidit dhe gjenocidit që po ushtrojnë pushtuesit e trojeve tona.

1. Anëtar i Fondit „Vendlindja Thërret“ mund të jetë çdo shqiptar që shpreh gadishmëri për të ndihmuar dhe kontribuar në grumbullimin e mjeteve financiare dhe ndihmimin e Kosovës përmes këtij fondi.
2. Anëtar të fondit mund të jenë ata persona që kanë dhënë dhe japin prova në ndihmimin e veprimtarisë patriotike. Ata duhet të jenë shembull i njeriut të ndershëm dhe veprimtarit të pa lodhshëm.
3. Anëtar i fondit nuk mund të jetë asnjë person që nuk e ndihmon me rregull Fondin „Vendlindja Thërret“
4. Anëtar të Fondit nuk mund të hyjnë persona që kanë kryer vepra penale dhe që ndiqen nga drejtësia e shtetit Zvicran, apo e shteteve tjera perëndimore.
5. Në fond nuk guxojnë të hyjnë para me prejardhje të dyshimtë.
6. Veprimtarët e Fondit „Vendlindja Thërret“ që pranojnë mjete me prejardhje të dyshimtë, automatikisht do të përjashtohen nga Fondi.

Këshilli Qendror i Fondit „Vendlindja Thërret“ Zvicër³²³

Sipas rregullores së Degës së LPK-së, faqe 10, pika 2 sipas të cilit „kontrollimi i hyrje – daljeve nga të gjitha fondet e bën Kryesia e KP të LPK-së”, Kryesia, në mbledhjen e saj të datës, 15.06.1996, mori vendim që të gjitha arkat e përfshira në pikën 1.1, 1.2, 1.3, 1.4., por edhe arka e fondit „Vendlindja Thërret“ të raportojnë në mbledhje të Kryesisë për gjendjen momentale të arkës, çdo muaj. Raportimi duhet të bëhet me shkrim, deri më datën 15 të muajit.

³²² Naim Balidemaj, *Tragjedia Kosovare, Rugova – Millosheviq, prishtinë 2001, fq.177.*

³²³ Rregullore e Fondit „Vendlindja Thërret”, arkivi i Fondit „Vendlindja Thërret” Aarau, Zvicër

Kjo formë bëhet me qëllim që Kryesia të marrë vendime të sakta dhe të cilat mund të mbulohen financiarisht.³²⁴Për shkak të volumit të punëve në organizimin dhe mbarëvajtjen e punëve, por edhe të kontrollimit të saj, KP i LPK-së, në mbledhjen e saj të mbajtur më 19 dhe 20 tetor 1996 mori vendim që: Komisioni qendror i Financimit i LPK-së të plotësohet edhe me tre anëtar të rinj: Ibrahim Kelmendi, Xhemajl Fetahu³²⁵ dhe I. Elshani. Të formohen në kohë sa më të shkurtër nënkëshillat e Këshillit Qendror të Financimit të LPK-së. Në Gjermani të mbetet konto „Vendlindja Thërret“, por të hapet edhe një konto e veçantë për pagesën e antarësisë së LPK-së. Këshilli Qendror i Financimit, kontrollon të gjitha nënkëshillat e financimit.³²⁶

Deri në Janar të vitit 1997, kur UÇK-ja kishte strukturën e vet të organizimit, financimi bëhej në mënyrë qendrore nga organet e këtij subjekti ushtarak, ndërsa mjetet financiare nga Këshilli i financimit i dërgoheshin nëpërmjet sektorit të SH.Q. të UÇK-së. Shtabi Qendror, pastaj bënte ndarjen e mjeteve financiare nëpër zonat dhe nënzonat e UÇK-së. Kështu vazhdoi deri në Janar të vitit 1997, kur pas vrasjes së Zahir Pajazitit dhe arrestimit të disa nga anëtarët e SH.Q të UÇK-së, lidhjet e LPK-së dhe anëtarëve të Fondit „Vendlindja Thërret“ u shkëputën. Mbi këtë bazë, si edhe pas konfirmimit gojor dhe me shkrim që arriti në Kryesinë e degës, por edhe nga Këshillat e LPK-së, që kishin lidhje me radhët e UÇK-së brenda vendit, kompetencat e mjeteve financiare i kaluan Kryesisë së KP të Degës së LPK-së.³²⁷

Pas këtij vendimi, shpërndarja e mjeteve financiare u bë nga Kryesia e KP të LPK-së. Kështu LPK, ndau mjete financiare për njësitet e UÇK-së, në Drenicë, veqanarisht në Prekaz, për njësitin e Llapit – Prishtinë, për njësitin e Dukagjinit dhe në Pollog, në viset shqiptare nën pushtimin maqedon. Shumën e këtyre mjeteve e vendoste Kryesia e KP të LPK-së, sipas nevojës që paraqitej në terren.³²⁸ Deri në janar të vitit 1998, fondi „Vendlindja Thërret“ kishte hapur Kontonumrin e saj në: Zvicër, Gjermani, Itali, Belgjikë, Holandë, Slloveni, Britani të Madhe, Finlandë, Kanada, Suedi, Austri, Norvegji, Francë, Danimarkë, SHBA, Australi etj.

³²⁴ Vendim i Kryesisë së KP të LPK-së, D.J.V, 15.06.1996.

³²⁵ Xhemajl Fetahu, edhe pse kishte detyra me rëndësi në kuadër të LPK-së dhe Fondit „Vendlindja Thërret“ iu bashkua radhëve të UÇK-së në Kosovë, ku bie heroikisht më 31 maj 1999.

³²⁶ Vendim i KP të LPK-së, 19 -20 tetor 1996.

³²⁷ Deklaratë e Muhamet Kelmendit, ish - n. Kryetar i LPK-së, deri në vitin 1999, dhënë më 20 janar 2009, Prishtinë.

³²⁸ Po aty.

Duke e parë se Fondi „ Vendlindja Thërret“ po gjente përkrahje nga mërgimtarët çdo ditë e më tepër, me insistimin e qeverisë së Serbisë, qeveria e Zvicrës në Janar të vitit 1998, mori vendim për mbykqyrjen e fondit, siç e quanin ata të LPK-së, Fondi „ Vendlindja Thërret“ poashtu u survejua dhe u pengua nga disa shtete Evropiane të cilët për një kohë i bllokuan mjetet e këtij fondi. Gazeta Zvicrane „ Der Bund“ njofton se, sipas ankesës së Serbisë, organet Zvicrane të drejtësisë janë duke e shikuar „ legalitetin e Fondit të Kosovës „ Vendlindja Thërret “.

Nga i njejtë burim mësohet poashtu se Prokuroria Federale e Zvicrës e ka futur „ në listën e përcjelljes“ edhe LPK-në.³²⁹ndërsa gazetata autoritative Zvicrane „ Der Bund“, „ Le Matin“ etj, në shkrimet e tyre akuzonin LPK-në, se duke mbledhur ndihma financiare përmes Fondit „ Vendlindja Thërret“ dhe duke propaganduar në Gazetën e saj „ Zëri i Kosovës“po bënë rekrutimin e vullnetarëve për të luftuar në Kosovë“.³³⁰

Të njejtin avaz e përsëriti edhe gazeta „ L' HEBDO“ e cila botohet në Lozanë, e cila akuzon LPK-në, se po organizon tubime në përkrahje të luftës në Kosovë dhe se po mbledh të holla përmes fondit „ Vendlindja Thërret“ për të përkrahur luftën e UÇK-së në Kosovë.³³¹ Pas kësaj ndalese, aktiviteti i veprimtarëve të LPK-së për mbledhjen e ndihmave financiare në kuadër të Fondit „ Vendlindja Thërret“ u rrezikua shumë, por falë udhëheqsve dhe veprimtarëve të LPK-së, u gjetën format dhe mundësitë që ushtarët e UÇK-së të kenë mjete financiare të mjaftueshme për vazhdimin e luftës Çlirimtare në Kosovë. Me fillimin e luftës së armatosur në mars 1998, deri në përfundim të saj, Fondi „ Vendlindja Thërret“ i cili vepronte në kuadër të LPK-së, u zgjerua edhe më shumë me veprimtar të saj në të gjitha vendet Evropiane, në Skandinavi dhe në SHBA. Tanimë, pas luftës dhe rënies heroike të Adem Jasharit dhe familjes së tij, populli shqiptar i Kosovës e kuptoi përfundimisht se lufta e filluar në Prekaz do të përhapet edhe në pjesët tjera të Kosovës dhe se ushtarët duhet ndihmuar me të gjitha mjetet e mundshme. Kësaj bindjeje i ndihmoi edhe një Komunikatë e UÇK-së, e lëshuar për opinion dhe mjetet e informimit, në të cilën veç tjerash thuhej se „ UÇK-ja ka si burim financimi kontributet vullnetare të popullit tonë nën moton „ Atdheu në rrezik - Vendlindja Thërret“³³²

³²⁹ Raport nga Mbledhja e KP të LPK-së, D.J.V, 24.01.1998, Eürzburg, Gjermani

³³⁰ Gazeta Zvicrane, Der Bund, 18.01.1998.

³³¹ Gazeta Zvicrane, L'HEBDO, 22.01.1998.

³³² Deklaratë politike nr. 2 e SH.P të Ushtirës Çlirimtare të Kosovës, 27.4.1998, Prishtinë.

Në vendet perëndimore, në klubet shqiptare, por edhe në ambiente tjera, tubimet në përkrahje të UÇK-së, mbaheshin qdo ditë. Veprimtarët e LPK-së dhe të Fondit „ Vendlindja Thërret “ organizuan me qindra e mijëra tubime mobilizuese si dhe zgjeruan edhe rrjetin e veprimtarëve të fondit. Anëtar të Fondit, sipas rregullores së tij, mund të bëhej çdo shqiptar, i cili e përkrahte luftën çlirimtare në Kosovë dhe i cili ishte i gatshëm të propagandonte në favor të kësaj lufte.

Shumë veprimtar të Këshillave të Emergjencës dhe të fondit të qeverisë Bukoshi, tani dolën hapur në përkrahje të Fondit „ Vendlindja Thërret“ dhe ishin të gatshëm të jepnin kontributin e tyre në përkrahje konkrete të UÇK-së.³³³ Ky fond ishte burimi kryesor financiar i luftës së UÇK-së në Kosovë, ndërsa degët e tij u krijuan edhe nëpër ato shtete ku nuk kishte organizim politik të LPK-së, por që kishte bashkëatdhetarë të cilët ishin të gatshëm ta ndihmonin financiarisht UÇK-në.

Në këto vende, veqanarisht në disa shtete të SHBA-së, veprimtarët e Fondit „ Vendlindja Thërret“ organizonin tubime për mbledhjen e mjeteve financiare, por edhe në organizimin e tubimeve dhe të demonstratave, për propagandimin e luftës së UÇK-së në Kosovë.³³⁴ Fakti pse bashkëatdhetarët filluan ti japin përkrahje të gjerë UÇK-së dhe fondit të sa „ Vendlindja thërret“ ishte sepse, bashkëatdhetarët që punoni dhe vepronin në shtetet Perëndimore, që nga vitet 80-ta, kishin tubuar shumëherë mjete, për ta ndihmuar qëndresën e popullit në Kosovë dhe luftën Çlirimtare, por që ata ishin zhgënjyer, sepse Qeveria në ekzil, e udhëhequr nga Bujar Bukoshi, nuk kishte ndërmarrë asgjë në dedikimin e mjeteve financiare për këtë qëllim, ndërsa tani që veq lufta kishte filluar, kjo qeveri, kishte bllokuar mjetet e saj dhe ende i mbante të mbyllura nëpër bankat Gjermane, Zvicrane etj.³³⁵

Këshilli Qendror për Administrimin e Fondit „ Vendlindja Thërret“, i cili tanimë nuk i takonte vetëm LPK-së, por të gjithë bashkëatdhetarëve që ishin të gatshëm ta ndihmonin luftën çlirimtare që po zhvillohej në Kosovë, gjatë tërë periudhës mars 1998 – qershor 1999, ishte në shërbim të luftëtarëve të lirisë dhe i zbatonte me përpikmëri kërkesat dhe urdhërat e SH.P të UÇK-së.³³⁶

³³³ Komunikatë e Këshillit Qendror për Administrimin e Fondit „ Vendlindja Thërret“ Aarau, Zvicër, 04. 06.1998.

³³⁴ Thirrje për demonstratë, e udhëheqësve të Fondit „ Vendlindja Thërret“, Neë York, 01.6.1998.

³³⁵ Komunikatë e Këshillit Qendror për Administrimin e Fondit „ Vendlindja Thërret“ Aarau, Zvicër, 04. 06.1998.

³³⁶ Deklarata politike nr.18 e UÇK-së, 10 nëntor 1998, Prishtinë.

Këshilli Qendror për Administrimin e Fondit „ Vendlindja Thërret“ duke analizuar gjendjen e rëndë të popullit të Kosovës, i cili po ballafaqohej për luftë a vdekje, pas kërkesë së SH.P të UÇK-së, vendosi që nga data 14 nëntor – 20 dhjetor 1998, të organizoj aksionin për mbledhjen e mjeteve financiare, nën moton „ Atdheu në Rrezik - Vendlindja Thërrer“. Përmes tij obligonte të gjithë bashkëatdhetarët që janë të punësuar dhe kanë të njohur statusin e tyre në Zvicër, Gjermani dhe shtetet tjera të Evropës Perëndimore, të paguajnë nga 1.000 frs, ose 1.000 DM, ndërsa bashkëatdhetarët që jetojnë në SHBA, Kanada, Australi etj, duhet të kontribuojnë me më së paku 1.000 dollarë Amerika. Gjithashtu, bashkëatdhetarët që jetojnë në Francë, Austri, Slloveni dhe vende tjera me standard më të ulët, duhet të paguajnë më së paku 700 – DM, ndërsa bashkëatdhetarët që kanë firma të regjistruara në vendet ku ata jetojnë, duhet të paguajnë së paku 3.000 FRZ, DM ose kundërvlera tjetër.³³⁷ E njejta thirrje u lëshua për bashkëatdhetarët edhe nga SH.P i UÇK-së.³³⁸ Në janar të vitit 1999, SH.P i UÇK-së, në përputhje me rregulloren e vet për rikonstruimin e drejtorive e të sektorëve të UÇK-së, vendosi që :

1. Të emërojë anëtarët e Këshillit Qendror të Fondit „ Vendlindja Thërret“
2. Të emëroj anëtarët e Këshillave të Fondit nëpër shtete të veqanta.
3. T’i publikoj emrat e përgjegjësve kryesor të fondit „ Vendlindja Thërret“

Anëtarët e emëruar të Këshillit Qendror të Fondit „ Vendlindja Thërret janë:

1. Jashar Salihu – Kryetar, Mujë Rugova – nënkryetar, Agush Buja – Kontrollor financiar, Fatmir Zyberi – drejtor ekzekutiv, Ramiz Lladrovci – përgjegjës administrativ, Hasan Ukëhaxhaj, Halit Naxhaku, Mehmet Bislimi, Hysni Sylaj, Naser Tupella, Jashar Alia, Naser Ramadani, Xhevat Bislimi, Bilall Sherifi, Shaban Muja – Anëtar.

Udhëheqës të Fondit „ Vendlindja Thërret“ në shtetet e Evropës dhe SHBA:- Mehmet Bislimi- Zvicër, Hasan Ukëhaxhaj – Gjermani, Xhevat Xhemajli – Austri, Xhevat Bislim – Francë, Nufri Lekaj – Norvegji, Pleurat Sejdiu – Britani e Madhe, Naser Berisha – Itali, Islam Selimi Holandë, Bedri Selmanaj – Kroaci, Bruno Selimaj – SHBA dhe Kanada, Halil Musaj – Australi.³³⁹

³³⁷ Vendim I K.Q. për administrimin e Fondit „ Vendlindja Thërret“ 14.nëntor 1998, Aarau, Zvicër.

³³⁸ Deklaratë politike nr. 19. e UÇK-së, 04 dhjetor 1998, Prishtinë.

³³⁹ Komunikatë e SH.P të UÇK-së, nr. 74. Prishtinë, 22 janar 1999.

Fondi „Vendlindja Thërret“ i themeluar në dhjetor të vitit 1993, i udhëhequr nga Jashar Salihu, një veprimtar i përkushtuar për çështjen kombëtare, ishte tashmë një fond i organizuar në mënyrë të studiuar dhe rigoroze, me një kontroll të rrept financiar dhe me një destinim të veçantë – çlirimin e vendit nga robëria. Duke qenë fond i të gjithë shqiptarëve ai tani ishte fond jasht partiak dhe ajo që i bashkonte bashkëatdhetarët rreth këtij fondi ishte ideja e lirisë, bashkimit dhe çlirimit të Kosovës.³⁴⁰

Aksione dhe veprimtari të tilla, K.Q. për Administrimin e Fondit „Vendlindja Thërret“ organizoi edhe gjatë muajve janar – qershor 1999, mvarësisht sipas gjendjes faktike në terrenin e luftimeve dhe kërkesave të SH.P të UÇK-së.³⁴¹

Përmes mjeteve financiare të këtij Fondi, SH.P i UÇK-së, arriti t’i furnizoj ushtarët e lirisë me mjete financiare, logjistike dhe armatim, por edhe në mbulimin e aktivitetit politik dhe diplomatik, që bënin aktivistët e LPK-së të autorizuar nga SH.P i UÇK-së për bisedime me përfaqësues të shteteve perëndimore, NATO-s, SHBA-së dhe Bashkësisë Evropiane. Është e vështirë të jepen vlerësime të përafërta për shumën totale të parave të mbledhura nga Fondi „Vendlindja Thërret“, megjithatë është e arsyeshme të konkludohet se gjatë periudhës më shumë se 5 vjeqare (dhjetor 1993 – qershor 1999) të ekzistimit të Fondit „Vendlindja Thërret“, degët e të cilit vepronin në më shumë se 20 shtete, ku kishte të shtrirë aktivitetin e tij, nga bashkëatdhetarët shqiptar Fondi „Vendlindja Thërret“ rreth 11 milion dollarë i ka mbledhur në SHBA, 50 milion dollarë në Zvicër, dhe 10 -12 milion dollarë në Gjermani . Sipas këtyre shifrave dhe duke e pasur parasysh se fondi ishte i shtrirë edhe në shtetet tjera, shuma e përafërt e mbledhur nga Fondi „Vendlindja Thërret“ do të ishte nga 75 milion dollarë - 100 milion Dollarë.³⁴²

E gjithë puna në terren për këta 5 vite e veprimtarëve të fondit bëhej në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë lloj kompenzimi. Gjatë ofanzivave të policisë dhe ushtrisë serbe kundër UÇK-së në muajt, korrik -tetor 1998 kur luftëtarët e lirisë, të lodhur nga luftërat, me mungesë të armatimit e të përkrahjes së institucioneve shtetërore të Kosovës, udhëheqësit e LPK-së ishin ata që fondin tashmë e kishin shëndrruar në fond të ushtrisë.

³⁴⁰ Komunikatë e Këshillit Qendror për Administrimin e Fondit „Vendlindja Thërret“ Aarau, Zvicër, 04. 06.1998.

³⁴¹ Thirrje e SH.P të UÇK-së, 12 janra 1999, Prishtinë.

³⁴² Henry H. Perritt Jr., UÇK, Rrëfimi prej brenda për një kryengritje, Koha, Prishtinë, 2008, fq.132.
- Ibrahim Kelmendi, janar 2009, Prishtinë.

Ishin ata që u jepnin krah e nxitje luftëtarëve për vazhdimin e luftës së armatosur deri në fitoren përfundimtare. Ajo e kishte të qartë se çlirimi pa gjak dhe pa ndihma materiale nuk mund të bëhej. Poashtu veprimtarët e LPK-së ishin ata të cilët në kohën kur politika shqipëtare e Kosovës i gëzohej dobësimit të radhëve të UÇK-së, bënë çmos për përkrahjen dhe afirmimin e saj qoftë edhe në qarqe ndërkombëtare.

3). Roli i gazetës „ ZËRI I KOSOVËS” organ i LPK-së.

Pas Plenumit të Brionëve (1966) dhe demonstratave të vitit 1968, në Kosovë, pati një dendësi të ngjarjeve politike që dëshmojnë për një arritje të konsiderueshme të legales dhe ilegales shqiptare. Edhe pas këtyre ngjarjeve të rëndësishme, populli shqiptar ishte i pakënaqur, ngase nuk iu realizuan dhe nuk iu plotësuan kërkesat e tyre jetike. Viti 1974, edhe për një gjë është i rëndësishëm, ngase po në këtë vit filloi të dalë edhe revista ilegale e organizatës “Grupi revolucionar” i pagëzuar me emrin “Zëri i Kosovës”, që njëherësh ishte edhe organi kryesor informativ i saj. Në vitet 70 –ta, ishte gjallëruar aktiviteti ilegal, dhe si detyrë parësore edhe më tutje kishte rivendosjen e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë dhe luftën e pakompromis kundër okupuesit. Revista “Zëri i Kosovës”, megjithëse doli vetëm në dy numra, trajtoi tematika dhe problematika nga më të ndryshmet.³⁴³

Historiku i gazetës „ Zëri i Kosovës“ daton që nga viti 1973, ndërsa numrin e parë i kësaj gazete grupi ilegal e nxori më 1 shkurt 1974, organ i Grupit Revolucionar të Kosovës, të udhëhiqur nga Kadri Osmani, Mehmet Hajrizi, Xhafer Shatri, Binak Ulaj dhe Feriz Seferaj. Kjo revistë doli vetëm në dy numra, ndërsa numrin e tretë (në dorëshkrim) e konfiskoi policia serbe gjatë arrestimeve që iu bë anëtarëve të grupit.

Revista edhe pse doli në numra të pakët, ajo trajtoi tematika dhe problematika nga më të ndryshmet. Të gjitha shkrimet që u botuan në këtë gazetë janë të nënshkruara me pseudonime për shkak të konspiracionit. Nëpërmjet shkrimeve që botoheshin në të i bëhej apel popullit të mos i duronte padrejtësitë e shumta, sulmohej sistemi okupues jugosllav dhe udhëheqja më e lartë e tij³⁴⁴.

³⁴³ Sabile Keçmezi – BASHA, GAZETA “ZËRI I KOSOVËS” dhe angazhimi i saj për ngritjen e ndërgjegjies dhe unitetit Kombëtar , Instituti i Historisë Prishtinë Punim studimor. Marrë për botim më, 11.05.2005

³⁴⁴ Sabile Keçmezi – Basha, po aty.

Përveç faqeve politike, në revistë anëtarët e grupit ilegal shkruanin edhe për çështje organizative të ilegales. Në pjesën e shkrimit “*Puna në celulat revolucionare dhe zgjerimi i radhëve*” paraqitet në pika të shkurtra organizimi i celulare dhe angazhimi i anëtarëve për t’i zgjeruar radhët e organizatës me anëtarë të rinj. Në këtë shkrim njoftohet opinioni i gjerë se me luftën ilegale që e bëjnë, bijtë dhe bijat më të mira të kombit kanë tri qëllime kryesore, çlirimi kombëtar, çlirimi shoqëror dhe bashkimi me shtetin amë, që edhe është qëllimi më i rëndësishëm.³⁴⁵

Në prill të vitit 1974, “*Grupi Revolucionar*” botoi edhe numrin e dytë të revistës “*Zëri i Kosovës*”. Moto e revistës ishte “*Popuj të robëruar në të gjithë botën, ngrihuni në revolucion*” dhe në vizatim ishte e shkruar motoja “*Liria nuk falet, por fitohet me gjak*”. Në pamundësi që organi “*Zëri i Kosovës*” të botohej dhe të shpërndahej me të madhe në masat e gjera popullore, kjo revistë fillimisht u shpërndahej vetëm aktivistëve të lëvizjes. Me përmirësimin e punës në radhët e organizatës, u krijuan mundësi të reja që të zgjerohet dhe të thellohet përmbajtja e propagandës dhe agjitacionit, në rend të parë, brenda radhëve të ilegales. Revista „*Zëri i Kosovës*”, “do të bëjë përpjekje që të sqarojë sa më shumë çështje, që të ndihmojë pjesëtarët e radhëve tona në pajisjen e tyre me një kulturë të gjithanshme dhe në edukimin ideo – politik të tyre.

Organi do të sqarojë gjithashtu edhe shumë çështje organizative. Kjo do të bëhet akoma edhe më e rëndësishme dhe nevoja e propagandimit të parimeve dhe të metodave të organizimit, të disiplinës dhe të teknikës konspirative del në planë të parë kur organet policore vihen me gjithë forcat e tyre për të na ndjekur dhe persekutuar”³⁴⁶.

Numrin 1 të „*Zërit të Kosovës*”, organ i LNKVSHJ-së, e ka nxjerrur Jusuf Gërvalla më 1981. Gazeta e Jusuf Gërvallës ishte më shumë me karakter politik. Më 1983 gazetën „*Zëri i Kosovës*” ka filluar t’u botojë Xhafer Shatri bashkë me Sabri Novosellën. Ish udhëheqësi i LPRK-së në atë kohë. Deri më 1984, nuk ka pasur redaksi të ZIK-ut, por ka pasur vetëm individ të cilët e kanë shtypur ZIK-un. Më herët, gazetën e kanë nxjerr, Xhafer Shatri, Fazli Veliu, Avni Dehari, e të tjerë, por Xhafer Shatri nuk ka bërë përpjekje për bashkimin e këtyre intelektualëve.³⁴⁷

³⁴⁵ “*Puna në celulat revolucionare dhe zgjerimi i radhëve*”, “*Zëri i Kosovës*“, nr. 1. 1974, f. 11.

³⁴⁶ “*Zëri i Kosovës*” nr. 2, 1974, f. 6.

³⁴⁷ Mustafë Xhemajli, intervistë dhënë autorit të këtij shkrimi, 07 korrik 2008, Prishtinë

Më 4 maj 1984 në Bern të Zvicrës është themeluar redaksia e ZIK-ut, ku janë pajtuar të gjithë, edhe Xhafer Shatri. Prej asaj kohe është krijuar redaksia e ZIK-ut në Bern. Në redaksi të kësaj gazete ishin: Mustafë Xhemajli – redaktor, Hasan Malaj, Saime Isufi, Agim Malaj, Muhamer Shabani dhe Emrush Xhemajli, gazetar dhe piktor. Nga 4 maj 1984 e deri në fund të vitit 1991³⁴⁸, gazetën „Zëri i Kosovës” e ka udhëhequr Mustafë Xhemajli. Redaksia punonte në kushte të vështira, sepse, kishte vetëm një makinë të Jusuf Gërvallës një gjysëm kompjuteri me të cilin Jusufi e kishte nxjerr numrin e parë të ZIK-ut. Me ardhjen e Fazli Veliut, Muhamet Kelmendit dhe Ibrahim Kelmendit, ky i fundit është marrë, sidomos me përkthime dhe ka qenë Organizatori kryesor në shtetet e Evropës Perëndimore, ku jetonte që nga viti 1979 në Gjermani.³⁴⁹

Në vitet 1991 – 1998, Gazeta „Zëri i Kosovës“ ishte bërë dritarja e vetme nga ku të gjithë shqiptarët atdhetarë, informoheshin drejtë dhe me kohë për aktivitetin e UÇK-së dhe luftën e tyre të drejtë që po bënin në Kosovë. Në këtë gazetë, jepen mendimet dhe qëndrimet e LPK-së në një anë, si dhe deklaratat e qëndrime të faktorëve politik ndërkombëtar si dhe qëndrimet negative të politikës pacifiste, lidhur me UÇK-në.³⁵⁰

Shkrimet e „Zëri i Kosovës“ nuk ishin të rëndomta e të një rrjedhe të njëjtë si të gazetave të atëhershme e të mëvonshme legale. Shkrimet në „ZIK“ ishin shënime të burgosurve shqiptar që shkruheshin me duart e përgjakura nga gardianët dhe policët, UDB-ashët e spiunët, ishin shkrime të studentëve të përjashtuar nga procesi arsimor dhe zëri i mërgimtarëve të ikur për shkak të ndjekjeve nga regjimi.³⁵¹

LPK, përmes gazetës së saj „Zëri i Kosovës” me shkrime të ndryshme argumentone se lufta çlirimtare e popullit shqiptar në Kosovë është e drejtë ngado që të shikohet, si nga e drejta natyrore për të jetuar i lirë çdo njeri, si nga pikëpamja e të drejtave të njeriut, por edhe nga pikëpamja kushtetuese e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nga Konventat ndërkombëtare.

³⁴⁸ Me ndryshimet në skenën politike në Kosovë pas vitit 1990, Mustafë Xhemajli do të tërhiqet tërësisht nga gazeta dhe nga LPRK-ja, për t'iu kthyer jetës së tij private.

³⁴⁹ Mustafë Xhemajli, po aty.

³⁵⁰ Artikuj të gazetës „Zëri i Kosovës” organ I LPK-së, 1991-1998, Zvicër.

³⁵¹ Fazli Veliu, LPK- UÇK, f.54.

Të gjitha veprimet e armatosura që i ndërmerre UÇK-ja kundër pushtuesve serb në Kosovë dhe të gjitha komunikatat për shtyp që i lëshonte ajo e të cilat nuk i botonte shtypi shqiptar në Kosovë, ose i shtrembëronte „ Zëri i Kosovës" i botonte ato me qëllim të njoftimit të opinionit me luftën e drejtë të popullit tonë.³⁵²

Dihet fare mirë se gazetat tjera që dilnin në Kosovë, si „Bujku“, „ Zëri“etj, por edhe ata që dilnin jashtë saj, sidomos „ Bota Sot“ e cila dilte në Zvicër, kishin frikë, por edhe ishin mjaft alergjik ndaj UÇK-së. Ata ishin vënë në shërbim të politikës pacifiste të LDK-së dhe të Ibrahim Rugovës. Sipas tyre, liria dhe Pavarësia e Kosovës, do të vie vetvetiu, me konferenca shtypi, me lutje dhe me vullnetin e bashkësisë ndërkombëtare. Në këto gazeta, aksionet e UÇK-së, cilësoheshin, „ terroriste, aksione të njerëzve të dyshimtë, apo edhe si aksione të dorës së zezë serbe“. Krejt ndryshe nga gazetat pacifiste, me origjinë nga „ Rilindja“ e cila ishte organ i LKJ-së, gazeta „ Zëri i Kosovës“, shkruante hapur për terrorin që bënte okupuesi serb në Kosovë, por edhe për luftën heroike që bënin djemt dhe vajzat më të mira të Kosovës, të cilët kishin formuar UÇK-në për t'i dalur zot Atdheut.

Më poshtë po japim disa shkrime të gazetës „ Zëri i Kosovës“ të viteve 1993 – 1998, të cilat dëshmojnë për rolin e LPK-së, lidhur me UÇK-në në këtë periudhë:

Në shkrimin me titull: „ ***Të forcohen aksionet çlirimtare popullore në Kosovë***“ të datës 1 maj 1993, LPK theksonte se Kombi shqiptar aktualisht gjendet në fazën më të rëndë të historisë së tij. Përveç që ra nën okupim më të rëndë ai sërish u rinda midis shteteve të Ballkanit të dala nga ish-Jugosllavia. Partitë politike shqiptare në vend që të marrin qëndrim të drejtë lidhur me UÇK-në dhe të ndryshojnë mënyrën e veprimit të tyre me format pacifiste, ato ende po vazhdojnë me fjalor të njëjtë si atë të pushtuesit. Në anën tjetër LPK në Kosovë dhe jashtë vendit ruan në vete përvojën e aksioneve kombëtare kundër pushtuesit dhe se anëtarët e saj janë të gatshëm që të punojnë dhe të luftojnë deri në Çlirimin e vendit....³⁵³

³⁵² Po aty.

³⁵³ Mbledhja Konsultative e LPRK, prill 1993, Kosovë. Gazeta Javore „ Zëri i Kosovës" organ i LPK-së, nr.6, 1 maj 1993.

Ndërsa në shkrimin tjetër: „**Mbrojtja e Kosovës është e drejtë e pacenueshme, e patjetërsueshme dhe obligim e nder i madh i çdo qytetari**“³⁵⁴ publikohet deklarata e Kryesisë së LPK-së, përmes së cilës LPK i jepte përkrahje aksioneve të armatosura kundër pushtuesve në Kosovë. LPK përkrah çdo veprimtari të armatosur kundër pushtuesve që qon drejt Pavarësisë së Kosovës dhe bashkimit të viseve të saj, pra edhe veprimeve që u bënë në muajin Prill(1993). LPK fton qytetarët që të respektojnë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, meqë në nenin 77 të saj thuhet: "Mbrojtja e vendit është e drejtë e pacenueshme dhe obligim e nder i madh i çdo qytetari".³⁵⁵ Përgjegjësinë për gjendjen e krijuar sipas LPK-së e mbajnë pushtuesit të cilët megjithë kërkesat e popullit shqiptar nuk po tërhiqen nga Kosova dhe viset e saj në mënyrë që të ndërpriten luftimet dhe të arrihet paqja. Vëmendje tërheqin deklaratat e disa individëve dhe partive shqiptare që po e inkriminojnë luftën e popullit tonë si „ rrebele" dhe „terroriste", me ç'ka vlerësimet e tyre pak dallojnë nga ato të Beogradit, Shkupit dhe Podgoricës. Sidoqoftë, vullneti i popullit për pavarësi, i shprehur në referendum qëndron mbi vullnetin e pushtuesve dhe atyre që u mbajnë ison.³⁵⁶

Gazeta „ Zëri i Kosovës“ me shkrimet e saja, i dha një hov edhe më të madh aksioneve luftarake të ushtarëve të UÇK-së në Kosovë, qoftë në aspektin propagandistik, qoftë duke i dalur në mbrojtje këtij subjekti ushtarak që sa vinte e rritej dhe përkrahja për te shtohet çdo ditë. Në aspektin financiar, daljen e gazetës „ Zëri i Kosovës“ e mundësonin Kryesia e KP të LPK-së dhe antarësia e gjerë, të cilët ishin të obliguar të paguanin shumë të caktuar mujore, por kishte edhe donator të shumtë të cilët ishin të interesuar që kjo gazetë të mos mbyllej.³⁵⁷Në faqet e kësaj gazete, penda të njohura shqiptare, si Rexhep Qosja, Shaban Sinani, Koço Danaj, Merxhan Avdyli, Nuhi Paqarizi, Bedri Islami, Muhamet Kelmendi Bislam Elshani, Kadri Çenko, etj, në formë të argumentuar mbronin luftën e drejtë të UÇK-së kundër propagandës serbe, si dhe të disa gazetave si „ Rilindja“ dhe „ Bota Sot“ të cilat të përkrahura nga politika pacifiste e LDK-së, zbraznin vlerin e tyre të dështimit kundër atyre që po e kthenin nderin e humbur tek shqiptarët e Kosovës së robëruar.

³⁵⁴ Gazeta Javore „ Zëri i Kosovës"numri 18, 1 maj 1996

³⁵⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Zëri i Kosovës, 1990, Zvicër, fq.23.

³⁵⁶ Gafurr Elshani, UÇK – dokumente dhe artikuj, Zëri i Kosovës, Zvicër, 1998, fq. 56 -57.

³⁵⁷ Komunikim I brendshëm I KP të LPK-së me Këshilla të rretheve, d.j.v.25.06.1994

Veçanarisht, gazeta „ Zeri i Kosovës“ duke bashkëpunuar edhe me gazetën e studentëve në Kosovë „ Bota e Re“ që udhëhiqej nga njëri nga liderët e Lëvizjes Studentore të vitit 1997, Muhamet Mavraj, në vitet 1997- 1998, kur Kosova gjëmonte nga luftëtarët e lirisë, ishin armë e fortë në vetëdijësimin e popullit si brenda edhe jashtë Kosovës, se lufta e drejtë e popullit të Kosovës, duhet të ndihmohet, dhe se kjo luftë është çlirimtare dhe patjetër do të triumfoj. Në këtë kohë, Komunikatat e UÇK-së, të cilat hezitonin ti botonin gazetata pacifiste „ Rilindja“ dhe „ Bota Sot“, ato botoheshin të plota në „ Zeri i Kosovës“ , ndërsa në Kosovë botoheishin në gazetën e studentëve „ Bota e Re“.“Zëri i Kosovës” gati në të gjitha shkrimet e saj shprehte urrejtjen ndaj okupatorit dhe angazhohej për luftën e pakompromis të popullit shqiptar për liri e pavarësi. Si kriter bazë në gjykimet e veta ky organ kishte vënë shqiptarizmin, kombin e atdheun³⁵⁸. Temat me tematika të drejtpërdrejta, të nxjerra nga përditshmëria e jetës dhe vetë angazhimi i autorëve, ato së bashku lëvizin në disa drejtime të ndryshme, pra në më tepër se në një dimension: robëria e liria - binome të pandara, dhuna e terrori, shtypja e mërgimi janë plagë që zënë vend të rëndësishëm në revistë dhe në të shumtën e rasteve vetë mënyra e të shkruarit të dukej e “frikshme” dhe plot revolucionaritet.

Poashtu Lufta për liri, robëria, shtypja, emigracioni, korrupsioni, krimi, burgu dhe vetë fati i pazgjidhur i shqiptarë e bëjnë revistën dhe tematikën e saj të plotë me diversitet dhe nxitëse, gjë që edhe sot e intrigon lexuesin për ta lexuar dhe analizuar gjer në fund revistën “ Zërin e Kosovës”. Revista “Zëri i Kosovës” lirshëm mund të thuhet se shënon vazhdimësinë e komunikimit ilegal që ishte krijuar e formësuar për dekada të tëra në Kosovë dhe si e tillë është dëshmi e qenies dhe ekzistencës sonë, dëshmi e njohjes dhe rinjohjes, e qëndresës së përjetshme, e ecjes dhe e gjakimit të ëndrrës sonë nëpër kohë. Shkrimet në këtë revistë janë të thjeshta dhe të qarta, janë shkrime të qëndrueshme që në vetvete përmbajnë dashuri për atdheun dhe për lirinë. Shkrimet e gazetës janë nga përditshmëria, por edhe gjuha me të cilën shkruhen është e përditshme dhe nuk ka nevojë për sqarime dhe komente. Shkrimet e gazettes „ Zëri i Kosovës” po qe se lexohen me vëmendje na ofrojnë një vërtetësi thelbësore të kohës dhe automatikisht këto shkrime shndërrohen në vlerë të qëndrueshme të të dhënave historike.³⁵⁹

³⁵⁸ Luan Zelka , “ Shtypi shqiptar gjatë viteve të pavarësisë 1913-1939”, Tiranë 2001, f. 129.

³⁵⁹ Sabile Keçmezi – BASHA, gazeta “ZËRI I KOSOVËS” dhe angazhimi i saj për ngritjen e ndërgjegjies dhe unitetit Kombëtar , Instituti i Historisë Prishtinë Punim studimor. Marrë për botim më, 11.05.2005

„Zëri i Kosovës” arriti të bëhet zëri i shqiptarëve në mbarë viset shqiptare të sunduara nga pushtuesit sllav, zëri i studentëve, zëri i gurbetqarëve patriot, por edhe zëri i luftëtarëve të UÇK-së dhe i aksioneve të tyre luftarake. Në faqet e saj, që nga fillimi i luftës për liri, gjetën vendin dhe përkrahjen e pakursyer luftëtarët e lirisë. Ndonëse ishte organ i LPK-së, „ Zëri i Kosovës” nuk mbrojti asnjëherë vetëm antarësinë e saj, por mbarë çështjen kombëtare.³⁶⁰

4). Qëndrimi i LPK-së për Marrëveshjen e Daytonit

Në fund të vitit 1995, bashkësia ndërkombëtare nën drejtimin e SHBA-së organizoi Konferencën e Paqes në Dayton, e cila i dha fund luftës së përgjakshme në Bosnjë e Hercegovinë. Më 21 nëntor të këtij viti, tre kryetarët e tri shteteve të reja që dolën nga zhbërja e ish – jugosllavisë, ai i Bosnjë – Hercegovinë, Alija Izetbegović, Sërbisë Slobodan Millosheviq dhe Kroacisë Franjo Tugjman, dolën nga baza ushtarake në Dayton të shtetit federal të Ohajos, me të nënshkruar të marrëveshjes për paqe, që dukej se nuk ishte tërësisht e vullnetshme, por me të cilën i dhanë fund luftës trevjeçare në Bosnje e Hercegovinë e cila mori rreth 250.000 jetëra njerëzish.³⁶¹

Në këtë Konferencë çështja e Kosovës dhe konflikti shqiptaro – serb, edhe pse ishte folur shumë herë, u anashkalua dhe prej aty filloi zhgënjimi dhe mosbesimi në rezistencën paqësore.³⁶² Më vonë do të merret vesh se një nga kushtet e Millosheviqit për të nënshkruar Marrëveshjen e Daytonit kishte qenë pikërisht mospërfshirja e problemit të Kosovës në këtë konferencë, rëndësinë e së cilës LDK u mundua ta minimizonte. Për më tepër Kosova ishte e qetë dhe gjërat nuk paraqitnin ndonjë nguti për qendrat ndërkombëtare të vendosjes.³⁶³ Në Dayton, vëmendja kryesore u përqëndrua në arritjen e një zgjidhje paqësore për konfliktin serbo – kroato –boshnjak. Futja edhe e çështjes së Kosovës në zgjidhjen e përgjithshme paqësore për Jugosllavinë, do të bënte që Beogradi të mos ishte i gatshëm për kompromise me Kroacinë dhe Bosnjën.

³⁶⁰ Fazli Veliu, UÇK – LPK, f.54 -55.

³⁶¹ Dr.sc. Ramë Buja, Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë, Prishtinë 2007, f.275.

³⁶² Aus Politik und Zeit Geschichte, Wochenzeitung Das Parlament, Bonn, 1999, f.22

³⁶³ Sylë Ukshini, Nga lufta në paqë, fq. 73, botoi Rozafa, Prishtinë, 2004

Daytoni, pra, do të kishte dështuar po të ishte futur edhe Kosova në rendin e ditës. Në këtë mënyrë Marrëveshja e Daytonit solli pasoja të rënda për zhvillimet në Kosovë.³⁶⁴ Gjatë diplomacisë lëvizëse edhe në Dayton, Riçard Hollbruk dhe Christofer Hill, u përpoqën disa herë që me Millosheviqin të hapin çështjen e Kosovës. Milosheviqi theksonte se çështja e Kosovës është çështje e brendshme për popullin serb dhe për shqiptarët. Ai këmbëngulte në qëndrimin e tij, prandaj ne nuk arritëm të gjejmë një arsye për të levizur këtë çështje në Dayton.

Megjithate Millosheviqi u pajtua që eventualisht të lejojë disa vizita dhe të japë lejen për hapjen e një zyre Amerikane për Informim në Kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë.³⁶⁵ Marrëveshja e paqes e Daytonit u solli Kosovarëve edhe një tjetër zhgënjim të hidhur. Që në fillim ishte bërë e qartë se shpresat e bahskësisë ndërkombëtare për paqe në Jugosllavi nuk i linin shumë vend kërkesës së Kosovarëve për pavarësi. Në bisedime nuk u ftua asnjë përfaqësues i Qeverisë Kosovare dhe u injorua tërësisht fakti që çështja e Kosovës kishte nevojë për një zgjidhje të ngutshme. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Daytonit më 1995 i diskreditoi „ institucionalistët e rrugës paqësore“. Edhe pse Shqiptarët e Kosovës kishin pritur që bashkësia ndërkombëtare t'i shpëtoj nga Millosheviqi, në vend se vetë ta luftojnë këtë regjim, ashtu siq bënë Kroatët dhe Boshnjakët, bashkësia ndërkombëtare e përqëndroi vëmendjen e saj në ndaljen e luftës në Bosnjë, duke e lënë Kosovën anash.³⁶⁶

Fakti që Daytoni kishte filluar ta rrëronte Rugovën, nuk ishte dukuri që u dallua menjëherë. U desh kohë dhe punë e pandërprerë nga LPK-ja dhe UÇK-ja për të bindur njëri-tjetrin se kishte edhe një alternativë tjetër, përveç qëndresës pasive. Një nga arsyet pse ndodhi kjo kaq ngadal ishte se LDK-ja kishte kontroll të drejtëpërdrejtë mbi pjesën më të madhe të mediave në gjuhën shqipe të cilat ndiqnin vijën e LDK-së.³⁶⁷

LPK, e cila me kohë kishte kundërshtuar vijën paqësore jo aktive të LDK-së, përmes një Komunikate, njoftoi opinionin e brendshëm dhe të jashtëm se, çështja e Kosovës, nuk zgjidhet e as që mund të zgjidhet, me politikë pacifiste, por duke e marrur vetë populli fatin e saj në duart e veta.

³⁶⁴ Wolfgang Petritsch, Rruga e gjatë në luftë, fq.79-82.

³⁶⁵ Wesley K. Clark, Të bësh luftë Moderne, Zëri, Prishtinë, 2003, f.95.

³⁶⁶ Henry H. Perritt Jr., UÇK- Rrëfim prej brenda për një kryengritje, fq.16, 17.

³⁶⁷ Tim Juda, Kosova, luftë dhe hakmarrje, fq.161.

Në komunikatën e LPK-së thuhet se „Marrëveshja për ndërprerjen e luftës në Bosnjë e Hercegovinë e nënshkruar këto ditë në Ohajo të SHBA-ve, nën tryshninë e komunitetit ndërkombëtar si dhe fryma që dominoi në të dhe pas saj, tregoi më së qarti se lufta disavjeçare në ish- Jugosllavi, e kryesisht në Bosnjë e Hercegovinë, legjitimoi luftën pushtuese të agresorëve serb dhe mjetet e dhunës që përdorën ata tregoi se kjo luftë ishte e karakterit ndërkombëtar. E tërë lufta dhe marrëveshtja e nënshkruar për ndërprerjen e saj, treguan më së miri se si flijohen popujt e vegjël, sidomos ata që verbërisht besojnë në drejtësinë botërore.³⁶⁸

Gjatë kohë u propagandua se edhe Kosova është e përfshirë në bisedat ndërkombëtare, për zgjidhjen globale të problemeve të ish- Jugosllavisë. Fatkeqësisht LPK, nuk mund të përshëndet marrëveshtjen e Daytonit, siç bëjnë disa politikan shqiptar, jo se është kundër paqes, por sepse kjo do të ishte përshëndetje e humbjes sonë, sepse do të përshëndetnim shpërblimin e agresorit me heqje të sanksioneve pa u vendosur paqja reale në Ballkan. Fatin tonë duhet ta marrim vetë në duart tona, andaj LPK apelon qartë edhe një herë se zgjidhjet e lehta në kurriz të popullit tonë, jo vetëm që nuk do t'i pranojnë, por edhe do t'ua kthejmë bumerang atyre që me përkushtim punojnë për to“.³⁶⁹

Përgjigjen më të duhur, për mospraninë e çështjes së Kosovës në Dayton e kishte dhënë, Rudolf Perrina, shef i Misionit diplomatik të SHBA-ve në Beograd, dhe pjesëmarrës në Konferencën paqësore për Bosnje e Hercegovinën në Dayton, pas një takimi me Dr. Ibrahim Rugovën në Prishtinë, pyetjes se „ pse në Dayton nuk u hap çështja e Kosovës“? iu përgjigj se „ Në Dayton janë ftuar ata që kanë luftuar“³⁷⁰. Vetëm një muaj pas qëndrimit të Perinës në Prishtinë, në shkurt 1996, do të plasnin bombat e UÇK-së në sulmet e tyre ndaj kampeve të refugjatëve serb nga Koroacia dhe nga Bosnja. Kosovarët do të kuptojnë se Perëndimi do zhurmë plimbash dhe pëlçitje bombash e jo porosi dhe apele për ndihmë³⁷¹. Rrjedhojat e Marrëveshjes së Daytonit sforcuan kritikën ndaj politikës joviolente të Rugovës dhe gjithnjë e më shumë shtoheshin zërat për një kurs më agresiv ndaj politikës represive serbe.

³⁶⁸ Qëndrimi i LPK-së për marrëveshtjen e Daytonit, Arkivi i LPK-se, 24.11.1995.

³⁶⁹ Po aty,

³⁷⁰ Blerim Shala, Vitet e Kosovës, 1998 – 1999, Zëri, Prishtinë, 2003, f.21 -22

³⁷¹ Po aty, f.22.

Një shtresë e caktuar e njerëzve brenda Kosovës, para së gjithash ish të burgosurit politik, kishin vendosur të bënin luftë të armatosur kundër infrastrukturës represive serbe dhe për këtë kaheerë kishin formuar formacionet e para guerile të UÇK-së, për të cilat pak kush dinte në publikun Kosovar. Në fakt UÇK-ja përfitoi nga dy ngjarje mbi të cilat ajo vet nuk kishte asnjë kontroll, por që quan në ndryshimin e tabllës strategjike të Ballkanit të Jugut. E para ishte Konferenca e Daytonit për Bosnjën, në nëntor 1995 dhe e dyta, rënia e Shqipërisë në anarki, në pranverë të vitit 1997. Kështu Kosova filloi të shëndrrohet në problem ndërkombëtar vetëm pas konfrontimeve të para të armatosura në Kosovë midis njësiteve guerile të UÇK-së dhe forcave ushtarake – policore serbe.³⁷²

³⁷² Sylë Ukshini, vepra e cituar, fq. 74, 75.

KAPITULLI I KATËRT

1). Qëndrimi i LPK-së, për zhvillimet në Kosovë dhe Shqipëri, 1996 - 1997

Vitet 1996- 1997, ishin vite të zhvillimeve të mëdha në trojet shqiptare të ndara padretjesisht. Më 1 shtator 1996 Kryetari i Kosovës Ibrahim Rugova nënshkroi dogovorin (marrëveshjen) me Kryetarin e Sërbisë, Slobodan Millosheviq për „ përmirësimin“ e kushteve të arsimit në Kosovë. Më 31 janar 1997 në fshatin Pestovë të Vushtrrisë vriten tre udhëheqësit e UÇK-së, Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu. Në mars, në Shqipëri, ndodhën revoltat e mëdha të qytetarëve kundër skemave piramidale, duke e sjellur shtetin shqiptar në një kaos politik dhe ekonomik, por duke sjellur edhe pasiguri dhe viktima të shumta, në tetor, studentët e UP- së do të organizojnë protesta për lirimin e objekteve të tyre shkollore, por edhe në përkrahje të UÇK-së, ndërsa më 28 nëntor 1997, tre ushtarë të UÇK-së do të flasin në emër të saj, në një ceremoni varrimi në Drenicë. Këto ngjarje u përjetuan shumë rëndë tek shqiptarët kudo që ishin në trojet e tyre, sepse lufta që ishte në prag, kërkonte një Shqipëri stabile, të fortë dhe krah i fuqishëm i çështjes së Kosovës. Megjithë anët negative, këto revolta ndikuan që ushtarëve e UÇK-së, t'u krijohen mundësi më të mëdha për furnizim me armatim dhe mjete tjera të nevojshëm për luftë.

Në anën tjetër, në Kosovë, pushtuesi serb, për çdo ditë ndërmerre masa të egra represive kundër popullit të pa mbrojtur të Kosovës, veçanarisht kundër veprimtarëve të LPK-së dhe LKÇK-së, të cilët ishin të organizuar në radhët e UÇK-së. Krahas luftës me të gjitha mjetet të pushtuesit serb kundër subjektit ushtarak që po rritej vazhdimisht në Kosovë, një luftë politike dhe psikologjike, po zhvillohej edhe nga subjektet „ legale“ në Kosovë, veçanarisht nga LDK-ja, e cila ende e kishte primatin dhe përkrahjen e shumicës së qytetarëve të Kosovës. Këtë logjikë të injorimit dhe të luftimit nga brenda të UÇK-së, e thyen rinia studentore, e UPSUP-së, të cilët të udhëhequr nga Muhamet Mavraj, Bujar Dugolli, Albin Kurti etj, dhe të përkrahur fuqishëm nga Rektori Ejup Statovci dhe profesorët patriot të UP-së, përkundër shumë pengesave arritën që më 1 tetor të vitit 1997, të organizojnë protesta në Prishtinë.

Pas këtyre protestave, politikës pacifiste filluan tu ik situata nga duart dhe shumica e studentëve dhe popullit të thjesht, dolën në përkrahje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.³⁷³

2). Qëndrimi i LPK-së, për Marrëveshjen, Rugova – Millosheviq

Më 1 shtator 1996 Kryetari i Kosovës Ibrahim Rugova nënshkroi dogovorin (marrëveshjen) me Kryetarin e Sërbisë, Slobodan Millosheviq për „përmirësimin“ e kushteve të arsimit në Kosovë. Tashmë është e ditur nga shumë qendra të vendosjes se jo vetëm për arsimin, por edhe për çështje tjera të pjesëshme e lokale (shëndetësi, kulturë, informim, gjyqësi, polici lokale, parlament e qeveri lokale, etj.), do të nënshkruhen dogovor-e të ngjashme. Ky „përmirësim“ i kushteve në robëri do të jetë „shpërblim“ për politikën disfatiste të liderëve të LDK-së dhe Kryetarit të saj Ibrahim Rugova. Subjektet ndërkombëtare, Serbisë si shpërblim do t’ia heqin „murin e jashtëm të sanksioneve“ dhe do t’ia rinjohin të drejtën e ripushtimit mbi Kosovën.

Marrëveshja (Dogovor-i) i shtatorit dhe Dogovor-et tjera të ngjajshme që Rugova ka ndërmend t’i nënshkruaj, po bëhen me qëllim, siç po dezinformohet, të „ikjes nga shpërthimi i hapur i konfliktit“. Pas veprimeve të armatosura çlirimtare të atdhetarëve shqiptarë në Kosovë, që prishën planet e tilla të deridjeshme, Kryetari i Kosovës, Ibrahim Rugova dhe padronët e tij hodhën në lojë këtë Dogovor për të mashtruar popullin dhe për t’a mbytur jehonën e veprimeve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave politike që e përkrahnin atë. Por ata që kanë menduar se me këso dogovor-ësh do të arrijnë ta shuajnë zjarrin e luftës çlirimtare në Kosovë, kanë gabuar rëndë!

Me këto përpjekje për të mashtruar popullin tonë, konflikti vetëm do të rritet. Gjaku i derdhur për Pavarësinë e Kosovës dhe Referendumi popullor u bënë jo për përmirësimin e kushteve nën robëri, por për pavarësinë e Kombëtare.³⁷⁴

Lëvizja Popullore e Kosovës thërret të gjitha forcat patriotike –çlirimtare, që janë të përcaktuara për çlirimin e njëmend të Kosovës, të denojnë këtë dogovor dhe sëbashku të luftojmë për çlirimin e vendit.

³⁷³ Komunikatë e LPK-së, shkurt 1997

³⁷⁴ Komunikatë e LPK-së, Prishtinë, shtator 1996.

Lëvizja Popullore e Kosovës do të përkrah veprimtarinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila shumë herë ka paralajmëruar se do të vazhdojë luftën deri në çlirimin e Kosovës.³⁷⁵

3). Qëndrimi i LPK-së për ngjarjet e marsit 1997 në Shqipëri

Natyrë e luftës së ardhshme për pushtet në Shqipëri kishte filluar të përvijohet qartë te vëzhguesit vendas qysh në mesin e shkurtit të vitit 1997. Rebelimi në jug ishte ende i kufizuar në një numër vendbanimesh relativisht të vogla, siq ishte Vlora dhe Lushnja. Qeveria e Shqipërisë më 3 mars shpalli gjendjen e jashtëzakonshme si dhe vendosi gjithashtu kontrollin e plotë të saj mbi mediat.

Vendimi për gjendjen e jashtëzakonshme u mor nga pazotësia e SHIK-ut dhe policisë për të shtypur revoltën, kurse Berisha dhe Kryeministri Aleksandër Meksi filluan ta shohin seriozisht sfidën ndaj autoriteteve të tyre.³⁷⁶ Qeveria e Shqipërisë ra në pranverë të vitit 1997, duke hapur rrugën për sasi të mëdha armësh. Forcat e Millosheviqit, tani të lira pas luftimeve në Kroaci dhe Bosnjë, filluan t'i kushtojnë rëndësi Kosovës, me qëllim të qrrënosjes së një kryengritje që po lindte.³⁷⁷

Ngjarjet e vitit 1997 në Shqipëri, sollën një gjendje të re politike në shtetin shqiptar, por ato e ndryshuan edhe gjendjen organizative dhe logjistike të UÇK-së. Partia socialiste që erdhi në pushtet ende nuk e kishte të qartë sa duhet vizionin e lëvizjes çlirimtare në Kosovë. Shteti Shqiptar poashtu në vitin 1997 nuk mund të paraqitej si mbështetës i veprimeve luftarake, të cilat kishin filluar të denoheshin si ekstremiste nga bota diplomatike. Diplomacia perëndimore mbështeste në këtë kohë fuqishëm politikën e Ibrahim Rugovës, duke ia mbajtur krahun atij. Shteti shqiptar po përpiqej të për të krijuar imazhin e një vendi perëndimor. Zyrtarisht ata mbështesnin atë që mbështeste bota diplomatike veçanërisht Amerikanët. Kjo mbështetje shkonte nganjëherë deri në naivitet politik, por edhe në mëkate politike. Nëse Shqipëria në vitin 1997 do të dilte hapur pro luftës së armatosur në Kosovë, ajo sigurisht do të kishte një ndëshkim dhe izolim të mëtejshëm.

³⁷⁵ Po aty.

³⁷⁶ James Pettifer, Miranda Vickers, Çështja Shqiptare- Riformësimi i Ballkanit, Tiranë – New York, 2007, f. 30 -34.

³⁷⁷ Henry H. Perrit Jr, vepra e cituar, fq.17.

Shteti shqiptar nuk i hapi rrugë takimeve me drejtues të LPK-së, për të cilët e dinte se ishin bashkëthemelues të UÇK-së, përfaqësues politik dhe mbështetës të vetëm financiar, sepse nuk donte të hapte telashe të reja. Megjithatë, rrugët drejt Kosovës i la të lira, gjë që ishte tejet e rëndësishme dhe në këtë periudhë nuk pengoi ngritjen e strukturave logjistike, aq të domosdoshme për më vonë.³⁷⁸

Ngjarjet e marsit dhe gjakëderdhja në Shqipëri, ka stepur çdo shqiptar që i dhimbset Atdheu e posaqërisht shqiptarëve që ishin jashtë kufirit të Shqipërisë së 1912. Lidhur me këto ngjarje LPK, përmes një Komunikatë thotë:

- LPK ka kërkesë për të gjitha forcat politike në Shqipëri të ndërpresin menjëherë gjakëderdhjen e mëtutjeshme.
- LPK është e ndërgjegjshme se okupatorët serb që përgjakën Kosovën këta muaj, kanë qenë dhe janë të interesuar që të bëhet gjakëderdhje sa më e madhe në shqipëri, që të ketë më kehtë ta sundojë Kosovën.
- LPK ka deklaruar hapur shumë herë se është e gatshme të dal në kufij në rast se dikush merr guximin të ndërhyj me forca të jashtme agresive në punët e Shqipërisë.
- LPK, thërret të gjithë anëtarët e saj, kudo ku janë, që të jenë të përgjegjshëm në këtë situatë dhe mos të bëjnë asnjë veprim që qon në kundërshtim me programin e LPK-së dhe në dëm të Kosovës e Shqipërisë.
- Ndihmimi i radhëve të armatosura në Kosovë që po luftojnë për çlirim është kontributi më i madh për qështjen kombëtare dhe rrjedhimisht edhe për zhvillimet e ardhshme në Shqipëri. Po të jetë për ta derdhur gjakun, ta derdhim si Zahiri, Edmondi dhe Hakifi dhe dëshmorët tjerë të Kosovës. Vetëm një Kosovë e çliruar do të mundësojë një Shqipëri stabile.³⁷⁹

³⁷⁸ Bedri Islami, fejtton, Dy poet e politikës në Kosovë, Epoka e re, 7 shtator 2001, fq.7

³⁷⁹ Komunikatë e Kryesisë së KP të LPK-së, D.J.V, për ngjarjet në Shqipëri, 2 mars 1997.

4). Zhvillimet politiko – ushtarake në Kosovë 1996 – 1997

Me gjithë pengesat e shumanshme që i vinin LPK-së dhe UÇK-së edhe nga faktori ndërkombëtar edhe nga ai shqiptar, ata vazhduan me ngulm të punonin në rritjen dhe forcimin e radhëve të luftëtarëve të lirisë të cilët kishin vendosur ti dilnin zot këtyre trojeve. Një nga elementët kyq, të nevojshëm për të kuptuar zhvillimin e UÇK-së, është ndjekja e ecurisë së bashkimit të grupeve të ndryshme të vogla me njëri tjetrin. Por rrethanat që u krijuan pas Marrëveshjes së Daytonit, në nëntor 1995, tregoi se po përgatitej një përzierje shumë shpërthyes.³⁸⁰

Udhëheqja politike e LDK-së e mohoi për një kohë të gjatë ekzistencën e UÇK-së. Në fillim të paraqitjes së UÇK-së, Kryetari i Kosovës, Ibrahim Rugova e quajti UÇK-në si „shpikje serbe për të përligjur sulmet brutale të forcave të sigurimit mbi popullsinë civile shqiptare“.³⁸¹ Ky qëndrim i Kryetarit të Kosovës, nënkuptonte padiskutueshëm edhe mosbashkëpunimin e tij me të gjithë ata që ishin të gatshëm ta përgatisin popullin për luftë çlirimtare. Anëtar i Kryesisë së LPK-së, dhe njëri nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Xhavit Haliti, në një takim që ka pasur me Ibrahim Rugovën në vitin 1991 në Lugano të Zvicrës, e ka njoftuar Kryetarin Rugova lidhur me përgatitjet që po bëhen për luftë të armatosur. Ai e ka sqaruar Presidentin Rugova, se LPK është duke futur armatim në Kosovë, ndërsa Kryetari Rugova ishte përgjigjur : “Unë nuk i futem kësaj veprimtarie. Unë s’mund t’ju pengoj, por mos i thoni kujt se jeni marrë vesh me mua, sepse unë nuk dua të kem punë me këtë çështje”³⁸². Informata për ekzistimin e UÇK-së, ka patur edhe Shërbimit Informativ të Shqipërisë. Ata janë njoftuar përmes përfaqësisë së Kosovës, në Tiranë. Sipas inspektorëve të SHIK-ut, mendimi i zyrtarëve të Prishtinës, është se kemi të bëjmë me njerëz të organizuar mirë dhe që kanë disa baza në Shqipëri, sidomos në Tiranë, Durrës dhe në Tropojë.”³⁸³

³⁸⁰ Tim Judah, Kosova, luftë dhe hakmarrje, prishtinë 2002, f. 150.

³⁸¹ Wolfgang Petritsch, vepra e cituar, fq.88.

³⁸² Xhavit Haliti, Gazeta “Zëri i ditës”, datë 8 shkurt 2001 faqe 11. Kryetari i Kosovës, z. Ibrahim Rugova, e ka ditur mirë se kush është Xhavit Haliti - Zeka, me çka merret ai në Zvicër dhe në Shqipëri, e ka ditur madje se në Shqipëri përfaqëson Lëvizjen Popullore të Kosovës dhe se është njëri nga njerëzit më përgjegjës për fuqizimin dhe armatosjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës etj. Ai i ka ditur të gjitha zhvillimet rreth përgatitjeve të UÇK-së për luftë të armatosur. Ai poashtu është njoftuar nga Shërbimi Informativ i LDK-së, gjithandej nëpër Kosovë, ndërsa në Shqipëri çdo gjë e ka mësuar përmes zyrës së LDK-së në Tiranë, e cila më vonë u shndërrua në Përfaqësi të Kosovës për tu mbikëqyruar edhe nga Kryeministri në ekzil Bujar Bukoshi..

³⁸³ Sherafendin Berisha, www.pashtriku.org

„ Veprimet e deritanishme të kësaj ushtrie, e cila e quan veten UÇK, kanë qenë të përqëndruara në Drenicë dhe në rajonin e Dukagjinit, që mund të përkufizohej në vijat Prizren – Shtimje dhe në rrugën Pejë – Mitrovicë. Tash, me aksionet që janë zhvilluar para pak ditësh, zyrtarët e Prishtinës mendojnë se ajo po vepron në një hapësirë krejt tjetër, që është më e gjerë. Sipas tyre „ UÇK-ja është në tri zona, mirëpo nuk kanë dijeni të sakta se cilat janë shtrirjet e zonave, vetëm se, më parë, zoti Ali Aliu, u kishte thënë se zona e dytë është në Maqedoni.³⁸⁴ Në takimin që ka pasur, Rexhep Gjergji, atëherë Ministër i punëve të brendshme të Kosovës, me një përfaqësues të qeverisë serbe, është pasur parasysh se aksione terroriste duhen pritur edhe në të ardhmen. Mendimi i tyre është se „ disa njerëz të veçantë, që mblidhen në organizata ilegale e që duhen vëzhguar, sidomos në Tiranë. Disa prej tyre nuk duhen lejuar të veprojnë në Shqipëri. Zyra e Kosovës do të paraqes një listë të emrave të njerëzve që dyshojnë se fshihen pas kësaj organizate terroriste”.³⁸⁵ Më 16 janar 1997 formacionet speciale për veprim të shpejtë të UÇK-së, kryen një atentat në Prishtinë, për asgjësimin e Radivoje Papoviqit, i cili ishte Rektor i dhunshëm i UP-së, për të cilin UÇK kishte njohuri për aktivitetin e tij antishqiptar kundër arsimit shqip në Kosovë. Në këtë atentat u plagos rëndë vetë Rektori Papoviq dhe shoferi i tij Nikolla Llaziq³⁸⁶.

Kryetari i LDK-së dhe i Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, në konferencën me gazetar të mbajtur më 24 janar 1997 në Prishtinë, kishte deklaruar se nuk ka informacione se ekziston UÇK dhe në emër të saj mund të paraqiten shërbime të ndryshme, pasi nuk është paraqitur askush i kësaj UÇK-je. Ai dënonte shpërthimin terrorist të autobombës në Prishtinë, si moment i rrezikshëm për gjendjen e rëndë në Kosovë dhe kërkonte që këtë rast t’ a hulumtojë FBI dhe Interpolli, të shihet ç’ka ishte ai eksplozim mjaft i sofistikuar.³⁸⁷ Vetëm pak ditë pas këtij aksioni dhe disa ditë pas kësaj deklarate të Kryetarit Ibrahim Rugova, shërbimi sekret serb i kishte rënë në gjurmë aktivitetit të UÇK-së.

³⁸⁴ Sipas një dokumenti sekret të Shërbimit Informativ të Shqipërisë (SHISH). Ky dokument, shpallon një bisedë të inspektorit të SHISH-it me shefin e përfaqësimit të Kosovës në Tiranë, në periudhën kur Sali Berisha ishte president i Republikës së Shqipërisë (1996). Në dokumentin e skeduar nën numrin AT 317/ b të datës 21 janar 1996, e të protokolluar tri ditë më vonë (24 janar '96), lartë në cepin e majtë të tij, është vënë shënimi i zëvendëshefit të SHISH-it: “Të kalojë për informim në presidencë...” (është fjala për presidencën në Shqipëri). Disa ditë pas dhënies së këtij informacioni, zyra e përfaqësimit të Kosovës në Tiranë, SHISH-it ia ka dorëzuar një listë me emra të personave që mendohet se janë bartës të UÇK-së dhe që kryejnë veprimtari “ilegale subversive” në Shqipëri. Atë periudhë, disa nga të dhënat që i ishin dorëzuar SHISH-it, do të prezentoheshin edhe në një informacion të përgatitur nga ish - Shërbimi i Sigurimit ushtarak jugosllav me emrin e quajtur KOS, në të cilin janë shtuar edhe disa karakteristika të tjera, si gjendja shoqërore e atyre që e përbëjnë Grupin e Drenicës në krye me komandantin legjendar Adem Jashari, arsimit i tyre, vendndodhja, karakteristikat e zonës etj.

³⁸⁵ Bedri Islami “Enigma e një vrasje të trefishtë”, Focus, Prishtinë, 2007, faqe.129

³⁸⁶ Komunikatë e UÇK-së, nr. 29, Prishtinë, 19.02.1997.

³⁸⁷ Gazeta „Rilindja“, 25 janar 1997, Prishtinë

Më 28 janar në mënyrë spektakolare, në Prishtinë u arrestua Nait Hasani, njëri ndër themeluesit dhe Shef Operativ i UÇK-së, ndërsa më 31 janar 1997, përderisa ishin duke shkuar në një aksion, Zahir Pajaziti, bashkë me Edmond Hoxhën dhe Hakif Zejnullhun u rrethuan nga policia serbe, në fshatin Pestovë të Vushtrrisë. Në një luftë të pabarabart, ata ranë heroikisht në mbrojtje të Kosovës.³⁸⁸ Me gjithë anatemimin që i bëhej UÇK-së dhe bartësve të saj nga institucionet „ legale“ të Kosovës, pas rënies së Zahir Pajazitit me shokë, situata politike dhe ushtarake po ndryshonte me hapa të shpejtë. UÇK kishte filluar të gjejë përkrahje te të rinjtë atdhetarë dhe te studentët dhe tani të gjithë kishin filluar të besonin praninë e UÇK-së, si diçka të rëndësishme që po ndodhte për Kosovën. Një pjesë e tyre po mendohej të gjente kanale për të rënë në kontakt me ata që ia kishin kthyer pushkën Serbisë.

Në këtë kohë LPK-ja , doli me një Komunikatë përmes së cilës njoftoi për zhvillimet e fundit në Kosovë dhe se nga data 26 janar 1997 ka shpërthyer një valë e egër terrori serb, ndërsa kulmi i kësaj vale u arrit të premtën më 31 janar, kur në afërsi të fshatit Pestovë, në rrugën Prishtinë –Mitrovicë ranë nga plumbat e okupatorit tre pjesëtar të UÇK-së Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu. Me këtë valë të dhunës, okupatori ka për qëllim të thyhet ngritja morale e popullit që u bë pas veprimeve të armatosura të UÇK-së. LPK thërret të gjithë anëtarët, simpatizantët dhe gjithë shqiptarët kudo që janë, që të rrisin besimin në forcat e veta të pa shterrshme, të rrisin bashkimin rreth luftës çlirimtare. T’i përkrahin moralisht, politikisht dhe materialisht luftëtarët e lirisë në realizimin e detyrave të shenjta për çlirimin vendit. Pushtuesve ua bëjmë me dije se rrënjet e luftës çlirimtare janë thellë në popull dhe kanë idelain e shenjtë të gjeneratave të tashme dhe të ardhshme – këputjen e prangave të robërisë.³⁸⁹

Edhe përkundër kësaj, zyrtarët e LDK-së nëpër konferencat e tyre të famshme për shtyp dhe në prononcimet për gazetar deklarorin se nuk kanë asnjë njohuri për ekzistimin e ndonjë organizate me emrin UÇK dhe nuk besojmë se shpërthimet e paradoditshme të jenë vepër e ndonjë subjekti shqiptar.³⁹⁰

³⁸⁸ Driton Sejdiu, Kush ishte Zahir Pajaziti, monografi, „UÇK-ZOLL”, 2001, Prishtinë, fq. 94 -101.

³⁸⁹ Komunikatë e LPK-së, shkurt 1997

³⁹⁰ Deklaratë e LDK-së, për ATSS- në, "Rilindja", 19 shkurt 1996.

LDK e njolloste me gjuhën më të vrazhdët UÇK-në, që në aspektin kushtetutar të Republikës së Kosovës i përkiste Kryetarit të shtetit dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës për t' i mobilizuar njëëzë, për të dhënë urdhrin dhe për ta përkrahur luftën në çastet kritike, kur Kosova ishte në rrezik.³⁹¹ Në anën tjetër, LPK në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të D.J.V të mbajtur më 28/29 qershor 1997, vlerësoi se gjendja në Kosovë është tejet kritike me tendencë të rritjes së konfliktit të armatosur në mes popullit tonë dhe pushtuesve serbo-maqedono-malazez. Terrori i pushtuesve dhe tradhëtarëve mbi popullin shqiptar, vrasjet, burgosjet, torturat, bastisjet dhe presionet e gjithëanshme nuk do të mund të mbytin vullnetin e popullit për të ecur përpara në rrugën e çlirimit kombëtar. UÇK e ndihmuar nga populli po vazhdon me guxim luftën për jetë a vdekje me okupatorët serbo-sllav. Duke folur për relacionet e LPK-së me partitë politike shqiptare, LPK theksonte se është e gatshme të bashkëpunojë vetëm me ato subjekte politike apo jo politike, varësisht sa ato ndihmojnë realisht luftën e armatosur të popullit tonë në trojet e pushtuara. Ky qëndrim vlen edhe për ato shoqata të krijuara nga ish të dënuar politik që janë bërë bisht i politikës së dështuar të LDK-së apo ndonjë subjekt tjetër që vepron me bekimin e Beogradit. Sado me fraza të bukura që të paraqiten subjekte të caktuara, apo të kenë merita për të kaluarën qoftë si subjekte, qoftë për shkak të personave të veçantë me të kaluar të mirë që mund të jenë në të, në rast se ato nuk janë të qarta në përkrahje të luftës së armatosur që po bënë UÇK, LPK ka rezerva dhe nuk mund të ketë marrëdhënie bashkëpunimi.³⁹²

Nga mesi i vitit 1996, Adem Jashari, në kontaktet e vazhdueshme që mbante me Kryetarin e LPK-së për Gjermani - Fehmi Lladrovci, duke i ditur rrethanat e reja që ishin krijuar në Kosovë, kishte kërkuar nga ai që të kthehet në Kosovë për të ndihmuar ata në organizimin e luftës. Meqenëse Fehmi Lladrovci ishte në hierarkinë e LPK-së, d.j.v, ai kishte bërë një kërkesë organeve udhëheqëse të LPK-së, që ai sëbashku me Xhevdë Krasniqin – Lladrovci, Ramiz Lladrovcin, Selim Krasniqin, Ilaz Kodra, Abedin Rexha, Rafet Rama, Ramush Haradinaj dhe disa shokë, të kthehen urgjent në Kosovë.³⁹³

³⁹¹ Shih, kushtetuta e Republikës së Kosovës, 1990, Prishtinë.

³⁹² Deklaratë e KP të LPK -së, D.J.V, 28/29 qershor 1997

³⁹³ Bedri Islami, Përjetësia e dyfishitë, gusht 2008, Tiranë, f.355

Në letrën që i kishte dërguar Kryesisë së KP të LPK-së, Fehmi Lladrovci theksonte se është i interesuar të shkojë në mënyrë të organizuar në Kosovë, në bazë të strukturave udhëheqëse të LPK-së.³⁹⁴ Po e kësaj natyre ishte edhe letra e Adem dhe Hamëz Jasharit, në dhjetor 1997 të cilën ia kishin dërguar LPK-së, përmes së cilës kërkonin kthimin e shokëve në strukturat e luftës.³⁹⁵ Kjo letër e udhëheqësve të UÇK-së në Kosovë dhe raportet që kishte Fehmi Lladrovci me Adem dhe Hamëz Jasharin, kishin ndikuar që Fehmi Lladrovci dhe të tjerët rreth tij, kryesisht nga Drenica, të merrnin vendim përfundimtar që të kthehen në radhët e UÇK-së në Drenicë.

Në Kryesi të LPK-së kishte mendime të ndryshme, sa i përket kërkesës së Fehmi Lladrovci për kthim në Kosovë dhe letrës së Adem Jasharit për ndihmë nga LPK-ja. Arsyetimi i Kryesisë së LPK-së ishte se në këtë kohë, UÇK-së nuk i duheshin njerëz, por të holla dhe mjete luftarake. Në një kasetë e cila është në arkivin e LPK-së, e ardhur nga Adem Jashari në vitin 1997, thotë se Fehmi dhe Ramiz Lladrovci janë shokët tanë dhe se veq vdekja më ndan prej Fehmi Lladrovci.³⁹⁶ Pas insistimit dhe këmbëngulësisë së Fehmi Lladrovci dhe shokëve të tij, Kryesia e LPK-së e miratoi kërkesën e grupit që t'i shkojnë në ndihmë Adem Jasharit dhe ushtarëve tjerë të UÇK-së të cilët operonin në rajonin e Drenicës, Llapit, Dukagjinit etj. Në maj të vitit 1997, në mënyrë të organizuar, grupi është nisur nga Gjermania për në Kosovë. Në përcjellje të grupit deri në Vlahnë kanë qenë: Ali Ahmeti dhe Emrush Xhemajli.

Më 4 maj 1997, në portin e Durrësit, në Shqipëri Fehmi Lladrovcin me shokë e kanë pritur vëllezërit Luan dhe Ramush Haradinaj, të cilët kanë qenë të autorizuar për t'i futur në Kosovë, deri në Drenicë. Grupi i parë nga Fehmi Lladrovci, Xhevë Lladrovci, Ramiz Lladrovci, Ilaz Kodra, Abedin Rexha, Selim Krasniqi, Rafet Rama, Gani Rama dhe Sami Lushtaku, të përcjellur nga Ramush dhe Luan Haradinaj, si dhe nga Ali Ahmeti e Emrush Xhemajli, etj, u nisën nga Tirana për në kufi. Më 06.05.1997, nga Vlahna e Kukësit grupi është nisur për të thyer kufirin shqiptaro - shqiptar dhe për t'iu bashkangjitur bashkëluftëtarëve të tyre në Kosovë. Kur ata ishin futur në territorin e Kosovës kishin rënë në pritë.³⁹⁷

³⁹⁴Po aty, f.361

³⁹⁵ Letra e Adem Jasharit dërguar LPK-së, Bedri Islami, „Përjetësia e dyfishtë“, fq. 387 – 392

³⁹⁶ Bedri Islami, vepra e cituar, fq. 355 -360.

³⁹⁷ Bedri Islami, vepra e cituar, f. 354, deklaratë e Abedin Rexhës, „SANDOKANIT“ dhënë Kryetarit të LPK-së.

Në një territor të panjohur më parë u zhvillua një luftë e madhe dhe në këto luftime mbeti i vrarë Luan Haradinaj, të cilin e kishin bartur deri në fshatin Vlahnë, ndërsa me ndihmën e fshatarëve të Vlahnës ai është varrosur me nderime dhe me ceremonitë e duhura. Pas kësaj që ndodhi, grupi u detyrua të anulojë udhëtimin për në Kosovë, sepse dyshohej se dikush i kishte përgjuar dhe denoncuar te policia kufitare Jugosllave".³⁹⁸

Më vonë, gati të gjithë anëtarët e këtij grupi do të futen prapë në luftë në Kosovë. Në verë të vitit 1997 në Kosovë hyjnë dy veprimtarë të dalluar të LPK-së dhe luftëtarë e komandant të UÇK-së, Ilaz Kodra dhe Abedin Rexha, ndërsa më vonë edhe Fehmi e Xhevë Lladrovci. Në janar të vitit 1998, nga Zvicra vjen Ramush Haradinaj, po ashtu veprimtar i LPK-së. Shumica nga këta do të vriten e do të bien më vonë heroikisht në fushëbetejën për tokën e Kosovës.

³⁹⁸ Intervistë e Gjeneral Ramush Haradinaj dhënë në një emision dokumentar në RTK, 2001, lidhur me këtë ngjarje.

5). Demonstratat studentore - 1 Tetor 1997

Ideja për fillimin e demonstratave të studentëve kishte lindur në fund të vitit 1996 dhe fillim të vitit 1997 nga bisedat dhe analizat e shpeshta që kishin bërë studentët, Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj, Driton Lajqi dhe Nazmi Muzlijaj³⁹⁹ Në janar të vitit 1997, studentët i kishin shkruar një peticion 550 nënshkrime Kryetari Ibrahim Rugova, por në vend të përgjigjies shumë nga studentët e nënshkruar, u arrestuan nga policia serbe nën akuza të ndryshme⁴⁰⁰. Megjithatë këto nënshkrime patën efektin e vet, sepse studentët u elektrizuan nga qëndrimet për dhe kundër peticionit.⁴⁰¹ Atëherë askush nuk e dinte se studentët kishin lidhje me LPK-në dhe UÇK-në, e cila i ndihmonte me fonde në sfidën e tyre të dyfishtë, si ndaj serbëve, ashtu edhe ndaj politikës pacifiste.⁴⁰² LPK, në mars 1997, kishte ngarkuar Habib Elshanin që në bashkëpunim me prof.dr.Muhamet Mehmetin të punonin me studentët e UP-së.⁴⁰³ Në gusht të vitit 1997, studentët në Prishtinë filluan në organizimin e protestave, sepse autoritet serbe nuk e kishin zbatuar marrëveshjen e vitit 1996 për arsimin të cilën e kishin nënshkruar Kryetari i Serbisë Slllobodan Millosheviq dhe Kryetari i Kosovës, Ibrahim Rugova, me ndërmjetësimin e shoqatës „ Shën Egjidio” nga Vatikani.

Në shtator 1997, Ibrahim Rugova kishte tentuar që t’i përfaqë studentët dhe të ndalonte mbajtjen e protestave të tyre, por studentët kishin humbur besimin tek partitë politike dhe kur ai kërkoi në shtator t’i ndalonte demonstratat, studentët nuk ia vunë veshin fjalëve të tij. Kryetari i “Republikës së Kosovës” dhe i një vargë funksioneve të tjera, Ibrahim Rugova, madje ishte edhe kundër demonstratave paqësore që i organizonin studentët e Universitetit të Prishtinës, duke u arsyetuar tashmë me slloganin e shumëfamshëm, se “duhet të jemi të kujdesshëm e të mos e tensionojmë situatën pa nevojë, në mënyrë që të mos e prishim rendin e krijuar demokratik”.⁴⁰⁴

³⁹⁹ Intervistë e Driton Lajçit, ish –udhëheqës i studentëve në vitin 1997, Epoka e Re, 1 tetor 2005, f.8

⁴⁰⁰ Komunikatë e LPK-së, 1 tetor 1997.Prishtinë.

⁴⁰¹ Driton Lajçi, po aty.

⁴⁰² Tim Judah, Kosova, luftë dhe hakmarrje, prishtinë 2002, f. 172.

⁴⁰³ Emrush Xhemajli, vepra e cituar, f.18.

⁴⁰⁴ www.pashtriku.org

Në takim me studentët, Kryetari Rugova nuk i kishte përkrahur ato për mbajtjen e protestave dhe i kishte lutur që protestat e tyre të shtyhen për një kohë të pacaktuar, por studentët e kishin refuzuar kërkesën e tij duke i thënë se janë të vendosur që protesta të mbahej më 1 tetor. Përkrahje studentëve u kishin dhënë, diploamtët Amerikan Robert Gelbard, Ambasada e Shqipërisë në Beograd, Artan Begolli dhe Florian Nova, Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Kryetari i saj z. Sali Berisha, të burgosurit politik, Hydajet Hyseni, Ali Lajqi, Berat Luzha dhe Ramë Buja, qindra mesazhe përkrahëse në formë elektronike nga Tirana, Shkupi, vendet Evropiane, Kanadaj, SHBA etj. si dhe shumë profesor të UP-së, të cilët u jepnin zemër studentëve për qëndresë.⁴⁰⁵

Në këtë periudhë edhe Lëvizja studentore kishte filluar të riorganizohej dhe të kundërshtojë politikën e pritjes e të mosbërjes asgjë kundër pushtuesit Serb. Ajo, e udhëhiqur nga Muhamet Mavrajt, Bujar Dugolli, Driton Lajçi, Albin Kurti *etj.*, poashtu gjeti përkrahje edhe nga profesori dhe rektori i nderuar Ejup Statovci, i cili me përvojën e tij dhe me shpirtin e një atdhetari intelektual i udhëhiqte ata në rrugën e drejtë të rezistencës e të lirisë. Populli tanime kishte filluar të mendonte ndryshe. Më 1 tetor 1997, rreth 20.000 student arritën t'i bënin ballë me sukses policisë serbe, e cila i rrahu dhe i arrestoi shumë studentë dhe profesorë të tyre. Demonstrata të ngjajshme pati edhe në pjesë të tjera të Kosovës.⁴⁰⁶ Protestat më 1997, vazhduan sipas planit të Këshillit Organizativ edhe më 29 tetor dhe 30 dhjetor 1997.⁴⁰⁷

Shtypi vendor, Koha ditore, Zëri, Bujku etj, i dhanë përkrahje protestave të studentëve, të cilat i zgjuan nga letargjia qendrat e vendosjes, pushtuesin serb, por edhe faktorin politik shqiptar.⁴⁰⁸ Për t'i dhënë jehonë kërkesave të studentëve të UP-së, redaksia e gazetës „Zëri i Kosovës" bëri marrëveshje me redaksinë e gazetës së studentëve „Bota e Re", e cila drejtohej nga Muhamet Mavraj, që të dalin me materiale të njëjta. Muhamet Mavraj kontaktet dhe lidhjet e tij me LPK-në i mbante me Adem Grabovcin dhe Lulzim Etemajn.

⁴⁰⁵ Intervistë e Driton Lajçit, ish –udhëheqës i studentëve në vitin 1997, Epoka e Re, 6 tetor 2005, f.8

⁴⁰⁶ Tim Juda, vepra e cituar, fq. 172.

⁴⁰⁷ Driton Lajçi, Epoka e Re, 6 tetor 2005, f.8

⁴⁰⁸ Koha ditore 30.09.1997, Bujku, 03.10.1997, Zëri, 04.10.1997

Marrëveshja me Redaksinë e „ Zërit të Kosovës“ dhe me udhëheqës të LPK-së, ishte gojore, e jo në formë të shkruar. Të gjitha shkrimet që botonte gazeta „ Zëri i Kosovës“ në Zvicër, botoheshin edhe në gazetën „ Bota e Re“.⁴⁰⁹ Përmes kësaj gazete, studentët kishin mundësi të informoheshin më për së afërmi me aktivitetin e LPK-së dhe të UÇK-së, prandaj atyre u ishte ofruarmundësia për të vlerësuar dhe për t’u përcaktuar se nga duhet shkuar. Ata tani kishin filluar të flisnin, dhe haptas t’a përkrahnin UÇK-në. Kuptohet që rreziku ishte i madh, por studentët dhe rinia arrinin që të njoftoheshin dhe të kuptonin gjendjen aktuale politike dhe të merrnin edhe informacione për aksionet e UÇK-së, përmes këtyre shkrimeve⁴¹⁰

LPK konsideron se pas demaskimit të plotë të përmbajtjes reale të „ dogovorit“ Millosheviq – Rugova, pjesa më e vendosur e studentëve ndërmori në mënyrë të pa shmangshme hapa konkret drejt realizimit të njërës nga të drejtat e popullit tonë, për lirin e objekteve arsimore të Kosovës. Më 1 nëntor 1997 në Prishtinë dhe qytete tjera Universitare të Kosovës për këtë qëllim u mbajtën manifestime të studentëve. Intervenimi brutal i policisë tregon edhe një herë se okupatori është i vendosur të mbajë Kosovën të pushtuar më të gjitha mjetet, të intervenojë kundër çdo shfaqje antipushtuese. Këto demonstrata tregojnë edhe një herë se tentimi për të avancuar çështjen kombëtare në kuadër të sistemit Millosheviq –Rugova, është absurd. Dalja në rrafshin e pavarur nga ky sistem siguron ecje para – dalje në rrafshin e luftës për çlirimin e Kosovës.⁴¹¹

LPK denon dhunën dhe terrorin shtetëror të ushtruar mbi studentët duarthatë, si dhe ata që krijuan klimë të përshtatshme për të intervenuar policia serbe. LPK dënon punën perfide dhe ndërhyrjen brutale të Ibrahim Rugovës, këtij bashkëpunëtori të dëshmuar të kriminelit të luftës Millosheviqit.⁴¹² Demonstratat e studentëve patën efektin e madh qysh në fillimin e tyre. Gjithë bota për një çast ktheu vëmendjen tek Kosova e harruar. Demonstrata ka rëndësinë e vetë edhe më të madhe kur kemi parasysh se ato po bëhen në kohën kur UÇK, i ka rritur veprimet e veta. Jemi të bindur se studentët janë të vetëdijshëm se nuk mund të çlirohet vendi me fjalë, pra as objektet që janë brenda tij dhe as ato të arsimit. Demonstrimi kundër uzurpimit të shkollës shqipe është vetëm një nga format e luftës së popullit tonë.

⁴⁰⁹ Muhame Mavraj, ish - Kyeredaktor i „ Botës së Re“ , qershor 2008

⁴¹⁰ Intervistë me Muhamet Mavrajn, qershor 2008, Prishtinë

⁴¹¹ Komunikatë e LPK-së, 1 tetor 1997. Prishtinë

⁴¹² Po aty.

Trupat terroriste të Beogradit nuk do të shkulen nga trojet tona me fjalë. Lufta e armatosur e popullit tonë kundër okupatorëve është determinuese në çështjen e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës.⁴¹³ Demonstrata të ngjajshme UPSP, organizoi edhe më 2 mars 1998, pas ngjarjeve të përgjakshme në Likoshan dhe Qirez, më 09 mars 1998, pas ngjarjeve të përgjakshme në Prekaz, por edhe për shkak se po këtë ditë mblidhej edhe Grupi i kontaktit, pastaj më 18 mars dhe 30 prill 1998. Në këto protesta, studentët nuk brohoritnin „Drenicë jemi me ty”, por fuqishëm jehonte parolla „UÇK, UÇK”.⁴¹⁴ Dhe vërtetë, brohoritmat për UÇK-në, nuk ishin vetëm brohoritma kuortazie, por rinia studentore, shumë shpejtë i la bankat e Universitetit dhe iu bashkua luftëtarëve të UÇK-së, për t’i dhënë vrull dhe gjak të pastër rinor. Protestat e UPSP-së, në Prishtinë dhe përkrahja e tyre për UÇK-në, ishin bindja më e mirë për popullin e Kosovës dhe opinionin botëror, se tani kjo rini studentore e dalur maleve, nuk mund të akuzohej se në UÇK, janë disa fshatarë të pa gdhendur që nuk pajtoheshin me pushtetin serb, por se në radhët e saj, UÇK-ja tani kishte të gjitha shtresat e popullit, që nga fshatarët, studentët, punëtorët, intelektualët dhe të gjithë ata që me vite e dekada kishin punuar që një ditë popullit të shumëvujtur t’i kthehet liria dhe dinjiteti i nëpërkëmbur nga okupatori serb. Gazeta serbe në Kosovë „Jedinstvo” kishte të drejtë kur shkruante se në Kosovë ndodhen dy shtabe të UÇK-së, njëri në Drenicë dhe tjetri në UPSP.

⁴¹³ Po aty.

⁴¹⁴ Driton Lajçi..... Epoka e Re, 12 tetor 2005, f.10

KAPITULLI I PESTË

1). Dalja publike e UÇK-së

Rënia heroike e tre themeluesve të UÇK-së, Zahir Pajazitit, Edmond Hoxhës dhe Hakif Zejnullahut, në janar të vitit 1997, aksionet e armatosura të njësiteve të UÇK-së gati në të gjitha pjesët e Kosovës, arrestimi i një pjese të udhëheqësve të UÇK-së, veqanarisht të Nait Hasanit më 28 janar 1997, protestat e studentëve më 1 tetor, rënia heroike e Ardian Krasniqit, më 15 tetor 1997 dhe ngjarjet që rrodhën gjatë periudhës së dytë të vitit 1997, ndikuan që situata politike dhe e sigurisë në Kosovë të marrë kahje krejt tjetër dhe tani fryma e UÇK-së dhe era e luftës ishte e pranishme kudo.

Pak javë pas rënies së Ardian Krasniqit, më 25 nëntor, policë serb të maskuar si puntorë të Elektro ekonomiksë, shkuan në fshatin Vojnik, por hasën në rezistencë të UÇK-së. Policia serbe, derisa po tërhiqeshin nga një betejë e humbur kundër UÇK-së vrau mësuesin Halit Geci. Më 28 nëntor 1997, në Llaushë të Skenderajt, u varros mësuesi i Halit Geci, i cili një ditë më herët ishte vrarë. Duke e parë se populli i Kosovës po keqinformohej dhe duke e ditur se propaganda, sidomos në mediat e shkruara është një mjet i rëndësishëm për rritjen e radhëve të UÇK-së, por edhe duke e parë se janë pjekur edhe kushtet tjera për një gjë të tillë, më 28 nëntor 1997, me rastin e varrimit të mësuesit Halit Geci, në të cilin varrim që morën pjesë mbi 20.000 veta, tre ushtarë të UÇK-së: Rexhep Selimi, Mujë Krasniqi⁴¹⁵ dhe Daut Haradinaj, zbresin nga malet e Drenicës dhe u thonë popullit të tubuar në varrim se „ ka dhe do të ketë UÇK, derisa të çlirohet Kosova nga Serbia" se „ Serbia po vret dhe po masakron shqiptarët dhe UÇK-ja është e vetmja forcë që lufton për çlirim dhe bashkim kombëtar“.⁴¹⁶ Dalja publike e UÇK-së aso kohe bëhej përditë nëpër rrugët e Kosovës. Megjithatë, ajo ditë ka qenë e veçantë, sepse mijëra qytetarë nga të gjitha vendet e Kosovës e pritën me duar hapur UÇK-në. Aty iu kthye besimi popullit se kësaj radhe është një forcë që do t'i dalë zot vendit. Edhe mesazhi ishte i qartë se ushtarët e UÇK-së janë të gatshëm të sakrifikohen për ta fituar lirinë.

⁴¹⁵ Mujë Krasniqi – Kapuqi, ish bashkëluftëtar i Adem Jasharit, njëri nga themeluesit e UÇK-së, tani dëshmor i kombit.

⁴¹⁶ Tim Judah, vepra e cituar, f. 172 -173.

Në atë ngjarje ka pasur burra të mëdhenj të kombit, si Komandanti Legjendar Adem Jashari dhe shumë bashkëluftëtarë, disa prej tyre sot janë dëshmorë dhe gjithsecili prej tyre i ka meritat në daljen publike të UÇK-së. Prej shumë ushtarëve është dashur të jenë tre dhe kjo hise i ra, Daut Haradinajt, Mujë Krasniqit dhe Rexhep Selimit.”⁴¹⁷ Lidhur me daljen publike të UÇK-së, shkaqet dhe arsyet e këtij prononcimi para opinionit dhe masës së tubuar, dy protagonistët kryesor të kësaj ngjarje, theksojnë se edhe gjatë veprimit të njësiteve të armatosura të UÇK-së, kishte komunikim përmes korrierëve edhe pse numri i tyre ka qenë shumë i vogël. Pas marrjes së lajmit për vrasjen e mësuesit Halit Geci, në Llaushë, UÇK edhe pse e pa përgatitur për të dalur para masës, nuk ishin të uniformuar dhe pa emblemë të UÇK-së, me ndihmën e Musë Jasharit, vendosën që, meqë është dita 28 nëntor, dita e flamurit kombëtar, të dalin para masës së tubuar dhe t’u bëjnë me dije ekzistencën e UÇK-së.“⁴¹⁸

Po atë ditë, në mëngjesin e 28 nëntorit 1997, Rexhep Selimi, i cili ishte caktua nga Komandanti i UÇK-së Adem Jashari për të folur në varrim,⁴¹⁹ e ka shkruar komunikatën, e cila do të lexohej në varrim, përmes së cilës është munduar që dalja publike e tyre të ketë më shumë efekt psikologjik te qytetarët e Kosovës, për shkak se deri në këtë kohë, UÇK, kishte ende strukturë të thjeshtë të organizimit.⁴²⁰

LPK sikurse aksionet e mëparme dhe aksionet e tashme të UÇK-së i përkrah pa rezervë si aksione të qëlluara çlirimtare. LPK, thërret të gjithë anëtarët e saj, popullin si dhe gurbetëqarët që ta ndihmojnë atë, të rrisë veprimtaritë për përhapjen e ideve çlirimtare te kurbetqinjët dhe të rriten veprimtaritë për ndihmimin e fondit „ Vendlindja Thërret“. Kryesia e LPK-së me vëmendje po përcjell lëvizjen e diplomacisë botërore në drejtim të Kosovës. Pas iniciativës Amerikano – Gjermane u ndërmorr edhe një iniciativë, ajo Franko – Gjermane. Edhe pse ende nuk është dhënë informacion i plotë për këtë iniciativë, siç është njoftuar deri më tash është parapar statusi special për Kosovën. LPK është kundër këtyre propozimeve. Populli shqiptar është kundër çdo lloj statusi të Kosovës, pos atij për pavarësi për të cilin është deklaruar me referendum.

⁴¹⁷ Intervistë e z.Daut Haradinaj, Epoka e Re, 27 nëntor 2006

⁴¹⁸ Daut Haradinaj, Intervistë në KTV, 19.02.2009.

⁴¹⁹ Libri i Lirisë, intervistë e Rexhep Selimit, Zëri, Prishtinë 2003, f. 266 -268.

⁴²⁰ Rexhep Selimi, Intervistë në KTV, 19.02.2009.

LPK është duke u përpjekur dhe do t'i bind me punë shtetet e botës se vetëm pavarësia e Kosovës vendos paqen dhe sigurinë në rajon. LPK përkrah bashkimet e pavarura të popullit shqiptar që përkrahin luftën e armatosur të UÇK-së.⁴²¹

Më 28 nëntor 1997, përmes një thirrje, drejtuar të gjithë shqipëtarëve që sakrifikojnë për çlirimin e vendit, LPK deklaroi se i mbështet veprimet e armatosurat të UÇK-së kundër trupave pushtuese serbe të cilat u intensifikuan ditëve të fundit në fshatrat e Drenicës, Dukagjinit dhe në vise tjera Shqipëtare. Lufta e popullit shqiptar është rrjedhojë dhe kundërveprim i imponuar nga shtypja e egër e okupatorit. LPK u bën thirrje gjithë shqiptarëve që sakrifikojnë, që të ndihmojnë UÇK-në, t'a ndihmojmë me njerëz, me çdo mjet dhe në çdo mënyrë njësitë e saja, t'u japim informacion, ndihmë mjekësore, bukë, veshëmbathje dhe mjete transporti. Të kuptohet drejtë shkalla fillestare e luftës së armatosur. Çdo popull që luftoi dhe që fitoi, kaloi nëpër këtë fazë të ashpër dhe të përgjakshme. Të ndihmojmë popullatën për të përballuar terrorin armik. Më mirë të vuajmë deri në çlirimin e vendit sesa të vuajmë pa kufi. Të injorohen frikacakët që po përhapin panik dhe konfuzion në popull. Lufta e popullit tonë për çlirim është e drejtë dhe do të ngadhënjejë!⁴²²

Në fund të vitit 1997 dhe në fillim të vitit 1998, në shtypin Kosovar dhe atë të huaj, por edhe koluarave të Prishtinës dhe më gjerë, po bëhëj një propagandë e fëlliqur kundër UÇK-së dhe bartësve të saj. Ata shkruanin se „ nuk ka UÇK, por grupe të vogla banditësh dhe terroristësh të cilët po e terrorizojnë popullatën e Drenicës, Llapit dhe të Dukagjinit". Pas fillimit të luftës frontale thuhej se „ në malet e Drenicës po luftojnë veglat serbe", se ata janë njerëzit e Arkanit, të frustruar, të pa shkollë, Enveristë e dokrra të tjera perverze e të pa kripë.

⁴²¹ Mbledhje e KP të LPK-së, D.J.V, 22 nëntor 1997

⁴²² Thirrje, e LPK-së, drejtuar të gjithë shqipëtarëve që sakrifikojnë për çlirimin e vendit, 28 nëntor 1997, Prishtinë

2). Fillimi i luftës së armatosur, mars, 1998

Janari i vitit 1998, solli me vete kumtin e fundit të paqes së rrejshme në Kosovë. Atëkohë kur UÇK-ja po bëhej gjithnjë e më shumë mbizotruese e situatës në Kosovë, u vu në lëvizje diplomacia ndërkombëtare, për të parandaluar rrjedhën e ngjarjeve që çonin pashmangshëm drejt luftës. Në Pranverën e hershme të vitit 1998, vatër e rezistencës dhe qëndresës heroike gjithmonë ishte Drenica. Edhe pushtuesi, gjithmonë e kishte pasur halë në sy këtë pjesë të Kosovës. Në dhjetor të vitit 1991, por edhe më 22 janar të vitit 1998 ishte sulmuar shtëpia e Shaban Jasharit në Prekaz.

Qasja e bashkësisë ndërkombëtare ndaj zgjidhjes së çështjes së Kosovës, ndërtohej mbi qëndrimin e njohur siç ishte mospranimi i gjendjes status-quo dhe kundërshtimi i aspiratave të shqiptarëve për pavarësi. Mbi këtë bazë, gjatë vitit 1998, Grupi i Kontaktit dhe qendrat tjera ndërkombëtare të vendosjes përmes diplomacisë së ashtuquajtur lëvizëse, do të udhëtonin sa në Beograd e sa në Prishtinë për të gjetur një zgjidhje politike për Kosovën, përmes negociatave. Ngjarjet më kulmore që i dhanë kahje zhvillimeve politike në Kosovë, konsiderohen vizitat e shpeshta të ambasadorit amerikan Robert Geldbard, i deleguari special i SHBA-ve për ish-Jugosllavinë, në janar-mars të vitit 1998 në Prishtinë dhe në Beograd. Robert Geldbard në një nga takimet e tij më 23.02.1998, me Kryetarin e Kosovës, Ibrahim Rugova në Prishtinë, publikisht e akuzoi “UÇK-në si organizatë terroriste”, ndërsa kërkonte forcimin e lidërshpimit politik të moderuar në krye me Ibrahim Rugovën dhe pranimin për mbajtjen e zgjedhjeve Parlamentare më 22 mars, të cilat do të përshpejtojnë shpërthimin e luftës në Kosovë.⁴²³ Një ditë më vonë z.Geldbard gjatë një takimi me Millosheviqin, i dhuroi Beogradit lehtësitë, duke deklaruar se disa nga sanksionet ekonomike do të hiqen. Ky veprim i diplomatit amerikan, skajshmërisht akuzues për UÇK-në, në të vërtetë i dha forcë shtytëse në aspektin politik LDK-së, ndërsa në aspektin ushtarak e trimëroi Slllobodan Millosheviqin, për të marrë një ofensivë për zhbërjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për vrasjen e shqiptarëve dhe shkatërrimin e vendbanimeve të tyre.⁴²⁴

⁴²³ Blerim Shala, Vitet e Kosovës 1998 -1999, Prishtinë 2001, f.30.

⁴²⁴ Tim Judah, Kosova, lufta dhe hakmarrja, Koha, Prishtinë 2000, f. 174.

Porosia e ambasadorit Robert Geldbard, për forcimin e lidërshiptit në Kosovë, duket se Ibrahim Rugovës, i ka dhënë edhe një arsye më shumë për të vënë kontrollin e plotë dhe fuqizimin e tij brenda strukturave të LDK-së, në Kuvendin e tretë të saj, që mbahet më 25 shkurt 1998. Në këtë kuvend, nga organet drejtuese të LDK-së, largohen ish të burgosurit politik në krye me Hydajet Hysenin. Dy ditë pas mbajtjes së kuvendit të LDK-së, më 27 shkurt 1998 forcat ushtarake-policore të Millosheviqit në emër të spastrimit të terrenit nga bandat terroriste të UÇK-së sulmuan fshatrat Qirez dhe Likoshan. Gjatë kësaj lufte u bënë përleshje të ashpra, në mes të forcave të UÇK-së dhe forcave serbe në Polac, Llaushë, Likoshan, Çirez dhe fshatra tjera të Drenicës. Në këto përleshje u vranë dhe u plagosën me dhjetra armiq serb, poashtu u kap edhe sasi e madhe e armatimit ushtarak si dhe u nxorën jashtë përdorimit dhjetra mjete të motorizuara të armikut dhe një helikopter. Gjatë tërheqjes forcat serbe vranë dhe masakruan dhjetra civil shqiptar si dhe u plagosën 3 ushtar të UÇK-së. Luftës 4 ditore të UÇK-së iu bashkangjiten edhe popullata e Drenicës duke u bërë një me forcat çlirimtare.⁴²⁵

Megjithë humbjet e fundshkurtit, forcat serbe nuk ishin zbrapsur nga qëllimi për ta shuar embrionin e luftës dhe të UÇK-së në Kosovë. Përkundrazi, ky sulm i forcave serbe jepte të kuptonte se interesimi i forcave serbe ishte shkatërrimi dhe zhdukja e kësaj ushtrie që synonte çlirimin e Kosovës. Për të shikuar forma të reja veprimi më 1 mars 1998, në Munich të Gjermanisë, udhëheqës të LPK-së ishin takuar me Ministri i punëve të jashtme të Shqipërisë, Paskal Milo, dhe Ambasadorin i shtetit shqiptar në Gjermani, Bashkim Zeneli. LPK-në e përfaqësonin, Fehmi Lladrovci – Kryetar i nëndegës së LPK-së në Gjermani, Rexhë Ibërdemaj, Sylë Ukshini dhe Ramiz Lladrovci. Veprimtarët e LPK-së i kishin njoftuar diplomatët Shqiptar se ekzistenca e UÇK-së është e vërtetë dhe e domosdoshme dhe se LPK-ja është e vendosur për ta qar seri në fund luftën e armatosur. Në këtë takim, përfaqësuesit e LPK-së, nga diplomatët shqiptar kërkonin mbështetje politike për UÇK-në dhe furnizim me armë nga ana e shtetit shqiptar.⁴²⁶

⁴²⁵ P o aty.

⁴²⁶ Paskal Milo, Ditari i një Ministri të Jashtëm, Konflikti I Kosovës 1997 -2001, Tiranë 2009, f.34.

Dhe profetizimi i Fehmi Lladriovcit në takim me Ministrin Paskal Milo, se në Kosovë së shpejti do të ketë luftë, doli të ishte i saktë. Nata e 4 dhe 5 marsit 1998, në Prekaz të Drenicës dhe në tërë Kosovën kishte gdhirë krejt ndryshe nga ditët tjera. Forca të mëdha policore e ushtarake e kishin rrethuar Prekazin dhe lagjen e Jasharajve, ku sipas tyre, fshihej Adem Jashari me çetën e tij. Pushtuesi i kishte marrë të gjitha masat që të pengohej ndihma që mund t'u vinte nga të gjitha anët. Rrethimin e kishte hetuar Komandanti Adem Jashari, por nuk kishte bërë asnjë përpjekje për t'u larguar, ndonëse kishte mundësi. Përkundrazi, ata kujtuan besën që kishin lidhur mes vete. Para se të zbardhte drita gjithëqka ishte e qartë.⁴²⁷ Ndonëse skajshmërisht të pabarabart, familja e Adem Jasharit nuk u përkul dhe nuk u dorëzua. Luftuan deri në frymën e fundit dhe ranë heroikisht në mbrojtjen e nderit të Atdheut, Ademi, Hamza, plaku Shaban Jashari dhe të gjithë anëtarët tjerë të familjes.

Pas tri ditë e tri net luftimesh të përgjakshme, shpëtoi vetëm Besarta për të dëshmuar ferrin e përjetuar. I fundit nga të gjithë luftëtarët ishte vrarë Adem Jashari. Ishte kjo një luftë që e revoltoi pa masë popullsinë shqiptare, por edhe që ngjalli shumë shpejtë shpresat për t'i rrokur armët dhe për t'ia kthyer pushkën armikut tonë shekullor. Populli i vuajtur shqiptar i Kosovës, i shtypur e i nëpërkëmbur nga pushtuesi serbo-sllav, me gëzim e priti fillimin e luftës së armatosur. Ai nuk kishte çka të humbte tjetër. Ato tri dite rezistence dhe lufte të armatosur ranë heroikisht komandanti Adem Jashari dhe 55 dëshmorë të lirisë, prej tyre u flijuan edhe gra, fëmijë dhe pleq. Nga rrethimi kishte arritur të shpëtonte e gjallë vetëm Besartë Hamzë dhe Bashkim Rifat Jashari.⁴²⁸

Qëndresa dhe lufta e Jasharajve nuk kishin ndodhur rastësisht. Ata e dinin se dikush duhet të flijohet, për lirinë e Kosovës. Hamzë Jashari, në një intervistë të dhënë pak kohë para rënies së tij heroike kishte thënë se edhe krejt n'u zhdukshim ne, kjo familje do të vazhdojë prapë, ngase do të mbeten katër meshkuj....⁴²⁹.

Lufta heroike e Jasharajve pushtoi të gjitha mediat dhe vuri në lëvizje politikën botërore. Më 9 mars Grupi i Kontaktit miratoi një deklaratë për Kosovën e cila denonte Beogradin dhe e paralajmëronte se do të merren masa shtrënguese nga tyre.⁴³⁰

⁴²⁷ Bashkim Jashari, Jasharët....., B.Hamza, F.Hoti, fq.100

⁴²⁸ Emine Halimi, Ajnishahe Shala, Histori e një qëndrese, k.k. Skenderaj, 2000, fq. 27 -36.

⁴²⁹ Fazli Veliu, LPK dhe UÇK: Një embleme dhe një qëllim, Prishtinë, 2000, fq. 113.

⁴³⁰ Paskal Milo, ditari i një Ministri, f.38.

Në deklaratën e Grupit të Kontaktit, kritikohet „përdorimi i tepruar i forcës“ dhe „tejkalimi i autorizimeve“ të njësive speciale të policisë serbe, „që ka sjellë për pasojë së paku 80 humbje jete“, ndërsa denohen në tërësi siç theksohet në deklaratë „aksionet terroriste të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, apo të çfarëdo grupi apo personi.“ Pra, Grupi i Kontaktit, operacionet shfarosëse të njësive speciale serbe kundër shqiptarëve i cilëson si përdorim i tepruar i forcës, ndërsa veprimet e UÇK-së që ishin në mbrojtje të popullatës shqiptare nga forcat serbe, i cilësonte si “aksione terroriste”!!!⁴³¹

Më 11 mars 1998, të gjithë të rënë në Prekaz u varrosën. Në varrim kishin marrë pjesë shqiptarët e të gjitha viseve të saj, si dhe nga shtetet perëndimore e më larg. Të gjithë kishin vetëm një fjalë, të gjithë kishin vetëm një betim: Të vazhdohet lufta deri në Çlirimin e Kosovës. Qëndresa heroike e kësaj familje ngjalli pa masë ndjenjat atdhetare dhe luftarake kundër pushtuesit. Pas ngjarjes së Prekazit, në një takim me Kryetarin e Serbisë, Slobodan Millosheviq, në Beograd, Robert Gillbard i kishte thënë atij se „ duke sulmuar popullsinë civile, në përpjekjet e tij për ta eliminuar UÇK-në, ai në të vërtetë po shëndrrohej në agjentin e UÇK-së për rekrutim“,⁴³² ndërsa Kryetari i Kosovës, deklaronte se „ Në Kosovë nuk mund të ketë luftë normale, por mund të ketë vetëm masakër. Serbët për dy ditë do të mund të na shkatërronin të gjithëve.“⁴³³

Në vazhden e aktiviteteve diplomatike, më 17 mars 1998 ministria e jashtme ruse, kishte marrë nismën për një zgjidhje politike për Kosovën. Ai e kishte bindur Millosheviqin që të merrte nismë lidhur me autonominë e Kosovës; të urdhëronte njësitë ushtarake të ktheheshin në kazerma; që personalisht të angazhohej për të filluar negociatat me liderin e krahut të moderuar të Kosovarëve, Ibrahim Rugovën dhe të pranonte vëzhguesit e OSBE-së.”⁴³⁴ Në frymën e qëndrimeve të Grupit të Kontaktit, më 18 mars 1998, i deleguari amerikan për çështje të Ballkanit ambasadori Geldbard, merr pëlqimin e Ibrahim Rugovës, për formimin e Grupit Negociator për dialog me Serbinë.⁴³⁵

⁴³¹ Sherafedin Berisha, www.pashtriku.org.

⁴³² Wesli K. Clark, Të bësh luftë moderne, gazeta ditore ZËRI, 2003, Prishtinë, fq.141.

⁴³³ Intervistë e Kryetarit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, në radio „Deutsche Wele“, 07.3.1998.

⁴³⁴ J.Primakov: Memoare, Jeta ime në politikën e lartë, fejon politik, “Zëri” 30 maj 2002, fq.9.)

⁴³⁵ Më 18 mars para gazetarëve, Ibrahim Rugova deklaroi: “Në bisedë me ambasadorin amerikan Geldbard, unë rikonfirmova zotimin tim të fuqishëm për dialog, si të vetmen mënyrë për zgjidhjen e problemeve të ngutshme në Kosovë.” “Për të qenë i suksesshëm dialogu”, - theksonte Rugova, “duhet të përfshihet patjetër këmbimi i hapur dhe i pakushtëzuar mes përfaqësuesve të zgjedhur të udhëheqjes së Kosovës dhe përfaqësuesve të presidentit Millosheviq, siç është bërë thirrje javën e kaluar në Londër nga ministrat e jashtëm të Grupit të Kontaktit”.

Edhe pse në Drenicë ishte gjendje lufte dhe vriteshin shqiptarët, LDK, e përkrahur edhe nga bashkësia ndërkombëtare, më 22 mars 1998 mbajti zgjedhjet “presidenciale dhe parlamentare” në Kosovë, ndërsa të nesërmen më 23 mars në Prishtinë nga grupi 3+3 në mes palës serbe dhe asaj të Kosovës, nënshkruhet aneksi për normalizimin e arsimit shqip në Kosovë.⁴³⁶

Më 24 mars 1998, LDK shpalli rezultatin e zgjedhjeve, ku ajo kishte fituar bindshëm në këto zgjedhje, në të cilat, sipas mediave me orientim për LDK-së, kanë votuar 88.71%, e elektoratit.⁴³⁷ Menjëherë pas zgjedhjeve, LDK-ja do të kumtojë listën prej 15 negociatorëve të Kosovës “G-15”, të cilët Rugova i quan si “Grup Këshilldhënësish”, për të përgatitur një platformë për bisedime me përfaqësuesit e Millosheviqit. Në listën e G-15-shit, me sugjerimin edhe të ambasadorit Geldbard u përfshinë: Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Edita Tahiri, Bujar Bukoshi, Rexhep Ismajli, Mark Krasniqi, Pajazit Nushi, Esat Stavileci, Adem Demaçi, Veton Surroi, Mahmut Bakalli, Hydajet Hyseni, Shkëlzen Maliqi, Bujar Dugolli dhe Blerim Shala.⁴³⁸

Sesioni i parë i G-15 u mbajt më 25 mars 1998, pikërisht një ditë kur kishte shpërthyer lufta në fshatin Gllogjan të Dukagjinit, në mes të forcave pushtuese serbe dhe UÇK-së. Në këtë takim të parë nuk u bisedua fare për strategjinë negociuese dhe fare pak u fol për luftën, e cila tashmë po hynte në muajin e dytë. Një rrëmujë e tillë, e shkaktuar nga Ibrahim Rugova, do të vazhdojë deri në fund të ekzistimit të G-15, deri në korrik të vitit 1998.⁴³⁹ Po atë ditë, më 25 mars 1998, Grupi i Kontaktit mban mbledhjen e radhës në Bon ku shqyrtohet situata në Kosovë, ndërkaq, më 26 mars, ambasadori amerikan Robert Geldbard së bashku me Jeremy Greenstock, Drejtor politik në Foreign Office të Anglisë, vizitojnë Prishtinën.

⁴³⁶ Grupi 3+3 që nënshkroi aneks marrëveshjen më 23 mars 1998, ishte vazhdimësi e bisedave të mëhershme në mes të Ibrahim Rugovës me Slobodan Millosheviqin, i përcaktuar qysh në marrëveshjen Millosheviq-Rugova më 1.09.1996dhe nuk kishte të bënte drejtpërdrejt me themelimin e grupit të ri negociatorë, që do të quhet G-15, edhe pse kemi të bëjmë me të njëjtit njerëz në krye të këtij grupi.

⁴³⁷ (QIK) Prishtinë, 24 mars 1998 Komisioni Republikani i Zgjedhjeve (KRZ), në një konferencë për gazetarë të mbajtur në orën 18.30, në të cilën u paraqitën disa nga të dhënat për rrjedhën e zgjedhjeve të 22 marsit. Në konferencë u bë e ditur se komisioni zgjedhor ka anuluar zgjedhjet në Fushë Kosovë, në të dy zonat zgjedhore, për shkak të gabimit të komisionit elektoral ku zgjedhjet do të përsëriten më 5 prill, ndërsa do të shqyrtohet edhe rezultati i një zone zgjedhore në Dragash. Nga të dhënat e përgjithësuara që u paraqitën, pa rezultatet nga Peja dhe Fushë Kosovë dhe një zonë në Dragash, del se në votime kanë marrë pjesë 88.71 për qind e elektoratit. Sipas rezultateve të deritashme, për Kryetarin Rugova kanë votuar 99.29 e zgjedhësve, ndërsa janë zgjedhur 89 deputetë, prej tyre 84 të LDK-së, 2 të PSHDK-së, njëri në koalicion me LDK-së, një i Lidhjes Qytetare të Kosovës, dhe nga një i PLK-së e i PAD-it, të dy në koalicion me LDK-në. Në konferencë përshtypjet e tij nga zgjedhjet e pardjeshme në Kosovë i paraqiti vëzhguesi nga Bolonja e Italisë, Simon Ginzberg, nga organizata "Kompania kundër dhunës në Kosovë".

⁴³⁸ Adem Demaçi, ndonëse nuk ishte pyetur fare, ishte kundër pjesëmarrjes në këtë grup, duke e quajtur këtë nismë si “mashtim të ri të Ibrahim Rugovës...”, ndërsa Hydajet Hyseni e Bujar Dugolli largohen nga ky grup me 13 maj 1998, në momentin kur merret vesh se pa dijen e “G-15” Ibrahim Rugova kishte vendosur të takohet me Millosheviqin më 15 maj në Beograd.

⁴³⁹ B. Shala- Vitet e Kosovës 1998-1999, Prishtinë 2000, f. 41

Grupi i Kontaktit ka kërkuar që sa më shpejt të fillojnë bisedimet Prishtinë-Beograd, për një “autonomi të gjerë dhe vetë administrim të mirëfillt të Kosovës”, ndërsa, Këshilli i Evropës, nxori një rezolutë, sipas së cilës “kërkohej fillimi i bisedimeve të menjëhershme të Serbisë - RFJ me shqiptarët për një autonomi të Kosovës në kuadër të RFJ-së”.⁴⁴⁰ Ibrahim Rugova, më 6 prill 1998 në një mbledhje të radhës të G-15, grupin G-15 e reduktoi në G-4, të cilët sipas tij duhej të përbënin Grupin e mirëfillt Negociator të Kosovës. Në G-4 ishin: Dr. Fehmi Agani, Mahmut Bakalli, Pajazit Nushi dhe Veton Surroi.⁴⁴¹

Në gjysmën e dytë të muajit prill, diplomatët e huaj që vizitonin shpesh Kosovën kishin hedhur idenë që negociatat me Serbinë të zhvilloheshin në dy faza. Më 25 prill 1998, vetëm katër ditë para mbajtjes së takimit të Grupit të Kontaktit në Romë, Umberto Vattani, sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Jashtme të Italisë qëndroi në Prishtinë dhe gjatë takimit me Ibrahim Rugovën zyrtarisht i propozoi këtij të fundit fillimin e menjëhershëm të negociatave me Beogradin, me ndërmjetësimin e shefit të Shoqatës: “Shën Exhidio”, Minsinjur Paglias.⁴⁴² Derisa në Prishtinë po bëheshin përgatitjet për negociata me Serbinë, lufta me shpejtësi po përhapej në shumë pjesë të Kosovës. Ushtria Çlirimtare e Kosovës, gjatë operacioneve ushtarake - policore serbe, me të gjitha njësitë e saj të organizuara ishte vënë në mbrojtje të popullatës shqiptare. Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në deklaratën Politike nr. 2. të datës 27 Prill 1998 lidhur me negociatat me Serbinë deklaroi, se: UÇK-ja pranon të marrë pjesë në bisedime me armikun me ndërmjetësimin e palës së tretë, ndërkombëtare të pranueshme, vetëm pasi të jenë larguar trupat e pushtuesit nga trojet shqiptare. Çdo lloj tjetër marrëveshjeje dhe pa praninë tonë, do të jetë e pavlefshme dhe e denueshme”.⁴⁴³

Më 9 maj 1998 nis një proces i ri përpjekjesh për fillimin e bisedimeve Beograd - Prishtinë. Atë ditë në Beograd, një delegacion amerikan në krye me diplomatin e njohur Riçard Holbrook, takohet me Sllobodan Millosheviqin, ndërkaq më 10 maj ky delegacion vjen në Prishtinë dhe takohet Ibrahim Rugovën.

⁴⁴⁰ Po aty.

⁴⁴¹ Po aty.

⁴⁴² Po aty.

⁴⁴³ Deklaratë nr. 2 e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, 27 prill 1998

Gjatë tri ditëve në vijim, 10 – 13 maj, Holbrook dhe Geldbard, zhvillojnë një turne diplomatik në relacionin Beograd – Tiranë – Prishtinë – Shkup dhe anasjelltas. Më 12 maj, Ibrahim Rugova ka pranuar para Holbrookut që të takohet me Slobodan Millosheviqin më 15 maj në Beograd.⁴⁴⁴ Më 15 maj 1998 Ibrahim Rugova ka udhëtuar për në Beograd me grupin G-4 të, Dr. Fehmi Aganin, Mahmut Bakallin, Pajazit Nushin dhe Veton Surroin. Ky takim do të zhvillohet në selinë presidenciale të Millosheviqit në Beograd, pa ndërmjetësimin ndërkombëtar, pa plan të qartë, madje pa pika të rendit të ditës.⁴⁴⁵ Po atë ditë derisa po mbahej takimi Millosheviq – Rugova në Beograd, forcat serbe në Kosovë kishin ndërmarrë një operacion të gjerë luftarak dhe me këtë rast vranë e masakruan dhjetra shqiptarë të pafajshëm. Pas takimit të 15 majit filluan përgatitjet për mbajtjen e takimit të radhës Prishtinë – Beograd. Siç dihet, faktori UÇK, ishte injoruar plotësisht nga Ibrahim Rugova, edhe pse përhapja e luftës kishte marrë një dinamikë të përshpejtuar. Ai nuk e kishte kuptuar, në të vërtetë ai nuk donte ta kuptonte, se zgjerimi i luftës në Kosovë e bënte të pakuptimt dhe absurde tërë procesin e negociatave me Serbinë.

Më 22 maj 1998 në Prishtinë, në ambientet e selisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës u mbajt takim i radhës në mes të palës serbe, të prirë nga Nënkryetari i Qeverisë së RFJ-së Nikola Shainoviq, i përbërë nga nënkryetari i qeverisë së Serbisë Ratko Markoviq, Nënkryetari i Partisë Radikale të Sheshelit, Tomisllav Nikoliq, Radoslav Rajkoviq dhe Lepasava Miliçeviq si dhe palës shqiptare i prirë nga Dr. Fehmi Agani ku bënte pjesë: Mahmut Bakalli, Pajazit Nushi, Veton Surroi, Bajram Kelmendi dhe Blerim Shala. Ishte i propozuar që pjesë e delegacionit shqiptar të jetë edhe dr. Esat Stavileci, por ai nuk ka pranuar të jetë pjesë e këtij takimi të dëmshëm për Kosovën.⁴⁴⁶ Takimi u mbajt pa ndërmjetësimin e palës ndërkombëtare edhe pse atë ditë në Prishtinë ishte ambasadori amerikan Christopher Hill dhe Brian Donnelly, ambasadori i Anglisë në Beograd.

⁴⁴⁴ Për këtë vendim sensacional dhe të pabesueshëm të Rugovës nuk kishte ditur as G-15, ata e morën vesh nga mediat perëndimore. Ibrahim Rugova ka pranuar të takohet me Millosheviqin pa i plotësuar kërkesat e Grupit të Kontaktit, të Mbledhjes së Londrës, të 9 marsit 1998 për tërheqjen e njësive speciale serbe nga vendbanimet shqiptare ku zhvilloheshin luftimet dhe për ndërmjetësimin e Misionit të Filipe Gonsalesit në bisedimet Beograd – Prishtinë. B.Shala, Vitet e Kosovës 1998 – 1999, Prishtinë 2000, fq.54-60.

⁴⁴⁵ Adnan Merovci - Shef i protokollit dhe i sigurisë së Ibrahim Rugovës, thotë: se për në Beograd kemi udhëtuar me tri vetura dhe një ka qenë si përcjellje. Ne shkuam deri në hyrje të Beogradit, aty na priti një makinë e shërbimeve serbe dhe na shoqëroi gjatë tërë kohës.”Libri “Pa protokoll-Bisedë me Adnan Merovcin”, Prishtinë, 2003, fq. 78

⁴⁴⁶ “Bota Sot” 24 maj 1998 faqe. 5

Ambasadori amerikan Hill, në kohën kur po zhvilloheshin bisedimet me palën serbe, ka qenë në ambientet e selisë së LDK-së, për të krijuar kështu, për palën tonë dhe mediat shqiptare, një përshtypje se, megjithatë, negociatat po zhvillohen me ndërmjetësimin e diplomacisë amerikane.⁴⁴⁷, ndërsa Ibrahim Rugova iu kishte përgjigjur se nuk ka dyshim që negociatorët kosovarë do të mbrojnë si duhet interesat e Kosovës.⁴⁴⁸

Zhvillimet dramatike në zonat e luftës, përveç që zhvlerësuan procesin e nisur negociues me takimin Millosheviq-Rugova në Beograd më 15 maj, treguan qartë se, këto bisedime nuk do t'i sillnin asgjë të mirë Kosovës. Për më tepër, vrasjet, ekzekutimet dhe masakrimet në mënyrë barbare të shqiptarëve në fshatrat e Dukagjinit dhe të Drenicës nga forcat policore-ushtarake të Millosheviqit, e zvogluan mundësinë e vazhdimit të negociatave me Beogradin, në formën që nisi në Prishtinë, më 22 maj 1998. Tani një forcë e re ushtarake, UÇK, po vazhdonte opcionin e fundit të politikës, për bërjen e shtetit të Kosovë, pra tani vetëm lufta çlirimtare, ishte përgjigjia më e mirë që do të merrte Millosheviqi në raport me shqiptarët e Kosovës.

⁴⁴⁷ B.Shala: Vitet e Kosovës 1998-1999, Prishtinë 2000, faqe. 68-71.

⁴⁴⁸ Blerim Shala, Ish-zëdhënësi i G-4, përkujton se pas përfundimit të takimit, me palën serbe, në dhomën e Ibrahim Rugovës në Selinë e LDK-së së bashku me Veton Surroi, kanë pasur një takim me ambasadorët Hill dhe Brian Donnelly, të cilët i kanë njoftuar për rrjedhën dhe atmosferën e takimit me delegacionin serb. Ndërkohë, thotë z.Shala "Danelly na informoi se kishte kaluar një kohë të gjatë me dr. Rugovën, në rezidencën e tij private, në lagjen e Velanisë, duke pirë verë të zezë dhe duke ngrënë djath Sharri. "Unë e pyeta, se cila është platforma negociatore e delegacionit tuaj dhe çka pritet të arrihet në takimin e sotëm..."", na tha Danelly.

3). Roli i LPK-së në luftën e UÇK-së 1998 -1999

Më 5, 6 e 7 mars 1998, forcat barbare serbe sulmuan fshatin Prekaz, duke përdorur gjithë arsenalin ushtarak modern, kundër familjes së Shaban Jasharit. Pas një lufte tre ditore të pabarabart, forcat serbe vranë mizorisht 56 anëtarë të familjes Jashari, në mesin e të cilëve gra, pleq dhe fëmijë, si dhe Komandanti legjendar i UÇK-së Adem Jashari. Pas këtyre ngjarjeve, ndërhyri diplomacia ndërkombëtare, e cila kërkojë ndërprerjen e dhunës së armatosur për t'i lënë rrugë zgjidhjes së problemeve përmes dialogut në mes palëve.

Grupi i Kontaktit kërkon „nga presidenti Slobodan Milosheviq të ndërmarrë hapa të shpejtë dhe efektivë për të ndërprerë dhunën dhe të angazhohet vendosmërisht për të gjetur një zgjidhje politike të çështjes së Kosovës përmes dialogut. Në veçanti brenda 10 ditëve ai duhet: - të tërheqë njësitë e policisë speciale dhe të ndërprejë veprimet e forcave të drejtuara kundër popullsisë civile, - që të deklarohet vetë publikisht mbi fillimin e procesit të dialogut në pajtim me paragrafin 10, me udhëheqjen e komunitetit shqiptar të Kosovës. Në konkluzat e Grupit të Kontaktit, vijëzohet qartë kundërshtimi për pavarësinë e Kosovës, ndërkohë që RSFJ-së gjegjësisht Serbisë po i ofrohej një shans shtesë për t'iu shmangur sanksioneve ekonomike të përgatitura prej kohësh.⁴⁴⁹

Faktori politik shqiptar, pa asnjë vërejtje i mbështet konkluzionet e Grupit të Kontaktit, ndërsa po atë ditë, më 9.03.1998, kur Grupi i Kontaktit ishte mbledhur në Londër, reagon SHQ i UÇK-së përmes Komunikatës nr.45, në të cilën komunikatë thuhet se “Shtabi Qëndror i UÇK-së u bën me dije forcave politike në botë dhe institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare, në veçanti Grupit të Kontaktit që takohet sot në Londër, si UE-së, OKB-së e shteteve demokratike, se UÇK dhe populli shqiptar do të vazhdojnë luftën çlirimtare, mbi bazën e vullnetit historik për pavarësi. Nga qendrat në botë kërkohet të pranojnë shtetin e Kosovës, ndërsa pushtuesin serb ta ndëshkojnë në bazë të konventave ndërkombëtare për luftën, mbasi dëshmohet lufta e tij fashiste për të zhdukur popullin shqiptar.”⁴⁵⁰

⁴⁴⁹ Po aty.

⁴⁵⁰ Komunikata nr. 45, e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

LPK, Dega Jashtë Vëndit, pas ngjarjes në Prekaz, më 6 mars organizon protesta masive në Zurich, Geneve dhe Bern të Zvicrës, por edhe në shtetet tjera Evropiane dhe më gjerë. Në këto protesta, ku ishin shumë bashkëatdhetar të ardhur nga të gjitha vendet, të rinjët, shumica të ikur nga dhuna dhe terrori i pushtuesit serb, kërkonin që menjëherë të ktheheshin në Kosovë, për t'iu bashkangjitur radhëve të UÇK-së.

Pa mbajtjes së protestës së Zurichut, ku ishin shumë pjesëmarrës, Kryesia e LPK-së, D.J.V, kishte mbajtur menjëherë mbledhjen e saj urgjente. LPK nga kjo mbledhje kishte lëshuar një thirrje drejtuar popullit shqiptar dhe një deklaratë politike, në të cilat shpjegohej shpërthimi i dhunës terroriste dhe i masakrave. Ato treguan me fakte diagonalen e konflikteve të armatosura.

Me to, pra në thirrje dhe deklaratë, LPK, ftone popullin për bashkim, unitet e heroizëm, duke i treguar rrugën e bashkimit nën flamurin e përbashkët të lirisë të udhëhequr nga UÇK-ja. Natyrisht, tregoheshin edhe detyrat e çdo subjekti përballë armikut dhe shprehej mendimi për bashkimin politik e aksional në luftën çlirimtare. Këto materiale u shpërndanë edhe në Kosovë.⁴⁵¹Në thirrjen e LPK-së, të datës 5 mars, thuhet se lufta e armatosur e popullit tonë për liri po rritet e zgjerohet. UÇK është bërë shpresa e kombit dhe pengesa kryesore ushtarake për okupatorët. UÇK, lindi nga populli, u rrit në beteja, po kalitet në vështirësi dhe po zgjerohet çdokund në trojet e pushtuara. Masakra e Drenicës kundër civilëve të pa mbrojtur ka lënduar zemrën e çdo shqiptari. Armiku po vazhdon goditjet e tjera kundër UÇK-së me aviacion, altileri, tanksa dhe mjete të blinduara.

Duke u nisur nga kërkesat e SHP të UÇK-së për mobilizim, LPK thërret:

- *Të gjithë anëtarët dhe simpatizantët e vet në trojet e pushtuara, që të hyjnë dhe plotësojnë njësitë luftarake të UÇK-së.*
- *Të ndihmohet formimi, rritja dhe zgjerimi i njësisve të UÇK-së në bashkëveprim dhe sipas komandës së ushtrisë.*
- *Të ndihmojmë furnizimin e UÇK-së me informacion, me armatime e informacione , me pajisje , mjete të transportit e vezhgimit, me ndihmë mjekësore, me ushqime e veshëmbathje.*

⁴⁵¹ Komunikata dhe thirrje të LPK-së, 05, 06 dhe 8 mars 1998, Zvicër.

- *Të luftohet propaganda e agjentëve të pushtuesit e lansuar në popull se goja përgjegjësinë për masakrat e forcave serbe e paska UÇK.*
- *Të injorohen frikacakët dhe të gjith ata që mbjellin dyshime e panik në popull. Lufta që kemi nisur është e drejtë, ajo është luftë për çlirim. Jemi në të drejtën tonë, në tokën tonë, dhe do të qëndrojmë këtu. Ata që duhet të shkojnë janë trupat agresive të okupatorit të ardhur në Kosovë. Të bashkuar politikisht e ushtarakisht këtë luftë do ta fitojmë.*⁴⁵²

Në këtë Mbledhje ishte marrë vendim urgjent që një grup i udhëheqësve të LPK-së, të udhëtojnë menjëherë për në Kosovë me qëllim të zgjerimit të radhëve të UÇK-së dhe propagandimit të nevojës së Luftës Çlirimtare dhe të armatosur.⁴⁵³

Më 07 mars, nga aeroporti i Zurichut u nisën fillimisht për në Tiranë e pastaj për të hyrë në Kosovë 30 veprimtarë e udhëheqës të LPK-së si: Fehmi e Xhevë Lladrovci, Ismet Jashari, Agim Bajrami, Hashim Thaçi, Fatmir Limaj, Shukri Buja, Haxhi Shala, Sami Lushtaku, etj. Ky grup do të takohet edhe me veprimtarë dhe udhëheqës të LPK-së, të cilët edhe më herët ishin në Shqipëri dhe pas konsultimeve paraprake ata do të nisen drejt Vlahnës, fshat kufitar i Shqipërisë, prej nga do të udhëtojnë për në Kosovë për t'iu bashkangjitur radhëve të UÇK-së.⁴⁵⁴

Kryesia e LPK-së poashtu kishte marrë vendim që, të zhvendosej nga qendrat Evropiane, Zvicër, Gjermani, Suedi, SHBA etj, dhe të vendosej në Tiranë, prej nga do të orientonin më lehtë luftën çlirimtare. Në mars 1998, Kryesia e LPK-së, u vendos në selinë e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë dhe menjëherë vuri kontakte me institucionet shtetërore të Shqipërisë.⁴⁵⁵ Për shkak të gjendjes së krijuar në Kosovë dhe fillimit të luftës së armatosur, rreth 1.500 të rinjë, kryesisht nga Drenica, kishin ardhur në Tropojë për t'u armatosur dhe për t'iu bashkangjitur UÇK-së. Kryesia e LPK-së e cakton Ibrahim Kelmendin dhe Gafurr Elshanin që të takohet me grupin e të rinjëve që kishin ardhur në Tropojë, të cilët ishin në gjendje të mjerueshme. Vrasja e Adem Jasharit dhe fillimi i luftës së armatosur e kishte nxënë LPK-në jo të përgatitur mirë në aspektin financiar dhe logjistik. Deri në këtë kohë, LPK, ishte përgatitur për luftë guerile dhe tani ky fluks i të rinjëve që kërkonin armatim i sillte probleme në terren.

⁴⁵² Komunikatë e LPK-së, 05 mars 1998, Prishtinë

⁴⁵³ Dokument i LPK-së, Akrivi i LPK-së, mars 1998, Prishtinë.

⁴⁵⁴ Isuf Sherifi, Hyrje për në Agim, monografi, SHKSH Mëmëdheu, Zvicër, fq.151.

⁴⁵⁵ Ibrahim Kelmendi, deklaratë, 04.2.2009, Prishtinë.

Policia e Shqipërisë, në rrethin e Tropojës kërkonte nga vullnetarët e UÇK-së që të paraqiten si refugjat, ndërsa ata kërkojnë të kenë takim me shefin e zyrës së Kosovës në Shqipëri, Ilaz Ramajlin, i cili nuk i pranon në takim. Përfaqësuesi i LPK-së, Ibrahim Kelmendi, merr kontakte me shefin e SHIK-ut, z. Fatos Klosi dhe Kryeministrin e Shqipërisë z. Fatos Nano dhe arrin që grupin e vullnetarëve që kishin ardhur për armatim në Tropojë, përmes njësisë speciale të policisë së Shqipërisë „ Brisku“ ta ndihmoj me ushqim dhe më vonë edhe paisjen me armatim.⁴⁵⁶ Shumë veprimtarë dhe udhëheqës të lartë të LPK-së si Emrush Xhemajli, Gafurr Elshani, Adem Grabovci, etj, tanimë ndodheshin në radhët e UÇK-së në Kosovë.

Anëtarët e LPK-së, shumica e të cilëve tanimë ishin në radhët e UÇK-së, me punën dhe sakrificën e tyre, u tregonin popullit të Kosovës se „ lufta jonë është e drejtë dhe se ajo medoemos do të triumfojë, se ajo nuk duhet të ndalet, por duhet të vazhdojë dhe të rritet deri në çlirimin e vendit". Veprimtarët e saj ishin kudo në mesin e popullit: me studentë, nëpër fshatra e qytete dhe në vijat e frontit, me fjalë të tjera kudo që e kërkonte nevoja. Në Prill, 1998 në Zvicër, mbahet Mbledhja e V-të e Përgjithshme e Degës së LPK-së, e cila tani kishte kompetenca edhe për LPK-në brenda vendit. Në Kosovë tashmë ishte luftë dhe nuk kishte mundësi të mbahej mbledhje e gjerë. Në Mbledhjen e Degës u konfirmua përcaktimi i LPK-së për luftën e armatosur deri në çlirimin e vendit dhe fuqizimin e UÇK-së. Pas Mbledhjes dolën organet e LPK-së. Kryetar i Degës së LPK-së u zgjodh Bedri Islami.⁴⁵⁷

Gjatë muajve shkurt, maj e qershor, me organizimin e LPK-së, përkatësisht të sektorit të veçantë të lidhjes, shumë veprimtarë të saj me përvojë iu bashkangjitën UÇK-së. Ndër ta ishin: Fehmi e Xhevë Lladrovci, Ismet Jashari, Agim Bajrami, Sejdi Sejdiu, Emrush Xhemajli, Hashim Thaqi, Ramush Haradinaj, Azem Sylja, Gafurr Elshani, Adem Grabovci, Fatmir Limaj, Shukri Buja, Haxhi Shala, Sabri Kiqmari, Sami Lushtaku, Selim Krasniqi, Metush Zenuni, Avdi Muja, Halil Çadraku, Agron Gërvalla, Imri Ilazi, Demir Demiri, Cenë Aliqkaj, Mjuharrem Dina, Reshat Salihaj, etj. Këta veprimtar të hershëm të radhëve të LPK-së, të cilët kishin dhënë sa e sa herë provimin e tyre në aksione e punë konkrete për Kosovën, tani po merrnin edhe një detyrë të re mbi supe.

⁴⁵⁶ Po aty.

⁴⁵⁷ Emrush Xhemajli, vepra e cituar, fq. 19.

Ata ishin bashkangjitur shokëve të mëhershëm të LPK-së që kishin ardhur nga Zvicra, Gjermania, Suedia e vendet tjera perëndimore, e të cilët tanimë udhëhiqnin njësitet dhe brigadat e UÇK-së në Kosovë dhe tani edhe de fakto po bëheshin anëtar të asaj ushtrie të cilën nga viti 1993, e kishin pasur ideal të jetës dhe për të cilën s'kishin pushuar së punuari, por edhe duke propaganduar nëpër sa e sa tubime, sa e sa ndeja të ndryshme me bashkëatdhetarët tanë, etj. Tani që lufta kishte filluar, kjo më nuk ishte e mjaftueshme, por duhej punë konkrete organizative e secilit për zgjerimin e radhëve të UÇK-së në terren dhe për t'i rrokur armët për çlirimin e vendin nga dhuna dhe terrori qindëvjeçar serb.⁴⁵⁸

Pjesa tjetër e LPK-së që mbeti jasht vendit, si : Fazli Velu, Ali Ahmeti, Xhavit Haliti, Jashar Salihu, Bardhyl Mahmuti, Ramadan Avdiu, Sejdi Gega, Rexhë Ibërdemaj, Agush Buja, Ramiz Lladrovci, Rexhep Halimi, Ragip Shala, Sahit Krasniqi etj, u bënë mbështetja kryesore politike, diplomatike, financiare dhe logjistike për UÇK-në. Kësaj pjese të LPK-së tani i mbeti barra e organizimit të tubimeve me bashkëatdhetarë, të mbledhjes së ndihmave financiare e logjistike për UÇK-në, por edhe për orientimin dhe organizimin e atyre të rinjëve të cilët ishin të interesuar për të ardhur në luftë në Kosovë.⁴⁵⁹

Gjatë muajve prill - gusht 1998, Kryesia e LPK-së zhvillon takime të shumta zyrtare me institucionet Shqipërisë, si: me Kryetarin e Shqipërisë, z. Rexhep Mejdani, Kryeministrin, z. Fatos Nanon dhe Shefin e SHIK-ut z. Fatos Klosin. Nga ana e LPK-së merrnin pjesë: Xhavit Haliti, Bedri Islami, Ibrahim Kelmendi dhe Ramiz Lladrovci, të cilët kërkonin mbështetjen e shtetit Shqiptar për luftën çlirimtare në Kosovë. Megjithëse Institucionet e Shqipërisë, për arsye diplomatike nuk guxonin të deklaroheshin hapur në mbështetje të UÇK-së, ato u morën vesh që tani e tutje kontaktet me Kryesinë e LPK-së dhe me UÇK-në t'i mbajnë përmes Xhavit Halitit.⁴⁶⁰ Në Kosovë, luftimet po merrnin përmasa të mëdha. Radhët e UÇK-së shtoheshin për çdo ditë e më shumë. Udhëheqësit e LPK-së, të cilët tani ishin zhveshur nga petku i një subjekti politik dhe ishin bërë një me të gjithë ushtarët e UÇK-së, po përballeshin me sfids të mëdha.

⁴⁵⁸ Po aty.

⁴⁵⁹ Po aty.

⁴⁶⁰ Ibrahim Kelmendi, intervistë dhënë autorit, 04 shkurt 2009.

Në një rën anë kishin popullin e pa mbrojtur, të ikur e të uriotur maleve të Kosovës, kishin poashtu gatishmërinë e të rinjëve, shumica studentë, të cilët vinin qdo dite dhe kërkonin armë për të luftuar. Në anën tjetër kishin forcat e mëdha ushtarake e policore, çetnike serbe, të udhëhequra nga Arkani e Shesheli, të cilët kërkonin dhe planifikonin zhdukjen e shqiptareve dhe ndjekjen e tyre pertej Bjeshkëve të Nemuna.

Kryesia e LPK-së kishte ngarkuar, Ali Ahmetin dhe Ibrahim Kelmendin për sistemimin e ushtarakëve të cilët kishin ardhur në Tiranë dhe ishin të interesuar të hynin në Kosovë. Në mesin e tyre ishte: Naim Maloku, Bislim Zyrapi, Fadil Demiri, etj, të cilët kishin zgjedhur Naim Malokun t'i përfaqësoj ata në takim me SH.Q. të UÇK-së.⁴⁶¹

Gjatë kohës sa Kryesia e LPK-së qëndroi në Shqipëri, në lokalet e Shoqatës së Shkrimtarëve të Shqipërisë u morën vendime të rëndësishme që ndikuan në rritjen e furnizimit të UÇK-së me armë, veshmbathje dhe barëra. Për këtë qëllim u bënë shumë takime me grupet e mobilizimit dhe ato logjistike të furnizimit. Po në këtë kohë me vendimin e Kryesisë së LPK-së blehet sistemi i parë i telefonisë satelitore për nevojat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Telefonat satelitor u shpërndanë në zonat aktive në këtë kohë.⁴⁶²

3. a). Qeveria Bukoshi dhe FARK-u

Politika pacifiste e disa subjekteve politike shqiptare në Kosovë, e cila udhëhiqej nga Ibrahim Rugova, LDK, Mark Krasniqi, PSHDK dhe Gjergj Dedaj PLK, të cilët gati pothuajse sa politika dhe mjetet e informimit serb, edhe këta bënë propagandë kundër luftëtarëve të lirisë. Ata ishin strukturuar në zyrat e tyre në Prishtinë dhe ftonin popullin që të mos i bashkohet UÇK-së, sepse, sipas tyre këta janë marksistë - leninist, enveristë dhe dorë e zgjatur e Serbisë, prandaj rrjedhimisht janë edhe kundër Kosovës dhe intersave të saj. Kjo politikë dhe propagandë e tyre i ka shkaktuar dëme tepër të mëdha UÇK-së dhe rekrutimit të shumë të rinjëve në radhët e saj.

⁴⁶¹ Po aty.

⁴⁶² Emrush Xhemajli, vepra e cituar, fq.20.

Qeveria e Bujar Bukoshit në mërgim, dy herë radhazi kishte dështuar me ministrinë e saj të mbrojtjes. Më 1991, Ministër i Mbrojtjes i Kosovës ishte caktuar, Anton Kolaj, i cili në tetor – nëntor të këtij viti kishte bërë organizimin e shkruarjes për stërvitje ushtarake në Shqipëri, por grupi ishte dekonspiruar dhe ishte detyrar të punoj i pavarur nga qeveria, ndërsa herën e dytë, më 1993, kur ishte caktuar Hajzer Hajzeraj⁴⁶³, i cili në valën e arrestimeve të këtij viti ishte arrestuar, bashkë me Haxhi Feratin, Adem Salihajn etj.⁴⁶⁴ Tanimë që lufta veq kishte filluar, Bujar Bukoshi nuk prante bashkëpunimin me UÇK-në e as të bashkonte fondin e saj me fondin e luftës „Vendlindja Thërret”.

LPK, për shumë vite rresht i kishte bërë thirrje Qeverisë Bukoshi, për përkrahje financiare për organizimin e njësiteve ushtarake në Kosovë, por ajo e kishte injoruar dhe nënqmuar forcën e LPK-së, ndërsa tani, kishte filluar ta formonte një ushtri tjetër, të quajtur FARK, që udhëhiqje nga disa eprorë shqiptar të ish - Jugosllavisë në Klubet e Zvicrës dhe të Gjermanisë, por që shtabin e kishin në Laprakë të Tiranës në Shqipëri. „Përderisa UÇK-ja çdo ditë përballej me forca të shumta të armikut, pjesa dërmuese e ushtarakëve të FARK-ut, agjintonin kundër saj. Qeveria, kishte caktuar Ministër të Mbrojtjes Ahmet Krasniqin, por ushtarakët nuk e pranonin atë për udhëheqës dhe si pasojë ishin shkaktuar shumë përçarje në mes të Qeverisë, UÇK-së dhe ushtarakëve që ishin të interesuar të hynin dhe të luftonin në Kosovë.”⁴⁶⁵ Gjendja në Shqipërinë e Veriut, ishte shumë e ndërlikuar. Në një nga kampet e Tropojës, qëndronin të fshehura disa njësi ushtarake të FARK-ut. Këta ushtarë dhe ushtarak, ishin besnik të Bujar Bukoshit dhe Ministrit të tij të Mbrojtjes, Ahmet Krasniqi. UÇK, kishte bërë shpeshherë përpjekje për bashkimin e forcave, por FARK-u kërkonte nga UÇK që të bëhej „ Ushtira e Republikës së Kosovës”.⁴⁶⁶ Në Kosovë, Tahir Zemaj, me njësitet e FARK-ut, operonte në rajonin e Dukagjinit, por ai nuk i përfillte dekretet e SH.O të Dukagjinit dhe kërkonte të dinte përbërjen e SH.P të UÇK-së.

⁴⁶³ Intervistë e Edita Tahirit, ish – sekretare e LDK-së për Marrëdhënie me jashtë. Libri I lirisë, Prishtinë 2003, f.281 -219.

⁴⁶⁴ Zëri i Kosovës, shtator 1993, f.1.

⁴⁶⁵ Ibrahim Kelmendi, deklarata e cituar, shkurt 2009, Prishtinë.

⁴⁶⁶ Tim Judah, Kosova, lufta dhe hakmarrja, prishtinë 2002, f. 215-216.

Ushtria e Tahir Zemajt një pjesë të armëve të rënda i la rrugëve, një pjesë ia dorëzoi shtabit të Izniqit, ndërsa pjesën tjetër e la në bunkerat e kazermës së saj. Pas armatimit, FARK në kazermën e saj la edhe mijëra kg. miell, tre ushtar të plagosur të cilët i zuri policia serbe, mjete medicinale etj.⁴⁶⁷ Kryeministri i Kosovës, Bujar Bukoshi mendonte ta merrte flamurin e luftës në Kosovë, tani kur lufta në Kosovë veq kishte filluar dhe UÇK-ja kishte dhënë me dhjetëra dëshmorë të saj. Por si duket ky nuk ishte qëllimi dhe misioni i Qeverisë së Bukoshit dhe i atyre që e përkrahnin atë në Kosovë. Ata më shumë se t'a udhëheqnin, dëshironin t'a pengonin luftën çlirimtare që kishte filluar në Kosovë.

Përkundër përpjekjeve të FARK-ut për të penguar gjatë tërë kohës së luftës, si dhe përkundër disa devijimeve dhe ndërskamcave edhe nga radhët e LPK-së, lufta tanimë kishte marrë kahje jashtë partiake, jashtë grupore e klanore.

Atë s'kishte më kush ta pengonte. Ajo tanimë ishte bërë luftë gjithëpopullore për çlirim nga armiku i egër serbomadhi dhe të kota ishin përpjekjet e atyre që mundoheshin të nxirrnin pengesa e të përfitonin në emër të luftës.⁴⁶⁸ Në fund të fundit, FARK-u nuk qe në gjendje të ushtronte ndonjë ndikim në rrjedhën e ngjarjeve të luftës në Kosovë. Duke e parë gjendjen reale në terren, shumë prej atyre pak njerëzve që bënë pjesë në njësitet e FARK-ut, me të hyrë në Kosovë, u bashkuan me UÇK-në dhe u mirëpritën nga bashkëluftëtarët, sepse shumica e tyre, si ish – oficer të ushtrisë Jugosllave, kishin njohuri dhe aftësi të specializuara.⁴⁶⁹

⁴⁶⁷ Fitnete Ramosaj, material në dorëshkrim, marrë në arkivin e LPK-së, Zvicër.

⁴⁶⁸ Po aty.

⁴⁶⁹ Tim Judah, Kosova, lufta dhe hakmarrja, Prishtinë, 2002, f. 216.

3. b). Ekipi diplomatik i LPK-së

Me zgjerimin e aksioneve të armatosura të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përveç ndihmës logjistike për UÇK- në, ishte e domosdoshme edhe sqarimi i diplomacisë dhe opinionit ndërkombëtar me qëllimet, legjitimitetin dhe karakterin çlirimtar të luftës sonë. Kështu, me direktivat e Drejtorisë Politike të UÇK-së, veprimtar dhe udhëheqës të LPK-së, filluar kontaktet, së pari me gazetarë të agjencive dhe medimeve më të mëdha informative botërore. Në kuadër të Drejtorisë Politike është formuar Grupi Politik i UÇK-së për marrëdhënie me jashtë. Fillimisht në atë grup kanë qenë Xhavit Haliti, Bardhyl Mahmuti dhe Ramadan Avdiu. Nga viti 1997, grupi politik i UÇK-së, ka filluar të organizojë konferenca për shtyp, së pari në selinë e OKB-së në Gjenevë e pastaj konferenca kemi organizuar edhe në shumë qendra, si po praktikohet të thuhet, të vendosjes.⁴⁷⁰ Me shtimin e volumit të punës grupi është zgjeruar dhe është përbërë nga: Bardhyl Mahmuti, Ramadan Avdiu, Jashar Salihu, Sabri Kiçmari, Pleurat Sejdiu, Bilall Sherifi, Mujë Rugova, Rexhë Ibërdemaj dhe Agush Buja. Deri në fund të luftës ky grup ka bërë një aktivitet mjaft intenziv si në sferën diplomatike ashtu edhe në atë mediatike.

Grupi politik i LPK- UÇK-së, ka organizuar 73 konferenca për shtyp me qëllim të informimit të opinionit ndërkombëtar në Gjenevë, Bruksel, Londër, Vjenë, Paris, Bon, Berlin Neë York. Ka pasur me qindra intervista, deklarata në mediumet më të fuqishme botërore, nga ana e përfaqësuesve të këtij grupi. Në anën tjetër po ashtu janë vendosur kontakte dhe janë mbajtur takime mjaft të rëndësishme me përfaqësuesit e qeverive të shumicës së vendeve të Bashkimit Evropian, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe me përfaqësuesit e mekanizmave ndërkombëtar të BE, OKB, OSBE dhe NATO. Takimi i parë- më i rëndësishmi- është bërë me ndërmjetësimin e Xhavit Halitit, i cili ishte si të thuash boshti kurrizor në funksionimin e UÇK-së. Takimi është zhvilluar me një delegacion të SHBA-ve në kuadër të të cilit ishte një i dërguar i posaçëm i presidentit amerikan. UÇK-ja ka qenë e përfaqësuar nga Bardhyl Mahmuti dhe Ramadan Avdiu.⁴⁷¹

⁴⁷⁰ Ramadan Avdiu, Intervistë në Epoka e Re,

⁴⁷¹ Po aty.

Ky takim më tepër ka pasur karakter të njohjes me qëllimet, platformën dhe me mendimin politik të UÇK-së. Në bisedë, e cila ka zgjatur më shumë se katër orë, grupi politik e ka sqaruar dhe justifikuar para diplomatëve ndërkombëtar në detaje luftën çlirimtare, si dhe ka bërë të qarta qëllimet UÇK-së e të popullit shqiptar dhe ka shprehur vendosmërinë e shkuarjes deri në fund. Ky takim i ka hapur rrugën takimeve të tjera me ambasadorët Gellbard dhe Holbrouke, të cilat janë realizuar dhjetë ditë pas takimit të parë, dhe pastaj kemi filluar fushatën diplomatike nëpër të gjitha kryeqytetet e vendeve të Evropës Perëndimore. Me një fjalë, ky grup ka funksionuar sikur të ishte ministri e punëve të jashtme e një shteti me përvojë në diplomaci dhe në arenën ndërkombëtare. Deri në përfundim të luftës, grupi politik i emëruar nga SHP i UÇK-së, zhvillonte takime e biseda me zyrat ndërkombëtare në Zvicër, në Gjermani, Austri, Belgjikë, Skandinavi dhe në SHBA, duke e informuar opinionin botërorë për luftën e drejtë çlirimtare që po bënte UÇK-ja kundër forcave serbe në Kosovë. Veprimtarët e LPK-së duhej të përballëshin me punë kolosale.

Duheshin ngritur struktura të reja ushtarake, duhej kaluar në Zona të reja Operative, duhej stërvitur ushtarët, duhej rregulluar strehimi, ushqimi, krijimi i spitaleve ushtarake etj, etj.

4). Qëndrimi i LPK-së për Marrëveshjen e Rambujesë

Siç dihet, pas masakrës së Reçakut më 15 janar 1999, ku serbët masakruan dhjetëra gra, fëmijë e pleq, Bashkësia Ndërkombëtare dhe NATO-ja ende ngurrnin për të vepruar ushtarakisht dhe ende nuk ishte e vendosur kundrejt barbarive serbe.⁴⁷² Pas kësaj masakre ajo më në fund u bind se çështja e Kosovës do zgjidhje politike dhe filloi t'i intesifikojë përpjekjet e saj për zgjidhjen e problemit të Kosovës, ndërsa kulminacioni i këtyre përpjekjeve do të jetë organizimi i Konferencës së Rambujesë.⁴⁷³

Më 6 shkurt 1999, pas një sërë përgatitjesh, filloi në Rambuje afër Parisit Konferenca e Paqës. Delegacioni shqiptar prej 16 vetash përfshinte udhëheqësin e moderuar Ibrahim Rugovë, gazetarin Veton Surroi, Akademikun Rexhep Qosja dhe delegacionin e UÇK-së.

⁴⁷² Eesli K. Clark, vepra e cituar, fq. 446.

⁴⁷³ Shkelzen Gashi, Marrëveshja për paqe të përkohshme, Interpress R. Company, Prishtinë, 2004, f. 258.

Delegatët zgjodhën Kryetar, Drejtorin e Drejtorisë politike të UÇK-së, 29 vjeçarin Hashim Thaçi. Zgjedhja e Thaçit për Kryetar të delegacionit, pasqyronte rënien e vazhdueshme të Kryetarit Ibrahim Rugova⁴⁷⁴. Baza e këtyre negociatave ishte një propozim, i cili po qarkullonte disa muaj më parë, i njohur si „Plani i Hillit“, i emëruar kështu sipas ambasadorit të SHBA-së në Maqedoni Cristofer Hill. Ky plan përmbante një tërësi të detajuar të aranzhimeve kushtetuese të autonomisë së Kosovës.⁴⁷⁵ Rol të madh në bisedimet e Rambujesë pos të tjerëve kishte luajtur edhe sekretarja e shtetit e SHBA-së Madeleine Albrighte, e cila kishte ndikuar sidomos te delegacioni që përfaqësonte UÇK-në që të nënshkruaj marrëveshjen.

Mesazhi i zonjës Albrighte për shqiptarët në Rambuje ishte „ Ju jeni udhëheqës. Jeni zgjedhur për të përfaqësuar popullin tuaj. Mendohuni mirë para se t’i denoni ata me një luftë. Marrëveshja do t’ju japë një vetëqeverisje, mbrojtjen e NATO-s, ndihmë ekonomike dhe të drejtën e shkollimit të fëmijëve tuaj në gjuhën e tyre. Nëse pranoni ato, do të shkoni drejt ardhmërisë dhe integritit në Europë.

Po hodhët poshtë atë, për pasojë do të vazhdojë lufta, që ju do ta humbni atë, e bashkë me të edhe mbështetjen ndërkombëtare“.⁴⁷⁶

Sipas Marrëveshjes, UÇK-ja do të detyrohej të çarmatosej dhe nuk do të ishte më e pavarur ushtarakisht. Përfaqësuesit e UÇK-së e kundërshtonin pikërisht këtë pikë të rëndësishme të propozuar në Rambuje. Autoritetet Serbe, në anën tjetër kundërshtonin tërheqjen e forcave të tyre nga Kosova.⁴⁷⁷ Pjesa e parë e bisedimeve në Rambuje zgjati deri më 23 shkurt, për t’u ndërprerë për afro një muaj për shkak se dokumentin e marrëveshjes nuk e nënshkruante delegacioni serb i Beogradit, ndërsa delegacioni shqiptar fatkeqësisht edhe atje ishte i përçarë. Ata u kthyen në Kosovë për të debatuar çështjen e nënshkrimit të dokumentit me popullin e Kosovës. Partitë politik, LDK dhe LBD bisedonin me masat e gjera popullore për aq sa e lejonin kushtet e luftës, ndërsa delegacioni i UÇK-së kishte për obligim të merrte pëlqimin e të gjitha Zonave Operative të saj. Në radhët e UÇK-së në Rambuje ishin: Hashim Thaçi, Xhavit Haliti, Azem Syla dhe Jakup Krasniqi. Tre të parët para luftës ishin anëtar të udhëheqjes së LPK-së dhe të tillë ende llogariteshin.

⁴⁷⁴ Madeleine Albright, Zonja sekretare, autobiografi, Dudaj, 2003, Tiranë, fq. 456.

⁴⁷⁵ Noel Malcolm, Kosova një histori e shkurtër, Koha, 2001, Prishtinë, fq. 28 -29.

⁴⁷⁶ Madeleine Albright, vepra e cituar, fq. 463.

⁴⁷⁷ Noel Malcolm, vepra e cituar, fq.29.

Përfaqësuesit e UÇK-së, kishin qenë në një kohë ose në një tjetër, ose vazhdonin të ishin edhe në strukturat e larta drejtuese të Lëvizjes Popullore të Kosovës, në Kosovë dhe jashtë saj, kishin qenë të ngarkuar politikisht nga organizata për përgatitjen e luftës dhe aty në atë konferencë ata përfaqësonin edhe mendimin politik dhe qëndrimin kombëtar të forcave politike ilegale.⁴⁷⁸

Megjithatë dihet fare mirë se gjatë kohës së luftës në Kosovë, veprimtarët e LPK-së, që tani ishin në pozita udhëheqëse të UÇK-së dhe në Drejtorinë Politike, shpeshherë nuk e përfillnin vetëm vijën politike të LPK-së. Hashim Thaqi, Xhavit Haliti dhe Azem Syla edhe pse ishin në organet udhëheqëse të LPK-së, tani duhej të konsultoheshin edhe me Komandantët e Zonave Operative të UÇK-së dhe pastaj të merret vendimi përfundimtar.

LPK, me fillimin e bisedimeve në Rambuje, kishte lëshuar deklaratë për shtyp ku kërkonte nga anëtarët e saj dhe të delegacionit shqiptar të mos e nënshkruanin asnjë dokument, i cili binte në kundërshtim me programin e LPK-së dhe të UÇK-së. **Në një deklaratë të lëshuar për opinion, me titull „ UÇK nuk është krijuar në Kosovë për të kapitulluar në Rambuje “, LPK-së thekson se në Konferencën e Paqes në Rambuje ndaj delegacionit shqiptar, nga segmente të veçanta të faktorit politik ndërkombëtar, po ushtrohet trysni e madhe për të pranuar çfarëdo zgjidhjeje, qoftë kjo edhe në dëm të interesave jetike dhe përcaktimeve historike të popullit shqiptar në Kosovë. Tashmë nga delegacioni shqiptar po kërkohet të hiqet dorë nga kërkesat e arsyeshme, duke i hapur rrugë miratimit të presionit të shumëanshëm pansllavist, i cili kërkon dhe synon një kolonizim të mëtejshëm të Kosovës.**

LPK e ka për detyrim t'i theksoj këtij segmenti të faktorit ndërkombëtar se ata mund të bëjnë trysni të gjithëfarshme mbi 15 anëtarët e delegacionit shqiptar në Rambuje, por nuk mund të bëjnë trysni mbi gjith popullin e Kosovës, mbi UÇK-në, mbi LPK-në me merita të pa kontestueshme mbi krijimin e qëndresës së armatosur të popullit shqiptar në Kosovë.

⁴⁷⁸ Bedri Islami, Intervistë në Gazetën shqiptare „ SHQIP”18.02.2007,Tiranë

LPK i bën thirrje delegacionit shqiptar të qëndroj unik dhe kërkon që në marrëveshjen finale të definohet qartë përcaktimi historik i popullit shqiptar për të ardhmen drejt pavarësisë, strukturimi i UÇK-së, ndërtimi i Kushtetutës së Kosovës si akt themelor i çdo shteti, largimi i menjëhershëm i trupave pushtuese serbe dhe lirimi nga burgjet i të gjithë të burgosurve politik shqiptar. Faktorët ndërkombëtar duhet të kenë parasysh se, pavarësisht nga dallimet, në kërkesën e drejtë – pavarësinë e Kosovës, shqiptarët janë dhe do të mbeten unik.⁴⁷⁹ Gjatë punimeve të Konferencës së Rambujese, LPK kishte ngritur një qendër e mbështetjes së delegacionit shqiptar, por edhe të lidhjes me qendrat e ndryshme mediale, të cilat, duke mos pasur kontakte të drejtpërdrejta me ata që ishin "brenda", kërkonin të vendosnin lidhje të tërthorta përmes atyre që ishin "jashtë". Grupin e Qendrës së mbështetjes e përbënin : Bedri Islami, Kryetar i LPK-së, grupi për marrëdhënie me jashtë i Drejtorisë Politike të UÇK-së : Sabri Kiçmari, Pleurat Sejdiu, Ramadan Avdiu dhe Xhevat Bislimi, të cilët njiheshin nga mediat e vendeve ku jetonin, si në Gjermani, Angli, Zvicër dhe Francë, si përfaqësues politikë të UÇK-së, pastaj Jashar Salihu, Kryetar i Fondit të UÇK-së, "Vendlindja thërret" dhe nënkryetar i LPK-së, si dhe Ibrahim Kelmendi, i cili ka pasur gjithnjë aftësinë për të vendosur lidhje të shpejta me qarqet mediatike, por edhe me përfaqësuesit e diasporës kudo që të ishin.⁴⁸⁰

Në Rambuje ishte edhe një delegacion i Shtetit Shqiptar, si: Pandeli Majko – Kryeministër i Shqipërisë, Paskal Milo, ish-ministër i Punëve të Jashtme të shtetit Shqiptar dhe Sabri Godo, ish-kryetar i Komisionit të Punëve të Jashtme të parlamentit shqiptar. Delegacioni i shtetit Shqiptar ishte vazhdimisht i interesuar për të ndihmuar, për të gjetur mundësi të lidhjeve politike e diplomatike të shtetit shqiptar dhe përfaqësuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me përfaqësues të diplomacisë botërore. Ndërsa Sabri Godo ishte figurë e njohur, jo vetëm si një ndër politikanët e shtetit shqiptar, por edhe si shkrimtar i shquar.

Prania e tyre në Rambuje, dëshmonte se shteti shqiptar ishte i preokupuar për të bërë më të mundshmen, pa ndërhyrë në problemet që kishin marrë përsipër të zgjidhnin pjesëtarët e delegacionit shqiptar në Rambuje. E vetmja gjë për të cilën ata këmbëngulnin deri në fund dhe deri në momentin e fundit ishte nënshkrimi i Marrëveshjes në Rambuje.

⁴⁷⁹Deklaratë e LPK-së, D.J.V: Zëri i Kosovës, 25 shkurt 1999, Zvicër.

⁴⁸⁰ Bedri Islami, Intervistë në Gazetën shqiptare „ SHQIP”18.02.2007,Tiranë

Pandeli Majko, në bisedë me Kryetarin e LPK-së, Bedri Islami, kishte theksuar se „ Delegacioni i Kosovës në Rambuje duhet t’a nënshkruaj dokumenti sa më parë. Ai kërkonte përmes përfaqësuesve të LPK-së, që "Thaçi duhet ta nënshkruajë dokumentin”⁴⁸¹. Ngurrimi i Kryetarit të Delegacionit të Kosovës në Rambuje, z.Hashim Thacit për të firmosur Marrëveshjen e Rambujesë vinte sepse, ai ishte krejt i lirë të vendoste si të dëshironte, për dy arsye madhore:

1. Nënshkrimi i drafteve të para ishte rikthimi i Kosovës dhe i çështjes shqiptare në vitin 1989, pra autonomi e zgjeruar, sovranitet i pakërkund, bankat, gjykatat, doganat, policia do të ishte serbe, lufta do të pushonte. Në shkurtin e vitit 1999 Ushtria Çlirimtare e Kosovës kishte mbi 28 mijë ushtarë, rreth 10 mijë të tjerë po përgatiteshin në Shqipëri. Kishte vërshim në strukturat e saj jashtë Kosovës, mbështetja financiare dhe politike ishte tepër e fuqishme. Asnjëri prej tyre nuk do e dëgjonte "nënshkrimin" e këtij lloji të Thacit. E gjithë ajo që paraqitej ishte në kundërshtim me gjithcka kishte synuar dhe punuar ai deri më tani.
2. Në kohën e "pikut" të Rambujesë, pra kur mendohej se gjithcka vërvitej e vendosej në sallat e kështjellës, në Kosovë po zhvilloheshin ngjarje dramatike. Adem Demaci, duke qenë krejtësisht kundër marrëveshjes së Rambujesë, kishte synuar një lloj "rebelimi" të komandantëve të zonave dhe kishte pasur përkrahje nga ndonjëri prej tyre, që nuk ishte pa ndikim. Mirëpo, ndërsa nuk e kishin pranuar "rebelimin" e Demaçit, SH.P i UÇK-së, kishte pasur rebelimin e tyre: kishin zgjedhur komandantin e ri të Përgjithshëm, Sylejman Selimin. Ishte si një lloj dalje nga loja e përgjithshme. "Rebelimi" i tyre kishte pasur një shkak: ende nuk e njihnin komandantin e Përgjithshëm, dhe kur e kishin marrë vesh se kush ishte ai dhe zëvendësi i tij, të pakënaqur kishin marrë gjithcka vetë përsipër.⁴⁸²

Më 19 shkurt 1999, Hashim Thaqi, nga Rambujeja, shkon në Lublanë të Sllovenisë, ku takohet me Adem Demaçin, për të diskutuar lidhur me nënshkrimin e Marrëveshjes.

⁴⁸¹ Po aty.

⁴⁸² Po aty.

Demaçi, ishte përfaqësues i atyre që kundërshtonin dhe biseda me te kishte rëndësi për ta përcaktuar qëndrimin e delegacionit shqiptar.⁴⁸³ Nga datat 6-7 mars 1999, pas mbarimit të manifestimit të për vjetorit të parë kushtuar rënies heroike të Adem, Hamzë dhe Shaban Jasharit, SH.P i UÇK-së filloi mbledhjen e vetë historike mbi marrjen e vendimit për nënshkrimin e Marrëveshjes kalimtare. Mbledhja u kryesua nga Komandanti i SH.P të UÇK-së, Sulejman Selimi – Sulltani. Pas një debati të gjërë të zhvilluar, në të cilën një pjesë e Komandantëve të Zonave ishin kundër nënshkrimit të Marrëveshjes, e një pjesë për, në fund me shumicë votash u vendos që ti jepet përkrahje delegacionit të UÇK-së për nënshkrimin e marrëveshjes, me kusht që të ndërrohet një pjesë e tekstit dhe që UÇK të mos të demilitarizohet.⁴⁸⁴ Lidhur me nënshkrimin e Marrëveshjes së Rambujesë LPK, D.J.V,;, përmes një Deklarate për media thotë se: Këshilli i Përgjithshëm i LPK-së, Dega jashtë vendit, në mbledhjen e tij të datës 06 mars 1999, analizoi dhe diskutoi me ndjenjë të lartë përgjegjësie dokumentin „ Marrëveshja e përkohshme për paqe dhe vetëadministrim në Kosovë“, paraqitur në takimin e Rambujesë.

Duke e shikuar në tërësi dokumentin e paraqitur, lidhur ngushtë me të sotmen dhe me aspiratat e popullit shqiptar në Kosovë me përcaktimin e tij për Pavarësi dhe prosperitet, dhe me të gjitha zhvillimet tjera të mundshme , KP i LPK-së, duke u mbështetur edhe në mendimin e Këshillave Popullor, në mënyrë unanime vendosi të deklaroj se kjo marrëveshje nuk duhet të nënshkruhet pasi në dokumentin e paraqitur nuk realizohet asnjëra prej aspiratave të popullit tonë. LPK, brenda dhe jashtë vendit, krijuese e UÇK-së, deklaroi qartë se askush nuk mund të paragjykojë të ardhmen e UÇK-së, e cila ka qenë dhe mbetet shpresa e vetme vitale për Pavarësinë e Kosovës. LPK nuk pranon që të nënshkruhet një dokument ku është përcaktuar ruajtja e integritetit të mbetjes Jugosllave, sepse kjo do të ishte pranim i një shkalle të ulët autonomie, mbetje nën serbi, dhe sepse ajo, LPK-ja, ka luftuar e do të luftojë për krijimin e shtetit të Pavarur të Kosovës.

⁴⁸³ Paskal Mili, vepra e cituar, f.153.

⁴⁸⁴ Procesverbal I SH.P të UÇK-së, 07 mars 1999, Drenicë.

- Përkundër kundërshimeve të LPK-së, megjithatë anëtarët e delegacionit shqiptar në Rambuje, pasi u konsultuan edhe me Komandantët e Zonave të UÇK-së, një pjesë e të cilëve ishin kundër nënshkrimit të kësaj marrëveshje, nënshkruan Marrëveshjen e Rambujesë, në të cilën parashihej përfundim i luftës së armatosure në Kosovë, transformimi i UÇK-së në ushtri civile të pa armatosur, ndërsa pas tri vitesh parashihej që të thirrej një mbledhje ndërkombëtare për të determinuar një mekanizëm për zgjidhjen finale për Kosovën, në bazë të vullnetit të popullit, të mendimeve të autoriteteve relevante.

LPK është për një Konferencë të re për Kosovën , në të cilën pa paragjykimë dhe mbi bazën e të drejtës historike të popullit për të jetuar i lirë dhe i pavarur, të merren vendime historike për të ardhmen e Kosovës.LPK deklaroi se asnjëri prej anëtarëve të saj, në qfarëdo strukturash të jetë, nuk është i autorizuar të nënshkruaj për autonominë e Kosovës. KP i LPK-së, D.J.V, obligon të gjithë anëtarët e këtij forumi drjetues, të cilët tashmë kanë detyra të rëndësishme në radhët e UÇK-së, që të përcaktohen qartë në mbështetje të kësaj deklarate dhe të qëndrimit politik të organizatës. LPK-ja u bën thirrje të gjithë anëtarëve të saj të cilët janë në radhët e UÇK-së, apo në territore tjera të Kosovës, që të përmbushin vendimin e organizatës.⁴⁸⁵ Më 13 mars 1999, nga aeroporti i Prishtinës, delegacioni, që në Kosovë kishte vendosur ta nënshkruante Marrëveshjen, kishte shkuar prapë në Paris.

Vazhdimi i Konferencës së Rambujesë në Paris zgjati nga 14 – 19 mars 1999. Një ditë para se të përfundonte Konferenca, Bedri Islami dhe Xhevat Bislimi, Biseduan me Kryetarin e delegacionit të Kosovës në Rambuje, z. Hashim Thaçi, për qëndrimin e LPK-së.⁴⁸⁶ Nga pala shqiptare dhe ajo ndërkombëtare marrëveshja u nënshkrua më 18 mars 1999, ndërsa pala serbe i mbeti besnike mospërfilljes dhe mosbashkëpunimit me ndërkombëtarët, veçanarisht me SHBA-të dhe nuk e nënshkroi marrëveshjen.⁴⁸⁷ Marrëveshja e përkohshme për paqe dhe vetëqeverisje në Kosovë u nënshkrua vetëm nga pala Kosovare, por jo edhe nga ajo serbo – jugosllave. Si rrjedhojë e mosnënshkrimit nga pala serbo – jugosllave, pas kësaj do të pasojë intervenimi i NATO-s më 24 mars 1999, i cili do të kurorëzohet fillimisht me planin G8, të cilin më 3 qershor e ka miratuar Parlamenti i Serbisë dhe presidenti Millosheviq dhe më pas me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së, më 10 qershor 1999. Pra intervenimi i NATO-s ka ndodhur për shkak të mosnënshkrimit të marrëveshtjes nga pala serbe dhe jo për shkak të nënshkrimit nga pala shqiptare.

⁴⁸⁵ Deklaratë e LPK-së, Koha ditore, e enjte, 11 mars 1999, fq.5.

- Qëndrimi i LPK-së kundër nënshkrimit të marrëveshtjes, ishte sepse, me këtë marrëveshje Serbisë i njihet sovraniteti mbi Kosovën dhe nuk ishte e sigurt se pas tri vitesh do të mbahet referendum për përcaktimin e mëvetësisë së shqiptarëve dhe pavarësisë së Kosovës, madje nuk ishte e sigurt se çfarë rregullimi shtetëror do të ketë Kosova pas përfundimit të luftës.

⁴⁸⁶ Po aty.

⁴⁸⁷ Ramë Bujë, Konferenca e Rambujesë, Prishtinë 2006, f.136.

Marrëveshja u bë jo për ta çliruar apo për t'a pavarësuar Kosovën, siç pretendojnë të thonë pjesa dërmuese e politikanëve Kosovarë dhe posaçërisht nënshkruesit e delegacionit të Kosovës në Rambuje. Ajo u bë për t'i sjellur Kosovës paqe dhe për t'a ruajtur sovranitetin dhe integritetin territorial të Jugosllavisë.⁴⁸⁸

Gjatë përpjekjeve afro dy vjeçare në luftën frontale kundër ushtrisë dhe policisë serbe në vijat e frontit të luftës morën pjesë shumë anëtarë dhe udhëheqës të LPK-së, të cilët dhanë një kontribut të madh në kuadër të UÇK-së, duke qenë shembull i qëndrimit, sakrificës dhe vetëmohimit për çështjen kombëtare. Një pjesë e tyre në luftime ballë për ballë me armikun ranë në krye të detyrës dhe në mbrojtje të Kosovës e të trojeve shqiptare. Në këtë luftë u vranë edhe shumë udhëheqës të LPK-së, si : Adem Jashari, Fehmi Lladrovci, Xhevë Krasniqi – Lladrovci, Zahir Pajaziti, Ismet Jashari, Behajdin Allaqi, Skender Çeku, Xhemajl Fetahu, Ahmet Kaçiku, Rexhep Bislimi, Agim Bajrami, Sejdi Sejdiu, Gursel Sylejmani, Abedin Rexha, Ilaz Kodra, Ilir Konushevc, Ardian Krasniqi, Mujë Krasniqi, Nazmi Ukzmajli, Vezir Jashari, e shumë të tjerë. Deri në fund të luftës shumë veprimtarë të LPK-së i qëndruan besnik programit të LPK-së dhe të UÇK-së. Megjithatë, pas përfundimit të luftës më 12 qershor 1999, disa veprimtar të LPK-së, të cilët tani ishin edhe në organet udhëheqëse të UÇK-së, kishin hudhur idenë se LPK e kishte kryer misionin e saj dhe se tani pas përfundimit të luftës duhet formuar një parti të re politike e cila do të ishte vazhdimësi e LPK-së.

Në luftimet që zgjatën nga marsi i vitit 1998 e deri më 12 qershor 1999, LPK-ja mori pjesë aktive në luftë, e përkrahu gjatë gjithë kohës atë, e ndihmoi financiarisht, propagandoi luftën e drejtë të saj dhe të popullit shqiptar për çlirim kombëtar etj. Në një intervistë të gazetarit të gazetës „Koha Ditore“ të bërë me Kryetarin e LPK-së, z. Fazli Veliu në Zvicër, gazetari me të drejtë e pyet: „A është UÇK-ja krahu i armatosur i LPK-së?“. z.Veliu i përgjigjet se „kjo pyetje i është bërë shpeshherë veprimtarëve dhe udhëheqësve të LPK-së. Ndoshta dhe mund të jetë, apo edhe të kuptohet kështu, por LPK kur mori vendim që të përkrah grupet e armatosura që po operonin gjatë viteve 1991 - 1993 nuk kishte menduar nga ky kënd. Ajo nuk e kishte menduar asnjëherë as atë se ajo mund të përfitoj politikisht.

⁴⁸⁸ Shkelzen Gashi, Marrëveshja për paqe të përkohshme, Interpress R. Company, Prishtinë, 2004, fq. 258.

LPK, këtë e kishte bërë për t'i qëndruar besnik programit dhe statutit të saj⁴⁸⁹ dhe poashtu për të respektuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të cilën nuk e mbronin dhe nuk e respektonin subjektet politike pacifiste që thirreshin në emër të saj sa për formë e mashtrim,⁴⁹⁰ në nenin 77 të Kushtetutës së Kosovës të shpallur më 7 shtator 1990 në Kaçanik shkruan: "Mbrojtja e vendit është e drejtë e pa cenueshme dhe e pa tjetërsueshme, obligim dhe nder i madh i çdo qytetari".⁴⁹¹

Pra, LPK ishte një organizatë serioze politiko - ushtarake e shqiptarëve të Kosovës. Ajo dinte çka donte, ajo dinte ta përgatiste terrenin për ta realizuar atë që aspironte dhe që ishte dëshirë e vullnet i popullit. Por, mbi të gjitha, LPK ishte një organizatë politike e cila atë që e thoshte dhe e kishte në program e në dokumentet e saj e mbronte me xhelozë dhe e realizonte me sukses. Kjo bëhej nga se shumë nga udhëheqësit e LPK-së që nga vitet e '90-ta e deri në përfundim të luftës së armatosur, më shumë mendonin për Kosovën dhe viset shqiptare si dhe për realizimin e programit të LPK-së, se sa mendonin për shëndetin, jetën e tyre, për familjet e tyre dhe për pasurinë e tyre. Kjo ishte ajo që e shquante LPK-në për të arritur sukses dhe që i dha asaj të drejtë të jetë subjekti më i afërt politik i UÇK-së dhe subjekti më i suksesshëm i lëvizjes ilegale dhe legale në Kosovë nga viti 1981 e deri në përfundim të luftës së armatosur në Kosovë më 1999.

⁴⁸⁹ Në statutin e LPK-së në vitin 1993 pika 5. shkruan „ Detyrat dhe të drejtat e anëtarit të LPK-së:5.1. „ Anëtari i LPK-së ka për detyrë: të luftojë për mbrojtjen e vendit dhe për të drejtat kombëtare e Demokratike".

Ndërsa në pikën III të programit të LPK-së të vitit 1993 shkruan: „ Për arritjen e aspiratave kombëtare, LPK do të përdor të gjitha format e luftës çlirimtare: demokratike, paqësor e politike dhe të rezistencës së armatosur".

⁴⁹⁰ Koha ditore, 27 nëntor 1997, intervistë me Fazli Veliun, ish- udhëheqës i LPK-së.

⁴⁹¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Zeri I Kosovës, shtator 1990.

5). Shëndrrimi i LPK-së në Parti Politike Legale

Gjatë kohës sa zhvillohej lufta në Kosovë, veqanarisht në vitin 1999, pas Konferencës së Rambujesë, dhe fillimit të bombardimit të Serbisë nga NATO-ja, LPK, kishte vlerësuar se fundi i luftës në Kosovë, nuk do të jetë edhe aq i largët, prandaj ajo duhet të përgatis terrenin e veprimit politik pas luftës në Kosovë, në kushtet dhe rrethanat e reja të krijuara pas luftës.⁴⁹² Për shkak se LPK kishte vepruar në kushte të ilegalitetit në Kosovë dhe për shkak se shumicën e aktivitetit të saj politik e kishte zhvilluar jashtë vendit (veqanarisht në Zvicër dhe Gjermani), si dhe për shkak të një opinionimi negative që ishte krijuar nga politika legale dhe pacifiste në Kosovë, shumica e udhëheqësve të LPK-së, kishin dhënë mendimin se LPK, pas përfundimit të luftës duhej të transformohet në parti politike legale.⁴⁹³ Ajo tani në gjirin e saj duhej të përfshinte gjithë elementët e dëshmuar kombëtar para dhe gjatë luftës, por edhe qytetarët e thjeshtë të cilët do ta përkrahnin programin e saj. Për këtë arsye, Kryesia e LPK-së, gjatë muajit prill 1999, në Tiranë, mban një takim konsultativ ku vendoset që LPK të ndërroj emrin e saj, të ndërroj programin dhe të shëndrrohet në një parti legale politike, e cila do të konkurronte në skenën politike të Kosovës pas luftës.⁴⁹⁴

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, gjatë muajve qershor - korrik 1999, në Prizren dhe Prishtinë, u mbajtën disa takime konsultative, ku morën pjesë shumica e udhëheqësve të KP dhe veprimtarë të LPK-së, të cilët me shumicë votash vendosën që LPK të shuhet si organizatë politiko – ushtarake dhe të formohet një parti politike .

Kryesia dhe pjesa dërmuese e KP të LPK-së, në kushtet e pas Çlirimit të Kosovës, pas konsultimeve me shumicën nga anëtarët e Kryesisë dhe të KP të LPK-së, formuan Grupin e Organizimit të Mbledhjes së Pestë të Përgjithshme. Grupi për organizimin e MPP-së përbëhej nga: Xhevat Bislimi- Kryetar, Ali Ahmeti, Bardhyl Mahmuti, Sabri Kiqmari, Mehmet Bislimi, Halil Selimi, Ramadan Avdiu, Fadil Lepaja, Esat Ymeri, Ramiz Lladrovci dhe Shasivar Makolli.⁴⁹⁵

⁴⁹² Muhamet Kelmendi, ish –n. Kryetar i LPK-së deri në vitin 1999, janar 2009

⁴⁹³ Ibrahim Kelmendi, ish - Kryetar i LPK-së në Gjermani, 03.1.2009

⁴⁹⁴ Xhevat Bislimi, shkurt 2009, Prishtinë.

⁴⁹⁵ Ramadan Avdiu 30.01.2009

Për shkak se LPK, nga viti 1993, në Kosovë, nuk ishte marrë me organizimin politik, por Këshillat e Rretheve dhe veprimtarët e saj i kishte organizuar në kuadër të organizimit ushtarak – UÇK-së, u vendos që ndje në Mbledhje, në cilësinë e delegatit të marrin pjesë edhe Komandantët e Zonave Operative dhe eprorët e lartë të UÇK-së, të cilët gjatë luftës, kishin pushuar aktivitetin e tyre politik në kuadër të LPK-së dhe ishin radhitur në radhët e UÇK-së. Shumica e këtyre komandantëve të UÇK-së, vinin nga radhët e LPK-së. Kjo kuptohet për shkak se LPK, ishte themeluese e UÇK-së, por edhe bartëse e angazhimit politik në qëndrimet e SH.P të UÇK-së, të drejtorisë politike dhe të grupit diplomatik jashtë vendit, të cilët kishin përfaqësuar UÇK-në në takime, bisedime dhe marrëveshje me Bashkësinë Ndërkombëtare deri në fund të luftës.⁴⁹⁶

Më 23.06.99, LPK, në Prizren mbajti, takim konsultativ me veprimtarë të LPK-së dhe Komandantë të Zonave të UÇK-së, për të shqyrtuar fatin e mëtejshëm të saj. Në takim, shumica e udhëheqjes së LPK-së, mendonin se LPK-ja duhet të shëndrrohet në parti politike legale. Kishte poashtu edhe të tjerë të cilët mendonin që LPK, megjithatë duhet t'a vazhdojë aktivitetin e saj, kuptohet tani në kushte legale, ndërsa një pjesë anëtarëve të Kryesisë së LPK-së, ishin të mendimit se nuk duhet të nguteshin, por të ofrojnë sa më shumë ekspertë dhe të konsultohen me veprimtar tjerë të LPK-së⁴⁹⁷. Anëtarët e LPK-së të cilët vinin nga trojet shqiptare në Maqedoni dhe Preshevë, mendonin se duhet që LPK të vazhdojë aktivitetin e saj, si edhe para luftës në Kosovë, sepse pjesët e banuara me shqiptarë jashtë Kosovës, ende ishin të pa çliruara.

Problem në vete ishte se, anëtarët e Kryesisë dhe të KP të LPK-së, ishte vështirë të mblidheshin në periudhën e pas përfundimit të luftës, në një takim me aq rëndësi, ku do të mirreshin vendime për fatin e mëtejshëm të LPK-së. Në fund të mbledhjes konsultative u vendos që, Mbledhja e Pestë e Përgjithshme e LPK-së, të mbahet më 27 qershor 1999 në Prizren.

⁴⁹⁶ Ibrahim Kelmendi

⁴⁹⁷ Xhevat Bislimi, Kryetar I Grupit për Organizimin e Mbledhjes së Pestë të Përgjithshme të LPK-së.

5.a).Mbledhja e Pestë e Përgjithshme e LPK-së

Në kushte krejt legale, pas çlirimit të Kosovës nga okupatori Serb, më 27.06.1999 në Prizren, për herë të parë prej ekzistimit të saj nga vitit 1982, filloi punimet MPP e LPK-së. Kuvendi zgjodhi Kryesinë e punës të MPP-së, në përbërje: B.Islami, B.Mahmuti, Shaban Shala, Emin Krasniqi, Ali Ahmeti, ndërsa, raport për punën e LPK-së që nga themelimi, e lexoi Bedri Islami, Kryetar I LPK-së.

Në mbledhje diskutuan, Fazli Veliu, ish – Kryetar dhe udhëheqës shumëvjeqar I LPK-së, Bedri Islami – Kryetar aktual I LPK-së, Hashim Thaqi – antër I KP të LPK-së dhe Drejtor I Drejtorisë politike të UÇK-së, Sabri Kiqmari, Bilall Sherifi e Bardhyl Mahmuti, anëtar të KP të LPK-së dhe të grupit politik të UÇK-së për Evropën Perëndimore, si dhe Halit Krasniqi, Sadik Halitjaha, Emin Krasniqi, Shukri Buja, Fatmir Limaj etj.⁴⁹⁸ Ish – Kryetari i LPK-së, Fazli Veliu, i cili në këtë mbledhje edhe përfaqësonte antarësinë e LPK-së në trojet shqiptare në Maqedoni, në fjalimin e tij, pasi i bëri një rezymë aktivitetit dhe punës afro 20 vjeqare të LPK-së, tha se „ Emërimi i organizatës mund të marrë edhe ndonjë nuancë tjetër, por vazhdimësia e programit kombëtar të LPK-së, duhet të jetë synimi ynë deri në realizimin final. Në rrethanat e krijuara, edhe më herët pati individ që LPK-në e quajtëm me mision të kryer, që nënkupton edhe pushimin e veprimtarisë së saj. Më duket se këtë përshtypje e kanë ata që nuk e dinë programin dhe forcën e LPK-së. LPK nuk e ka kryer misionin e saj as brendapërbrenda kufinjëve të Kosovës, të caktuar nga të tjerët, e të mos flasim për atë detyrim e pjesë të programit që parasheh tërësinë tokësore shqiptare në Preshevë, Bujanovc, Medvegjë, Maqedoninë Perëndimore dhe viset shqiptare në Mal të Zi.

Prandaj LPK duhet të marrë shtytje të re për veprimtari të gjerë dhe realizim të programi të saj“.⁴⁹⁹ Pas shumë debatesh, shumica e delegatëve të pranishëm votuan për transformimin e LPK-së në një parti legale. Kundër ishte delegati nga Suhareka, Muharrem Elshani, ndërsa ka abstenuar, Shukri Buja, delegat nga Lipjani dhe ish – Komandant i Zonës Operative të Neredimes së UÇK-së⁵⁰⁰.

⁴⁹⁸ Ditari i Jashar Salihut, qershor 1999, Prizren.

⁴⁹⁹ Fazli Veliu, raport I shkurtër mbi veprimtarinë dhe gjendjen organizative të LPK-së midis dy mbledhjeve të përgjithshme (korrik 1993 – qershor 1999)

⁵⁰⁰ Ibrahim Kelmendi, delegate në mbledhje, deklaratë, 03.2.2009.

Me shumicë votash u vendos që LPK të shëndrrohet në parti politike. Poashtu u vendos që mbledhja për themelimin e partisë së re të mbahet më 04 korrik 1999 – Prishtinë.⁵⁰¹

5.b). LPK shëndrrohet në parti – PBD

Më 04 korrik 1999, në sallën e Kuqe të Fakultetit Filozofik në Prishtinë, u mbajt Mbledhja themeluese e partisë së re, vazhduese e LPK-së.

Fjalën e hapjes e mbajti Bedri Islami- Kryetar i LPK-së, i cili e lexoi një fjalë rasti si dhe një historik të shkurtër të LPK-së. U zgjodh edhe Kryesia e punës në përbërje: Muhamet Mehmeti, Bardhyl Mahmuti, Ali Ahmeti, Emin Krasniqi dhe Jashar Salihu. Procesmbajtës, Ramadan Avdiu, Bajram Ajeti, Ragip Shala. Komisioni i votimit: Time Kadrijaj, Mustafë Bajrami, Pleurat Sejdiu, Haki Morina, Berat Luzha. Jashar Salihu e lexoi projekt programin e partisë, vazhduese e LPK-së, ndërsa Emin Krasniqi lexoi projekt statutin. Këto u aprovuan me vërejtjet e bëra. Pastaj u kalua në propozimin për emrin e Partisë: Partia e Bashkimit Demokratik, Partia Demokratike e Kosovës, Partia e Progresit Demokratik. Pas votimit dhe diskutimeve u vendos që partia të quhet PBD.⁵⁰²

Më 7 korrik 1999 në Prishtinë, udhëheqës të LPK-së, si : Bedri Islami, Xhavit Haliti , Bardhyl Mahmuti, Jashar Salihu, Hashim Thaçi, Ramadan Avdiu, Xhevat Bislimi etj, bashkë me anëtarë të drejtorisë politike të UÇK-së formuan Partinë e Bashkimit Demokratik – PBD e cila më vonë u quajt PPDK dhe në fund mori emrin PDK..⁵⁰³

⁵⁰¹ Ditari i Jashar Salihut, njëri nga udhëheqësit e LPK-së dhe të fondit „ Vendlindja Thërret”, 1999.

⁵⁰² Po aty.

⁵⁰³ Po aty.

Në nëntor 1999, Emrush Xhemajli- ish Sekretar i Përgjithshëm shumëvjeçar i LPK-së, Dega Jashtë Vendit, Fazli Veliu- ish Kryetar, Gafurr Elshani – ish arkatar i LPK-së dhe bartës i disa funksioneve në LPK, para luftës në D.J.V, si dhe anëtarët dhe veprimtarët e LPK-së: Musa Xhaferi – Kërçovë, Ilaz Kadolli – Suharekë, Durmish Gashi e Binak Berisha – Rahovec, Ali Reshani – Ferizaj, Ismet Sylejmani – Gjilan, Avdyl Mushkolaj – Deçan, Metush Zenuni, Kaçanik, Jonuz Musliu – Preshevë, Shefit Xhaferi – Gostivar, etj, ishin të mendimit se LPK duhet të vazhdoj aktivitetin e saj politik në Kosovë, si dhe duhet të vazhdojë luftën çlirimtare në Maqedoni dhe në Kosovën Lindore.⁵⁰⁴

Ky ishte edhe synimi përfundimtar i LPK-së dhe betimi i ushtarëve të UÇK-së. Në nëntor të vitit 1999, pas përfundimit të luftës u formua në Prishtinë Këshilli për Koordinimin e Veprimtarisë së LPK-së. Qëllimi ishte që të vazhdohet programi i LPK-së në kushte të reja. Poashtu në këtë kohë, në Prishtinë, pas 18 vitesh, pikërisht në Janar, në Flakën e Janarit të Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës, filloi të dalë për herë të parë legalisht, gazeta „ Zëri i Kosovës“, gazetë kjo e cila kishte filluar me të madhin Jusuf Gërvalla. LPK-ja përveç se ishte themeluese e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ajo u bë bazament i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegj dhe Bujanoc – UÇPMB-së në Kosovën Lindore, dhe i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare - UÇK-së në viset etnike shqiptare në Maqedoni, në vitet 1999 – 2001.

⁵⁰⁴ Arkivi i LPK-së, Prishtinë 1999.

PËRFUNDIMI:

Kthesa më e rëndësishme, në historinë më të re të shqiptarëve në Jugosllavi, ishin demonstratat e „Pranverës së Kuqe“ të vitit 1981. Këto demonstrata, të cilat u organizuan nga rinia studentore në Prishtinë dhe qytete tjera të Kosovës, i shinë të projektuara dhe të inicuar nga grupet atdhetare ilegale që vepronin pashkëputshëm që nga rënia në burg, e Adem Demaqit me shokë në vitet ,60 – ta dhe rrënjët i kishin në LBRSH. Grupet ilegale, si OMLK, Zëri i Kosovës, LKÇK, LRSSHJ, PKLSHMNJ, Fronti i Kuq Popullor, etj, kishin celulatat e tyre në të gjitha pjesët e Kosovës dhe torjeve shqipëtare në Jugosllavi.

Pas këtyre demonstratave dhe pas vrasjes së vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës në Gjermani, nga UDB-ja Jugosllave, grupet ilegale që vepronin në Kosovë dhe në shtetet e Evropës Perëndimore, më 17 shkurt të vitit 1982, u bashkuan në një subjekt të vetëm politik të quajtur LRSSHJ, e cila në vazhdimësi, konform kushteve dhe rrethanave e nderroi emrin, në LRSHJ, LPRK, për t’u quajtur më në fund, nga viti 1993 LPK.

LPRK, më vonë LPK, ishte organizatë, politiko – ushtarake, ilegale e shqipëtarëve në ish- Jugosllavi. Aktivitetin e saj ajo e shtriu në të gjithë territorin e ish –jugosllavisë, por edhe në shtetet e Evropës Perëndimore, në Skandinavi dhe SHBA, ku jetonin shumë shqipëtar të ikur nga dhuna dhe terrori i pushtuesit serbo, maqedono, malazez.

LPK-ja, ka bërë përpjekje mbi 20 vjeqare në rrugën e saj drejt lirisë, pavarësisë dhe bashkimit të të gjitha trojeve etnike shqipëtare të cilat padrejtësisht u ndanë nga fuqitë e mëdha në Kongresin e Berlinit më 1878 dhe në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913. Në Historinë më të re të Kosovës, në të ardhmen LPKdo të zë vendin e merituar, sepse edhe kontributi i saj në të gjitha lëvizjet kombëtare që rrodhën, sidomos pas vitit 1981, e këndeje, ishin të pa mundura të zhvilloheshin pa rolin dhe pa kontributin e LPK-së.

Nga viti 1981, e deri me formimin e partive politike legale më 1989 dhe 1990, LPK, ishte i vetmi zë i shqipëtarëve të robëruar në ish- Jugosllavi dhe i atyre në Evropën Perëndimore. Opinioni ndërkombëtar, në Gjenevë, Bruksel, Paris, Hagë etj, u njoftua për pozitën e shqipëtarëve në ish – Jugosllavi qysh në vitet 80-ta , pikërisht falë aktivitetit të madh që bëri LPK në këto shtete.

Megjithate, edhe pas formimit të partive legale në Kosovë, gjatë viteve 1989, 1990, kur shqipëtarët e shtypur nga pushtuesi menduan se me formimin e partive me orientim pro evropian çlirohet kosova, LPK, nuk u regjistrua në Beograd dhe nuk e ndal aktivitetin e saj ilegal për qlirim dhe bashkim kombëtar.

Dhe ky qëndrim i LPK-së doli i saktë . Në vitët 1993, 1994 e tutje shqiptarët e Kosovës filluan të zhgenjeheshin nga politika pacifiste e LDK-së. Në momentin kur atyre u duhej një subjekt i fortë ushtarak, për të ndryshuar strategjinë e veprimit, LPK, në vitin 1993, në Prishtinë dhe Drenicë, bashkoi grupet ushtarake dhe formoi UÇK-në. Po në këtë kohë, në shtetet e Evropës Perëndimore dhe SHBA, LPK formoi edhe fondin e Ushtrisë „Vendlindja Thërret“.Në këtë periudhë, veprimtarët e LPK-së edhe pse të dëmtuar nga burgosjet masive që ndodhën në këtë vit, ku u burgosën një pjesë e udhëheqsve të saj, ajo mobilizoi anëtarët e saj në Kosovë dhe në D.J.V për ta ndihmuar politikisht, financiarisht dhe moralisht UÇK-në.

Pas rënies heroike të Komandantit, Adem Jashari dhe familjes së tij, kur lufta mori përmasa edhe më të mëdha, LPK thirri anëtarët e saj për mobilizim të përgjithshëm. Një pjesë e anëtarëve të kryesisë dhe të këshillave të Rretheve u udhëzuan të ktheheshin në Kosovë, për ta udhëhequr luftën, ndërsa pjesa tjetër që mbeti jashtë vendit, punonin në financimin, propagandimin dhe rekrutimin e ushtarëve të rinj që vinin në luftë.

Gjatë luftës frontale një vjeqare në Kosovë, roli i LPK-së dhe anëtarëve të saj ishte shumë i madh, shumë dimensional dhe i pa krahasueshëm. Edhe pas përfundimit të luftës në Kosovë, LPK dha kontribut në formimin e UQPMB-së dhe të Ushtrisë Qlirimtare Kombëtare në Maqedoni. Edhe përkundër kësaj pune dhe këtyre përpjekjeve kaq të mëdha, LPK ende nuk arriti të realizoj programin e saj për bashkim kombëtar me shtetin amë.Megjithate edhe LPK, gjatë rrugëtimit të saj afro 20 vjeqar në ilegalitet, pati gabime dhe mospajtime që nganjëherë i bënë dëm organizimit ilegal në Kosovë, por kontributi i saj kolosal në çështjen kombëtare është i pa zëvendësueshëm.

Gjatë punës sime një vjeçare, çështja më e rëndësishme ka qenë hulumtimi dhe gjetja e burimeve arkivore të LPK-së. Përparsi për mua ka qenë fakti se për shumë vite kamë qenë veprimtar i LPK-së, dhe duke i njohur personalisht të gjithë udhëheqësit dhe veprimtarët e saj, të cilët për 20 vite rresht kishin barrën kryesore të organizimit politik dhe ushtarak të LPK-së, kamë mundur më lehtë të vijë edhe deri tek materialet e kërkuara. Gjatë kësaj pune hulumtuese studimore në Temën time të Masterit, ndihmesë të madhe më kanë dhënë, duke më furnizuar me dokumentacione të dorës së parë, udhëheqësit e LPK-së: Fazli Veliu, Emrush Xhemajli, Muhamet dhe Ibrahim Kelmendi, Gafurr Elshani, Ramadan Avdiu, Sejdi Gega, Murat Bytyqi, Xhevat Bislimi e shumë të tjerë. Ndërsa për dokumentacionin lidhur me fondin „Vendlindja Thërret“ ndihmesë më kanë dhënë: Familja e Jashar Salihut, ish – Kryetar i fondit të UÇK-së, Ragip Shala, Ibrahim Kelmendi, etj.

Për sigurimin e këtyre materialeve arkivore, për aktivitetin e LPK-së, nga data 15 mars - 25 maj 2008, kamë qëndruar në Zvicër, ku ndodhet edhe arkiva kryesore e LPK-së, ende e pa sistemuar si duhet. Poashtu në Zvicër jamë konsultuar dhe ndihmuar edhe nga shumë veprimtar të LPK-së të cilët ende vazhdojnë të jetojnë në këtë shtet dhe kanë dosje të pasura me dokumente nga aktiviteti i LPK-së, veqanarisht për aktivitetin e LPK-së, Dega Jashtë Vendlindjes. Në punimin tim të Masterit, gjatë hulumtimeve të mia kamë arritur që të analizoj dhe studioj këto burime arkivore të cilat janë të dorës së parë, pra janë marrë nga Arkiva e LPK-së dhe nga Arkiva e veprimtarëve të saj. Sa i përket shtypit shqiptar, për punimin tim „LPK dhe roli i saj në formimin e UÇK“ burim kryesor imi kanë qenë gazetat „Zëri i Kosovës“ 1974 -1999, Organ i LPK-së, dhe gazeta Rilindja 1981 -1999. Poashtu nga shtypi shqiptar që botohet në Kosovë kamë konsultuar edhe gazetat ditore: Bujku, Kohën Ditore, Epoka e Re, Zeri, Kosova Sot, Bota Sot etj, si dhe revistat: Liria, Alternativa, Ekskluzive dhe Fjala.

Në vitet 1991 – 1998, Gazeta „ Zëri i Kosovës“ ishte bërë dritarja e vetme nga ku të gjithë shqiptarët atdhetarë, informoheshin drejtë dhe me kohë për aktivitetin e UÇK-së dhe luftën e tyre të drejtë që po bënin në Kosovë. Në këtë gazetë, jepen mendimet dhe qëndrimet e LPK-së në një anë, si dhe deklaratat e qëndrime të faktorëve politik ndërkombëtar si dhe qëndrimet negative të politikës pacifiste, lidhur me UÇK-në.⁵⁰⁵ Shkrimet e „ Zëri i Kosovës“ nuk ishin të rëndomta e të një rrjedhe të njëjtë si të gazetave të atëhershme e të mëvonshme legale.

Shkrimet në „ZIK“ ishin shënimet e të burgosurve shqiptar që shkruheshin me duart e përgjakura nga gardianët dhe policët, UDB-ashët e spiunët, ishin shkrime të studentëve të përjashtuar nga procesi arsimor dhe zëri i mërgimtarëve të ikur për shkak të ndjekjeve nga regjimi.⁵⁰⁶ LPK, përmes gazetës së saj „ Zëri i Kosovës“ me shkrime të ndryshme argumentone se lufta çlirimtare e popullit shqiptar në Kosovë është e drejtë ngado që të shikohet, si nga e drejta natyrore për të jetuar i lirë çdo njeri, si nga pikëpamja e të drejtave të njeriut, por edhe nga pikëpamja kushtetuese e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nga Konventat ndërkombëtare. Të gjitha veprimet e armatosura që i ndërmerre UÇK-ja kundër pushtuesve serb në Kosovë dhe të gjitha komunikatat për shtyp që i lëshonte ajo e të cilat nuk i botonte shtypi shqiptar në Kosovë, ose i shtrembëronte „ Zëri i Kosovës“, i botonte ato me qëllim të njoftimit të opinionit me luftën e drejtë të popullit tonë.⁵⁰⁷

Gazetat dhe Revistat - të cilat i kamë konsultuar gjatë punimit të Temës së Masterit, për dallim nga Gazeta „ Zëri i Kosovës“, i cili ka pasqyruar në mënyrë të drejtë ngjarjet dhe aktivitetin e LPK-së dhe të UÇK-së, është edhe Gazeta „ Rilindja“ nga viti 1981 – 1990, organ i LKJ-së , të cilën e kamë konsultuar për të mësuar qëndrimin e LKJ-së rreth grupeve ilegale, veçanarisht të LPK-së, ndërsa nga viti 1990 -1999, Rilindja e cila botohej në Zvicër, ishte përkrahëse e vijës së LDK-së, dhe interesimi im ka qenë qëndrimi i kësaj gazete rreth grupeve ilegale të viteve 80-ta dhe UÇK-së.

⁵⁰⁵ Artikuj të gazetës „ Zëri I Kosovës“ organ i LPK-së, 1991-1998, Zvicër.

⁵⁰⁶ Fazli Veliu, LPK- UÇK, f.54.

⁵⁰⁷ Po aty.

Gazetat ditore si: Zëri ditor, Koha ditore, Epoka e Re, Kosova Sot, Bota Sot, etj, për punimin tim kanë qenë të rëndësishme, Fejtonet e botuara me personalitete dhe ngjarje nga viti 1981 -1999, të cilët kanë folur për ngjarje që më herët, deri në çlirimin e Kosovës, nuk kanë guxuar apo nuk kanë mundur të flasin. Nga gazetatat dhe revistat shqiptare dhe ato të huaja, burim bazë për punimin tim ka qenë gazeta „ Zëri i Kosovës” e cila duke qenë organ i LPK-së dhe i UÇK-së, ka qenë shumë afër dokumenteve burimore dhe në të njëjtën vijë të qëndrimeve politike lidhur me aktivitetin e LPK-së dhe UÇK-së. Në anën tjetër kamë shfrytëzuar Gazetën „ Rilindja, ish – gazetë e LKJ-së, e cila kishte qëndrimin e kundërt me gazetën „ Zëri i Kosovës” dhe aktivitetin e LPK-së, por që kishte shkrime shumë me rëndësi për temën time.

Poashtu një ndihmesë më ka dhënë edhe shfletimi i gazetave tjera ditore si: Koha ditore, Bota sot, Kosova Sot, Epoka e Re etj, të cilat pas luftës janë marrë në masë të konsiderueshme me aktivitetin e LPK-së dhe të UÇK-së nga vitet 1981 – 1999.

Në punimin „ LPK dhe roli i saj në formimin e UÇK-së”, kamë përfshirë dokumentet burimore të cilat i kamë shfrytëzuar për punim të Temës siç janë:

1. Dokumentet arkivore të veprimtarisë së LPK-së dhe UÇK-së.
2. Literatura nga autorë shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë shkruar për LPK-në dhe UÇK-në.
3. Gazetat dhe revistat Shqipe dhe ato të huaja, të cilat kanë shkruar lidhur me ngjarjet, në të cilat është e përfshirë edhe aktiviteti i LPK-së dhe UÇK-së,
4. Fejtonet e ndryshme të cilat janë botuar në shtypin shqiptar pas vitit 1999
5. Intervistat dhe deklaratat e ish – veprimtarëve të LPK-së dhe udhëheqësve të UÇK-së.

1. Dokumentet arkivore

të LPK-së të cilat i kamë konsultuar janë dokumente të dalura nga mbledhjet e Kryesisë së LPK-së, procesverbale të mbledhjeve, Komunikata dhe Thirrje, si dhe qëndrime të LPK-së të cilat ky subject politik i ka lëshuar për opinion dhe shtypin vendor apo të huaj lidhur me situatat e ndryshme të ndodhura në Kosovë gjatë viteve 1981 -1999. Një pjesë të këtyre dokumenteve e kamë siguruar nga Arkivi i pa sistemuar mirë i LPK-së në Prishtinë dhe Zvicër, ndërsa pjesën tjetër nga veprimtarët dhe udhëheqësit e LPK-së në Kosovë, Maqedoni, Presheve dhe Zvicër.

2. Literatura

Sa i përket literaturës së shfrytëzuar për punimin tim të Masterit, më duhet të them se në shumicën e rasteve kamë hasur në vështirësi të selektimit të tyre dhe përzgjedhjes së tyre, për shkak se edhe autorët e huaj, por edhe ata shqiptarë, shumë pak janë konsultuar me arkivën dhe dokumentet e LPK-së dhe shumicën e rasteve kanë shkruar për LPK-në dhe UÇK-në në bazë të shtypit vendor dhe intervistave individuale që shumë herë nuk janë përputhur me dokumentet origjinale të cilat i kamë siguruar unë nga arkivi i LPK-së dhe UÇK-së. Megjithate, shumicën e rasteve, këtë literaturë e kamë përdorur për të plotësuar ndonjë qëndrim të LPK-së dhe UÇK-së për ngjarjet e caktuara. A jo çka më ka sjellur probleme tek shfletimi i literaturës, qoftë të autorëve shqiptar, por qoft edhe të atyre të huaj, ishte se në shumicën e rasteve, nuk përputheshin të dhënat që ishin tek këta autorë në krahasim me dokumentet arkivore të LPK-së, të cilat i kisha grumbulluar gjatë punës 1 vjeçare., por edhe gjatë tërë veprimtarisë sime afër 20 vjeçare.

Prandaj, në shumicën e rasteve literatura më ka shërbyer për përshkrimin e ngjarjeve historike dhe politike, ndërsa për shkrimet në të cilat më është dashur të kemë data dhe ngjarje të rëndësishme lidhur me Temën, i jamë referuar Dokumentacionit arkivor të LPK-së, si: Procesverbaleve, Komunikatave, Thirrjeve, Vendimeve dhe raporteve të ndryshme të LPK-së.

Gjatë punës sime, kamë pasur biseda, intervista dhe konsultime me shumë personalitete, ish- udhëheqës të LPK-së dhe UÇK-së, me të cilët kamë komunikuar me dhjetra herë, kamë mësuar nga ta shumë ngjarje dhe takime me rëndësi për Kosovën. Ajo çka do të veçoja në këtë rast është se zhvillimet politiko – ushtarake të LPK-së dhe UÇK-së, gjatë viteve 1981 – 1999, shumicën e madhe të takimeve dhe aktiviteteve për shkak të konspiracionit të thellë, nuk kanë mundur të shkruhen, prandaj përmes bisedave dhe intervistave, kamë arritur të ndriçoj shumë ngjarje që deri tani nuk janë bërë të njohura për lexuesit.

3. Fejtonistika

Në gazetatat ditore dhe revistat në gjuhën Shqipe, më kanë mundësuar që të plotësoj boshllëkun e informative të dorës së parë, sepse shumë autor të ngjarjeve të viteve 1981 - 1999, për shkak të kushteve të okupimit, nuk kanë mundur ta thonë aktivitetin e tyre me kohë dhe pas luftës, përmes intervistave dhe fejtoneve i kanë thënë shumicën e ngjarjeve të kaluara. Veçanarisht fejtonet e botuara në gazetatat ditore në Kosovë, kanë rëndësi të madhe për punimin tim shkencor, sepse, në pamundësi për të thënë dhe treguar apo shkruar ngjarje të ndodhura nga vitet 1981 – 1999, kur Kosova ishte e pushtuar nga Serbët, veprimtar të ndryshëm të LPK-së dhe të Lëvizjes ilegale në përgjithësi, shumë gjëra me rëndësi i kanë publikuar në shkrimet e tyre Fejtonistike në gazetatat ditore të botuara nga viti 1999 – 2009.

Gjatë punimit tim shkencor, një document burimor shumë me rëndësi kanë qenë edhe intervistat apo bahskëbisedimet që kamë pasur me udhëheqës politik dhe ushtarak të LPK-së dhe UÇK-së me të cilët jamë konsultuar shumë herë dhe nga të cilët kamë mësuar shumë ngjarje që nuk kamë mundur ti lexoj në dokumentet e shkruara apo në librat dhe gazetatat që janë marrë me këtë problem. Përparësi për mua ka qenë se, duke qenë edhe vet veprimtar i kësaj Lëvizjeje afër 20 vjet, kamë ditur se ku mund të drejtohem për sigurimin e dokumenteve, kamë pasur raporte shumë të mira miqësore me shumicën e bartësve të aktivitetit politik dhe ushtarak të LPK-së dhe UÇK-së, dhe kjo më ka ndihmuar që më lehtë të vijë deri tek burimi dhe e vërteta e mundshme për ndonjë ngjarje të caktuar.

Intervistat, bisedat dhe konsultime me shumë personalitete, ish- udhëheqës të LPK-së dhe UÇK-së, me të cilët kamë komunikuar me dhjetra herë, kamë mësuar nga ta shumë ngjarje dhe takime me rëndësi për Kosovën. Ajo çka do të veçoja në këtë rast është se zhvillimet politiko – ushtarake të LPK-së dhe UÇK-së, gjatë viteve 1981 – 1999, shumicën e madhe të takimeve dhe aktiviteteve për shkak të konspiracionit të thellë, nuk kanë mundur të shkruhen, prandaj përmes bisedave dhe intervistave, kamë arritur të ndriçoj shumë ngjarje që deri tani nuk janë bërë të njohura për lexuesit. Jamë shumë i vetëdijshëm, që në punimin tim nuk kamë mundur ta them gjithë atë që duhet thënë dhe shkruar për LPK-në, por jamë munduar të jap një kontribut modest në formë të argumentuar dhe shkencore, me pretendimin që punën time shkencore t'a vazhdoj edhe në të ardhmen.

Burimet dhe Literatura:

I. Burimet Arkivore të pa botuara:

1. Arkivi i LPK-së:

- Raport i KP, për Mbledhjen e II të Përgjithshme të LPRK-së, shtator 1989.
- Arkivi i LPK-së, Dega Jashtë Vendi
- Projektstatusi i FKQK-së ose BKQK-së, GOR E LPRK-së, maj 1993, Prishtinë.
- Rregullore e nëngrupit të Organizimit dhe Riorganizimit të Këshillave të Rretheve të LPRK-së, maj 1993.
- Komunikim i brendshëm I KP të LPK-së me Këshilla të rretheve, d.j.v.25.06.1994
- Qarkorja interne e K.RR të LPRK-së, Preshevë, mars 1993, si dhe Njoftim i Këshillit të Rrethit të LPRK-së në Presheve, dërguar Kryesisë së LPRK-së, maj 1993.
- Raport nga Mbledhja e KP të LPK-së, D.J.V, 24.01.1998, Eürzburg, Gjermani
- Njoftim nga Procesverbali i Mbledhjes së KP të LPK-së, 30.04.1994.
- Njoftim për Këshillat e Rretheve të LPK-së, nxjerrë nga procesverbali i Mbledhjes së KP të LPK-së, 02.12.1996
- Njoftim i KP të LPK-së, nxjerrë nga Procesverbali i mbledhjes, 28.04.1996
- Material i Kryesisë së PK të LPRK-së, nëntor 1992.
- Raportet dhe njoftimet e KP të LPK-së D.J.V, 1993 -1999.
- Material për Këshillat e e LPK-së, maj 1994
- Platforma e LPK-së për luftën e armatosur në Kosovë dhe Rregullorja e UÇK-së, fq. 24-26.
- Arkivi i LPK-së, Prishtinë 1999

- Ditari i Jashar Salihut, qershor 1999, Prizren.
- Procesverbal i SH.P të UÇK-së, 07 mars 1999, Drenicë.
- Dokument i LPK-së, Akrivi i LPK-së, mars 1998, Prishtinë.
- Mbledhje e KP të LPK-së, D.J.V, 22 nëntor 1997

II. Burime akriore të botuara:

- Tezat rreth Frontit popullor për Republikën e Kosovës, OMLK, 1981
- Thirrje e LPRK-së për demonstratë, e cila u mbajt më 31 tetor 1987, në Bern, Zvicër.
- Komunikatë e KP të LPRK-së, 12 dhjetor 1987.
- Komunikatë e LPRK-së, 26 nëntor 1988.
- Komunikatë e LPRK-së, 29 mars 1989, Prishtinë.
- Komunikatë e LPRK-së, 29 mars 1989
- Komunikatë e LPRK-së e lëshuar më 29 mars 1989 e cial u shpërnda në të gjitha qytetet dhe fshatrat e Kosovës, por edhe në viset tjera shqiptare nën Jugosllavi“. Arkivi i LPK-së, Zvicër, 29 mars 1989.
- Trakt i LPRK-së, lëshuar më 27 tetor 1989,
- Komunikatë e KP të LPRK-së, 3 nëntor 1989
- Thirrje e LPRK-së, janar 1990, Prishtinë
- Komunikatë e LPRK-së, janar 1990, Prishtinë
- Komunikatat e LPRK-së, 29 janar, 3 shkurt dhe 20 mars 1990.
- Komunikatë e LPRK-së, d.j.v, qershor 1990,
- Peticion dërguar OKB-së , 19 maj – 2 qershor 1990
- Komunikatë e LPRK-së, gusht 1990, Prishtinë
- Konkluzionet e KP të LPRK-së, 22 dhjetor 1990.
- Komunikatë e LPRK-së, 13 shtator 1992, Prishtinë.
- Informatë e LPRK-së, lëshuar më 06 dhjetor 1992)
- Komunikatë e LPRK-së, shkurt 1993
- Njoftim i Kryesisë së LPRK-së, 23 janar 1993.

- Komunikatë e LPRK-së, 16.04.1993.
- Komunikatë e LPRK-së, prill 1993, Prishtinë
- Konkluzat e Mbledhjes Konsultative të LPRK-së, prill 1993
- Komunikatë e LPRK-së, 25.06.1993
- Komunikatë e LPRK-së, D.J.V, 04 korrik 1993
- Komunikatë e LPK-së, 14 gusht 1993
- Vendim i Kryesisë së KP të LPK-së, 1993
- Komunikatë e LPK-së, Bruksel, 17.12.1994.
- Vendim i LPK-së, 04.12.1993
- Vendim i Mbledhjes së IV të Përgjithshme të LPK-së, 1993
- Vendim i Kryesisë së LPK-së, 04 dhjetor 1993,
- Vendim i Kryesisë së KP të LPK-së D.J.V, 04.5.1996.
- Komunikatë e UÇK-së, nr. 30, 3 shkurt 1997.
- Vendim i Kryesisë së KP të LPK-së, D.J.V, 15.06.1996.
- Vendim i KP të LPK-së, 19 -20 tetor 1996. Qëndrimi i LPK-së për marrëveshtjen e Dejtonit, Arkivi i LPK-se, 24.11.1995.
- Komunikatë e LPK-së, shkurt 1997
- Komunikatë e LPK-së, Prishtinë, shtator 1996.
- Komunikatë e Kryesisë së KP të LPK-së, D.J.V, për ngjarjet në Shqipëri, 2 mars 1997
- Komunikatë e LPK-së, shkurt 1997
- Deklaratë e KP të LPK -së, D.J.V, 28/29 qershor 1997
- Komunikatë e LPK-së, 1 tetor 1997.Prishtinë.
- Thirrje, e LPK-së, drejtuar të gjithë shqipëtarëve që sakrifikojnë për çlirimin e vendit, 28 nëntor 1997, Prishtinë
- Komunikata dhe thirrje të LPK-së, 05, 06 dhe 8 mars 1998, Zvicër.
- Komunikatë e LPK-së, 05 mars 1998, Prishtinë
- Deklaratë e LPK-së, D.J.V. 25 shkurt 1999, Zvicër.
- Deklaratë e LPK-së, 11 mars 1999, fq.5.

2. Arkivi i Fondit „ Vendlindja Thërret”

- Arkivi i Fondit „ Vendlindja Thërret” Aarau, Zvicër
- Rregullore e Fondit „ Vendlindja Thërret” Aarau, Zvicër
- Deklaratë politike nr. 2 e SH.P të Ushtirsë Çlirimtare të Kosovës, 27.4.1998, Prishtinë.
- Komunikatë e Këshillit Qendror për Administrimin e Fondit „ Vendlindja Thërret”Aarau, Zvicër, 04. 06.1998.
- Thirrje për demonstratë, e udhëheqësve të Fondit „ Vendlindja Thërret”, New York, 01.6.1998.
- Komunikatë e K.Q. të Fondit „Vendlindja Thërret”Aarau, Zvicër, 04. 06.1998.
- Vendim i K.Q. për administrimin e Fondit „ Vendlindja Thërret” 14 nëntor 1998, Aarau, Zvicër.
- Komunikatë e Këshillit Qendror për Administrimin e Fondit „ Vendlindja Thërret”Aarau, Zvicër, 04. 06.1998.

3. Arkivat Private

- Aktakuza e ngritur nga pushteti i dhunshëm serb kundër Ilaz Kadollit, Behajdin Allaqit dhe Hysen Gegës, Hep.nr. 292/93, Gjykata e Qarkut Prizren, 10 nëntor 1993
- Arkivi i Familjes së Behajdin Allaqit, ish – udhëheqës i LPRK-së në vitet 1991 -1993, ish –ushtar i UÇK-së, tani dëshmor i Kombit.
- Arkivi i Jashar Salihut
- Arkivi i Agim Bajramit
- Arkivi i Sejdi Gegës
- Arkivi i Murat Bytyqit
- Arkivi i Avdi Xhemajlit

- Arkivi i Beqir Beqës
- Arkivi i Xhevat Zekës
- Arkivi i Metush Zenunit

4. Arkivi i UÇK-së:

- Komunikatat e SH.P të UÇK-së, nr. 13 - 74. Prishtinë
- Thirrjet e SH.P të UÇK-së.
- Deklarata politike nr. 1 – 34
- Procesverbal i SH.P të UÇK-së, 06-7 mars 1999, Drenicë
- Raporte të SH.P të UÇK-së 1998/1999

II . Shtypi Shqiptar dhe i huaj:

- Zëri i Kosovës
- Rilindja
- Zëri
- Koha Ditore
- Epoka e Re
- Kosova Sot
- Bujku
- Bota Sot
- Zëri i Popullit
- SHQIP

- Shtypi Serb

- Borba
- Veçerni Novost
- Jedinstvo

- Shtypi Zvicran

- Le Courier
- 24 Heurs
- Tribun de Genevë
- Der Bund
- L'HEBDO
- FACTS
- BLICK

- Shtypi Gjerman

- SUDOSTEUROPA
- Aus Politik und Zeitgeschichte
- Frankfurter Allgemeine Zeitung

- Web faqet

- [www.lpk](http://www.lpk.org) - org
- QIK- mars – prill 1998
- www.pashtriku.org
- www.dervina.com
- www.albania.com
- www.shqipëriaebashkuar.com
- www.google.com

- Revistat Mujore :

- Liria
- Alternativa
- Ekskluzive
- Albanica
- Fjala

- **Revistat shkencore:**
- Gjurmime Albanologjike (Prishtinë)
- Studime Historike (Tiranë)

III. Literatura:

1. ASHRSH, Studime Historike, Instituti i Historisë nr. 1-4, Tiranë 1995
2. ASHRSH, Studime Historike, nr. 1-4, 1997
3. ASHRSH, Studime Historike, nr. 3 – 4, 1998
4. ASHRSH, Studime Historike, nr. 1-2, 2001
5. ASHRSH, Studime Historike, nr. 3 - 4, 2002
6. ASHRPSSH, E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë 1990
7. Albright Madeleine, Zonja sekretare, autobiografi, Dudaj, Tiranë 2003
8. Bakalli Emine, Marrëdhëniet ekonomike Shqiptar – Jugosllave 1929 -1939, Prishtinë 1997
9. Baftiu Fehmi, Kosova krizë ndërkombëtare, Prishtinë 2004.
10. Basha - Keqmezi Sabile, Organizatat dhe grupet ilegale në Kosovë, 1981 -1989
11. Bajrami Hakif, Politika dhe lufta e drejtë shqiptare, përballë nazifashizmit serb, 1989 – 1999, Prishtinë 2006
12. Balidemaj Naim, Tragjedia Kosovare, Rugova – Millosheviq, Prishtinë 2001
13. Braha Shaban, Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare 1844 – 1990, Gjakovë 1991
14. Berisha Nuhi, Pranvera e luleve të kuqe, Kujtime – Ribotim, Gjiilan 2002
15. Bugajski Janus, ngritja e Kosovës, Prishtinë 2006
16. Buja, Ramë Konferenca e Rambujesë, Prishtinë 2006
17. Buja Ramë, Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë, Prishtinë 2007
18. Clewing Konrad, Reuters Jens, Der Kosovo – Konflikt, Munchen, 2000
19. Clark. K . Wesley, Të bësh luftë Moderne, Zëri, Prishtinë, 2003
20. Çeku Ethem, Mendimi politik i lëvizjes ilegale në Kosovë 1945 – 1981
21. Çeku Ethem, Shekulli i ilegales, Prishtinë 2004

22. Çubrilloviq Vasa, Problemi i pakicave Kombëtare në Jugosllavinë e re, Zëri i Kosovës, 1987
23. Danaj Koço, Koha e Demokracisë, apo e shpëtimit kombëtar, Zvicër, 1993
24. Danaj Koço, UÇK-ja dhe cinizmi i politikës, Tiranë 1998
25. Danaj Koço, 50 – vjet histori e pahumbur, Zvicër 1995
26. Dehari Avni, Hajdini Destan, *Arif Seferi në shërbim të popullit*, monografi, Zvicër, 1993
27. Gashi Shkelzen, Marrëveshja për paqe të përkohshme, Interpress R. Company, Prishtinë, 2004,
28. Gjeqovi Xhelal, Qëndrimet e shtetit shqiptar ndaj demonstratave të vitit 1981, studime historike, ASHRSH, 3-4, Tiranë 2001
29. Elshani Gafurr, UÇK, dokumente dhe artikuj, Zvicër 1998
30. Haxhiu Baton, Lufta ndryshe, Prishtinë 2008
31. Hoxha Enver – Fjalim në Kongresin e 8 të PPSH-së, të mbajtur më 1 nëntor 1981, Tiranë.
32. Hoxha Enver, TITISTËT – Kombinati Poligrafik, Tiranë 1992
33. Xhemajli Emrush, LPK, 20 vjet veprimtari 1982 -2002, Zëri i Kosovës, Prishtinë, 2002
34. Hajrizi Mehmet, *Në rrugë drejt lirisë, shkrim autorial, Prishtinë. 1977/78*
35. Hasani Sinan, KOSOVA, të vërtetat dhe mashtrimet, Prishtinë 1987
36. Halimi Emine, Shala Ajnishahe, Histori e një qëndrese, k.k. Skenderaj, 2000
37. Hamza B., F.Hoti, Jasharët, Zëri, Prishtinë 2003
38. Halimi Bedri, Rugova ngritaj dhe rënia, Prishtinë 2000
39. Hoti Ukshin, Filozofia Politike e çështjes shqiptare, Zëri i Kosovës, Tiranë 1995
40. Kosumi Haki, Rritja e lëvizjes ilegale në Kosovë 1981 -1990, punim në dorëshkrim.
41. Kondi Arben, Krimi I fundshekullit, Tiranë 2002
42. Krasniqi Jakup, Lëvizja Politike dhe qëndresa e armatosur në Kosovë 1991 -1999 Punim magjistrature, Prishtinë 2004
43. Krasniqi Jakup, Kosova në kontekst historik, Prishtinë 2005
44. Krasniqi Jakup, Kthesa e madhe – UÇK, Prishtinë 2007

45. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë 1990
46. Kelmendi Muhamet, Pse nuk u ndërtua Fronti për Çlirimin e Kosovës, Tiranë 1999
47. Kelmendi Ibrahim, Shqipëria – Jashtë veriut dhe Jugut, Zvicër 1997
48. Klinaku, Shukri, Vendimi Fatal, Prishtinë 2000
49. Llakër Uolltër, Europa në Kohën tonë, 1945 – 1992, Dituria, Tiranë, 2003
50. Maleqka Rajmonda, Ora e Kombit, Tiranë 2005
51. Milo Paskal, Ditari i një Ministri të Jashtëm, Konflikti i Kosovës 1997 -2001 Tiranë 2009
52. Neziri Ibish, Ahmet Haxhiu, një jetë të tërë në lëvizjen ilegale, Prishtinë 2001
53. Islami Bedri, E fshehta e hapur e Kosovës, Epoka e re, Prishtinë 2001
54. Islami Bedri, Përjetësia e dyfishtë, Tiranë 2008
55. Islami Bedri. “Enigma e një vrasje të trefishtë”, Focus, Prishtinë, 2007
56. Judah Tim, Kosova, luftë dhe hakmarrje, Prishtinë 2002
57. J.Primakov: Memoare, Jeta ime në politikën e lartë, fejton politik, “Zëri” 30 maj 2002
58. Perritt Henry, UÇK- Rrëfim prej Brenda për një kryengritje, Prishtinë. 2008
59. Petritsch Wolfgang, Rruga e gjatë në luftë, Prishtinë 2002
60. Pettifer, James Vickers, Miranda Çështja Shqiptare- Riformësimi i Ballkanit, Tiranë – NewYork, 2007
61. Pirraku Muhamet, Për kauzën e shtetësisë së Kosovës, Prishtinë 2008
62. Pushkolli Fehmi, Zahir Pajaziti Hero I Kombit, Prishtinë 2001
63. Stephan Lipsius, Untergrundorganisationen in Kosovo, Sudeuropa 47, 1998.
64. Sejdiu Driton, Kush ishte Zahir Pajaziti, monografi „UÇK-ZOLL”, Prishtinë, 2001
65. Sinani Shaban, Kosova në Gjeopolitikë, Tiranë 1998.
66. Shala Blerim, Vitet e Kosovës, 1998 – 1999, Zëri, Prishtinë, 2001
67. Shala Blerim, Lufta diplomatike për Kosovën, dialog me ambasadorin Christopher Hill, Prishtinë, 2003
68. Shala Blerim, Hamzaj Bardh, Pa protokoll, bisedë më Adnan Merovcin, Prishtinë 2003.
69. Sherifi Isuf , Hyrje për në Agim, monografi, SHKSH Mëmëdheu, Zvicër, 2002

70. Tafallari Faridin, Terror, dhimbje, qëndresë, Tiranë 1997 Tezat rreth Frontit popullor për Republikën e Kosovës, 1981.
71. Ukshini Sylë, Kosova dhe Perëndimi, Prishtinë 2001.
72. Ukshini Sylë, Refleksione Historiografike, Prishtinë 2002.
73. Ukshini Sylë, Nga lufta në paqë, botoi Rozafa, Prishtinë, 2004.
74. Ukshini Sylë, Lufta për Kosovën, Prishtinë 2008
75. Veliu Fazli, LPK dhe UÇK: një emblemë, një qëllim, Tiranë 2000.
76. Xhonsoll, Kohët Moderne I - II, Bota nga 1920 – 1990, Tiranë 2000.
77. Zelka Luan, “ *Shtypi shqiptar gjatë viteve të pavarësisë 1913-1939*”, Tiranë 2000
78. ZËRI, Libri i Lirisë, Intervista, Prishtinë 2003.
79. Zhitia Skender, UÇK, ZOLL, Prishtinë 2008.

IV. Intervistat:

1. Fazli Veliu, ish – Kryetar i LPK-së, prill 2007, shkurt, tetor, dhjetor 2008, shkurt 2009.
2. Muhamet Kelmendi, ish nën - Kryetar i LPK-së para vitit 1999, deklaratë e dhënë më 20 janar 2009
3. Emrush Xhemajli, ish – sekretar i LPK-së para vitit 1999, bisedë me mars 2008, qershor, 2008, shtator 2008, nëntor 2008 dhe 30 janar 2009
4. Mustafë Xhemajli, intervistë, 07 korrik 2008, Prishtinë.
5. Ramadan Avdiun, udhëheqës i LPRK-së në vitet 1989 – gusht 1993, marrë më 02 gusht 2008, 15 janar 2009, 30.01.2009, 01.2.2009 Prishtinë.
6. Ilaz Kadolli, intervistë, 12.09.2008 Prishtinë.
7. Adem Grabovci, njëri nga udhëheqësit e LPRK-së dhe të aksionit për pajtimin e gjaqeve, deklaratë e dhënë më 20. Janar 2009, Prishtinë.
8. Ibrahim Kelmendi, 17 janar 2008, Gjilan, 03.1.2009 dhe 04.2.2009, Prishtinë.
9. Xhevat Bislimi, Kryetar i Grupit për Organizimin e Mbledhjes së Pestë të Përgjithshme të LPK-së, bisedë në shkurt 2008, qershor 2008 dhe shkurt 2009, Prishtinë.
10. Intervistë me Muhamet Mavrajn, qershor 2008, Prishtinë

11. Sejdi Gega, mars prill, maj, 2008, Zvicër,
12. Xhevat Zeka, mars prill, maj, 2008, Zvicër
13. Ragip Shala, mars, prill, maj, 2008, Zvicër, shtator, dhjetor, 2008, Prishtinë, mars 2009, Prishtinë.
14. Beqir Beqa, mars prill, maj, 2008, Zvicër,
15. Murat Bytyqi, mars prill, maj, 2008, Zvicër,
16. Zenuni Bajrami, mars prill, maj, 2008, Zvicër,
17. Murat Jashari, mars prill, maj, 2008 Zvicër
18. Avdi Xhemajli, mars prill, maj, 2008 Zvicër
19. Haki Morina mars prill, maj, 2008
20. Shaban Muja, tetor, dhjetor, 2008, mars 2009, Prishtinë

V. Fejtonistika:

1. Koha ditore, fejton, në përkujtim të demonstratave të vitit 1981, 4 prill 2006,
2. Kosova Sot fejtoni çfarë tha udhëheqja kosovare për dem.1981, e hënë 15 mars 2007
3. Epoka e Re, Xhafer Durmishi, 25- vjetori i vrasjes së vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës, 25 janar 2007.
4. ZERI, „Fejton ekskluziv, Dokumente sekrete të Sekretariatit Federativ për punë të brendshme të RSFJ-së për Kosovën gjatë viteve 1983 – 1992, gazeta ditore 29 maj 2000
5. Zëri, Xhavit Haliti, Si e bëmë UÇK-në, fejton ekskluziv, , Prishtinë, 2003,
6. „Zëri” Fejton ekskluziv, Pesëvjetori i luftës në Kosovë, Xhavit Haliti, njëri ndër themeluesit e UÇK-së, e hënë, 24 mars 2003
7. “Epoka e re” Ibrahim Shala Prishtinë, 22.11. 2001, Botuar në vazhdime, 11-16 mars 2002, Prishtinë
8. ZËRI, Xhavit Haliti, Fejton ekskluziv, pesëvjetori i UÇK-së, gazeta ditore, , 31 mars 2003, Prishtinë.
9. Epoka e Re, Intervistë e Driton Lajçit, ish –udhëheqës i studentëve në vitin 1997, 1 tetor 2005